

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË

KDU: 94 (05)

K O S O V A

41
2016

**PRISHTINË
2016**

KRYEREDAKTOR

Prof. assoc. dr. Sabit SYLA

SEKRETAR I REDAKSISË

Dr. sc. Gjon BERISHA

REDAKSIA

Prof. assoc. dr. Sabit SYLA

Akademik Beqir META

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI - BASHA

Akademik assoc. Marenglen VERLI

Prof. dr. Pëllumb XHUFI

Prof. dr. Frashër DEMAJ

Prof. dr. Hamit KABA

Dr. sc. Gjon BERISHA

Dr. sc. Bedri MUHADRI

THE INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” - PRISHTINA

K O S O V A

41
2016

**PRISHTINA
2016**

PËRMBAJTJA-CONTENTS

Nermin BASHA

Dëshmi të hershme mbi Apoloninë.....	9
The earliest evidence on Apolonia	29

Ilir CULAJ

Disa aspekte të religjionit në Ulpianën antike	31
Some aspects of religion in ancient Ulpian	43

Teuta SHALA – PELI

Prania e etnonimit <i>Albanensis</i> në Raguzë gjatë mesjetës, sipas burimeve dokumentare.....	45
The presence of the ethnonym "Albanensis" in Ragusa during the middle ages based on documentary sources	51

Agron ISLAMI

Raja e Gjakovës sipas defterit të xhizjes të vitit 1750	53
The raya of Gjakova according to the defter of jizya of the year 1750.....	67

Fehari RAMADANI & Gjyla ÇELIKU

Shkollat Austro-hungareze në Vilajetin e Kosovës (1911-1912)	69
Austro-hungarian schools in the Vilayet of Kosova (1911-1912).....	77

Marenglen VERLI

Luhatjet e Fuqive të Mëdha dhe qëndrimi shqiptar pas Kongresit të Lushnjës.....	79
The volatility of the Great Powers and the Albanian position after the Congress of Lushnje	96

Hasan BELLO

Republikë apo monarki? Argumentet e deputetëve republikanë dhe monarkistë lidhur me formën e regjimit të shtetit shqiptar në vitin 1924.....	97
Republic or a monarchy ? Signs of deputies republicans and monarchist regime regarding the form of the Albanian state in 1924.....	116

Beqir META

Minoriteti bullgar (Maqedonas) në vitet 1925-1939.....	117
Bulgarian (Macedonian) minority in the years 1925 to 1939	140

Marbona CUKA

E drejta penale shqiptare në periudhën 1939-1945.....	141
The Albanian criminal law in the period of 1939-1945.....	150

Alban DOBRUNA

Bashkësia Islame e Gjakovës, gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945)	151
The Islamic community of Gjakova during World War II (1941-1945)	165

Çlirim DURO

Reforma arsimore e vitit 1946 në Shqipëri.....	167
The educational reform of 1946 in Albania	176

Mrika LIMANI

Një analizë kuantitative e viktimave të Prizrenit dhe rrethinës gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas listës së viktimave të luftës, lëshuar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë (I).....	177
A quantitative analysis of Prizren and surrounding victims during World War II, according to the list of the victims of war issued by the Federal Executive Council of Yugoslavia(I)	192

Sabile KEÇMEZI – BASHA

Dokumente të rëndësishme të Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, 1964.....	193
Important documents of the Revolutionary Movement on the Unification of Albanians, 1964	204

Shkodran IMERAJ

Referendumi për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, 26-30 shtator 1991, sipas gazetës "Bujku" në Kosovë	205
The referendum on Kosovo as a sovereign and independent state from 26 th to the 30 th of september 1991, according to the newspaper "Bujku" in Kosovo.....	219

Miftar KURTI

Zona Operative e Shalës dhe veprimtaria e saj luftarake	221
The Shala Operative Zone was one of seven operational zones of the Kosovo liberation army.....	239

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Hamit KABA

Të drejtat e njeriut në Jugosllavi (1983)243

Naser FERRI

Gjurmëve të një lajmi Shtatorja e parë e Nënës Terezë ishte ngritur
në Novosellë të Gjakovës261

RECENSIONE

Zef Mirdita, “Dardanci i Dardanija u antici”, Hrvatski institut za povijest
(biblioteka hrvatska povjesnica: monografije i studije III/67),
Zagreb 2015, 624 f.(Gjon BERISHA)..... 269

Teuta Shala-Peli, “Drishti në Mesjetë”, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-
Prishtinë, Prishtinë 2016, 345 f. (Gjon BERISHA).....279

Mitologjia Antike mes “Mjekësisë Hyjnore” dhe asaj profesioniste
Daniela Rigato, “Gli dei che guariscono: Asclepio e gli altri”,
Itinerari di storia antica/5, Patron Editore, Bologna 2013, f. 164.
(Naser FERRI).....285

IN MEMORIAM

Akademik Zef Mirdita (1936–2016) 293

Prof.dr.Tahir Abdyli (1942 -2015) 299

AKTIVITETE

Aktivitetet e Institutit të Historisë “Ali Hadri”- Prishtinë
gjatë vitit 2016 (Teuta SHALA-PELI).....301

Nermin BASHA

DËSHMI TË HERSHME MBI APOLONINË

Meqë mosmarrëveshjet e lindura prej disa vitesh nuk mundën t'i zgjidhnin përmes bisedimeve, mes Senatit Romak dhe Pompeut, nga njëra anë, dhe Cezarit, nga ana tjetër, shpërtheu konflikti i armatosur, që njihet në histori me emrin “Lufta civile”.

Vetë Cezari, shkurtimisht, por shumë qartë, ka paraqitur ngjarjet e ndodhura në veprën që ai e quajti “Commentari” (Shënime, komente), të përbërë nga tre libra, respektivisht me 87, 44 dhe 112 krerë. Mosmarrëveshjet e pazgjidhura, u kthyen në armiqësi të hapur mes këtyre dy figurave më të rëndësishme politike e ushtarake të Romës, që çuan në shpërthimin e përplasjes së ashpër, në vitin 48 para e. s. Cezari ndodhej në Gali, të cilën e kishte nënshtuar dhe paqëtuar pas një lufte dhjetëvjeçare. I shpallur “armik i atdheut” nga Senati Romak, ai kapërcen lumin e vogël Rubikon (sot Marekia), që ndante kufirin mes Italisë dhe Galisë, dhe, me një pjesë të vogël të ushtrisë, hyn në Itali, popullsia e së cilës e pranoi pa luftë. Me të mësuar këtë lajm, Pompeu dhe Senati largohen me ngut nga Roma, mbërrijnë në Brindizi dhe, që andej, hidhen në bregun tjetër të Adriatikut, duke synuar Durrësin, ku kishin grumbulluar tërë arsenalin e luftës.

Pa humbur kohë Cezari e ndoqi kundërshtarin e tij, të mirarmatosur dhe të mirëfurnizuar. Duke i shpëtuar përgjimit dhe ruajtjes së flotës pompejane, vendosur në Korfuz, Cezari i zbriti trupat e vet në bregdetin epirot të Shqipërisë së sotme, në një zonë shkëmbore dhe të vështirë, në Palasë të Himarës; me shpejtësinë që ka karakterizuar tërë veprimet e tij, pushtoi portin e Orikut, të Apolonisë dhe kërcënonte Durrësin. Këtu u zhvilluan dy betejat: Cezari nuk mundi ta shtinte në dorë Durrësin, madje u thye, por nuk u dorëzua. Pas kësaj, ai

zuri vend në zonën mes Durrësit e Apolonisë. Dy kundërshtarët i bënë trojet ilire teatër të veprimeve të tyre; emra malesh, lumenjsh, portesh, qytetesh fisesh, madje edhe bime për të gatuar bukë e mjaft të tjera, vijnë të emërtuara drejtpërsëdrejti ose të nënkuptuara në librin e tretë të veprës së Cezarit.

Nga çasti i zbarkimit të tij në bregdetin epirot, interesi i shkrimit cezarian në lidhje me shkencën e ilirologjisë, në veçanti, dhe atë albanologjike në përgjithësi, rritet, sepse Cezari, sado i kursyer, prapëseprapë na ka dhënë lëndë të vlefshme për historinë e moçme të trojeve tona. Prandaj, nga këndvështrimi ynë, libri III i veprës së Cezarit është parë si material me vlerë albanologjike në plotësimin e lëndës së historisë së lashtë të vendit tonë.

Në 67 nga 112 krerët e librit të tretë të “Luftës civile”, gjejmë të njoftuara drejtpërsëdrejti ose të nënkuptuara emra qytetesh, vendesh, fisesh, malesh, lumenjsh të trojeve të Ilirisë e të Epirit në kohën e zhvillimit të ngjarjeve dhe, mes paraqitjes tepër të shkurtër nga autori, mund të mësosh për qëndrimin e popullsisë ndaj komandantëve romakë, për gjendjen e rrugëve dhe të komunikacionit, në përgjithësi, për gjendjen e fushave dhe prodhimtarinë e tyre, për dendurinë e popullsisë, për bimësinë e vendit, për blegtorinë, e mjaft njoftime të tjera. Në këtë paraqitje, ne do të ndalemi vetëm në përmendjen e emrit të qytetit Apolonia (sot fshati Pojan), lëndë që do të pasurohet e plotësohet edhe me shkrime të autorëve të tjerë, para e pas Cezarit. Autori e ka përmendur 9 herë emrin Apolonia, konkretisht në krerët: 5, 11, 12, 13, 26, 30, 75, 78, 79. Për mundësitë e një reviste, në shkrimin tonë do të ndalemi në disa fragmente të një pjese të këtyre krerëve. Përkthimi i atij fragmenti ku gjenden këto përmendje të Cezarit do të jepet i plotë, ndërsa, në fund të faqes, do të jepet po ky fragment në gjuhën latine.

Kreu 5: *...(Pompeu) kishte vendosur të dimëronte në Dyrrah, në Apoloni dhe në të gjitha qytetet bregdetare, me qëllim që të pengonte Cezarin të kapërcente detin dhe, për këtë arsye, kishte hapërdarë flotën përgjatë tërë bregdetit.*¹

Pas Dyrrahut (sot Durrësi), qyteti tjetër ku kishte vendosur të dimëronte Pompeu, ishte Apolonia, dhe kjo, me një qëllim të mirëstudiuar nga ana e tij. Apolonia, “dikur vendbanim i njohur i

¹ *...Hiemare Dyrrachii, Apolloniae omnibusque oppidis maritimis constituerat, ut mare transire Caesarem prohiberet, eiusque rei causa omni ora maritima classem disposuerat. Cesare, “De bello civili”, liber tertius, Milano 1938, f.27*

shkencës dhe i mençurisë, nga ku merrnin të gjithë mend...”², ashtu si edhe Dyrrahu, qe teatër i luftës mes dy romakëve të fuqishëm të kohës. Ajo bën pjesë në grupin e qyteteve të rëndësishme të kohës së ngjarjeve, themeluar në vitin 558 para e. s., madje, sipas disa të dhënave të tjera, rreth vitit 600 para e. s. Megjithëse, në të vërtetë, Apolonia, e themeluar shumë më herët nga banorët pellazgë, mendohet “të ketë qenë zgjeruar dhe zbukuruar prej kolonëve nga Korinti dhe Korfuzi”. Duke kaluar nëpër zonën e bregdetit, duke zbritur poshtë Dyrrahut, “më pas vjen lumi Aps dhe Aos, mbi të cilin është ndërtuar Apolonia, një qytet me ligje shumë të mira, ndërtuar nga korinthatit e nga korkyrasit; ky qytet është larg lumit dhjetë stade (178 m.) dhe nga deti gjashtëdhjetë”.³

Apolonia, pra, qe koloni, e ndërtuar në vazhdimin e traditës që grekët e lashtë krijuan qysh nga shekulli VIII para e. s., për të themeluar koloni tregtare në shumë qendra bregdetare të Mesdheut dhe të Detit të Zi. Këto koloni greke u ngritën pranë qendrave të banuara nga popullsia vendase, si e dëshmon, veç të tjerash, edhe muri që rrethon qytetin, mur, që, në disa vende, qe vazhdim i themeleve të murit që i takon një vendbanimi të lashtë të fillimit të mijëvjeçarit të parë, para ngulimeve helene. Zona e Apolonisë ishte e banuar nga një popullsi ilire, kur erdhën e u vendosën atje një grup prej 200 “kolonistësh” grekë nga Korinthi e Korcira.⁴ Emrin ia vunë kolonistët. Apoloni konsiderohej mbrojtësi i kolonistëve. Prandaj, si duket, ata i vunë emrin e hyjit.

Kishte mbi 30 qytete antike me këtë emër dhe qyteti ynë dallohej nga cilësimi “Apolonia e Ilirisë”, ose “Apolonia e Jonit”, ose “Apolonia e Epirit”. Shumë ngjarje e ushtri nga më të ndryshmet pa Apolonia dhe popullsia e saj, që mbajti mbi kurriz thundrën e tyre, qoftë edhe kalimthi. Mbretërit maqedonas i kanë lakmuar vazhdimisht qytetet bregdetare të Ilirisë, kështu edhe Apoloninë. Në vitin 314 para e. s., ushtria e mbretit maqedon, Kasandër, e pushtoi Apoloninë, të cilën, pas dy vjetësh, falë kryengritjes së apolonianëve, të ndihmuar nga fqinjët e tjerë ilirë, u detyrua ta lëshonte. Përsëri ndeshen apolonianët me mbretin tjetër maqedon, Filipin, për të mbrojtur lirinë e tyre dhe deri tek ne ka

² Pukëvil, “Në oborin e Vezirit të Janinës”, kreu V, bregdeti shqiptar, nga Vjosa ne veri deri në Drino ose Drilo, që e ndan nga Scutari ose Scodra. -Apolonia. -Berati. -Lumenjtë Aous, Apsus, Genusus. -Durazzo. -Croia. -Alessio. Tiranë 1999, f. 84.

³ Strabonis, “Geographica”, libri VII, kreu 8 (εἰς ὃ Ἄψος ποταμὸς καὶ ὁ Ἄωος, ἐφ’ Ἀπολλονία πόλιν εὐνομοτάτη κτίσμα Κορινθίων καὶ Κερκυραίων, τοῦ ποταμοῦ μὲν ἀπέχουσα σταδίων δέκα, τῆς θαλάττης δὲ ἐξήκοντα.)

⁴ Shaban Demiraj, Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët, Tiranë 2008, f. 97

mbërritur njoftimi i Tit Livit, sipas të cilit: “Filipi shkretoi tokat e apolonianëve dhe, si iu afrua mureve, i ftoi romakët për luftë”.⁵ Si thyen Hanibalin në vitin 201 para e. s., romakët iu kthyen Filipit të Maqedonisë dhe goditjen vendosën t’ia japin nga Iliria. Në vjeshtën e vitit 200 para e. s., dy legjione zbritën në Apoloni dhe ngritën lëmin në afërsi të lumit Aps. Këtej filloi sulmi kundër pozitive të Filipit në Dasareti.⁶ Madje ishte pikërisht konsull Sulspici, i cili kishte vendosur fushimin e tij mes Apolonisë dhe Dyrrahut, në brigjet e lumit Aps.

Vazhdimisht zona mes këtyre dy qyteteve kishte shërbyer si pikë zbarkimi për ushtritë romake. Në vitin 229 para e. s., në kohën e luftës iliro-romake, Apolonia kishte marrë anën e romakëve. Më vonë, në pranverën e vitit 168 para e. s., Ap Klaudi kishte futur në ushtrinë e tij trupa ndihmëse të rekrutuara te Bylinët, në Apoloni dhe në Dyrrah, njoftim ky që na vjen nga Tit Livi.⁷ Më pas, pretor Anici, i caktuar për të zëvendësuar Ap Klaudin, arrin në Apoloni, bashkohet me ushtrinë në brigjet e lumit Genus dhe i shton trupa ndihmëse parthine që i kishte tashmë me vete, 2 000 këmbësorë, (të komanduara nga Epikadi, i cili mban një emër vendas) dhe 200 kalorës.⁸ Para e përgjatë kësaj periudhe historike, ushtri të shumta zbarkuan e fushuan në këto troje, veçanërisht në zonën mes Dyrrahut e Apolonisë për të vazhduar, më pas, edhe në brendësi të Ilirisë, të Epirit e për të shkuar në Tesali, Maqedoni etj.

Këto ecejake të ushtrive e, bashkë me to edhe të tregtarëve të skllevërve e të mallrave, krijuan më shumë të ardhura dhe mbarësi për këto qytete dhe zonat përreth. Qyteti u rrit e u zhvillua, si një qytet i madh me një sipërfaqe mbi 130 hektarë, falë afrisë me detin, falë vendosjes pranë dy lumenjve, falë pasurive të saj, tokave e kullotave të shumta e pjellore. Plini shkruan se në tokën e Apolonisë gjendet mineral sere ose ka edhe një përzierje natyrale pisë-asfalt, prej pisës dhe asfaltit

⁵ T. Livii, “*Ab Urbe condita*”, libri XXIX, kreu 12 (*Philippus agros Apolloniatium uastavit et ad urbem admotis copiis potestatem pugnae Romano fecit*)

⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, I (Tiranë: Akademia e Shkenca e Shqipërisë, 2002), 127.

⁷ T. Livii, “*Ab Urbe condita*”, tomos quintus, libri XLIV, caput XXVI, Bassani, 1778f. 37 (*Jam Ap Claudius, adsumptis ad eum exercitum quem habebat, Bulinorum et Apolloniatium et Dyrrhachinorum auxiliis, profectus ex hibernis circa Genusum amnem castra habebat.* - Tashmë Ap Klaudi, si i bashkon ushtrisë së tij trupa ndihmëse nga bulinët, apolloniatët dhe dyrrahasit, u nis prej vendqëndrimeve dimërore për të shkuar te lëmi pranë lumit Genus).

⁸ Pierre Cabanes et Faik Drini, “*Etydes epigraphiques 2, Corpus des iscriptions grecques d’Illyrie meridionale et d’Epire. Epidamne-Dyrrhachion et Apollonia*”, Ecole Française d’Athenes 1995, f. 42.

që del nga tokat e Apolonisë.⁹ Eliani e zgjeron më shumë paraqitjen e tij për këtë pasuri: “Apolonianët banojnë në një qytet fqinjë me Epidamnin, në gjirin jonian. Dhe në vende shumë afër Apolonisë shihen miniera bitumi, që nxirret nga toka duke gërmuar; po ashtu është plot me burime uji. Jo larg shkëlqen një zjarr i përjetshëm. Por, kodra që digjet nuk është e lartë; ajo ka një rreth të ngushtë; mban erë squfuri e shapi dhe rreth saj ka gjelbërim dhe bimë që lulëzojnë vazhdimisht; zjarri që del me vrull aty pranë, nuk dëmton aspak mbirjen e bimëve, as gjelbërimin; sipas apolonianëve, zjarri nuk pushon së djeguri ditë e natë pa pushim...”¹⁰

Ky zjarr vazhdoi të digjej pa ndërprerje; dëshminë e fundit për të e jep historiani Dion Kasi.¹¹ Për më tepër, aty pranë zhvilloheshin herëpashere lojëra e festa sportive, ku vinin atletë edhe nga vendet fqinjë. Shumë vjet më vonë, më 1806, Pukëvili e ka shkelur këtë vend të bukur e begatë “që përfshin një pjesë të territorit të vjetër të Apolonisë dhe minierat apo shtresat e njohura të bitumit, që zëvendëson të gjitha rrëshirat bimore. Shtresat e bitumit ndodhen në një kënd të formuar nga derdhja e Shushicës në Vjosë, në të majtë të saj ose të pjesës jugore. Shtresat bituminoze duken se shtrihen në një largësi të konsiderueshme drejt juglindjes dhe mund të ketë rezerva të tilla që mund të furnizojnë

⁹ C. Plini Secundi, “*Naturalis Historiae*”, te “*Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*”, libri XXIV, Tiranë 1965, f. 199.

¹⁰ Claudii Aeliani, “*Varia historia*” libri XIII, kreu 16 (*Apolloniatae finitimam Epidamno urbem in situ ionico positam incolunt, & ex propinquis locis bituminis fodinae conspiciuntur, quod e terra erumpens eodem modo, quo pleriq; fontium, locum replet. Non longis immortalis ignis elucet. Est autem exiguus quidam collis ardens, no admodum altus, circuitu no magno, qui sulphur, & alumen redolet. Circa ipsum floridae arbores, & pleriq; virides, a, quibus germinantibus, & iam adultis ignis noctu, & interdiu sine ulla intermissione ardens abstinet*) Klaud Eliani jetoj nga viti 170 deri në vitin 235 para e. s. Nga vepra e përmendur kanë mbetur 17 libra, kurse vepra tjetër e tij titullohet “*De animalium natura*”, të dyja këto vepra kanë rëndësi për ne, sepse përmblajnë të dhëna interesante mbi faunën e florën e Ilirisë, mbi pasurinë me asfalt të Apolonisë, mbi disa zakone të ilirëve, etj.

¹¹ Dionis Cassii Cocceiani, “*Historia romana*” në “*Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*”, libri XLI, kreu 45, Tiranë 1965, f. 273. Autori jep këtë përshkrim për Nymfeun e Apolonisë, që arkeologët e vendosin pranë fshatit të sotëm, Frakulla: “Por ajo që më çudit më shumë se çdo gjë tjetër është një zjarr i madh që del pranë lumit Ana dhe që nuk përhapet më tepër se në tokën rreth e rrotull dhe as atë, në të cilën del e qëndron, nuk e djeg në një farë mënyrë, por përkundrazi atje, bile shumë afër tij, ka edhe gjelbërim dhe pemë që lulëzojnë; përveç kësaj, kur bie shi, ky zjarr shtohet edhe ngrihet më lart. Për këtë, ky vend quhet Nymfe dhe madje këtu ka pasur edhe një orakull”.

të gjithë Evropën...Njerëzit e këtyre anëve pohojnë se, pothuajse çdo natë, dallojnë vezullime mbi sipërfaqen e tokës - rrethana që janë vënë në dukje nga Aristoteli dhe shkrimtarë të tjerë të kohëve të lashta, që i adresohen Nymphaeut të përshkruar nga Plutarku në veprën e tij, kushtuar jetës së Sulës. “Pranë Apolonisë, (gjashtë milje në juglindje), ndodhet Nymphaeum, një vend i shenjtë, ku shfaqen pa pushim vezullime të zjarra, pa konsumuar bimësinë në mes të luginës së gjelbër dhe kullotës”.¹²

Dy shekuj pas ngritjes, qyteti mori formë të plotë me mure rrethuese, me akropol, me akademi, me faltore, me teatër, me banesa pasanikësh, me shëtitore të zbukuruara me monumente, me monedhën e vet dhe me marrëdhëniet tregtare e kulturore që kishte me Atikën dhe viset italice; u bë qendër e rëndësishme për studime në arkitekturë, në skulpturë, retorikë e filozofi, ku vinin edhe djemtë e aristokracisë romake. Të gjitha këto ndërtesa e monumente, të zgjidhura dhe të harmonizuara nga ana arkitektonike, i jepnin Apolonisë një shkëlqim të rrallë që e bënin të dallohej nga të tjerët. Ciceroni e quan “qytet të madh e hijerëndë”,¹³ “qytet me ligje të mrekullueshme”, shumë të zhvilluar sa, “kur luftërat civile përfunduan, me qëllim që të formonte shpirtin e këtij djaloshi të veçantë (Oktavian Augustit) në shkencat liberale, (Cezari) e dërgoi në shkollat e Apolonisë për studime”.¹⁴

Këtë njoftim, veç Vellej Paterkolit, na e jep edhe Svetoni, kur flet mbi jetën e perandorëve, ku, duke na njohur me Apoloninë e atëhershme për shkak të zhvillimeve që ajo pati, ne mësojmë për këtë qytet si një qendër e madhe arsimore-shkencore në lashtësi, fakt për të cilin flet edhe vetë qëndrimi i Cezarit, njeriut më të fuqishëm të kohës, i cili, nipin e vet, pasardhësin e caktuar të pushtetit të tij, e dërgon mu në Apoloninë e Ilirisë, për të ndjekur studimet. “Cezari e dërgoi Oktavianin qysh më parë në Apoloni që të jepej pas studimeve”. E jo vetëm kaq,

¹² Pukëvil, “Në oborrin e Vezirit të Janinës”, *Shënime udhëtime*, shkruar 200 vjet më parë, kreu IV, *Akrokeraunet ose Rajoni Malor i Himarës*, Tiranë 1999, f. 77.

¹³ M. Tulli Ciceronis, “*Oratio Philippica undecima*”, kreu 26 (.. *qui tenet Apolloniam, magnam urbem et gravem.*)

¹⁴ C. Velleius Paterculus, “*Historiae romanae*”, liber posterior, kreu 59 (*Et patris bellis civilibus ad erudiendum liberalibus disciplinis singularis indolem iuvenis Apolloniam eum in studio miserat.*) Vellej Paterkuli është përfaqësues i letërsisë së oborrit perandorak. Lindi në Kapua rreth viti 19 para e.s. dhe vdiq pas viti 31 të e. s. Shkroi veprën “*Historia romake*” në dy libra; në këtë vepër gjejmë të dhëna mbi luftën e ilirëve të veriut kundër pushtimit romak, veçanërisht, mbi kryengritjet e viteve 6-9 të e. s.

sepse Oktaviani “i kushtoi gjuhës e letërsisë greke një kujdes jo të vogël, duke arritur këtu edhe suksese me rëndësi. Mësuesi i tij i stilistikës dhe i gojëtarisë greke ka qenë Apollidori nga Pergami, të cilin, ai, kur ishte akoma djalosh, megjithëse Apollidori ishte i thyer nga mosha, e mori me vete kur u nis prej Rome në Apoloni... Gjatë qëndrimit të vetmuar në Apoloni, një ditë, i shoqëruar nga Agripa, hipi në observatorin e astrologut Theogen.¹⁵ Madje në këtë qytet ishte Oktaviani, djali i motrës i birësuar nga Cezari, kur ky binte në Romë nga 23 goditjet e thikave të përбетusve. Apolonia (e rrëguar sot në fshatin Pojan) pranë grykës së Semanit, ishte konkurreuese e Durrësit; ajo qe qendër studimesh, së cilës Roma i dha mësues të shquar e me kulturë, dhe i riu Oktavian studioi këtu retorikë.¹⁶ Një përshkrim të Apolonisë ka dhënë edhe Pukëvili, që shkruan se në bregun tjetër të lumit ndodhej fshati mjaft i madh i Fierit dhe një milje në perëndim ishte manastiri i Shën Mërisë së Polinës, në vendin e Apolonisë antike, i vetmi vend i banuar i kësaj treve, dikur të shenjtë për Apolonin. “Duken monumentet e qytetit, të ngritur nga Apollo, drejt kufijve të detit Jon”.

Kështu, sipas Pausanias, ishte mbishkrimi i gdhendur me shkronja antike në piedestalin e statujës së zotit të ditës. Një kishë e rrethuar me disa qeli, karakteristike për manastiret, dhe e mbyllur e gjitha me mure, e përshtatshme për dymbëdhjetë murgj, dëshmon tani Apoloninë e dikurshme të madhe dhe të nderuar, qytet i preferuar i Jul Cezarit dhe vendi i zgjedhur për edukimin e nipit të tij të madh, Augustit. Në hapësirën e mësipërme të zënë nga Apolonia, duken shenja, si: kolona të thyera, afreske dhe shkronja kapitale, tulla, ku shënohen numrat e atyre legjioneve romake, të cilët i kanë shkruar ato... Në një lartësi aty pranë ndodhet një kolonë e vetme e stilit dorik. Kjo është e vetmja pjesë ku qëndron në këmbë një tempull... Midis rrënojave të kësaj godine, në vitin 1813, u zbulua statuja e Dianës dhe, disa vite më vonë, po në të njëjtin vend, u zbulua një basoreliev që përfaqësonte Apolonin të ulur në një karrocë të tërhequr nga kuajt, pamje kjo e paraqitur nga Pusini në një nga pikturat e tij. Në rrënojat e këtij qyteti janë zbuluar një sërë medaljesh, që, pothuajse të gjitha, mbajnë kokën e Apolonit, brirë të stolisur me rrush dhe gjethe rrushi. Janë gjetur stoli të ngjashme që përfaqësojnë Apolonin me lirën e tij”.¹⁷ Sipas Prashniker

¹⁵ C. Svetoni Tranquilli, “*De vita Caesarum- Divus Augustus*”, te “*Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*”, libri II, kreu 89 dhe 94, Tiranë 1965, f. 214- 215.

¹⁶ Antonio Baldacci, “*L’Albania*”, Roma 1929, f. 226.

¹⁷ Pukëvil, “*Në oborrin e Vezirit të Janinës*”, Shënime udhëtimi, shkruar 200 vjet më

dhe Shober, një gërmim në Apoloni premtonte shumë sukses. Në ndryshim nga Dyrrahium, që ka qenë banuar pa ndërprerje dhe dëshmitë e antikitetit janë përzier pothuajse vazhdimisht, Apolonia është braktisur në fund të periudhës antike. Po sipas këtyre arkeologëve, në fshatrat Pojan dhe Sop, duhen pritur dëshmi të shumta ndërtimesh të të gjitha periudhave të antikitetit, mbasi qyteti ka luajtur rol të rëndësishëm gjatë tërë antikitetit, që nga themelimi i tij, dhe, në kohën perandorake, ai vazhdon të lulëzojë si qytet universitar i frekuentuar shumë nga rinia romake.¹⁸ Si port i madh detar, Apolonisë i shërbente Vlora. Apolonia, duke qenë në lidhje të ngushtë me Korfuzin (Korkyrën) e me Durrësin dhe në kontakt me Bylisin e Amantian, ekskluzivisht aristokratike, u bë qendër shpirtërore e kolonive të shumta helene të lindjes dhe të jugut, për të cilat sot na flasin shumë rrënoja e vetëm disa emra.¹⁹ Edhe ky qytet i ofronte bollëk e rehati Pompeut, po mbi të gjitha ai ishte pranë bregdetit, që Pompeu, ashtu si gjithë portet e limanet, me fanatizëm e mbante në duart e veta për të mos lejuar Cezarin të bregëzonte.

Kreu 11: *Mbasi i parashtroi propozimet e Cezarit në prani të komandantëve të flotës në Korcirë, Vibuli mendoi se ishte shumë e nevojshme që t'i kumtonte Pompeut mbërritjen e papritur të Cezarit, me qëllim që ai të mund të merrte masat e duhura për këtë çështje, përpara se të fillohej shqyrtimi i propozimeve për paqe, prandaj, duke udhëtuar ditë e natë dhe duke ndërruar kafshët e barrës (mushkat) në të gjitha qytetet për shpejtësi më të madhe, u drejtua kah Pompeu që ta lajmëronte se Cezari ishte afër. Në këtë kohë Pompeu ndodhej në Kandavi dhe, nga Maqedonia, po nisej drejt Apolonisë dhe Dyrrahut, për në vendqëndrimet dimërore. Por, i shqetësuar nga ky lajm befasues, përpiqet të mbërrijë në Apoloni me marshim të përshpejtuar, me qëllim që të pengonte Cezarin të pushtonte qytetet bregdetare.*²⁰

parë, kreu V, *Bregdeti shqiptar, nga Vjosa në veri deri në Drino ose Drilo, që e ndan nga Scutari ose Scodra. - Apollonia, Berati. - Lumenjtë Aous, Apsus, Genusus. - Durrazzo. - Croia. - Alessio, Tiranë 1999, f. 83 dhe 84,*

¹⁸ C. Praschniker und A. Schober, *“Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro”*, Vjenë 1919, f. 71. Po në këtë faqe dy autorët shënojnë se në luginën e Kryegjatës, Leake ka parë gërmadhat e një tempulli jonik, i zhdukur krejt nga Ibrahim Pasha, i cili në fillim të shekullit XIX, ka marrë këtu 70 karroca me material guri dhe i ka dërguar në Berat për të ndërtuar sarajet e reja.

¹⁹ Milan Shuflaj, *“Serbët dhe shqiptarët”*, Tiranë 2004, f. 6.

²⁰ Vibullius, *his expositis, non minus necessarium esse existimavit de repentino adventu Caesaris Pompeium fieri certiolem, uti ad id consilium capere posset, ante quam de mandatis agi inciperetur, atque ideo continuato nocte ac die itinere atque*

Kreu 12: Si shtiu në dorë Orikumin, pa asnjë vonesë, Cezari niset drejt Apolonisë. Luc Staberi, që komandonte këtu, nxitoi të çonte ujë në fortesë, ta fortifikonte dhe t'u kërkonte pengje apolonianëve. Por banorët (e Apolonisë) iu përgjigjën se nuk do t'i jepnin pengje, se nuk do t'ia mbyllnin portat para syve konsullit, se nuk do të merrnin vendime të ndryshme nga gjithë Italia dhe populli romak. Si mësoi vullnetin e këtyre, Staberi doli tinëz nga Apolonia. Apolonianët dërgojnë përfaqësues te Cezari dhe e presin në portat e qytetit. Shembullin e tyre e ndjekin Bylinët, Amantinët, qytetet e tjera të afërta e gjithë Epiri dhe, si nisin përfaqësi te Cezari, e sigurojnë se do ta përkrahnin.²¹

Para luftës me Teutën, Roma nuk ka pasur zotërime të mirëfillta në Iliri. Por, para Luftës së Parë Punike, Apolonia kishte kërkuar mbrojtjen e Romës. Meqë në vitin 264 para e. s., dy senatorë romakë, Fabrici dhe Aproni, kishin fyer ambasadorin e dërguar në Romë nga Apolonia, Senati ua dërgoi ata të dy, si kriminelë, apolonianëve, që t'u jepej ndëshkimi prej vetë atyre sipas dëshirës së qytetit. Por, pavarësisht dënimit, Apolonia u bëri një pritje të mirë senatorëve romakë dhe i nisi përsëri me shumë nderime. Në vitin 228 para e. s., romakët kishin pushtuar dhe mbanin në Iliri një territor të konsiderueshëm, mes të tjerash, Apoloninë, Dyrrahun, Lisin.

Në këtë çast të ngjarjeve, në vitin 48 para e. s., Iliria kishte rënë nën sundimin romak; viset ilire shërbenin, pos të tjerash, edhe për rekrutime trupash. Si Cezari, edhe Pompeu, përpiqej të fitonte përkrahjen dhe mbështetjen e garnizoneve të vendosura aty, si edhe të popullsisë vendase, që do të mbushte radhët e ushtrisë së tyre me trupa, por do të shërbente edhe si bazë për furnizimin e ushtrisë. Orikumi,

omnibus oppidis mutatis ad celeritatem iumentis ad Pompeium contendit, ut adesse Caesarem nuntiaret. Pompeius erat eo tempore in Candavia iterque ex Macedonia in hiberna Apolloniam Dyrrachiumque habebat. Sed re nova perturbatus maioribus itineribus Apolloniam petere coepit, ne Caesar orae maritimae civitates occuparet. ...Cesare, "De bello civili", Milano 1938, f. 36.

²¹ *Recepto Caesar Orico nulla interposita mora Apollonian proficiscitur. Eius adventu auditu Luc Staberius, qui ibi praeerat, aquam comportare in arcem atque eam munire obsidesque ab Apolloniatibus exigere coepit. Illi vero daturos se negare neque portas consuli praeclusuros neque sibi iudicium sumpturos contra, atque omnis Italia iudicavisset. Quorum cognita voluntate clam profugit Apollonia Staberius. Illi ad Caesarem legatos mittunt oppidoque recipiunt. Hos sequuntur Byllidenses, Amantini et reliquae finitimae civitates totaque Epirus et legatis as Caesarem missis, quae imperaret, facturos pollicentur. Cesare, "De bello civili", Milano 1938, f. 38.*

limani “pyjor” i Akrokerauneve²² në fund të radës së Vlorës, shumë i frekuentuar nga grekët përpara e nga romakët, më pas, në lidhjet e tyre me Lindjen, i pushtuar nga Filipi V në vitin 214 para e. s., ra pastaj në dorë të romakëve. Në Orikum, Paul Emili imbarkoi ushtrinë e tij për Itali në vitin 167 para e. s. Cezari e zotëroi Orikumin në marshimin e tij në vitin 48 para e. s., nga Paleste (sot Palasa) drejt lumit Aos dhe këtu, po Cezari çarmatosi flotën e tij në luftën kundër Pompeut; zona është e famshme për dru ndërtimi.²³ Cezari e shtiu në dorë Orikumin pa luftë, sepse e përkrahu edhe garnizoni, edhe banorët.

Nga Orikumi, ku nuk harxhoi veçse disa pak orë, Cezari niset vrik në drejtim të Apolonisë, 55 km larg. Nxitimi lidhej me dëshirën dhe planin e strategut romak për ta shtënë në dorë qytetin e madh të Apolonisë me anë të befasisë së sulmit të tij. Gjithmonë Apolonia dhe fushat e saj kishin qenë pika të rëndësishme strategjike, kishin qenë vendi prej nga ushtritë e huaja kishin hyrë në trojet ilire, pos të tjerash për të kaluar edhe në vendet fqinje. Tit Livi, në një pjesë të veprës së tij, na përçon: “ Bashkë me ata, P. Licini erdhi në Brindizi pranë ushtrisë dhe, prej andej, bashkë me të gjitha forcat, i transportuar kah Nymfeu, i nguli shatorret në truallin Apoloniati”.²⁴ Madje, edhe flota mund të qëndronte pranë brigjeve Apoloniane, sepse atëkohë edhe lumi Aos (sot Vjosa) ishte më pranë Apolonisë. Përsëri Tit Livi na përcjell: “Bashkë me flotën qëndronte pranë bregut, jo fort larg Apolonisë”.²⁵ Edhe në kohën e ngjarjeve tona, Cezari e njihte rëndësinë e këtij qyteti, madje, të gjithë kësaj zone. Prandaj, pas një marshimi të jashtëzakonshëm, përmes një rruge të vështirë për t’u kapërcyer, përgjatë malesh që anësojnë nga lindja gjirin e Aulonës (sot Vlora), me dy net pa pushim, studiuesit mendojnë se Cezari do t’i ketë lënë trupat të pushojnë një natë dhe, menjëherë, të vihen në marshim përsëri, në një terren të zënë nga

²² Sipas Karl Patsch, “*Das Sandschak Berat in Albanien*”, Vjenë 1904, Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë, f. 22, këto male nuk ishin vetëm të pasura në drurë të ndryshëm, por edhe në vitin 1900 gëlonin nga kafshët. Përmes ditarit të tij, ai na përcjell se “gjëja në Akrokeraune është shumë e pasur. Kudo ka kaproj, dhi të egra. Të shumtë janë çakajtë, ujëqit dhe derrat e egër. Ka lepuj, thëllëza, pëllumba të egër, shapka, gada lumi dhe rosa të egra, kurse në zonën e ulët ka tufa të mëdha dhensh e dhish”.

²³ Antonio Baldacci, “*L’Albania*”, Roma 1929, f. 402

²⁴ T. Livii, “*Ab Urbe condita*”, tomus quartus, libri XLII, caput XXXIX, Bassani MDCCCLXXXVIII, f. 403 (*Cum iis P. Licinius Brundisium ad exercitum, atque inde cum omnibus copiis transvectus ad Nympheum, in Apolloniati agro posuit castra*).

²⁵ T. Livii, “*Ab Urbe condita*”, tomus quintus, libri XLIV, caput XXVI, Bassani MDCCCLXXXVIII, f. 38 (*Tum classis ad oram haud procul Apollonia stabat.*)

përmbytjet dimërore, me një largësi më të madhe nga pika mbërritëse, përfshirë këtu edhe kalimin e vështirë të një lumi. Edhe po të fuste lehtë në dorë Apoloninë, si edhe ndodhi, prapëseprapë Cezari ishte larg qëllimit ku synonte. Pas Apolonisë, përpara tij kishte marshimin drejt Dyrrahut. Cezari nuk humbi kohë, madje, te shpejtësia e veprimeve qëndronte një nga arsyet kryesore të fitoreve të tij; pa u vonuar, nëpër rrugë të llumta nga përmbytjet dimërore, me marshime ditore përmes rrugësh në terren të butë dhe pas kalimit të lumit Aos, ai nxiton drejt asaj zone me rëndësi për çdo luftë në Shqipëri, që zbulon me kontrastet e veta, gjithë karakterin e vendit, drejt qytetit të pasur tregtar të Apolonisë, me pjesën e saj të lartë që ngrihet mbi dy kodrat, me muret e saj, faltoret dhe portin e saj të lulëzuar,²⁶ niset drejt asaj Apolonie, e quajtur korinthase, që ndodhet në një vend të bukur të tokës dhe të detit, në një vend shumë të bukur lumenjsh,²⁷ ku duhet të ketë arritur pas dy ditësh. Kjo gjë përputhet edhe nga sa lexojmë më poshtë, sepse puna që bëri komandanti pompejan në fortesë dhe në mure, nuk shkonte më shumë se dy ditë. Si lexohet në këtë kaptinë, me afrimin e Cezarit pranë Apolonisë, komandanti pompejan, Staberi, çon ujë në “arx”, pra, në fortesë, që ishte vend i përshtatshëm për mbrojtje, dhe e fortifikon.

Përmes kësaj paraqitjeje ne mësojmë që, edhe në kohën e Cezarit, qyteti përbëhej nga një pjesë e lartë, më e vogël, dhe nga një pjesë e ulët, më e shtrirë. Pikërisht, në pjesën e lartë ndodhej akropoli, maja më e lartë e qytetit, i përshtatshëm për mbrojtje. Deri atë kohë kjo fortesë, në pjesën më të madhe të saj, ishte e mbuluar nga vepra arti.²⁸ Nga mesi i shekullit XIX, në vitin 1854, Apolonia vizitohet nga Hahn, kurse në 1876-1877 kemi misionin e kryer nga Leon Hëze, Daumet dhe shënimet e A. Gillieronit. Hëze nuk i kushtoi veçse një ditë vizitës në vendndodhjen e Apolonisë dhe një pjesë të asaj kohe ia ka kushtuar sigurimit të skulpturave për Muzeun e Luvrit.²⁹ Gillieron bën një

²⁶ Giorgio Veith, “*La campagna di Durazzo fra Cesare e Pompeo*”, Roma 1942, f. 62.

²⁷ Dionis Cassi Cocceiani, “*Historia romake*” te “*Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*”, libri XLI, kreu 44, Tiranë 1965, f. 273.

²⁸ Giorgio Veith, “*La campagna di Durazzo fra Cesare e Pompeo*”, Roma 1942, f. 33.

²⁹ Pierre Cabanes et Faik Drini, “*Etydes epigraphiques 2. Corpus des inscriptions grecques d’Illyrie méridionale et d’Epire. Inscriptions d’Epidamne-Dyrrachion*”, *Ecole Française d’Athenes*, 1995, f. 14. Në qershor të vitit 1900, pas udhëtimit të bërë nëpër Shqipërinë e asaj kohe, Karl Patsch, në veprën e tij, “*Das Sandschak Berat in Albanien-Sanxhaku i Beratit në Shqipëri*”, Vjenë 1904, Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë, f. 34, shkruan se po atë muaj ai kishte pasur mundësinë të shihte skulpturat

përshkrim të Apolonisë, ku, mes të tjerash, thotë se ka parë kolonën Stouladi (Shtyllas) “një kolonë e madhe e veçuar, me 7 m lartësi dhe kapitel dorik, më e vjetër se ajo e Partenonit”.³⁰ Për nga pasuria e madhe arkeologjike që ruan, Apolonia mund të quhet Pompei i Shqipërisë. E vendosur në një peizazh që pak ka ndryshuar nga lashtësia, Apolonia të magjeps në kombinimin e monumenteve me natyrën e virgjër, duke të tërhequr për orë të tëra 2 000 vjet larg të sotmes në një atmosferë çlodhjeje dhe meditimi.³¹

Gërmimi i parë i vërtetë arkeologjik në Apoloni u bë në vitin 1916,³² nga një repart ushtarak nën drejtimin e arkeologut austriak Prashniker, i cili, mjaft objekte të gjetura prej tyre ose të ruajtura ndër shekuj prej fshatarëve, i transportoi në muzen e Vjenës. Gërmimet kanë zbuluar veprat e artit të këtij qyteti; agora, që datohet në shekullin IV para e. s., e ndërtuar sipas stilit grek: një shesh i hapur, me kolona dhe i shtruar, i rrethuar me dyqane dhe ndërtesa publike, e hapur nga perëndimi, duke dhënë kështu një pamje të mrekullueshme mbi fushën e Myzeqesë deri në detin Adriatik. Më 1924, francezi Leon Rei vazhdoi me gërmimet, duke bërë zbulime të mirëfillta, shumë të rëndësishme: shtëpi të mëdha, shtatë nike (stele, kamare) të portikut të madh, më vonë edhe shtatë të tjera, përsëri të portikut, dhe shumë statuja të periudhës perandorake, bazorelieve, odeonin, santuarin e vogël, gjimnazin dhe mjaft pjesë të murit rrethues. Pesë breza arkeologësh gjatë një shekulli i janë përkushtuar Apolonisë. Ajo çka ata kanë zbuluar përbën jo më shumë se 5% të sipërfaqes së qytetit të lashtë dhe duket se proverbi latin “*ars longa, vita brevis*”, i përshtatet plotësisht Apolonisë.³³ Si duket, pjesa e sipërme e qytetit, që kishte ruajtur popullsinë vendase në

nga Apolonia, që gjenden në muzen e Luvrit.

³⁰ Pierre Cabanes et Faik Drini, “*Etydes epigraphiques 2. Corpus des inscriptions grecques d’Illyrie méridionale et d’Epire*.” Ecole Française d’Athenes, 1995, f. 14.

³¹ Neritan Ceka, “*Apollonia*”, Tiranë 2005, f. 7; Edhe Prashniker e Schober, “*Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*”, Vjenë 1919, f. 69, e përshkruajnë kështu peizazhin e mrekullueshëm të pozicionit të Apolonisë: “Peizazhi i Apolonisë të lë përshtypje gjurmëlënëse. Nga ngjyrat dhe linjat e tij, të duket sikur je në Greqi. Vargu i butë i kodrave, fusha kafe me grupe pemësh të shkëputura dhe, pas tyre, deti i errët ku dallon ishulli shkëmbor i Sazanit dhe malet e Gadishullit Akrokeraun. Krejt afër gjiri i Vlorës, ku ne mund të numërojmë anijet italiane. Shtu pastaj dhe pasurinë në thesare antike.”

³² Neritan Ceka, “*Udhëtim në kështjellat ilire*”, Tiranë 2006, f. 133.

³³ Neritan Ceka, “*Apollonia*”, Tiranë 2005, f. 14.

³³ Appiano Alessandrino, “*Delle guerre civili de Romani*”, In Vinegi A, Appresso Camillo Franceschini, 1575, f. 79.

pjesën më të madhe të saj, duhet të kishte ujë të bollshëm në puse, sepse ishte dimër, pra, kohë shirash; mirëpo kjo popullsi, duke përkrahur Cezarin, si na e thotë vetë ai, mbajti qëndrim armiqësor dhe as e mbështeti, as e ndihmoi Staberin pompejan, i cili u detyrua të ikte fshehurazi nga Apolonia. Duke e gjetur miqësor edhe qytetin e Apolonisë, që ashtu si Orikumin e kishte futur në dorë të vet “me shpatën në mill”,³⁴ Cezari mblodhi ushtrinë dhe u kujtoi ushtarëve se, në sajë të shpejtësisë, ata kishin kapërcyer detin në furtunë, kishin zënë pa luftë dy qytete, që i përkisnin armikut, i cili ende nuk kishte asnjë lajm për mbërritjen e tyre. “Për këtë arsye, thotë ai, në qoftë se ne do të kapim edhe Dyrrahun, që është depoja e Pompeut, çdo gjë do të jetë në dorën tonë, çdo gjë që ai ka grumbulluar gjatë gjithë kësaj vere në municione dhe në ushqime”.³⁵

Qëndrim miqësor kanë mbajtur apolonianët, jo vetëm ndaj konsullit romak të vitit 48 para e. S., pra, Jul Cezarit, por edhe pas vrasjes së tij; siç dihet, djali i birësuar i Cezarit, Oktavian Augusti, ndodhej në Apoloni për studime në kohën e vrasjes së Cezarit; apolonianët mbajtën qëndrim miqësor ndaj Oktavian Augustit, pasardhësit dhe trashëgimtarit të Cezarit, duke e lutur, madje, të qëndronte në qytetin e tyre, derisa të qetësohej gjendja në Romë. Nikolla i Damaskut, që jetoi për ca kohë në oborrin perandorak të Augustit, na ka lënë këtë njoftim për banorët e Apolonisë: “Apolonianët, të mbledhur që të gjithë, i luteshin Cezarit (Oktavian Augustit) me dashamirësi që të qëndronte pranë tyre një farë kohe, duke i premtuar t’i vinin në shërbim qytetin e tyre për çdo gjë, si nga dashuria për të, ashtu edhe nga nderimi për të vdekurin (Jul Cezarin). Por, Cezari, ...nuk hoqi dorë nga mendimi i tij dhe tha se ishte nevoja të nisej me det për të qenë pranë ngjarjeve. Atëherë i lëvdoi apolonianët dhe, kur erdhi në fuqi, u dha liri dhe i përjashtoi nga detyrimet. Përveç këtyre, shumë mirësi të tjera u solli dhe qytetin e tyre e bëri nga më të lumturit. Atëherë, kur po ndahej, i gjithë populli e përcolli me lot në sy, duke admiruar sjelljen e mirë dhe urtësinë e tij gjatë këtij qëndrimi të shkurtër në qytetin e tyre, duke mallkuar njëkohësisht edhe për fatin”.³⁶

³⁴ Appiano Alessandrino, “*Delle guerre civili de Romani*”, In Vinegi A, Appresso Camillo Franceschini, 1575, f. 79.

³⁵ Appiano Alessandrino, “*Delle guerre civili de Romani*”, In Vinegi A, Appresso Camillo Franceschini, 1575, f. 79.

³⁶ Nicolai Damascensi, *Fragmenta*, “*Jeta e Cezarit*”, te “*Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*”, kreu 17, Tiranë 1965, f. 174. Nikolla i Damaskut me prejardhje nga Siria jetoi

Kreu 13:Kur pa se Pompeu po arrinte para tij në Dyrrah, Cezari ndërpret marshimin dhe ngre kampin pranë lumit Aps, në kufi të Apolonianëve, me qëllim që t'i mbronte, me fortësa dhe me truproja, popullsitë që meritonin mbrojtjen e tij; gjithashtu, vendosi të priste këtu ardhjen e legjioneve të tjera nga Italia dhe të nxirrte dimrin nën çadra. Të njëjtën gjë bëri edhe Pompeu dhe, pasi nguli kampin në bregun tjetër të lumit Aps, solli aty gjithë trupat dhe forcat ndihmëse.³⁷

Kreu 75: Kështu, pa humbur kohë, si siguroi të sëmuret dhe të plagosurit, sapo filloi të ngrysej, në heshtje të plotë, Cezari nxori nga kampi dhe nisi drejt Apolonisë të gjitha bagazhet, me urdhrin e prerë që të mos ndalonin për asnjë çast, derisa të përfundonin udhëtimin....³⁸

Në ndeshjen mes dy kundërshtarëve në zonën e Dyrrahut, Cezari u thye, por nuk e lëshoi veten. Më mirë se fituesi (Pompeu), i munduri (Cezari) vlerësoi kushtet dhe rrethanat që i shkaktuan disfatën. Detyra e vetme e tij këtë çast ishte të mbulonte dhe të siguronte rrugën e zgjedhur për tërheqjen e trupave drejt Apolonisë. Humbja i kishte dhënë atij një pamje më të qartë të situatës dhe i kishte diktuar një plan të ri lufte. Hëze mendon se fillimisht Cezari duhet të ketë menduar zhvendosjen e luftës në Apoloni dhe në territoret e fituara përreth saj. Por, këto territore, të rraskapitura për një kohë të gjatë, të ndara nga Italia prej detit, gjë që ishte në dobi të armikut, nuk mund të konsideroheshin më si bazë veprimesh të sigurta; ai duhej të ishte i kënaqur që rrethanat po e detyronin të kërkonte një vend tjetër.³⁹ Me shkathtësinë dhe shpejtësinë e gjeneralit që di të orientohet edhe në situatat më të vështira, nxori të gjithë bagazhet nga kampi, të ngarkuar nëpër qerre e kafshë barre, dhe i nisi drejt Apolonisë, me qëllim që ushtarët të ishin sa më të lehtësuar nga peshat; kjo i vlente marshimit të shpejtë dhe krijimit të një largësie sa më të madhe nga Pompeu, i cili me siguri do t'i vihej pas, me qëllim që "t'i kapte në befasi, gjatë rrugës, cezarianët e tmerruar". Më pas,

edhe në oborrin perandorak të Augustit. Vepra e tij, një histori botërore, që përbëhet nga 144 libra, nuk ka mbërritur e plotë në ditët tona, por me fragmente.

³⁷ ...*Caesar, praeoccupato itinere ad Dyrrachium, finem properandi facit castraque ad flumen Apsum ponit in finibus Apolloniatium, ut castellis vigiliisque bene merita civitates tutae essent, ibique reliquarum ex Italia legionum adventum expectare et sub pellibus hiemare constituit. Hoc idem Pompeius fecit et trans flumen Apsum positus castris eo copias auxiliaque conduxit.* Cesare, "De bello civili", Milano 1938, f. 38.

³⁸ *Itaque nulla interposita mora sauciorum modo et aegrorum habita ratione impedimenta omnia silentio prima nocte ex castris Apolloniam praemisit ac conquirere ante iter confectum vetuit.* ... Cesare, vepër e përmendur, f. 118.

³⁹ Léon Heuzey, "Les opérations militaires de Jules César", Paris 1886, f. 91.

Cezari nxori nga të gjitha portat e kampit në një kohë të shkurtër pjesën më të madhe të ushtrisë dhe, menjëherë, doli edhe vetë me gjithë praparojën, prej dy legjionesh, dhe kalorësinë. Këtë çast u dhanë sinjalet e zakonshme për lëvizjen e kampit, gjë që i shërbeu më së miri edhe ruajtjes së rregullit ushtarak, edhe mbulimit të nisjes së ushtrisë cezariane ndaj armikut, çast kur marshimi nuk mund të fshihej më.⁴⁰

Pompeu nuk mundi ta ndiqte Cezarin, sepse trupat e tij ishin shpërndarë për probleme të ndryshme mbas betejës; veç kësaj, falë veprimit të zgjuar e të shpejtë të Cezarit, ishte krijuar një përparësi e madhe, prej rreth 14 km; kjo e bindi Pompeun se legjionet e tij nuk mund të arrinin trupat e Cezarit në tërheqje, prandaj ai nisi kalorësinë, e cila e mbërriti praparojën e Cezarit shi kur kjo kishte kaluar lumin Genus (sot Shkumbini) dhe kishte zënë pozicion pranë kodrave, në mbrojtje të kalimit, meqë lumi kapërcehej me vështirësi, në kampin në afërsi të Asparagut. Pas tri ditësh, me një largësi prej 16 km, prej Cezarit dhe lumit Genus mes tyre, Pompeu u detyrua të hiqte dorë nga ndjekja. Ndërprerja e ndjekjes së ushtrisë cezariane nga Pompeu, qe një fitore jo e vogël e Cezarit. Shpejtësia dhe rregulli i habitshëm i kësaj tërheqjeje të Cezarit nga Dyrrahu në drejtim të Apolonisë, tregon aftësinë e madhe strategjike të tij. Diçka tjetër që tërheq vëmendjen në këtë kaptinë është shprehja “të sëmurët dhe të plagosurit”; kuptohet se të plagosurit ishin ata që morën plagë në betejën e zhvilluar ose gjatë tërheqjes, të paraqitur në krerët më sipër. Po të sëmurët? Studiuesit mendojnë se, të paktën një pjesë e këtyre të sëmurëve, janë ushtarët e kapur nga ethet e malaries. Skena e luftës mes romakëve zhvillohet në bregdet ose në zonat pranë bregdetit deri në çastin ku kemi arritur.

Këto zona, kryesisht ato nga Dyrrahu deri në Apoloni, janë zona me lumenj të mëdhenj dhe me shumë ujë, të cilët shumë shpesh vërshonin, ndërronin drejtimin, duke krijuar sipërfaqe të mëdha me ujë të ndenjur dhe kënetat, plot me shavarë (bimë), kushtet më të mira për ekzistencën e malaries. Që malaria ka bërë kërdinë në shumë forma në vendet e lashta mesdhetare, kjo gjë pohohet nga shumë dokumente. Në Romë perëndesha “Febris” kishte, që nga kohët shumë të lashta, një faltore mbi kodrën Palatine. Vetë Ciceroni në një vepër të tij na tregon shumë qartë për dy lloje të kësaj sëmundjeje. Edhe te Plini gjejmë njoftime për një lloj tjetër të kësaj sëmundjeje. Në bregdetin ilirik,

⁴⁰ Giorgio Veith, “*La campagna di Durazzo fra Cesare e Pompeo*”, Roma 1942, f. 160.

veçanërisht Myzeqeja, ku ndodhej Apolonia, ishte e mbushur me ujëra të tillë. Edhe Hahn ka bërë përshkrimin e kësaj fushe dhe të klimës jo të shëndetshme të saj. E gjithë fusha, sipas tij, duket se është formuar prej lumenjve që e përshkojnë (Vjosa, Semani, Shkumbini, Darçi, Leshniqe, Erzeni, Ishmi, Mati, Drini dhe Buna), të cilët vazhdimisht punojnë për zmadhimin e saj. Këtë gjë na e tregon vargu i kënetave, ku më të mëdha e ku më të vogla, që rrethojnë buzën e detit dhe gjuhëzat tokësore që hyjnë thellë në det. Këto krijohen prej mbeturinave që lënë lumenjtë te gryka, prandaj ky brez zgjerohet shpejt dhe ndryshon formë pas çdo furtune.⁴¹ Malaria këtu bën kërdrinë nga fundi i stinës së verës.⁴² Qytetet e kësaj zone, falë shkallës së lartë të kulturës së tyre, do të kenë luftuar gjatë kundër këtij armiku të tmerrshëm. Apolonia, ishte një qytet mjaft i njohur, me kulturë të spikatur; po kështu Dyrrahu, të cilët kishin arritur një shkallë të lartë zhvillimi, falë rëndësisë së tyre si porte tregtare. Gjatë fushatës së Cezarit, trupat e tij, që qëndruan e vepruan në zona fushore dhe pranë territoresh të kënetëzuara, kanë vuajtur këtë sëmundje, kurse trupat që kishin fushuar në zona të larta, jo.⁴³ Që

⁴¹ Johan Georg von Hahn, *“Albanesische Studien”*, Jena 1854, Studime Shqiptare, Tiranë 2003, f. 21. Po në këtë vepër, f. 109, duke paraqitur pozicionin e Durrësit dhe duke menduar se lënda e sjellë nga ujërat e lumenjve që nga lashtësia ka arritur ta kthejë ishullin e kohëve shumë të lashta në një gadishull, Hahn mendon se fusha ranore që e lidh gadishullin me tokën është fare pak më e lartë se sipërfaqja e detit; gjithashtu, kjo fushë, pranë kodrave është aq e ulët, sa uji i shirave dhe i detit në kohë tallazi e furtune, hyn këtu dhe nuk mund të kthehet më mbrapsht. Uji që fle në dimër formon një varg kënetash, të cilat në verë thahen dalëngadalë dhe e mbushin me ajër të keq qytetin dhe rrethinat e tij. Pra, vazhdon Hahn, duke qenë puna kështu, nuk duhet të çuditemi që ethet e kanë qendrën në Durrës dhe, sidomos, në vjeshtë janë shumë të rrezikshme.

⁴² Po ai dhe po aty.

⁴³ Giorgio Veith, *“La campagna di Durazzo fra Cesare e Pompeo”*, f. 61. Në lidhje me sëmundjen e malaries në kohën e vëzhgimeve të tij në terren, ky autor në f. 17, shkruan: “Nëse dimri shqiptar me shirat e furishëm, me përmbytjet e vendit, për rrjedhojë ndalimin e qarkullimit, përbën pengesë për çdo veprimtari njerëzore, në stinën e verës, si zhduken të gjitha këto pengesa, shfaqet një armik i ri, akoma më i tmerrshëm - malaria. Malaria është endemike dhe përhapet në gjithë vendin. Në udhëtimin e bërë në vitin 1914, vazhdon Veith, vura re që periudha e infeksionit fillonte në zonën e Vlorës kah gjysma e prillit, kurse në Durrës 2-3 javë më vonë”. Edhe Karl Patsch, në studimin e tij *“Das Sandschak Berat in Albanien”*, Vjenë 1904, kreu 9, Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë, f. 4, duke përshkruar disa lumenj të Shqipërisë, si: Matin, Ishmin, Erzenin, Shkumbinin, Semanin, Vjosën thotë se ata sjellin e shkarkojnë sasira të mëdha materiali të rëndë, shtyjnë përpara grykave të tyre vijën bregdetare, i mbushin ato me materiale dhe krijojnë në këtë mënyrë gjire moçalorë, plot malarie.

ushtria e Cezarit ka vuajtur nga kjo sëmundje duket qartë edhe në këtë kaptinë. Në kreun 87, Labieni, ish-komandant, dikur mik dhe shok e bashkëluftëtar shumë i afërt i Cezarit, në çastin e ngjarjeve tona i bashkuar me Pompeun, i kujton këshillit ushtarak të Pompeut se “shumë ushtarë i hëngri epidemia e vjeshtës në Itali”, duke na kujtuar se kjo epidemi ishte edhe në vendin pranë Italisë në ato kohëra. Shqipëria është nga ana e detit. Në luginat dhe në fushëgropat e brendshme që shohin Adriatikun, një vend i dëmshëm për shëndetin; në ultësirat pjellore, në shkrepat e ashpra të maleve deri në një lartësi të konsiderueshme mbi nivelin e detit, në plazhet e këndshme, përreth qyteteve, si edhe në vende të vetmuara, ethja është ende forca e tmerrshme vrastare e këtij vendi fatkeq.⁴⁴ Malaria bënte dëme në ushtri e në popullsi. Qytetet antike që nuk kishin kushtet e nevojshme për jetesë u shuan me të shpejtë.⁴⁵ Apolonia përmendet për herë të fundit nën perandorin Justinian, në katalogun e qyteteve të Hieroklit. Pak më vonë u rrënua për shkak të rritjes së moçaleve... Me banorët e saj u mbushën qytetet e vogla që gjendeshin në afërsi.⁴⁶

Sot Apolonia është një qytet i vdekur i mbuluar nga disa metra dhe, i cili prej shumë kohësh ka shërbyer si gurore për ndërtimin e shtëpive të bukura të Beratit.,⁴⁷ bërë i tillë, sepse moçalet dhe “ajri i keq” bënë që një pjesë e madhe e popullsisë të largohej e të shpërngulej në zona të tjera. Mbrojtja e Augustit, as dija e institucioneve nuk kanë mundur ta shpëtojnë dhe nuk ka mbetur më gjë për të njohur “hijerëndën dhe madhështoren Apoloni”, fqinjën e vendit të taulantëve, së cilës emri i është sakatuar si ndërtesat.⁴⁸

Kreu 78: *Cezarit i duhej të shkonte në Apoloni për të lënë të plagosurit, për t’u shpërndarë rrogat ushtarëve, për t’u dhënë zemër aleatëve dhe për të vendosur garnizone mbrojtëse pranë tyre.*⁴⁹

Në këtë kaptinë, Cezari thotë se duhej të shkonte në “Apoloni për të lënë të plagosurit dhe për t’u shpërndarë rrogat ushtarëve”. Ai nuk

⁴⁴ Antonio Baldacci, “*L’Albania*”, Roma 1929, f. 33.

⁴⁵ Milan Shufllaj, “*Serbët dhe shqiptarët*”, Tiranë 2004, f. 9.

⁴⁶ Milan Shufllaj, “*Serbët dhe shqiptarët*”, Tiranë 2004, f. 10.

⁴⁷ Pierre Cabanes et Faik Drini, “*Etydes epigraphiques 2. Corpus des inscriptions grecques d’Illyrie méridionale et d’Epire*”, Ecole Française d’Athenes 1995, f. 9.

⁴⁸ Pierre Cabanes et Faik Drini, “*Etydes epigraphiques 2. Corpus des inscriptions grecques d’Illyrie méridionale et d’Epire*”, Ecole Française d’Athenes 1995, f. 11.

⁴⁹ *Caesari ad saucos deponendos, stipendium exercitui dandum, socios confirmandos, praesidium urbibus relinquendum necesse erat adire Apolloniam....* Cesare, vepër e përmendur, f. 121.

kishte marrë nga Italia asnjë furnizim në ushqime, me qëllim që të mund të hipte nëpër anijet e pakta një sasi sa më të madhe ushtarësh; më vonë ai mendoi të sillte andej grurë e haje për ushtrinë, mirëpo, i bllokuar nga flota pompejane, iu dogjën prej njerëzve të Pompeut edhe ato pak anije ngarkese që kishte. Kështu që i mbeti të furnizohej vetëm me çfarë mund t'i siguronte vendi ku po vepronte. Cezari përmend edhe rrogat e ushtarëve, që u shpërndareshin në periudha të përshtatshme mosluftimi. Lind pyetja: kishte marrë me vete Cezari (apo Pompeu, që, në fillim të luftës civile zotëronte edhe qytetin e rëndësishëm, Apoloninë) denarë për shpenzimet e mëdha financiare të luftës, ku futen edhe pagesat e mëditjeve të ushtarëve? Mendojmë se përgjigjja e kësaj pyetjeje gjendet në studimin e dy thesareve të gjetura nën tokë në rrethinat e qytetit të Tiranës: njëri prej 63 copash, ndërmjet të cilëve 39 janë denarë, pra, monedha romake të periudhës republikane.

Monedhat antike përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme për hulumtimin e historisë së antikitetit. Veç të tjerave, përmes tyre ndiqen edhe ngjarje historike, të cilat plotësohen me mbishkrimet ose simbolet që kanë monedhat e gjetura. Kështu, monedhat më të reja të thesarit të sipërpërmendur përmbajnë emrat e konsujve romakë, Luc Kornel Lentuli dhe Kaj Klaud Marcelli, të cilët ushtruan detyrën e konsullit nga viti 49 para e. s. deri në vitin 48 para e. s., pikërisht në kohën e shpërthimit të luftës civile mes Cezarit dhe Pompeut, gjë që na e thotë edhe vetë Cezari në librin e parë të veprës së tij. Një pjesë e këtyre monedhave ruante shkëlqimin dhe bukurinë e vulës së prerjes, sepse u mungonte çdo gjurmë e fërkimit të shkaktuar nga qarkullimi, prandaj futja e monedhave në tokë ka të ngjarë të jetë bërë në muajt e parë të hedhjes së tyre në treg, por sidoqoftë, jo më vonë se në vitet 49 apo 48 para e. s.⁵⁰

Në fillim të vitit 49 para e. s., Pompeu bashkë me pjesën më të madhe të senatit romak dhe dy konsujt e përmendur më sipër, lanë Romën e Italinë dhe u hodhën me gjithë ushtri në brigjet tona. Vetë Cezari në kreun 14 të librit të parë, na thotë se: *“Me t’u marrë vesh në Romë këto ngjarje, përhapet një panik aq i madh, saqë, kur konsull Lentuli shkoi për të hapur kasën e thesarit dhe për të marrë një sasi të hollash për Pompeun, sipas vendimit të Senatit, ikën menjëherë nga Qyteti (Roma), duke e lënë të çelë kasën e brendshme të thesarit”*.⁵¹

⁵⁰ Hasan Ceka, “Mbi disa çështje të historisë ilire në dritën e të dhënave numizmatike”, në Kuvendi i studimeve ilire, Tiranë 1972, f. 88.

⁵¹ Julius Caesar, “Mbi luftën civile”, libri I, kreu 14, Tiranë 2007, f. 69

Thesaret e gjetura, me mbizotërim të denarëve, flasin për një rritje të vërshimit ekonomik të Romës në Ilirinë e Jugut, flasin për një kthesë të madhe vendimtare në marrëdhëniet ekonomike mes Gadishullit Apenin dhe Dyrrahut e Apolonisë, nga njëra anë, dhe Ilirisë, në përgjithësi, nga ana tjetër. Tregu ilir mbushet me denarë romakë, përhapjen e të cilëve e lehtëson jo vetëm pesha më e ngritur e kësaj monedhe, por edhe gjendja e re politike, që e shndërron Ilirinë e Jugut, përfshirë edhe Dyrrahun e Apoloninë, në një pushtim ushtarak.⁵² Autoritetet romake me Pompeun, të tërhequra në Ilirinë e Jugut, gjatë qëndrimit të tyre më se një vjeçar duhet të kenë ngritur punishte të veten për prerjen e monedhave.

Kësaj i shtohet edhe njoftimi i Ciceronit, i cili na thotë se në Apoloni në këtë kohë, në vitin 49, vepronte një punishte monetare romake. Pompeu, i larguar rrufeshëm nga Roma me afrimin e Cezarit, si u përmend pak më lart nga vetë Cezari, nuk mund të shpresonte për fitore vendimtare mbi kundërshtarin e tij të rrezikshëm, përderisa nuk do të siguronte mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve ushtarake, ku futeshin edhe pagesat e mëditjeve të ushtarëve. Sigurimi i argjendit nuk paraqiste vështirësi, sepse si Iliria, prej nga ushqeheshin edhe punishtet monetare autonome të Dyrrahut e të Apolonisë, ashtu edhe Maqedonia e afërt, ishin të pasura në këtë mineral. Nuk mund të ketë asnjë dyshim që në vitin 49 para e. s., punishtja monetare e Apolonisë u vu në shërbim të thesarit romak dhe nxori në qarkullim denarë me emrat e konsujve L. Kornel Lentuli dhe C. Klaud Marcelli, në pamundësi për t'u shtypur në punishtet e Italisë, nga ngutja me të cilën u larguan nga Roma autoritetet e larta shtetërore të kohës. Kështu, nëse kjo punishte ishte krijuar vërtet në Apoloni, si pohojnë faktet, edhe Cezari duhet ta ketë shfrytëzuar për të prerë monedha, me qëllim që, të paktën, të paguante mëditjet e ushtarëve të tij.

Thesari tjetër, i përbërë prej 119 copash, mes të cilëve 46 copë janë denarë republikanë romakë, përsëri ka monedha me monogramet e dy konsujve të sipërpërmendur; këtë thesar, i gjetur në veri të Tiranës, studiuesi Ceka e lidh me groposjen e këtyre monedhave nga gjendja e pasigurisë që shkaktoi lufta civile romake në krahinat e Ilirisë dhe, veçanërisht, plaçkitja e fisit të parthinëve nga kalorësia e Pompeut,

⁵² Hasan Ceka, "Mbi disa çështje të historisë ilire në dritën e të dhënave numizmatike", në "Kuvendi i studimeve ilire", Tiranë 1972, f. 91.

fillimisht, dhe nga legjionet e Cezarit gjatë pushtimit të qytetit të tyre, më pas.⁵³

Në përfundim të këtij studimi, ne mund të kujtojmë fjalët e Johan Irmsher tek «*Shënime rreth konceptit gjerman të shekullit XVIII dhe XIX mbi ilirët*»; duke përmendur leksikografin Samuel Christoph Schirlitz (1797-1875), Irmsher shkruan se leksikografi e përfundon artikullin e vetë mbi Ilirinë, duke konstatuar se: “*Vlera e kësaj Ilirie rrjedh nga rëndësia e shumë qyteteve, që ishin ndërtuar atje, si Dyrrachium, Apolonia, një qytet ku shkencat kishin selinë, dhe ku Oktaviani, më vonë i shpallur Perandori August, ka ndjekur studimet*”.

⁵³ Hasan Ceka, “*Mbi disa çështje të historisë ilire në dritën e të dhënave numizmatike*”, në “Kuvendi i studimeve ilire”, Tiranë 1972, f. 99.

Nermin BASHA

SUMMARY

THE EARLIEST EVIDENCE ON APOLLONIA

The article, which is based on the important work of Julius Caesar "The Civil War", especially the third book, are presented valid evidence for the science of Albanalogy in general and the science of Illyrology in particular, related to the ancient city of Apollonia. Located near the sea, between two great water rich rivers, Apollonia over the centuries not only served as a port for trade exchanges, but also as a strategic point for many armies.

This city is rich and aristocratic, where science had their headquarters in the high citadel at the top and the lower part was the most important location for Julius Caesar and his army during military actions against Pompey in the second half of the first century B.C., the year 48-49. From the data given by Caesar, supplemented with materials of other writers before and after him, set up a more comprehensive picture of the situation of ancient Apollonia.

Ilir CULAJ

DISA ASPEKTE TË RELIGJIONIT NË ULPIANËN ANTIKE

Dardania përbënte një pjesë të regjioneve qendrore të siujdhesës ballkanike. Pozita gjeografike e saj dhe vetitë e hidrografisë, të relievit, klimës etj., e bëjnë si një tërësi të ndarë e të veçantë gjeografike, gjë që ka ndikuar në zhvillimin e saj historik dhe kulturor.¹ Njëra nga qendrat kryesore të Dardanisë ishte Ulpiana, e cila paraqet njëherit edhe njërën nga qendrat më interesante arkeologjike në Kosovë dhe rajonin e gjerë të gadishullit Ilirik. Shtrirja pranë depozitimeve minerare xehetare të pasura me metale të çmueshme, tokat pjellore përreth saj, si dhe pozita e mirë gjeostrategjike që posedonte duke qenë pjesë e një udhëkryqi të rëndësishëm rrugësh antike, ishin faktorët kryesorë që ndikuan në themelimin, zhvillimin dhe ekzistencën e saj shekullore.² Prezenca e *statione beneficiarii consulari*³ në Ulpianë e dëshmuar në burimet epigrafike, vetëm sa e dëshmon rolin dhe rëndësinë e madhe ekonomike që paraqiste ajo për romakët.

Vendbanimi i Ulpianës shtrihet në një hapësirë të rrafshët rreth 7 km në juglindje të qytetit të sotëm të Prishtinës, 10 km në veri të Lipjanit, 1.5 km në lindje të fshatit Llapnasellë dhe 1.5 km në perëndim të Graçanicës.⁴ E themeluar që në shek. I pas Krishtit, vendbanimi u

¹ Emil Čerškovič, *Romakët në Kosovë dhe Municipiumi D.D te Soçanica* (Prishtinë: Obod, 1973), 11.

² Milot Berisha, "Ulpiana e Dardanisë në dritën e hulumtimeve arkeologjike", *Gërmime dhe studime arkeologjike në Kosovë 2000-2012* (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2014), 296.

³ Emine Kalaja-Hajdari, "Stacionet beneficiare (stationes beneficiarii) në pjesën qendrore të Dardanisë", *Kosova* 35/36 (2012), 50-51.

⁴ Zef Mirdita, *Mbi një mbishkrim nga Municipium Ulpianum* (Prishtinë: Enti i Historisë së Kosovës, 1976), 328.

ngrit në rang të municipiumit që në çerekun e parë të shek. II.⁵ Municipium Ulpiana zhvillimin më të madh e ka arritur në periudhën mes shekujve III-IV, periudhë kjo kur ajo arriti të shndërrohet në një qendër të rëndësishme politike, ekonomike dhe kulturore e një territori të gjerë në qendër të Dardanisë. Gjatë kësaj periudhe, ndoshta edhe më vonë, Ulpiana gëzonte epitelin Municipium Ulpiana Splendidissima, që kishte kuptimin municipi i Ulpianës madhështore.⁶

Gërmimet arkeologjike të zhvilluara në Ulpianë që nga fillimvitet e '50-ta, pos që kanë mundësuar lokalizimin e qytetit, organizimin urbanistike, kronologjinë dhe fazat e zhvillimit të qytetit të Ulpianës⁷, ato ofrojnë gjithashtu të dhëna të çmueshme të cilat mundësojnë të bëhet një vështrim i përgjithshëm mbi botën shpirtërore të banorëve të Ulpianës, banorët e së cilës adhuronin dhe nderonin një varg perëndish të religjionit oficial dhe jo oficial romak. Por, edhe pse burimet epigrafike që dëshmojnë, hyjnitë burimore dardane janë më të mangëta⁸, ato na ofrojnë dëshmi të shumta dhe janë një segment shumë i rëndësishëm në trajtimin e aspekteve religjioze të dardanëve. Disa burime të tilla epigrafike janë dëshmuar në Ulpianë, dhe ndihmojnë që të kemi një pasqyrë edhe më të mirë për botën shpirtërore dhe religjioze të banorëve të qytetit.

Paganizmi

Kur shkruajmë për Ulpianën antike, është me interes që të ndalemi edhe tek aspekti religjioz, të trajtojmë ndikimin e religjionit në formimin dhe zhvillimin e kulturës në qytet. Të shohim se cilat ishin format e besimit të popullsisë së Ulpianës dhe sa ishin të përkushtuar rreth religjionit banorët e këtij qyteti. Qysh në lashtësi, religjioni apo besimi kishte një rëndësi të madhe për popujt. Por, natyrisht se mënyrat dhe format e besimit ishin të ndryshme. Për t'u njohur më mirë me historikun e religjionit në Ulpianë është e domosdoshme që fillimisht të bëhet një vështrim i përgjithshëm rreth religjionit në Dardani. Bota shpirtërore e religjioze dardane në shekujt IV-I pësoi ndryshime të dukshme. Përderisa kulti i Diellit dhe ai i Gjarprit ishin veçori të fazave

⁵ Čerškov, *Romakët*, 36.

⁶ Berisha, "Ulpiana", 298.

⁷ Čerškov, *Romakët*, 20.

⁸ Edi Shukriu, *Hyjnesha Dardane* (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2014), 22.

paraurbane dardane, në fazën urbane u bë sinkretizëm i kulteve dhe ato morën trajta antropomorfe. Sipas modelit të mbretërisë, që kishte pushtetin në tokë, u krijua mbretëria qiellore, përkatësisht u vunë themelet e politeizmit dardan. Në panteonin dardan, përveç hyjve të tjerë ilirë, një vend të rëndësishëm zë Hyjnesha dardane (Dea) dhe Hyj Andin.⁹ Hyjnesha dardane përcjellë të gjitha fazat e besimit dardan, që nga periudhat parahistorike e deri në shek. IV. Ajo u adhuroi dhe u fuqizua gjatë periudhës romake, si bartëse e identitetit dardan.¹⁰

Lidhur me besimet e kultet e hyjnive dhe për tempujt dhe faltoret në Dardani para pushtimit romak dihet pak. Duket se para Krishtit dhe gjatë shekujve të parë pas Krishtit, në vendbanimet dardane ishin nderuar hyjtë burimorë vendas siç ishin: Hyjnesha Dardane, Andini, Zbeltiurdud, Tatto, Liber Pater, Silvani, Dracco, Draccena etj.¹¹ Duket se te dardanët nuk ekzistonte një panteon i rregulluar unik, por perëndi të caktuara nderoheshin prej disa fiseve dhe territoreve të caktuara. Disa hyjni të tjerë që nderoheshin nga fise ilire ishin: Vidasus (Hyji i kullosave), Thana (Hyjneshtë e gjahut), Bindi (Hyji i detit dhe ujërave në përgjithësi), Ika (mbrojtëse e burimeve), Tadenus (Perëndi i bukurisë, i muzikës), si dhe shumë hyjni të tjerë.¹²

Në Dardani janë zbuluar edhe një varg monumentesh skulpturore të realizuara në relief dhe skulpturë të tre perëndive që përbëjnë trininë e mjekësisë: Asklepi, Higia dhe Telesfori.¹³ Nuk ka dyshim se kontaktet e ndërsjella me fqinjët kanë ndikuar në rrjedhat e jetës shpirtërore të dardanëve në përgjithësi, konkretisht në aspektin e besimit. Mund të konstatohet se kontaktet e para të dardanëve me qytetërimin greko-romak datojnë qysh herët.¹⁴ Pushtimi i trojeve dardane nga romakët bëri që me kohë kultura dhe besimi romak të përhapej tek dardanët. Siç potencon edhe arkeologu Çershkov, romanizimi solli me vete përhapjen e religjionit romak. Por, pavarësisht romanizimit, format e besimit të vendasve nuk u zhduken, ato u ruajtën

⁹ Edi Shukriu, "Shteti i Dardanisë", *Kosova* 22/23 (2003), 33.

¹⁰ Shukriu, *Hyjnesha*, 171.

¹¹ Naser Ferri, "Nderimi i hyjnive autoktone dhe të importuar në vendbanime dhe nëpër vende publike në Dardaninë Romake", *Gjurmime albanologjike: seria e shkencave historike* 41/42 (2012), 284.

¹² Naser Ferri, *Mitologjia e gjallë* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2012), 33.

¹³ Exhlale Dobruna-Salihu, "Prania e perëndive të mjekësisë dhe e mjekëve në Dardani", *Kosova* 39 (2014), 9.

¹⁴ Ferri, *Mitologjia*, 33.

në forma të ndryshme, sidomos në fshatra, ku romanizimi depërtoi më pak se në qytete. Sa i përket numrit të monumenteve epigrafike kushtuar perëndive në Dardani, shumica prej tyre janë zbuluar si monumente kushtuar perëndive romakë e më pak janë gjetur të tilla që ju kanë kushtuar hyjnive burimorë dardanë.¹⁵

Rrjedhimisht edhe në Ulpianë religjioni dhe besimi kishin karakter të tillë. Në Ulpianë janë gjetur një varg monumentesh kushtuar perëndive vendase dardane, por ato janë të pakta në krahasim me ato që ju kanë kushtuar perëndive romak. Kjo erdhi si pasojë e romanizimit, i cili pati një përhapje të madhe sidomos në zonat urbane, siç ishte Ulpiana dhe qytetet tjera.

Në Ulpianë është gjetur një monument epigrafik kushtuar Silvanit e Silvanës, pastaj shumë monumente i kushtohen Jupiterit. Rëndësi të veçantë kanë disa monumente religjioze të kushtuara hyjnive të Lindjes. Në Ulpianë është gjetur një monument epigrafik kushtuar hyjnisë siriane Dolichenus, ajo është ngritur nga priftërinjtë e këtij kulti: Demetrius Ambibi dhe Victor Demetri nga Ulpiana, kjo lë të kuptohet se në qytet mund të ketë ekzistuar faltorja e hyjnisë së përmendur më lartë.¹⁶ Një pllakë votive me përfytyrimin e “kalorësit trakas” është zbuluar në Ulpianë gjatë gërmimeve arkeologjike nga arkeologu Çerškov. Ky kult ishte shumë i përhapur.¹⁷ Pllaka ka trajtë katërkëndëshe dhe është e copëtuar në disa pjesë që ngjiten mirë, kurse në një pjesë është e thyer në anën e djathtë, dorën e djathtë e ka të ngritur lart po që nuk dihet se çfarë mbante. Kali njërën këmbë të përparme e ka të ngritur lartë, përfundi tij gjendet derri i egër dhe qeni, ndërsa përpara, druri me gjarprin e përdredhur, që duket pjesërisht. Kjo pllakë është e punuar nga mermeri, ka ngjyrë të përhimët me përmasa 25 x 25 x 2 cm, i takon shekullit III dhe gjendet në Muzeun e Kosovës. Po ashtu, një pllakë tjetër kushtuar kalorësit trakas, por me përmasa më të vogla është gjetur në Ulpianë në këtë periudhë kohore.¹⁸

Në mesin e shumë gjetjeve interesante të karakterit religjioz në Ulpianë, një vend të rëndësishëm kanë disa altarë kushtuar kryehyjtit romak - Jupiterit. Do t'i përmendim dy altarë të tillë të gjendur në nekropolin perëndimor të qytetit. I pari i takon fundshekullit I dhe fillim

¹⁵ Čerškov, *Romakët*, 69-70.

¹⁶ Po aty, 72.

¹⁷ Po aty, 70-71.

¹⁸ Exhlale Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2005), 813.

shek. II, është i ruajtur në tërësi dhe në tri anët e ka të profilizuar bazamentin me kurorë. Altari është gjetur në nekropolin perëndimor, është i punuar nga mermeri i bardhë dhe ka përmasa 98 x 47 x 34 cm. Altari përmban një mbishkrim në gjuhën e vjetër greke dhe gjendet në Muzeun e Kosovës.¹⁹

Altari tjetër është gjetur gjatë hulumtimeve arkeologjike të vitit 1958 në nekropolin perëndimor të Ulpianës. Altari i takon fundshekullit II dhe fillimshekullit III dhe është i tëri, por ka një thyerje në anën e djathtë të pjesës së përparme të kurorës. Është i punuar nga mermeri dhe ka përmasa 95 x 23 cm. Mbi të është një mbishkrim në gjuhën latine, me anë të cilit dëshmohet se ky altarë i është kushtuar Jupiterit dhe ruhet në Muzeun e Kosovës.²⁰ Ndërsa, arat votive, të dedikuara Jupiterit, në tërë territorin e Municipium Ulpianës janë dëshmuar në Gushtericë të Poshtme, pastaj në Vushtrri, në Graçanicë dhe në Runjevë.²¹ Në territorin e Municipium Ulpianës, Jupiteri na paraqitet edhe përmes Triada Kapitoline e cila përfshinte tre kulte: Jupiteri, Junona dhe Minerva, të cilët paraqiten si me vete ashtu edhe në kombinim me kulte të tjera.²² Në një arë votive të gjetur në Graçanicë, Triada kapitoline dëshmohet në bashkësi me Diis Deabusue.²³ Ka raste kur kulti i Jupiterit është dëshmuar edhe me epitelin e emrit të qytetit. Një fenomen i tillë është dëshmuar pikërisht edhe në qytetin e Ulpianës. Identifikimin e Jupiter Ulpianensis e ka bërë E. Čerškov. Kjo na lë të kuptojmë se kjo hyjni vendëse që është identifikuar me Jupiterin, ka qenë karakteristike për Ulpianën, si pajtore e këtij qyteti.²⁴

Gërmimet arkeologjike në Ulpianë kanë nxjerrë në pah një varg monumentesh të karakterit religjioz, të cilat ofrojnë të dhëna të rëndësishme dhe mundësojnë të bëhet një vështrim i përgjithshëm mbi historikun e religjionit të qytetit.

Në vazhdën e gjetjeve me karakter religjioz në Ulpianë është edhe zbulimi i një skulpture prej bronzi kushtuar Merkurit me atributet e veta, me kafshë rreth vetit, dhe me një fëmijë në krah të majtë, ku ka gjasë që ai fëmijë të jetë Dionisi i vogël. Kjo skulpturë i përket shek. II-III dhe ka lartësi prej 13 cm. Skulptura në fjalë është një prodhim i artit

¹⁹ Po aty, 812-813.

²⁰ Po aty, 831-832.

²¹ Zef Mirdita, *Religjioni dhe kultet e dardanëve dhe Dardanisë në antikë* (Zagreb: UBSHRK, 2001), 100.

²² Po aty, 98.

²³ Po aty, 105.

²⁴ Po aty, 38.

provincial romak i punuar sipas modeleve helene në punëtoritë lokale.²⁵ Mercuri, ishte hyj i bartur nga panteoni i hyjnive greke, i cili u përshtat dhe u adaptua nga romakët. Po ashtu, konsiderohet si hyj parahelen i nderuar në Peleponez qysh në mijëvjeçarin e dytë para Krishtit, ndërsa në epokën klasike në Greqi njihej me emrin Hermes. Ishte shumë i popullarizuar dhe një nga hyjtë më të rëndësishëm. Mendohej se ishte njëri nga bijtë e kryehyjit Zeus. Sipas mitologjisë ai ishte mbrojtës i kopeve nga kafshët e egra, dhe padron i udhëtarëve, por njihet shpesh edhe si hyj i oratorisë, mençurisë, dinakërisë etj.²⁶

Një informatë shumë interesante dhe e rëndësishme rreth religjionit në Ulpianë na vjen nga studiuesi Zef Mirdita. Sipas tij, Melcidi është një hyjni që për të parën herë u dëshmuar në Ulpianë, në një arë votive, në bashkësi me *IOM*. Autori mendon se është fjala për një hyjni vendëse me atributet e Jupiterit e cila është quajtur Melcid. Funkcioni i saj nuk mund të përcaktohet saktësisht. Por, ngaqë është në bashkësi me *IOM*, ka mundësi që ajo ka zotëruar vetitë e një hyjnie të lartë vendase.²⁷

Një kult që është dëshmuar në territorin e Dardanisë, por jo edhe në territorin e gjerë të Moesia Superior, është kulti i hyjnisë Ezzaïos. Ky kult i dedikohet Zeusit, dhe e ndeshim si *Zeus Aseis*. Sipas A. Mócsy kjo hyjni mund t'i takojë panteonit semit, ndërsa sipas S. Dušanić kjo është hyjni trakase që mund të lidhet me tempullin e njohur të Zeusit në qytetin Aizanoi. Por, sidoqoftë, vlen të përmendet, që ky kult është dëshmuar në një arë votive, të gjetur në Ulpianë, e cila i takon fundshekullit I ose fillimshekullit II.²⁸

Një kult tjetër i dëshmuar në Ulpianë është edhe ai i Apolonit, zotit të diellit, stinëve të motmotit, luftës, orakujve, poezisë dhe muzikës etj. Ky ishte një kult shumë i përhapur në Perandorinë Romake. Ndërkaq, në Ulpianë është zbuluar një statujë e Apolonit prej bronzi, me anë të së cilës dëshmohet prania e këtij kulti në qytet.²⁹ Po ashtu, në Ulpianë është gjetur një skulpturë e cila për nga vetitë karakteristike, mund të konsiderohet si shëmbëlltyrë e hyjnisë Fortuna. Kjo hyjni njihej me emrat Tyche apo Fortuna, apo shqip Fati dhe së pari është quajtur Fors-Fuqi. Kjo hyjni ishte pajtor (nëse është fjala për shenjtor

²⁵ Ferri, *Mitologjia*, 92.

²⁶ Po aty, 92-93.

²⁷ Mirdita, *Religjioni*, 49-50.

²⁸ Po aty, 36-37.

²⁹ Po aty, 117-118.

mbrojtës?) e grave, ushtarëve, popujve, individëve etj.³⁰ Sipas arkeologut E. Čerškov, kjo hyjni na shfaqet si mbrojtëse e familjes Furii (Fortuna Aeterna domus Furianae - CIL III, 8196), dhe se ishte një hyjni mjaft e përhapur në kuadër të Perandorisë Romake.³¹

Në Ulpianë janë gjetur edhe shumë altarë, pllaka dhe artefakte të tjera me motive religjioze, dhe me siguri do të zbulohen edhe shumë të tjera, të cilat do ndihmojnë që të kemi një pasqyrë më të mirë rreth historisë së religjionit në qytet. Gjetjet e karakterit religjioz që u përmenden më sipër, le të shërbejnë si mostër, që të kuptohen format e paganizmit në Ulpianë, si shprehej ai dhe cilët ishin disa nga hyjtë që nderoheshin më së shumti nga banorët e qytetit. Roli dhe rëndësia e paganizmit në Ulpianë, filloi të zbehej, atëherë kur feja e re - krishterimi, filloi të përhapej në qytet.

Krishterimi

Koha kur u paraqit krishterimi është kohë e krizës së gjithëmbarshme morale, politike, ekonomike, shoqërore, juridike e kulturore që e përshkoi tërë Perandorinë Romake. Në një klimë të tillë krishterimi u paraqit si një fuqi shpëtimtare morale dhe një gjendje e tillë bëri që krishterimi të triumfonte mbi besimet e tjera.³²

Krishterimi, si fe e re që ishte, filloi që të përhapej me shpejtësi të madhe. Ishin një varg arsyesh se pse krishterimi po përhapej me shpejtësi. Krishterimi erdhi me ide të reja plotë me shpresë, dhe njerëzit që kishin nevojë për shpresë shpejt e përqaftuan këtë fe. Një nga dallimet themelore mes krishterimit dhe paganizmit ishte fakti se të krishterët besonin në një zot apo perëndi, kurse paganët kishin shumë perëndi.³³

Krishterimi u përhap edhe në Ilirik, rrjedhimisht edhe në trojet dardane. Karakteristikë e krishterimit në trevat iliro-shqiptare është fakti se këtu krishterimin nuk e sollën as misionarët latinë, as ata grekë, por është i kohës së apostujve dhe dishepujve të tyre.³⁴ Iliriku ka hyrë në literaturën sakrale pikërisht me Shën Palin Apostull. Vet fillet e krishterimit në Ilirik lidhen me emrin e tij. Në letrën e tij drejtuar

³⁰ Po aty, 129-131.

³¹ Čerškov, *Romakët*, 71.

³² Zef Mirdita, "Gjashtë shekujt e parë të krishtenizmit në trevat iliro-shqiptare", *Krishterimi ndër shqiptarë-Simpozium Ndërkombëtar* (Tiranë: Toena, 2000), 36.

³³ Michael Fred, *Monotheism and Pagan Philosophy in Later Antiquity* (New York: Oxford University Press, 1999), 41.

³⁴ Mirdita, "Gjashtë shekujt", 37.

romakëve ai, ndër të tjera, shkruan: “*Kështu prej Jerusalemit e rreth e përqark deri në Ilirik e kam kryer plotësisht detyrën time të përhapjes së lajmit të gëzueshëm mbi Krishtin*”.³⁵

Hershmërinë e krishterimit në Dardani, përveç martirëve na e dëshmon edhe struktura organizative kishtare, e cila funksiononte shumë mirë menjëherë pasi krishterimi u lejua të praktikohet si religjion, në Perandorinë Romake. Sa i përket dokumenteve që dëshmojnë prezencën e krishterimit në Dardani, të parat na vijnë pikërisht nga qyteti i Ulpianës, ku flitet për rastin e martirizimit të Shën Florit dhe Laurit.³⁶ Historia e Florit dhe Laurit është një nga dëshmitë më të fuqishme të hershmërisë së krishterimit në qytetin e Ulpianës, por, edhe në gjithë Dardaninë. Kur shkruajmë për historikun e Ulpianës nuk mund të kalohet pa e trajtuar historikun e dy martirëve të saj, të cilët lanë gjurmë të pashlyeshme në rrjedhat e historisë së qytetit.

Sikurse shumë vende të tjera, edhe Dardania i ka pasur martirët dhe shenjtërit e saj, të cilët me jetën e vet e kanë dëshmuar besimin fetar. Farlati i ka dhënë emrat e katër martirëve dardanë: Florit, Laurit, Prokulit dhe të Maksimit. Në Martirologiumin e Romës, në datë 18 gusht janë shënuar vetëm emrat e Florit dhe Laurit. Ndërsa, Acta Sanctorum na jep informata se atdheu i mirëfilltë i Florit dhe Laurit ishte Dardania, kurse vendi i martirizimit, Ulpiana.³⁷ Sipas Martyrologium Romanum thuhet se Flori dhe Lauri kanë qenë dëshmitarët e parë të krishterimit në Ulpianë, po ashtu, thuhet se profesioni i tyre ishte gurgdhendës, (artis lapidiciane).³⁸ Flori dhe Lauri ishin vëllezër binjak dhe ishin zhvendosur nga vendbanimi i mëparshëm i tyre bizantin dhe mendohet se u vendosën në Ulpianë për të ndërtuar një tempull ngaqë ishin mjeshtër të përpunimit të gurit. Ata në Ulpianë u paraqitën edhe si predikues dhe misionarë, i shëronin njerëzit e plagosur, shpërndanin edhe pagën e tyre për banorët e varfër të Ulpianës dhe filluan që disa banorë të Ulpianës t’i kthenin në të krishterë. Pasi që tempulli pagan kishte përfunduar së ndërtuari, Flori dhe Lauri shkatërruan të gjitha simbolet pagane të tempullit dhe aty vendosën kryqin. Pas kësaj ngjarje Flori dhe Lauri u dërguan tek Licini me ç’rast u morën në pyetje dhe pastaj u ekzekutuan dhe u hodhën në një pus të

³⁵ Gaspër Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj* (Ferizaj: Drita, 1992), 23.

³⁶ Exhlale Dobruna-Saliu, “Përhapja e krishterimit në Dardani”, *Dardania Sacra* 1 (1999), 49.

³⁷ Gjini, *Ipeshkvia*, 59.

³⁸ Gjon Berisha, *Organizimi kishtar në Kosovë gjatë Mesjetës* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2014), 26-27.

thellë.³⁹ Bashkë me këta dy martir, përmenden edhe “socii plures”, që do të thotë shumë shokë. Sipas disa dorëshkrimeve greke, këta duhet të ishin të varfrit e shumtë të cilëve ju ndihmuan Shën Flori dhe Lauri. Këta shokë, u ndihmuan Florit dhe Laurit t’i rrëzonin dhe thenin idhujt pagan të tempullit të ri, por edhe për këta u urdhërua që të vriteshin, përkatësisht të digjeshin. Në kohën e sundimit të Kostandinit të Madh u gjetën eshtrat e Shën Laurit dhe Florit të cilat pastaj u bartën në Kostandinopojë. Atje i vendosën në Kuvendin e Shëlbuesit të Gjithëpushtetshëm, afër kishës së Shën Filip apostullit.

Një çështje ende e pa definuar plotësisht është koha kur kanë jetuar dhe kur u martirizuan këta martirë. Askund se kemi të shënuar kohën e persekutimit të tyre, prandaj nuk mund të japim një përgjigje definitive në këtë çështje. Sipas G. Gjinit mund t’i përafrohemi viteve të veprimtarisë së Florit dhe Laurit duke e lidhur atë me kohën e persekutimit të mësuesve të Florit dhe Laurit. Ata ishin Prokuli dhe Maksimi. Këta të fundit u martirizuan në kohën e perandorit Hadrian (117-138). Sipas kësaj, edhe nxënësit e tyre Florin dhe Laurin duhet t’i vendosim në një kohë jo shumë larg martirizimit të tyre. Licini, i cili urdhëroi ekzekutimin e Florit dhe Laurit ishte një administrator në Dardani që përmendet në disa akte dhe nuk duhet të ngatërrohet me kohën e perandorit Licin (308-325), i cili ishte një tjetër personazh i cili veproi vite më vonë. Me gjasë, martirizimi i Shën Forit dhe Laurit ka ndodhur kah mesi i shekullit II.⁴⁰

Pas fuqizimit të krishterimit dhe përhapjes më të gjerë, Flori dhe Lauri u shndërruan në një kult dhe zunë një vend të rëndësishëm në fenë e krishterë. Kultu i tyre u përhap në shumë vise dhe në forma të ndryshme. Në kalanë e Harilaqit, e cila gjendet rreth 16 km në jugperëndim të Prishtinës⁴¹ dhe prej nga shihet Ulpiana, në lindje të një kishe janë zbuluar mbetjet e dy objekteve identike arkitektonike në formë unazore. Në një monografi mbi Kalanë e Harilaqit, autorët: Fatmir Peja, Bedia Rraci dhe Arben Hajdari, pohojnë se këto objekte paraqesin një kompleks të veçantë në tërë Ballkanin Qendror dhe kanë shërbyer si një vend i rëndësishëm pelegrinazhi. Autorët në fjalë e kanë lënë të hapur mundësinë që këto objekte kanë pasur një karakter eventual të një martyriumi të cilat mund të lidhen pikërisht me kultin e

³⁹ Enver Hoxhaj, “Qyteti Dardan i krishterimit të hershëm-Ulpiana dhe marrëdhëniet me Romën”, *Kosova Arkeologjike* 1 (2006), 103.

⁴⁰ Gjini, *Ipushkvia*, 60.

⁴¹ Fatmir Peja et al., *Kalaja e Harilaqit* (Prishtinë: Muzeu i Kosovës, 2012), 15.

Shën Florit dhe Laurit.⁴² Në Patriarkanën e Pejës gjendet një ikonë e cila pasqyron ngjarjen kur Flori dhe Lauri persekutohen me vdekje dhe hedhen në një pus të thellë.⁴³

Ndërkaq, arkeologu turk, Haluk Çetinkaya pretendon se kisha pranë pagëzimores e zbuluar viteve të fundit në Ulpianë, ka mundësi që i është dedikuar Shën Florit dhe Laurit. Kulti dhe fama e Shën Florit dhe Laurit është përhapur edhe jashtë trojeve dardane, duke depërtuar deri në Rusi e vise të tjera.⁴⁴ Kulti i Florit dhe Laurit vazhdon të jetë prezent edhe në ditët e sotme, figurat e tyre tashmë janë paraqitur në dritaret e Katedrales “Nënë Tereza” në Prishtinë.

Është me rëndësi të potencohet se krishterimi u lejua të praktikohej si religjion në kuadër të Perandorisë Romake pikërisht nga një perandor me origjinë nga Dardania, më saktë nga Naissusi (Nishi i sotëm). Ky ishte Kostandini i Madh, i cili me Ediktin e Milanos në vitin 313 ia dha lirinë krishterimit. Siç shprehet edhe profesori Mirdita, ky vendim i Kostandinit nuk ishte gjest i bindjes së tij fetare, por ishte thjesht, një gjest politik. Ky ishte një veprim shumë logjik i perandorit sepse në qoftë se dëshironte të sundojë edhe mbi Lindjen, atëherë, ai patjetër ka qenë i detyruar në mos të ishte i krishterë, atëherë së paku të ishte simpatizues i krishterimit. Me këta hapa Kostandini arriti që t’i ofrohej pastaj edhe hierarkisë kishtare dhe të bëhej pjesë e zhvillimeve kryesore brenda krishterimit.⁴⁵

Me fitoren e Kostandinit kundër Licinit, fitorja e krishterimit dukej e përfunduar.⁴⁶ Një vit pas kësaj fitoreje, Kostandini në maj të vitit 325 e organizoi Konkilin e Nikesë ku morën pjesë disa qindra priftërinj.⁴⁷ Konkretisht, më 20 maj të vitit 325 Konkili i filloi punimet. Konkilin e kryesonte vet perandori, aty ishin mbledhur përfaqësues të shumë vendeve. Këtu mori pjesë edhe ipeshkvi i Dardanisë - Dacus Dardaniae nga Scupi.⁴⁸ Selia e parë ipeshkvnore në Dardani, besohet se

⁴² Po aty, 38.

⁴³ Milot Berisha, “Një vështrim historik i Dardanisë gjatë antikitetit të vonë”, *Kosova Arkeologjike* 2 (2015), 85.

⁴⁴ Haluk Çetinkaya, “Pagëzimorja dhe kisha e hershme e krishterë e sapo zbuluar në Ulpianë”, *Kosova Arkeologjike* 2 (2015), 105.

⁴⁵ Mirdita, “Gjashtë shekuj”, 44.

⁴⁶ Greame Clarke, “Third-century Christianity”, *The Cambridge Ancient History*, vol. XII (New York: Cambridge University Press, 2005), 665.

⁴⁷ Fergus Millar, *The Roman Near East 31 BC–AD 337* (Harvard University Press, 1993), 212.

⁴⁸ Gjini, *Ipeshkvia*, 30.

ishte qyteti i Scupit. Pas Scupit, Ulpiana është dëshmuar si një nga qytetet më të rëndësishme të Dardanisë. Edhe pse krishterimi në Ulpianë ishte dëshmuar shumë më herët, si seli ipeshkvnore, për herë të parë ajo përmendet në shek. IV, më konkretisht në Konkilin e Sardikës (343). Në këtë Konkil e kemi të njohur emrin e ipeshkvit të Ulpianës, në aktet e këtij Konkili ai njihet me emrin Macedonius a Dardania de Ulpianis. Pjesëmarrja e ipeshkvit të Ulpianës në këtë koncil është një dëshmi shumë e fortë për organizimin e mirë kishtar dhe për një shtrirje të gjerë të krishterimit tek popullata e qytetit.

Sipas G. Gjinit, në një letër që ipeshkvijtë dardanë i dërgojnë Papës Galezit në vitin 494, por që aty figurojnë vetëm emrat e tyre pa treguar për selitë e tyre, në mesin e nënshkrimeve të ipekshvijeve duhet ta kërkojmë edhe ipeshkvin nga Ulpiana.⁴⁹

Po ashtu për ipeshkvin e Ulpianës, kemi njoftime se luajti një rol të rëndësishëm në lidhje me fërkimet religjioze që ndodhën në kohën e perandorit Justinian. Këtë e vërteton një njoftim i biografit të Justinianit, Prokopit, i cili njofton se në këtë konflikt Ulpiana paraqitej si një qendër e rebelimit dhe se për qetësimin e situatës atje ishin dërguar trupa të shumta ushtarake. Ulpiana në atë kohë ishte qytet-seli ipeshkvnore në provincën e Dardanisë, nën metropolitanë Scopia (Shkupit) në dioqezën e Ilirikut Lindor.⁵⁰

Zhvillimet e krishterimit në Ulpianë na japin dëshmi që ashtu sikurse pothuajse në gjithë Dardaninë, edhe Ulpiana ishte vazhdimisht një zonë ku ndesheshin interesat për ushtrim ndikimi të Romës në njërën anë dhe Kostandinopojës në anën tjetër. Pikërisht në kohën e perandorit Justinian këto dallime u thelluan edhe më shumë. Me ardhjen në pushtet të perandorit Justiniani I, kisha e krishterë gjeti një mbrojtës dhe një kryetar të saj. Justiniani u mor edhe me drejtimin e çështjeve të kishës, ai ndërhyri në shumë çështje rreth organizimit fetar, organizoi koncile etj. Në kohën e perandorit Justinian filloi një epokë e re edhe për vet Kishën e Dardanisë, ajo u riorganizua dhe u fuqizua me këto reforma të reja.⁵¹ Krishterimi në Ulpianë mund të identifikohet dhe dëshmohet edhe me emra të përveçëm, Shën Flori dhe Lauri nuk janë të vetmit që lanë gjurmë të rëndësishme për historikun e krishterimit në Ulpianë, padyshim se kishte edhe të tjerë. Njëri nga këta emra ishte

⁴⁹ Gjini, *Ipeshkvia*, 55.

⁵⁰ Gjon Berisha, *Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore XI-XV* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2015), 381-382.

⁵¹ Berisha, *Arbërorët*, 385.

ipeshkvi monofizit Gergenci i shek. VI. Vendlindja e tij konsiderohet Ulpiana, dhe si argjipeshkëv i Safarës apo Thafarës ai ishte misionarë në brigjet e Detit të Kuq.⁵²

Sipas G. Gjinit, prej gjysmës së parë të shek. IV e deri në mesin e shek. VI, në Dardani përmenden këto dioqeza: Scupi, Ulpiana, Neutina, Diokletiana, Mariana, Justiniana e Parë, pastaj edhe Zapara dhe Stobi.⁵³ Ndërsa sa i përket historikut dhe zhvillimit të krishterimit të hershëm në Ulpianë ai mund të ndiqet prej shek. II. Pas fillimit të shek. IV duket se Ulpiana ishte qendër ipeshkvnore, nën qendrën e mitropolisë së Scupit. Pas shek. VI Ulpiana dhe dioqeza e saj mbetën të izoluar, sepse ndodheshin përballë dyndjeve sllave dhe ruajtjes së ekzistencës së tyre.⁵⁴ Me invadimin e barbarëve në Dardani, Ulpiana dhe shumë qendra të tjera pësuan dëme dhe krime të mëdha. Gjatë kësaj kohe u ndërpreu edhe kontaktet kishtarë me Romën.⁵⁵ Për fat të keq, historikun e qytetit dhe dioqezës nuk mund ta përcjellim gjatë shekujve vijues.

⁵² Gjini, *Ipeshkvia*, 55.

⁵³ Po aty, 56

⁵⁴ Hoxhaj, "Qyteti", 111-112.

⁵⁵ Zef Mirdita, "Shqiptarët në kontekstin e katolicizmit dhe të ortodoksisë - fryma ekumenike ndërkishtarë", *Malësia*, 8 (2013), 235-292.

Ilir CULAJ

SUMMARY

SOME ASPECTS OF RELIGION IN ANCIENT ULPIANA

The archaeological excavation developed in Ulpiana provide valuable evidence that allow us to get a general overview of the spiritual world of the inhabitants of Ulpiana, whose dwellers worshiped and honoured a number of gods, of the official and not official roman religion. Likewise, epigraphic sources, have proven some gods of dardanian origin in Ulpiana. Ulpiana was characteristic of the cult of Jupiter Ulpianensis, which is believed to have been a local deity, identified with Jupiter. Furthermore, in the town have been found a number of monuments dedicated to the Roman Jupiter. Epigraphic monuments have been found in Ulpiana dedicated to the gods such as Silvanus, Ezzaios, Mercury, Apollo, Fortuna, Knight Trakas, Dolichenus etc. An important information about religion in Ulpiana, shows that Medici was a high local god with the attributes of Jupiter and that for the first time has been proven in Ulpiana.

Regarding the documents that prove the presence of Christianity in Dardania, the first we receive are exactly from the city of Ulpiana, which talk about the occasion of the martyrdom of St. Florus and Laurus. Although Christianity was witnessed in Ulpiana much earlier, as there is an Episcopal residence mentioned for the first time in the 4th century, more specifically at the Council of Serdica (343). In this council we come to know the name of the bishop of Ulpiana, who in the acts of the Council is known as Macedonius a Dardania de Ulpianis. The participation of the Bishop of Ulpiana in this council is a very solid evidence for the good organization of the Church and for a wide expansion of Christianity among the population of the city.

After the sixth century Ulpiana and its diocese were isolated because they faced the Slavic invasions and the preservation of their existence. With the invasion of the barbarians in Dardania, Ulpiana and many other centers suffered major damage and atrocities. During this time the church has halted all the contacts with Rome. Unfortunately, the history of the city and diocese can not be followed during the following centuries.

Teuta SHALA-PELI

**PRANIA E ETNONIMIT ALBANENSIS NË RAGUZË GJATË
MESJETËS, SIPAS BURIMEVE DOKUMENTARE**

Duke u mbështetur në burimet dokumentare të hartuara në Raguzë gjatë shekujve XIV-XV, hasim të dhëna edhe për shqiptarët të cilët jetuan, vepruan apo ishin në kontakt me raguzasit qoftë për marrëdhënie tregtare apo edhe më gjerë. Nga të dhënat e shumta që ndeshim për shqiptarët po veçojmë ato që i referohen mënyrës se si ata identifikoheshin në burimet dokumentare të asaj kohe. Duke ju referuar këtij fakti kemi vënë re se shqiptarët që i ndeshim në Raguzë gjatë mesjetës, në një numër të konsiderueshëm të burimeve dokumentare, kur mungonin të dhënat për emrin e familjes (mbiemrin) apo vendin prej nga ata vinin, identifikoheshin si *albanesi*. Nuk janë të rralla rastet, kur në dokumente ndeshim termin *Albanensis* i cili në cilësinë e mbiemrit tregonte për përkatësin shqiptare të personit apo personave të caktuar që përmendeshin në ato dokumente.

Rastet ku përmendet mbiemri *Albanensis* po e fillojmë me një dokument të vitit 1302 të hartuar më 5 janar në Raguzë, i cili ka të bëjë me dëshmitë e durrsakëve në dokumente të Raguzës, me ç'rast përmendet *Stefanus Albanese*.¹ Mbiemrin *Albanensis* e ndeshim edhe në dokumentet e mëposhtme të hartuara në Raguzë: më 5 maj të vitit 1360 *Tomasius Dominici Arbanensis* merr nënshtetësinë raguzase²; në vitin

¹ L.Tholloczy-C.Jericek- E.Sufflay, *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, vol. I, Vindobonae 1913-1918(ribotim në Prishtinë: Ekskluzive 2002), I/537: " Die 5 (?) ianurii iuraverunt: "*Stefanus Albanese , Marinus de Durachio, Micho de Çachono, Conradus de Ystriço*". (më tej: Acta Alb.).

² Acta Alb., II/150: "*In minori consilio „Tomasius Dominici Arbanensis" factus est civis Ragusinus; qui iuravit esse fidelis Ragusinus et obbedire et facere omnes factiones reales et personales sicut quilibet alius Rag1usinus*"; Irmgard Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters", *Beiträge zur Südosteuropaforschung anlässlich desI. internationalen balkanologenkongresses*

1372 *Nicola Albanensis* e ndeshim në një dokument të hartuar në Raguzë, i cili flet për keqtrajtimin e raguzasëve nga ana e Gjergj Balshës në shtëpinë e tij në Shkodër³; më 5 tetor 1377 sipas një dokumenti i cili flet për banorët e Shqipërisë që kthehen në sklllevër në Raguzë, përmendet *Jançe Albanensi*.⁴ Më 11 dhjetor 1388, në një dokument të hartuar në Raguzë, i cili flet se si banorët e Shqipërisë ua japin me qira punët e tyre raguzasëve, përmendet Maria vajza e *Menschumani (!) Albanensis*.⁵ Ndërsa, në vitin 1402 përmendet *Bozitik Albanensis* nga Stanjo, i cili sillte një barkë kripë në Raguzë.⁶

Po kështu, më 21 nëntor të të njëjtit vit, përmendet përsëri *Bozitik Albanensis* si padron i një barke e cila barte kripë prej *Stanji* në Raguzë (*Un de ceux-ci est le "valet de Bositichus albanensis patron de la dite griparea", lequel déclara que Bositichus albanensis ne se trouvait pas fans cette griparea*).⁷ Në vitin 1403, *Nikollë Albanensis* i lëshohen me qira disa toka e vreshta që gjenden në rrethin e Raguzës, duke iu caktuar detyrimet përkatëse.⁸ Po në Raguzë, më 27 janar të vitit 1408, prokuratorët e fretërve të provincës së Bosnjës, dëshmojnë se kanë marrë për një manastir të Kurcolës "tetëmbëdhjetë perperë të shpenzuar në blerjen e grurit që *Bostik Albanensis* ka dërguar në Stanjo".⁹ Krahas qytetarëve të rëndomtë, në burimet dokumentare me mbiemrin *Albanensis* i ndeshim edhe mjaftë klerikë të cilët vepronin në Raguzë. Një rast të tillë e ndeshim në një akt noterial të vitit 1400, sipas të cilit për vërtetësinë e një dokumenti dëshmojnë dy klerikë, njëri nga

in Sofia. München 1966, 384. (Më tej: Mahnken, "Beziehungen")

³ Acta Alb., II/297.

⁴ Acta Alb., II/346: "*Dobrussa filia Goyslavi de Albania*" promittit stare annos 6 cum *Jançe Albanensi*" se obligante dare victum et vestitum et tenere ipsam pro filia carnali et in fine termini ipsam maritare".

⁵ Acta Alb., II/434: "*Maria filia Menschumani (!). Albanensis*" locat se Çanino Sallimbene speciaro ad anrios 4."

⁶ Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV, vëllimi I, përgatitur nga Injac Zamputi, Luan Malltezi, Tiranë 1987, dok. 238 (më tej: *Dokumente për historinë*): "*Est attesté, durant un procé, que " Bositichus albanensis de Stagno. Conducebat vnam barcham salis Ragusium*".

⁷ Dokumente për historinë, dok., 282.: "... *Un de ceux-ci est le "valet de Bositichus albanensis patron de la dite griparea", lequel déclara que Bositichus albanensis ne se trouvait pas fans cette griparea*".

⁸ Državni Arhiv u Dubrovniku, *Diversa Notariae*, XI/53v (më tej: DAD, Div. Not.) Dokumentet e cituara nga Arkivi Shtetëror i Raguzës, janë huazuar nga studiuesi Gjjon Berisha.

⁹ Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë, Dokumente për historinë e Shqipërisë, shek. XV (1406-1410), Dosja A. III./563, dok. 204, (më tej: AIH, A. III./563).

ta është dom *Pjetër Albanensis*, ish-sakrestan i Kishës së Shën Marisë së Madhe të Raguzës.¹⁰ Po ashtu, në vitin 1404, në Raguzë flitet për dy klerikë shqiptarë, dom *Gjon Albanensis* dhe dom *Nikollë Albanensis*. Me këtë rast Zviku, tellalli i bashkisë, dëshmon se me urdhër epror ka sekuestruar pranë dom *Gjon Albanensis* dhe dom *Nikollë Albanensis* dhe Zvikut, një krevat të pajisur dhe ka dhënë urdhër të mos t'ia japin askujt derisa të dalë e drejta në shesh.¹¹

Dokumente tjera të rëndësishme në të cilat e ndeshim mbiemrin *Albanensis* janë edhe testamentet e hartuara gjatë mesjetës në Raguzë. Në vijim po përmendim disa prej tyre: në testamentin e “*Stepe de Silliuastro*”, të vitit 1337, ndër personat e tjerë që përmenden është edhe një “*filius Nicole Albanesis*”¹²; në vitin 1363 përmendet *Dobre Neptis albanensis*, gjatë ekzekutimit të një testamenti¹³; më 25 tetor 1400 në Raguzë, gjatë shpërndarjes së disa të hollave dhe plaçkave të lëna në testamentin e Stanislavës, përmendet dom *Nikollë Albanensi*, i cili së bashku me dom Theodorin nga Pulti dhe dom Pjetër Verdemirin, marrin nga 2 perperë e 2 groshë, për 12 meshat e kënduara për Stanislavën dhe burrin e saj.¹⁴ Më 24 shtator 1401, përsëri në Raguzë, si dëshmitar i një testamenti përmendet dom *Theodor Albanensis* (*Le testament de pribna vxor dobrouich a comme témoin aussi dompnus Theodorus Albanensis*),¹⁵ ndërsa, më 19 shkurt 1403 në Raguzë, përmendet dom *Gjon Albanensis*, kapelan i Kishës së Shën Vlashit, i cili dëshmon se kishte marr një shumë nga testamenti i zonjës Nuce për meshime.¹⁶ Po në këtë vit, më 10 dhjetor në Raguzë, nga shpërndarja e testamentit të Zvjetskës, përmendet edhe dom *Gjon Albanensis*, i cili bën dëshmi se mori pesë perperë,¹⁷ për meshime.¹⁸ Më 17 janar 1405, në testamentin e Ljubes të hartuar në Raguzë, përmendet tregtari *Gen (Gjon) Albanensis*, tek i cili ajo thotë se ka vënë peng një unazë argjendi të smaltuar për 7

¹⁰ DAD, *Testamentam Notariae*, VIII/242v. (më tej: DAD, Testam.).

Dokumente për historinë, dok., 79: “... sont temonis “dompnus Petrus albanensis olim sacristanus ecclesie Sancte Marie maioris Ragusij et dompnus Petrus de Antibaro”.

¹¹ DAD, *Diversa Cancellariae*, XXXV/62. (më tej: DAD, Div.Canc.).

¹² Mahnken, “Beziehungen”, 384.

¹³ Ibid.

¹⁴ *Dokumente për historinë*, dok., dok. 75: “... Item dixit dedisse Dompno Theodoro, de pollato, et Don Nicolao albanensi et domino Petro Verdemir...”.

¹⁵ Ibid., dok., 140.

¹⁶ DAD, *Distributione Testamentam*, VI/120. (më tej: DAD, Dis. Test.).

¹⁷ DAD, Dis.Test, VI/160v.

¹⁸ *Dokumente për historinë*, dok., 403, shën.6.

groshë.¹⁹ Më 6 tetor 1406, në Raguzë, nga zbatimi i testamentit të Nikollës, djalit të Mikel de Bodazia, dëshmojnë se kanë marrë të holla priftërinjtë: “*Nikola Albanensis...*, Andrea Gjergji nga Tivari..., Marku nga Pulti.”²⁰ Ndërsa, më 9 gusht 1407 në Raguzë, Pribil Nigoceviq dëshmon në testament se ka disa pengje të marra nga *Gjon Albanensis* nga Tivari.²¹ Kurse, më 12 maj 1408 në Raguzë, një prift shqiptar nga Propati dëshmon se ka marrë një sasi të hollash për shërbime fetare.²²

Gjithnjë duke ju referuar burimeve dokumentare të hartuara në Raguzë, krahas të dhënave që i përmendem më lartë, të shumta janë edhe rastet të cilat ju referohen çështjeve që kanë të bëjë me aspekte të natyrës gjyqësore, si rrahje, ngatërresa të ndryshme, dëshmi për grindje etj., në të cilat mbiemri *Albanensis* tregon për përkatësinë shqiptare të personave të përfshirë në to. Të kësaj natyre janë shembujt në vijim. Më 15 maj 1401 në Raguzë, *Nikollë Albanensis* e padisin se ka marrë pjesë në një rrahje (*Est accusé Nichola albanensis por avoir pris part á une rixe*)²³, ndërsa, më 21 shkurt 1402, në një padi në Raguzë përmendet *Johan (Gjon) Albanensis*. Sipas padisë kuptojmë se hebreu Isak hedhë në gjyq rrobaqepësin *Johan Albanensis*, se është rrahur prej tij. Rrobaqepësi *Johan Albanensis* ankohet gjithashtu nga ana e vet kundër hebreut Isak i cili pa paguar, por me forcë deshi t’i merrte një xhaketë që ai i kishte bërë këtij (*Ixach Ebreus cite en justice Johannem albanensem sartorum, sodium magjistri Ricardo. Sartoris por s’être fait malmener par lui. Johanes albanenses artor*).²⁴ Më 5 nëntor 1402 në Raguzë, *Gjon Albanensis* përmendet si dëshmitar në një proces për grindje (*Jon albanassin figure comme témoin fans un procès de conflit*).²⁵ Përsëri, më 30 dhjetor 1402, në Raguzë, *Johan Albanensis*, rrobaqepës, përmendet si dëshmitar i një padije që bën shërbyesja e një rrobaqepësi tjetër nga Franca (*Johannes albanensis artor figure comme témoin d’un plaid que fait la domestique d’un tailleur de la France*).²⁶ Më 26 prill 1403, në Raguzë, *Gjin Albanensis* është ndër dëshmitarët e një çështjeje në Raguzë (*Gin albanensem figure du nombre des témoins*

¹⁹ DAD, Testam., IX/65v-66.

²⁰ AIH, A.III./563, dok. 83.

²¹ DAD, Testam., IX/94v-95.

²² AIH, A. III./563, dok. 231.

²³ *Dokumente për historinë*, dok., 107.

²⁴ *Ibid.*, dok., 191.

²⁵ *Ibid.*, dok., 272.

²⁶ *Ibid.*, dok., 291.

por une affaire à Raguzë),²⁷ më 13 tetor 1403 në Raguzë, *Nikolla Albanensis* figuron si dëshmitar në një grindje (*Nicholla albanensin figure comme temoins fans un plaid*).²⁸ Më 8 nëntor 1403, në Raguzë, një durrsak akuzohet se ka marrë në anije *Stefan Albanensis*, i cili ishte arratisur nga porti i Prapatonës (*un de ceux-ci était Stefanus Albanenssis*).²⁹ Më 11 dhjetor 1403, në Raguzë, *Johan Albanensis* padit në gjyq Bogiç kovaçin duke thënë se: “dje në mbrëmje, ndërsa po bëja rojën në dhjetëshen e natës, Bogiçi i thënë më goditi me një copë dru”, (*Johannes albanenssi cite en justice Bogich fabrum dicens quod eri de sero dum essem ad custodiam pro decenia noctis dictus bogich cum una macia ligne percusit me*).³⁰ Në një gjyq për grindje, më 28 prill 1405, në Raguzë, flitet edhe për *Gjon Albanensis* (*Dans un plaid por conflit figure également un Gion albanensem de Vmbla*).³¹

Përsëri në qershor të vitit 1405, në një gjyq për grindje si dëshmitarë ishte edhe *Johani Albanensis* dhe *Andrea*, vëllai i tij, (*Dans un plaid por conflit, sont appelés comme témoins Jon albanensis perlaput et Andreas krater Jon albanensis perlaput*).³² Më 20 shkurt 1406, në Raguzë, përmendet *Nikola Albanensis* kovaç në një grindje.³³

Më 17 mars 1406 në Venedik *Pjetri Albanensis*, furrar nga Lezha, shprehet kundër venedikasve dhe për këtë torturohet nga Republika e Venedikut.³⁴ Më 8 korrik 1408, në Raguzë, *Nikolla Albanensis* del dëshmitar në çështjen e një ankese që bëhet kundër “Radsla Balsiqit”,³⁵ më 5 shtator 1409 në Raguzë, *Andrea Albanensis*, figuron i regjistruar si dëshmitar, së bashku me disa të tjerë për një padi të bërë nga “Pribio Bratinoviq”, kundër “Miro Skrobotiviqit”³⁶; më 21, 25 nëntor 1409, në Raguzë, “*Pal Albanensis*” është regjistruar si dëshmitar i një padie që ka ngritur “Zvetko Suniqi” kundër “Radasim Osegoviciq”.³⁷

²⁷ Ibid., dok., 325.

²⁸ Ibid., dok., 382.

²⁹ Ibid., dok., 396.

³⁰ Ibid., dok., 405.

³¹ Ibid., dok., 514.

³² Ibid., dok., 529.

³³ AIH, A. III./563, dok. 16.

³⁴ AIH, A. III./563, dok. 25.

³⁵ AIH, A. III./563.

³⁶ AIH, A. III./563.

³⁷ AIH, A. III./563.

Në përmbyllje të këtij punimi mund të themi se burimet dokumentare të lartpërmendura, krahas problemit që e shtruam në këtë punim, ruajnë të dhëna me interes edhe për shumë çështje të cilat lidhen me veprimtarinë e shqiptarëve në Raguzë gjatë mesjetës, duke përfshirë sfera të ndryshme nga integrimi i tyre në jetën ekonomike, politike, laike e fetare.

Teuta SHALA-PELI

SUMMARY

THE PRESENCE OF THE ETHNONYM "ALBANENSIS" IN RAGUSA DURING THE MIDDLE AGES BASED ON DOCUMENTARY SOURCES

In the documentary sources produced in Ragusa during the XIV-XV century, we have found evidence for the Albanians who lived, worked or were in contact with Ragusians either on trade relations or even beyond. From the data we have found for the Albanians, we highlight those that refer to how they were identified in the documentary sources of that time. Referring to the fact that Albanians we have noted that we encounter in the Middle Ages in Ragusa, in a significant number of documentary sources, when data lacked about the family name (surname), or the country from which they came, were identified as *Albanesi*.

Cases where the family name Albanensis is mentioned, which we have outlined in this paper, we started with a document drafted on the 5th of January 1302 in Ragusa, where *Albanese Stefanus* is mentioned. Other important documents in which we encountered the surname Albanensis, are testaments developed during the Middle Ages in Ragusa. Always referring to the source documents produced in Ragusa, many are also cases which refer to matters that have to do with aspects of a judicial nature, like beating, various confusions, evidence of contention, etc., in which the family name Albanensis indicates the Albanian ethnicity of those persons.

Documentary sources mentioned in this paper, in addition to the problem posed, store data of interest to many issues related to the activity of Albanians in Ragusa during the Middle Ages, including different areas of integrating themselves in the economic, political, secular and religious life. We can also conclude that there are no rare cases, when we encounter in the documents the surname Albanensis which showed about the Albanian ethnicity of the person or persons designated to be mentioned in those documents.

Agron ISLAMI

**RAJA E GJAKOVËS SIPAS DEFTERIT TË XHIZJES TË
VITIT 1750**

Xhizja është taksë vjetore e cila merrej nga meshkujt jomyslimanë, nënshtetas të Perandorisë Osmane. Kjo taksë e cila mbulonte pjesën më të mirë të buxhetit të shtetit osman¹ deri në vitin 1856, ishte mbledhur nën emrin *xhizje*, ndërsa nga viti 1856-1909 ishte mbledhur nën emërimin *bedelat-i askerijje* (taksa e shërbimit ushtarak) dhe më 1909, pas aprovimit të ligjit për shërbimin ushtarak të gjithë shtetasit meshkuj pa dallim feje, ishte larguar si taksë.

Praktika e mbledhjes së xhizjes i takon perandorive dhe qytetërimeve shumë më të hershme se vetë shteti osman², sikur bie fjala, romakët merrnin taksën e quajtur "*gezîd*" nga banorët e *gotëve* të Francës, mbi parimin e ruajtjes së jetëve të tyre³, ashtu sikurse edhe në Hungarinë e sotme merrej një flori për kokë banori nga sundimtarët e kohës.⁴ Ndërsa, sistemin e regjistrimit të tokave nëpër defterë me qëllim identifikimi për vjeljen e taksës së tokës e gjejmë edhe në traditën e shtetit paraosman të selxhukëve.⁵

¹ Ziya Kaziç, *Osmanlı Vergi Sistemi*, (Istanbul: Samil, 1997) f. 7-8.

² Mehmet Z. Pakalin, *Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü* (Istanbul: Nadir Kitap, 1971); Halil İnalcık, "Osmanlılarda Raiyyet Rüsumu", *Belleten* 297, 1959.

³ Neşet Çağtay, "Osmanlı İmparatorluğunda reâyâdan Vergi ve Resimler", *Ankara Üniversitesi Dil ve Tarih-Coğrafya Fakültesi*, V/V, (1947), f.484-510.

⁴ Halil İnalcık, "Osmanlılarda Cizye", *DİA*, Vëllimi VIII, (1959), f. 45-48.

⁵ Nedim Filipoviç, "Ilustrimi shqiptar nga historia e hershme e sistemit të timareve në Ballkan", *Simposium për Skënderbeun* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1968), f. 83.

Pas marrjes nën kontroll të një territori nga ana e osmanëve, kadiu obligohej që të bënte regjistrimin⁶ e të gjithë banorëve, të cilët do të ngarkoheshin me pagesën e taksës së xhizjes. Defteri i përgatitur nga kadiu emërohej “*Defter-i Cizye-i Geberan*” dhe përgatitej në dy kopje, njëra kopje shkonte tek përgjegjësit e buxhetit të Perandorisë, ndërsa kopja tjetër dorëzohej tek përgjegjësit e Bejlerbejlikut. Për të bërë verifikimin e të vdekurve dhe banorëve tjerë të cilët për arsye të ndryshme nuk ishin përfshirë në regjistrimin e mëparshëm (siç ishte rasti i të miturve), një herë në tre vite bëhej krahasimi i defterëve me numrin e xhizje paguesve.⁷

Mbledhja e taksës së xhizjës tek osmanlinjtë ishte e rregulluar me ligjin (kanunamet) osman dhe sipas kësaj, tagrambledhësi duhej të merrte parasysh kushtet e parapara nëpër kanunamet osmane. Në kanunamen e Livasë së Hatvanit thuhet: “*për plotësimin e kushtit në mbledhjen e xhizjës duhet që pasuria vjetore e banuesit (qytetarit) jo myslimanë të mbërrinte vlerën prej 300 akçeve, nga vlera e shtëpisë, të mbjellat e kopshtit, delet, dhitë, pijet alkoolike etj, dhe në rast se banuesi nuk e arrin shumën e 300 akçeve nga ai nuk mund të merret taksa e xhizjës.*”⁸ Ligji osman specifikon edhe personat dhe personalitetet që ishin të falur nga xhizja, siç ishin: prijësit fetarë (priftërinjtë), fëmijët, familjet e punonjësve të shtetit, të moshuarit, gratë, personat me të meta fizike, të varfrit, të papunët etj.,⁹ por përkundër kësaj në periudhat e mëvonshme shohim që edhe personalitetet fetare kishin paguar taksën e xhizjes.¹⁰

Sipas juridiksionit osman, xhizja ndahej në dy grupe: taksa e cila merrej njëherë në vit nga principatat e krishtera të vasalizuar, dhe taksa e cila merrej nga raja osmane jomyslimane që ishte po ashtu vjetore dhe merrej për kokë banori.¹¹ Kishte raste kur shteti obligohej që taksat t’i merrte në shuma të caktuara si pasojë e kryengritjeve ose ndërrimit të vendbanimeve nga ana e fshatareve me qëllim të ikjes nga xhizjedari. Një rast të tillë e kemi në zonat e fshatrave të Kurveleshit të Shqipërisë, të cilët në vitin 1695 për t’i ikur xhizjës ndërronin vendbanimet.

⁶ Dritan Egro, *Ligji osman ndër shqiptarët e mesjetës së vonë*, (Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2012), f. 24.

⁷ İnalçık, DİA, po aty.

⁸ Çağatay, po aty.

⁹ Ahmet Tabakoğlu, *Türk İktisat Tarihi*, (İstanbul: Dergah 1994), f. 179.

¹⁰ İnalçık, po aty.

¹¹ Halil İnalçık, *Fatih Devri Üzreinde Tetkikler ve Vesikalar*, (Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1978) f.19-20.

Përgjegjësit e Perandorisë Osmane me qëllim të ruajtjes së rajasë në vendbanimet e tyre kishin bërë një marrëveshje me prijësit fetarë të zonës, ku sipas kësaj marrëveshjeje, fshatarët nuk do të paguanin taksën për kokë banori, por shumën e caktuar prej 3 031 kurushë.¹²

Vlera e xhizjës ndryshonte sipas kursit të vlerës së valutës osmane-akçes, që për rezultat shohim se në periudha të ndryshme kemi rritje drastike të vlerës së xhizjes, p.sh. përderisa në periudhën e Sulltan Sylejmanit ligjvënësit (1520-1566) vlera e xhizjes ishte mes 60-75 akçeve, në periudhën e sundimit të Muratit IV (1648-1687) ishte ngritur në 333 akçe.¹³ Duhet theksuar se deri në vitin 1690 pavarësisht gjendjes ekonomike të rajasë, xhizja merrej në vlerë të barabartë nga të gjithë pronarët e shtëpive (*hane*). Mirëpo, me iniciativën e sadrazemit me prejardhje shqiptare Mustafa Pasha Kopruluzade (1689-1691), u bë reformë edhe në mbledhjen e xhizjes dhe si rezultat i kësaj reforme ekonomike taksa e xhizjës do të mblidhej mbi parimin e gjendjes ekonomike të rajasë e cila do të ndahej në 3 klasa: e lartë (*a'la*), e mesme (*evsat*) dhe e ulët (*ednâ*). Sipas kësaj ndarjeje nga klasa e lartë do të merreshin 4 monedha ari, nga e mesmja 3 dhe nga e ulëta 1 monedhë.¹⁴

Ashtu siç u theksua më lartë, defterët e xhizjes titulloheshin me: *defter-i cizye-i geberan*, dhe vazhdojnë me emrin e ejaletit, sanxhakut, kazasë, nahijes, fshatit, çifligut apo lagjes, varësisht se cilës njësi administrative i takonin. Është me rëndësi të vihet në pah se përveç banorëve vendas të rajasë në këta defterë shpesh gjejmë edhe regjistrimin e banorëve të huaj apo të ardhurve nga zonat tjera,¹⁵ një fenomen të tillë të të ardhurve nga fshatrat e Shkodrës dhe Manastirit e gjejmë edhe në defterin që e kemi në trajtim.¹⁶

Defteri që kemi në trajtim fillon me përshkrimin: “*ky defter i xhizjes i vitit 1164 (hixhëri)/1750 miladi i përket banorëve të rajasë së kazasë së Gjakovës*”. Sikur gjithë defterët tjerë të xhizjes edhe defteri i Gjakovës përmban të dhëna të detajuara për jo myslimanët e zonës së Gjakovës. Sipas defterit në fjalë në *lagjen e vjetër (mahalle-i atîk)*

¹² Halil İnalcık, *Osmanlı İmparatorluğu Toplu ve Ekonomi, Osmanlılarda Raiyyet Rûsûmu*, (Istanbul: Eren 2009) f.15-31.

¹³ Tabakoğlu, po aty; Markus Koller, “Shqiptarët në Perandorinë Osmane-një vështrim historiografik (shekujt XVII-XVIII)”, *Historia e shqiptarëve*, përg. Oliver Jens Schmitt dhe Eva Anne Frantz (Tiranë: Botimet Përpjekja, 2012), f. 107.

¹⁴ Başbakanlık Osmanlı Arşiv Rehberi (Istanbul: BOA 2010), f. 164-165.

¹⁵ BOA, po aty.

¹⁶ BOA. D.CMH.d.26787.

banonin *jo myslimanët* e komunitetit të quajtur *latin* (të krishterë shqiptarë); në *lagjen Haxhi Omer* banonin komuniteti *romë*; në *fshatin Deçan* banonin *romë* të shpërngulur; në *lagjen Manastir të Deçanit* banonin po ashtu *romë* të shpërngulur; në *fshatin Deçan* banonin edhe 2 shtëpi tjera (që sipas substratit të emrave të banorëve kuptojmë se bëhet fjalë për rajanë shqiptare); në *fshatin Zym* banonin të krishterët shqiptarë (*latin*) të shpërngulur nga fshatrat e Hasit. Në defter gjejmë edhe komunitetin e koptëve për të cilët nuk specifikohet vendbanimi i saktë, po ashtu defteri jep të dhëna me vlerë edhe për të huajt, respektivisht të ardhurit nga fshatrat e Shkodrës dhe Manastirit të cilët kishin ardhur për të punuar ose për shkaqe tjera banonin në zonën e Gjakovës.

Në këtë punim do të mjaftohemi vetëm me dhënien e tri tabelave me informacione nga defteri për komunitetet, emrat e lagjeve, profesionet, numrin e shtëpive, numrin e banorëve taksapagues, sipas ndarjes së gjendjes ekonomike familjare, numrin e të miturve, numrin e të falurve nga taksa dhe numrin e përgjithshëm të banorëve të zonës së Gjakovës sipas ndarjes administrative në lagje dhe fshat, dhe krejt në fund do të japim tabelën e plotë të rajasë shqiptare të zonës së Gjakovës.

Tabela nr.01: Ndarja e rajasë sipas lagjeve dhe komuniteteve

Vendbanimi	komuniteti	E lartë	E mesme	E ultë	I mitur	I sëmur i falur	Nr. i shtëpive	Nr. i banorëve
Lagjja e vjetër	Shqiptarë		2	3	7	3	0	118
Lagjja Haxhi Omer	Romë		8	21	0	9	7	181
Fshati Deçan	Romë			6				26
Lagjja Manastir i Deçanit	Romë			5		1	2	25
Fshati Deçan	Shqiptarë							7
Fshati Zym	Shqiptarë		4	4	9		3	107
Koptët	Koptë			7				7
Të huajt	Jabanxhinj		0			1	1	21

Profesionet e rajasë në zonën e Gjakovës

Ashtu siç u theksua edhe me lartë, se në defterët e xhizjes veç klasifikimit të banorëve sipas të ardhurave vjetore në rangjet: *i lartë*; *i mesëm* dhe *i ulët*, gjejmë të dhëna edhe për profesionet, respektivisht zanatet e kohës që janë një vlerë shkencore për hulumtuesit e jetës socio-ekonomike të periudhës osmane. Duhet theksuar se në defterin e Gjakovës është regjistruar vetëm profesioni i pronarit të shtëpisë (*hanes*), por jo edhe i anëtarëve tjerë të familjes (djalë, vëlla, nip, akraba etj.) që mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me familje të mëdha në numër të cilat ushtronin të njëjtin profesion.

Tabela nr.02: Profesionet e rajasë

Lloji i profesione	Lagjia e Vjetër (shqiptarë)	Lagjia Haxhi Omer (romë)	Fshati Deçan (romë)	Manastiri i Deçanit Lagjia (romë)	Fshati Deçan (shqiptarë)	Fshati Zym (shqiptarë)	Koptët	Jabanxhinjtë (profesionet e jabanxhinjve nuk janë dhënë)
Argjendarë	31							
Armëpunues		2						
Bojaxhi		16		1				
Bukëpjekës	7	3				3		
Buiq			6		1	16		
Çoban						1		
Gëlqerebërës		4						
Hekurpunues		6					6	
Kopshtarë		3						
Leshpunues		24						
Marangozë		3						
Mihës		3						
Mjekë		1						
Mullis								
Murgë				9				
Poçarë	2	5						
Rrobaqepës		5						
Samarpunues								
Shërbëtor	2	1		10				
Shitës pemë-perime		2						
Shitës i qirinjve								

Shpatapunues		1						
Sëndukpunues		1						
Tregtarë								
Punëtor në fermë kuajsh		1						

Tabela nr.03:Regjistrimi i rajasë shqiptare në zonën e Gjakovës

LAGJJA E VJETËR				
Nr. i shtëpive (haneve)	Emri	Mosha	Profesioni	Shtresa
1	Ndueja, i biri i Kolës	52		E lartë
	I biri Frona	12		I liruar
	I biri tjetër Kola	5		I liruar
	I vëllai Pjetëri	42		E mesme
	I biri (i Pjetërit) Mëhilli i posa hyrë në moshën e pjekurisë	18		E mesme
2	Tare? i biri i Lazërit	51	Argjendarë	E Mesme
	I biri Mirafka	32		E ultë
	I biri tjetër To(u)na?	22		E ultë
	I biri tjetër Ndue	17		E ultë
	Nipi Lazër	2		
	Nipi tjetër Batamca?	3		
3	Toma i biri i Brankos	32	Argjendarë	E Mesme
	I biri (i Tomës) Branko, i posa hyrë në moshën e pjekurisë	15		E ultë
	I biri tjetër Marku	8		
	I biri tjetër Mata	7		
	I biri tjetër Balas(sh)in?	4		
	I biri tjetër Sima	3		
	I vëllai Siman	27		E ultë
	I vëllai tjetër Branko	9		
4	Istani, i biri i Agustinit	37	(Bosh)	E ultë
	I biri i Agustini	7		
	I biri tjetër T(o)una?	3		
	Nipi Kola	7		
5	Sebe (Shep(b)e)? i biri i Leshenit	32	Argjendarë	E ultë
6	Zefi, i biri i Lazërit	37	Argjendarë	E Mesme
7	Sini, i biri i Marko-s	32	Shitës	E ultë

			(pemësh, erimesh)	
	I vëllai Deda	27		E ultë
8	Simani i biri i Markos	42	Argjendarë	E lartë
	I biri Andreja	22		E ultë
	I biri tjetër Filipi	19		E ultë
	I biri tjetër Tu(o)na	7		
	I vëllai Sebe	40		E ultë
	I vëllai tjetër Toma	27		E ultë
	I vëllai tjetër Balrasan?	20		E ultë
	Nipi Marko, i posa hyrë në moshën e pjekurisë	16		E ultë
9	Kola i biri i Jakos	44	Argjendarë	E ultë
	I biri Mëhilli	3		
10	Brankoja i biri i Popas?	58	Argjendarë	E Mesme
	I biri Jako	27		E ultë
	I biri tjetër Zefi, i posa hyrë në moshën e pjekurisë	17		E ultë
	I biri tjetër Gjoni	3		
11	Pjetri, i biri i Kolës	47	Rrobaqepës	E mesme
	I biri Gjergji	27		E ultë
	I biri tjetër Ndoka	20		E ultë
	Nipi Damiku	19		E ultë
	Nipi tjetër Frona	9		
	Nipi tjetër Gjoni	3		
12	Agustini i biri i Markut	47	Argjendarë	E lartë
	I biri Pashka	12		
	I biri tjetër Sebe	8		
	I biri tjetër Gjoni	4		
	I biri tjetër Zefi	3		
	I vëllai Jako	37		E ultë
	Nipi Simani	8		
	Nipi tjetër To(u)na?	32	Me të meta mentale (mexhnun)	
13	Pjetri, i biri i Gjonit	27	Argjendarë	E ultë
	I biri Filipi	2		
14	Tona, i biri i Brankos	44	Bukëpjekës	E ultë
	I biri Ceka	14		E ultë
	I biri tjetër Zefi	8		
15	Tona, i biri i Lekës	42	Bukëpjekës	E ultë
	I biri Gjergji	10		
	I biri tjetër Frona	2		
16	... i biri i Markos	42	Armëpunues	E ultë
	I biri Pali	11		

	I vëllai Ndue	12		
	Nipi Jako	3		
17	Taroja? I biri i Gjonit	33	Argjendarë	E mesme
	I vëllai Siman	29		E ultë
	I vëllai tjetër Agustini	25		E ultë
18	Jako, i biri i Stefanit	53	Armëpunues	E mesme
	I biri Kola	37		E ultë
	I biri tjetër Branko		Me të meta fizike	
	Nipi Laranç-i	7		
19	Lazëri, i biri i Ndreces	32	Argjendarë	E mesme
	I biri Branko	8		
	I biri tjetër Marko	2		
	I vëllai Zefi	20	Gjendet në Kajro	
20	Mati, i biri i Zefit	42	Shitës	E ultë
	I biri Zefi	9		
21	Larançi, i biri i Pjetërit	22	Argjendarë	E ultë
22	To(u)na, i biri i Markos	32	Argjendarë	
23	Tareje? I biri i Markos	32	Argjendarë	E ultë
24	Zefi, i biri i Prandit	23	Argjendarë	E ultë
25	Mati, i biri i Zefit	23	Shitës	E ultë
27	Gjini, i biri i Noçit?	57	Bukëpjekës	E mesme
28	Gjergji i biri i Nreces	57	(Bosh)	E ultë
29	Ndrek(c)a, i biri i Markut	32	Argjendarë	E ultë
30	Mati, i biri i Ivanit	27	Argjendarë	E ultë
	I vëllai Buzha (Buza)	19		E ultë
	Marku, i biri i Batamcas	37	Argjendarë	E ultë
	I biri Filipi	3		
	I vëllai Zefi	30		E ultë
	I vëllai tjetër Kola	26		E ultë
	I vëllai tjetër Siman	23		E ultë
	I vëllai tjetër Pjetër	22		E ultë
31	Gjoni, i biri i Markut	37	Bukëpjekës	E ultë
	I biri Pjetër	2		
32	Tushi, i biri i Markut	37	Argjendarë	E mesme
33	Ndrek(c)a, i biri i Brankut	46	Argjendarë	E ultë
34	Pjetri, i biri i Goqit	47	Bukëpjekës	E ulët
	I biri Pjetëri	10		
	I biri tjetër Lazër	2		
35	Ndue, i biri i Pjetrit	12	Argjendarë	
	I vëllai To(u)na	8		
36	Lazëri, i biri i Tonas	46	Argjendarë	E ultë
	I biri Pjetri	17		E ultë
	I biri tjetër Zefi	7		


37	Tareja (tadheja?), i biri i Filipit	24	Argjendarë	E mesme
	I vëllai To(u)na	12		E ultë
38	Gjoni, i biri i Dodes	26	Argjendarë	E ultë
39	I vëllai Marku	18		E ultë
	I nipi Damiku, i biri i Kolës	12		E ultë
40	Batamca i biri i Sipas?	23	Rrobagepës	E ultë
41	Xhika i biri i Ndreces	24	Argjendarë	E ultë
	I vëllai Palë	18		E ultë
42	Tomi i biri i Sebit	37	Bukëpjekës	E ultë
43	Tomi, i biri i Mates	65	Argjendarë	E mesme
44	Zefi, i biri i Filipit	13	Argjendarë	E ultë
45	Jako, i biri i Kolës	50	Argjendarë	E ultë
46	Ndoka, i biri i Benadit	35	Bukëpjekës	E ultë
47	Stefani, i biri i Gjonit	17	Argjendarë	E ultë
48	Batamca, i biri i Agustinit	12	Argjendarë	E ultë
49	Tomi, i biri i Sebit	37	Argjendarë	E ultë
50	Kola, i biri i Zefit	12	Banues në Gjakovë, i ardhur nga Shkodra	
	Pjetëri (pa emër të prindit)	57	(bosh)	(bosh)
	I biri Filipi	20		
FSHATI DEÇAN				
1	Çase i biri i Markut	52	(Bosh)	E ultë
	I vëllai Gjoka	27		E ultë
	Nipi Ilija	32		E ultë
	Nipi tjetër Kosta	27		E ultë
	Nipi tjetër Kristo	23		E ultë
	Nipi tjetër Doda	17		E ultë
2	Krista i biri i Danes	37	Bujk	E ultë
TË SHPËRNGULURIT NGA ZONA E HASIT NË FSHATIN ZYM				
1	Simoni, i biri i Jozit	47	(Bosh)	E ultë
	I vëllai Agustin	32		E ultë: shkollimi në Prizren
	I nipi Pali	12		E ultë
	Nipi tjetër J(xh)efi	2		
	I afërmi (akraba) Lazëri, i biri i Brankos	42		E mesme

	I afërmi tjetër Branko	9		
2	Simoni, i biri i Markos	37	Bujk	E mesme: Shkollimi në Prizren
	I biri Leka	5		
	I vëllai Toma	34		E mesme
	Tjetri Loski?	33		E ultë
	Nipi Marko	7		
	Nipi tjetër Depe?	4		
	I afërmi (familjarë) Pjetër-i i biri i Xhikës	27		E ultë
	I afërmi tjetër Ndrek(c)a	14		E ultë: Shkollimi në Prizren
3	Filipi, i biri i Xhikes	67	Bujk	E mesme
	I biri Xhika	24		E ultë
	I biri tjetër Jako	30		E ultë
	I biri tjetër Tare	27		E ultë: Shkollimi në Prizren
4	Toma, i biri i Mates	47	Bujk	E ultë: Prizren
	I biri Xhibi	23		E mesme
	I biri tjetër Ivani	20		E ultë: Shkollimi në Prizren
	I biri tjetër Stefani	16		E ultë
	I biri tjetër Larançi	2		
5	Larançi i biri i Hebes?	27	Bukëpjekës	E ultë
	I biri Paloshi	22		E ultë
	I biri tjetër Tuna	22		E ultë
	Nipi Zefi, i biri i Ndues	5		
6	Depi, i biri i Sebes	24	Bujk	E ultë
	I biri Marko	2		
	I vëllai Loka i biri i Sebes	34		E ultë
7	Xhin i biri i Giç?	74	Çoban	E ultë: i ardhur nga Prizreni
8	Damik i biri i Gjonit	37	Bujk	E ultë
	I vëllai Gjergji	12		E ultë: Shkollimi në Prizren

9	Pjetëri, i biri i Pjetrit	37	Bujk	E ultë
10	Xhika, i biri i Depes	27		E ultë
	I vëllai Duka	7		
	I afërmi (akraba) Lazër i biri i To(u)nas	31		E mesme
	Mata, i biri i Doçit	64	Bukëpjekës	E mesme
	I vëllai Pjetri	60		E ultë
	Nipi Mako i biri i Markos	17		E ultë
	Nipi tjetër Doç	6		
11	Pjetëri, i biri i Dukas	86	(Bosh)	E mesme
	I biri T(o)una	27		E ultë
	I vëllai Filipi	58		E ultë
	Nipi Lazëri, i biri i Agustinit	37		E ultë
	Nipi tjetër Hili	24		E ultë
	Nipi tjetër Rafi	16		E ultë
	Nipi tjetër Doda i biri i Filipit	15		E ultë
12	Marko i biri i Brankos	47	Bujk	E ultë
	I biri Nika	18		E ultë: Shkollimi në Prizren
	I biri tjetër Branko	14		E ultë
13	Mata, i biri i Ndues	30	Bukëpjekës	E ultë: Shkollimi në Prizren
	I biri To(u)na	22		E ultë
	I biri tjetër Giras?	18		E ultë
	I biri tjetër Hill	8		
14	Deje i biri i To(u)nas	69	(Bosh)	E ultë
	Nipi Ndoka	47		E ultë
	Nipi tjetër Siman, i biri i Ndrekes	18		E ultë
	Nipi tjetër Gjoni	12		E ultë
15	Zefi i biri i Jozes	27	Bujk	E mesme
	I biri Palosh	22		E ultë
	I biri tjetër Gjergji	5		
	I biri tjetër Sebe	4		
	I vëllai Pranka (Prenek)	52		E mesme: Shkollimi në Prizren

	Nipi Stefan, i biri i Gjonit	37		E mesme: Shkollimi në Prizren
	Nipi tjetër Tuna, i biri i Pjetrit	27		E ultë
	Nipi tjetër Kola, i biri i Gjonit	13		E mesme: Shkollimi në Prizren
	Nipi tjetër Filipi	12		E ultë: i posa regjistruar
	Simon, i biri i Paloshit	37		E ultë
	I vëllai Agustin	14		E ultë
	I vëllai tjetër Xhika	12		E ultë
16	Ketre? I biri i Dodes	52	Bujk	E ultë
	I biri Dode	14		E ultë
	Nipi Ndrek(c)a i biri i Kolës	42		E ultë
	Tetri Pranka	12		E ultë
17	Deje? I biri i Filipit	29	Bujk	E ultë
18	Gjergj i biri i Nikas	32	Bujk	E ultë: Shkollimi në Prizren
	I biri Tomi	18		E ultë
	I biri tjetër Gjika	10		
	I biri tjetër Lesh	8		
	I biri tjetër Leka	4		
	I biri tjetër Simon	7		
19	Kola i biri i Ndrekes	62	Bujk	E ultë
	I biri Pranka	27		E ultë: Shkollimi në Prizren
	I biri tjetër Gjon	12		E ultë
	I biri tjetër Simon	22		E ultë
20	Ndrek(c)a i biri i Dodës	62	Bujk	E mesme
	I biri Marko	20		E ultë
	I biri tjetër Dod	9		
	I biri tjetër Zef	7		
	I afërm (akraba) Pjetëri i biri i Gjergjit	27		E ultë: Shkollimi në Prizren
	I biri tjetër Ndrek(c)a			E ultë

	I biri tjetër Tuna	14		E ultë: i shkolluar në Prizren
	I biri tjetër Gjika	12		E ultë
21	Agustin, i biri i Pjetrit	42	Bujk	E ultë
	I biri Marin	18		E ultë: Shkollimi në Prizren
	I vëllai Joze, i biri i Pjetrit	23		E ultë: Shkollimi në Prizren
	Tjetri Lazëri i biri i Pjetrit	21		E ultë
	Nipi Gjika	21		E ultë: shkollim në Prizren
	Nipi tjetër Toma, i biri i Tares	12		E ultë
22	Kola i biri i Pjetrit	49	Bujk	E mesme
	I biri Pjeter	26		E ultë
	I vëllai Joze	32		E ultë: shkollim në Prizren
	Nipi Marko	18		E ultë
	Nipi tjetër Toma	21		E ultë: shkollimi në Prizren
23	Mato, i biri i Ndrekes	40	Bujk	E ultë
	I biri Ndreka(c)a	20		E ultë

Faksimile nga defteri i xhizjes:

Agron ISLAMI

SUMMARY

THE RAYA OF GJAKOVA ACCORDING TO THE DEFTER* OF JIZYA OF THE YEAR 1750

The Defter, which we are analyzing can be found in the Ottoman Archive of the Prime Minister of the Republic of Turkey in the fund of Kamil Kepeci-Cizye Muhasebe Kalemi with the no. 26,787 and is dedicated to the raya (non-Muslims) of the kaza of Gjakova. The Defter consists of 15 pages in the A3 format and holds the year 1750 where the inhabitants of the raya are registered by districts, the number of houses (*hane*), age, occupations and economic status by classification; high, medium and low. In this paper, after the basic information about the jizya tax, there will be given three tables with data on communities, the names of the districts, professions, number of houses, the number of taxpaying residents by division of the economic situation of the households, the number of minors, the number of those freed from taxes and the total number of residents in the area of Gjakova, and at the end we will give a complete chart of the Albanian raya of the Gjakova area.

* Registry, register

Fehari RAMADANI & Gjyla ÇELIKU

**SHKOLLAT AUSTRO-HUNGAREZE NË VILAJETIN E
KOSOVËS (1911-1912)**

Disfata që pësoi Perandoria Habsburge në luftë me Prusinë për dominim në botën gjermane, në vitin 1866, e detyroi qeverinë e Vjenës që politikën e saj të jashtme ta drejtonte drejt Ballkanit, të vetmen trevë ku ajo mund të shtrinte ndikimin e saj. Që atëherë, qeveria e Vjenës orientoi tërësisht politikën e saj të jashtme drejt Lindjes. Në këtë kuadër Shqipëria dhe çështja shqiptare do të bëhen pjesë e programit politik dhe strategjik të saj në Gadishullin Ballkanik. Ballkani duhej t'i zëvendësonte Austrisë humbjet e territoreve në Itali dhe të rolit udhëheqës në Gjermani¹, si dhe t'i rikthente dinastisë së Habsburgëve prestigjin e humbur.

Ky ndryshim në kursin e politikës së jashtme, bëri që qeveria e Vjenës të fillonte të investonte në politikën e saj ballkanike. Fillimisht ajo u angazhua të fuqizonte pozitat ekonomike dhe politike në Ballkanin Perëndimor dhe në Shqipëri, me çka nga gjysma e dytë e shek. XIX fitoi një pozitë të privilegjuar në raport me fuqitë tjera evropiane.

Nga ajo kohë qeveria e Vjenës fillon të interesohet për çështjen shqiptare në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë për kulturën dhe shkollat shqipe. Qëllimi i Austro-Hungarisë ishte ngritja arsimore dhe kulturore e popullit shqiptar, të cilin synonte ta kishte aleat në Ballkan. Vjena si mbrojtëse e besimtarëve dhe në këtë kuadër edhe e klerit katolik në Perandorinë Osmane, kishte depërtuar prej kohësh në

¹ Prela, Zef. 1962. Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912), Në *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, (Përmbledhje studimesh kushtuar 50-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë). Tiranë, f. 103.

Shqipërinë e Veriut, në kuadër të *Kultusprotektoratit**. Ajo vepronte në marrëveshje me Vatikanin, duke dhënë ndihma të gjithanshme kishës katolike shqiptare si dhe mbajtjen e shkollave, të cilat i drejtonte kleri katolik, kryesisht shqiptar. Kështu, elementit katolik shqiptar iu lejua nga Perandoria Osmane të hapte shkollat e veta fetare, ku gjuha shqipe mësohej si mjet për t'i shërbyer edukatës fetare.² Por, meqenëse ai zhvillohej në gjuhën shqipe ishte me interes të veçantë, pasi ndikonte në ndërgjegjësimin kombëtar dhe në këtë kuadër ndihmonte Lëvizjen Arsimore Shqiptare.

Shkolla e parë, ku fillon mësimi i gjuhës shqipe, e që ishte nën përkujdesjen e qeverisë austriake, ishte Shkolla Françeskane e Shkodrës*. Më 1861 u hap në atë qytet Shkolla e Fretërve (Françeskanë). Kjo ishte shkolla e parë që njihet, “*me të cilën zën fill mësimi i gjuhës shqipe*”³. Shkollat “katolike” në Shqipëri kishin vepruar edhe para vitit 1861, por, në to mësimi ishte zhvilluar në gjuhë të huaj. Sipas revistës françeskane “Hylli i Dritës”, në Prizren, Gjakovë dhe Pejë, që përpara vitit 1840 kishin funksionuar shkolla për djem.⁴ Në vitin 1846 ishte hapur shkolla e Stubllës,⁵ kurse shkolla e Janjevës ishte

* Të drejtën e *Kultusprotektoratit* mbi popullsinë katolike shqiptare, Austro-Hungaria e siguroi në bazë të disa marrëveshjeve që nënshkroi me Perandorinë Osmane, siç ishin: paqja e Silvatorokut të vitit 1615, Traktati i Karllovacit (26 janar të 1699), Traktatin e Pozharevacit të 21 korrikut të vitit 1718 dhe të Beogradit të 18 shtatorit të 1739, si dhe në “*Letrat patente*” të lëshuara nga sultani, sipas të cilave “*Austria trashëgoi nga Venediku të drejtën e mbrojtjes së Vendeve të Shenjta dhe të drejtën e paraqitjes së ipeshkëve katolikë të Rumelisë*”. Në këtë kuadër përfshihej edhe Shqipëria. Në bazë të këtyre marrëveshjeve, qeveria austriake (austro-hungareze), ushtronte të drejtën e protektoratit për sa i përket fesë katolike, kishës, priftërinjve dhe kuvendeve të tyre dhe kundrejt instituteve bamirëse. Nga viti 1837, Kuria Romake ia kalon perandorit të Austrisë të drejtën e mbrojtjes së katolikëve shqiptarë, çka shënoi forcimin e ndikimit dhe të interesimit të Perandorisë Danubiane për Shqipërinë. [Për më tepër shih: Ramadani, Fehari. 2011. Fillimet e interesimit të Austrisë (Austro-Hungarisë) për çështjen shqiptare. Në *Gjurmime albanologjike*, nr. 40-2010. Prishtinë, f. 216-218].

² Shaplllo, Siri. 1975. *Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri*. Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike, f. 15-16.

* Austro-Hungaria që nga viti 1855 kishte filluar të financonte shkollat në Shqipëri. Por, në ato shkolla mësimi është zhvilluar në gjuhën italiane. Prandaj, si shkollë e parë ku fillon zhvillimi i mësimi në gjuhën shqipe konsiderohet Shkolla Françeskane.

³ Pipa, F. 1962. *Nji shekull Shkollë Shqipe 1861-1961*. Romë: Shëjzat, f. 3; “Hylli i Dritës”, Nr. 10, Shkodër, 1931, f. 570.

⁴ “Hylli i Dritës”, Nr. 5, Shkodër, 1933, f. 242; Shih dhe “Leka”, Nr. 7, Shkodër, 1937, f. 293-294; Redžepagić, J. 1974, *Školstvo i prosveta na Kosovu od kraja XVIII stoleća do 1918 godine*, Priština, s. 102-103.

⁵ Koliqi, Hajrullah, 2002, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*,

hapur më 1857.⁶ Para vitit 1880, shkolla për djem, ku mësimi është zhvilluar në gjuhën shqipe kanë pasur Shkupi e Zymi, kurse pak më vonë një shkollë e tillë u hap edhe në Ferizaj.⁷ Megjithëse disa nga këto shkolla ishin hapur pa përkrahjen e Vjenës, më vonë ato u mbështetën financiarisht nga qeveria austro-hungareze.

Rritja e rivalitetit me Rusinë dhe Italinë e shtynë qeverinë vjeneze të shtonte interesimin e saj për shkollat në Shqipëri. Për të fituar simpatinë e popullit shqiptar, Austro-Hungaria futi gjuhën shqipe si gjuhë mësimi në shkollat e saj në tokat shqiptare, si dhe në vazhdimësi rriti numrin e shkollave.

Austro-Hungaria, megjithëse vazhdoi të mbante marrëdhënie të mira me Perandorinë Osmane edhe gjatë fundit të shek. XIX dhe fillimit të atij XX, ajo ishte e vetëdijshme, se kësaj perandorie i kishte ardhur fundi dhe se nuk do të ishte e largët dita, kur ajo do të duhej të largohej nga pjesa e mbetur e Evropës Juglindore, pra edhe nga tokat shqiptare. Në një letër që ministri i Jashtëm austro-hungarez, Goluchowski, i dërgonte ambasadorit të tij në Stamboll Kalise (Calise) në shkurt të vitit 1897, theksonte që në fillim se *status quo*-ja e Perandorisë Osmane ishte vërtetë “*garancia*” më e mirë për Austro-Hungarinë, por tatëpjeta e Perandorisë së sulltanëve ishte tashmë kaq e qartë, sa që nuk mund të rrihej më duarkryq në pritje të ngjarjeve.⁸ Prandaj, Vjena filloi t’i kushtojë rëndësi gjithnjë e më shumë çështjes shqiptare, e sidomos çeljes dhe funksionimit të shkollave shqipe.

Dëbimi i Perandorisë Osmane nga Ballkani do t’i hapte rrugë Rusisë që nëpërmjet shteteve aleate në Gadishull të zgjeronte sferën e ndikimit të saj në këtë pjesë të Evropës Juglindore, çka binte në kundërshtim me interesat austro-hungareze. Prandaj, Vjena i kushtoi një rëndësi të veçantë çështjes shqiptare. Ajo ishte e interesuar të ndihmonte në ngritjen kulturore të popullit shqiptar, të cilin synonte ta përdorte si barrierë kundër pansllavizmit. Shkollat austro-hungareze u hapën në territoret e banuara nga shqiptarët e besimit katolik. Pjesa më e madhe e shkollave u hapën dhe funksionuan në Vilajetin e Shkodrës dhe sidomos në qendrën e këtij vilajeti, në qytetin e Shkodrës. Por, shkolla të tilla kanë vepruar edhe në Vilajetin e Kosovës.

Prishtinë: Shtëpia Botuese Libri Shkollor, f. 149.

⁶ Rexhepagiq, Jashar, 1970, *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Prishtinë, f. 24.

⁷ Gjini, Gaspër, 1982, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Zagreb: Drita, f. 185.

⁸ Puto, Arben, 2003, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Tiranë: albin, f. 46-47.

Të dhëna me interes për veprimtarinë e shkollave austro-hungareze në Shqipëri, përfshirë këtu dhe ato të Vilajetit të Kosovës, na sjell mësuesi i shkollës shqipe të Pejës, Zef M. Harapi, i cili ishte mësimdhënës në shkollën austro-hungareze të këtij qyteti, në vitin 1911. Sipas tij Porta e Lartë nuk e shihte me simpati funksionimin e këtyre shkollave, por, ishte mbrojtja e Austro-Hungarisë që mundësonte veprimtarinë e tyre. Ai theksonte se: *“qeveritarëve tyreq të Pejës nuk u kishte kande (nuk u pëlqente- F. R.) veprimin e asnjë shkolle shqype”*. Mirëpo, shkollat shqiptare të financuara nga qeveria e Vjenës, vazhdonin të punonin me sukses, ndonëse Portës së Lartë nuk i konvenonte veprimtaria e tyre. Sipas Zef Harapit, qeveritarët osman *“...me të plasun zëmre do të kercnojshin dhamët pá mujtë me bâ gjâ, pse ishte mproja e Austrí-Ungerís, sikurse edhe mbi të gjitha shkollat katolike që mbaheshin prej saj n’at kohë”*. Po sipas tij, në territoret shqiptare, në atë kohë, funksiononin diku tridhjetë shkolla të financuara nga qeveria e Vjenës,⁹ duhet theksuar se kjo shifër nuk është e saktë. Numri i shkollave austro-hungareze në territoret shqiptare në atë kohë ishte më i madh. Para shpalljes së Pavarësisë vepronin rreth 50 shkolla të financuara nga qeveria austro-hungareze.

Nga të dhënat që na sjell Zef Harapi, në Vilajetin e Kosovës, gjatë vitit 1911, funksiononin këto shkolla:

Në Shkup: Një mësues e një shkollë. Numri i nxënësve sillej diku 30-40. Në atë shkollë, një kohë, punoi mësues edhe atdhetari dhe lëvruesi i palodhur i gjuhës shqipe, Mati Logoreci.

Në Prizren: Shkollë fillore mashkullore me dy mësues. Ndër mësuesit më të shquar që punuan në këtë shkollë ishin: Mati Logoreci, Ndue Paluca, Lazer Lumezi, Ndoc Lezhja, Luigj Kromiqi etj. Shkollë fillore fëmnore, e drejtuar prej Motrave të Dashtnís, ku jepnin mësim 3 mësuese dhe mësonin 80 nxënës.

Në Gjakovë: Një shkollë me një mësues. Në këtë shkollë ligjëruan: Mihill Nd. Kurti, Pashko Logoreci, Ejll Ndoca.

Në Pejë: Një shkollë fillore e përzierë me një mësues dhe 30 nxënës. Në fillim mësues ishte famullitari i Pejës, kurse më vonë, në atë shkollë punuan mësuesit shekullarë: Gjergj Gjinaj, që filloi të jepte mësim në vitin 1898, e pastaj Zef M. Harapi.

Në Zym (Hasi i Prizrenit): Një mësues dhe një shkollë me 50 nxënës. Punuan mësues, Frano Pecolli dhe Frano Lufi.

Krahas shkollave të mësipërme, në Vilajetin e Kosovës vepronin

⁹ “Leka”, Shkodër, 1937, Nr. VIII-XII, f. 464, 468.

edhe shkolla të tjera austro-hungareze. Në Shkup funksiononte shkolla për vajza dhe një kopsht fëmijësh. Gjithashtu, në kryeqendrën e Kosovës vepronte edhe shkolla e Hekurudhës, në të cilën mësimi zhvillohej në gjuhë të huaj. Në këtë shkollë mësimet i ndiqnin edhe nxënës shqiptarë, të cilët mësonin gjuhët e huaja dhe pastaj arsimimin e tyre e vazhdonin në shkollat evropiane. Në Ferizaj kemi shkollën katolike të famullisë me tre klasë. Shkollë e njëjtë funksiononte edhe në Stubëll. Në Prizren krahas shkollave të sipërpërmendura vepronte edhe një kopsht fëmijësh. Shkolla katolike e famullisë në Janjevë kishte katër klasë për djem dhe tre për vajza, kurse shkolla katolike e famullisë në Letnicë kishte tre klasë.¹⁰

Disa autorë shkruajnë se në shkollat e Janjevës dhe të Letnicës, mësimi është zhvilluar vetëm në gjuhën kroate apo serbo-kroate. Mirëpo, ka të dhëna që dëshmojnë se në to është mësuar edhe në gjuhën shqipe. Sipas Jakov Slishkoviqit, të cilit i referohet prof. Jashar Rexhepagiq, në shkollën e Janjevës *“në fillim mësimi është zhvilluar në gjuhë të ndryshme, e më vonë vetëm kroatisht”*, me siguri ai e ka fjalën se mësimi është zhvilluar edhe në gjuhën shqipe. Gjithashtu, sipas katalogut të shkollës, që i takon vitit 1908, *“në ato vite nxënësit kanë mësuar edhe gjuhën shqipe”*.¹¹ Në një njoftim, që Ministria e Jashtme austro-hungareze i dërgonte konsullit të saj në Shkup, Para, në dhjetor 1904, ku e njoftonte për dërgimin e teksteve mësimore për disa shkolla të atij rrethi konsullor, ku bënë pjesë edhe këto dy shkolla, ndër të tjera thuhet: *“Shkollat fillore katolike të Shkupit, Letnicës dhe Janjevës të pajisen me tekste të reja shqipe...”*¹². Nëse nxënësit e shkollave të Janjevës dhe Letnicës nuk do të kishin mësuar edhe në gjuhën shqipe, nuk kishte arsye që në ato shkolla të dërgoheshin tekste mësimore në gjuhën shqipe. Angazhimi në shkollën e Janjevës i mësuesve shqiptarë, si: Pal Gjergja dhe Maria Gjergja, është dëshmi plotësuese se aty mësohej edhe shqip. Nuk kishte arsye tjetër pse të angazhoheshin mësues shqiptarë në një shkollë kroate, po të kemi parasysh faktin se në atë kohë kishte mungesë të theksuar të mësuesve shqiptarë. Madje, në

¹⁰ Ramadani, Fehari, 2010, Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare (1900-1912), Tetovë: Ars-ZZ, f. 96-97.

¹¹ Rexhepagiq, Jashar, *vep. e për.*, f. 168, 228.

¹² Haus Hof und Staats Archives, Politisches Archives, Wien, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, F. Dokumente të sjella nga Arkivi i Vjenës dhe të përkthyer në shqip, Vj. 13-7-7?? (dy numrat e fundit të palexueshëm). Njoftim nr. 89295/6. Fk. 190-192, i Ministrisë së Punëve të Jashtme për konsullin austro-hungarez në Shkup, Para, Vjenë, 19 dhjetor 1904. (Më tej: AIH, Vj...).

shumë shkolla shqiptare, të financuara nga Austro-Hungaria, ishin angazhuar mësues të huaj, në mungesë të mësuesve shqiptarë. Mungesa e mësuesve shqiptarë, e nxiti qeverinë austro-hungareze, që të rriste bursat për nxënës dhe studentë shqiptarë, të cilët mësonin në shkollat e saj dhe pasi mbaronin shkollën, shumë prej tyre u angazhuan të punonin mësues në shkollat shqiptare. Konsiderojmë se të dhënat e mësipërme janë dëshmi e qartë se në shkollën e Janjevës, krahas gjuhës kroate është mësuar edhe në gjuhën shqipe.

Edhe në shkollën e Letnicës, krahas zhvillimit të mësimi në gjuhën kroate, nxënësit kanë mësuar edhe në gjuhën shqipe, pasi edhe atje mësuesi ishte shqiptar. Në qoftë se mësimi do të ishte zhvilluar vetëm në gjuhën kroate, atëherë do të ishte angazhuar një mësues kroat dhe nuk kishte nevojë për mësues shqiptar. Por, me siguri mësimi në shkollë është zhvilluar në dy gjuhë dhe është parë e nevojshme që mësuesi t'i njohë të dyja gjuhët.¹³

Sipas “Hyllit të Dritës” deri në vitin 1911, pati dhjetë shkolla shqipe për vajza në Veri. Austro-Hungaria hapi shkolla të tilla në Prizren, Shkup, Pejë¹⁴ etj. Këtë e vërteton edhe Donat Kurti, i cili thotë se deri në vitin 1911, “katolikët kishin hapur 47 shkolla shqipe, ndër të cilat 10 për vajza”.¹⁵

Austro-Hungaria, të drejtën për hapjen dhe funksionimin e shkollave në territoret shqiptare, e kishte fituar në bazë të marrëveshjeve me Perandorinë Osmane. Sipas *Kultusprotektoratit*, Vjenës i njihej e drejta të kujdesej dhe të mbronte katolikët në shtetin osman. Për rrjedhojë Porta e Lartë nuk kishte të drejtë të ndërhynte në çështjet që mbulonte *Kultusprotektorati*, ku bënin pjesë edhe shkollat. Në anën tjetër qeveria e Stambollit u krijonte mjaft vështirësi shkollave kombëtare shqiptare, duke penguar hapjen e tyre ose i mbyllte ato që ishin hapur. Pengesat që nxirrnin autoritetet osmane për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe, bëri që në fillim të vitit 1912, banorët e dhjetë fshatrave të Gostivarit dhe të Dibrës, t’u pohonin autoriteteve xhonturke se do ta ndërronin fenë dhe do të bëheshin katolikë, në qoftë se qeveria nuk shpejtonte në hapjen e shkollave nëpër fshatrat e tyre, në të cilat të mësohej gjuha shqipe “*me shkronja latine*”.¹⁶ Kështu ata mendonin se

¹³ Ramadani, Fehari, vep. e përm., f. 69.

¹⁴ Sinani, Beqir, 1970, Arsimi i gruas gjatë Rilindjes Kombëtare. Në *Studime historike*, Nr. 1. Tiranë, f. 120.

¹⁵ P. Donat Kurti O. F. M. 1935, *Vepra kulturele e elementit katolik në Shqipëri*, Shkodër: Botim i “Hyllit të Dritës”, f. 16.

¹⁶ Myzyri, Hysni, 1994, Lufta e shqiptarëve të Maqedonisë për shkollën shqipe gjatë

me ndërrimin e fesë do të hynin nën *Kultusprotektoratin* austro-hungarez dhe do të fitonin të drejtën e shkollimit në gjuhën shqipe.

Qeveria e Vjenës kujdesej për mbarëvajtjen e procesit arsimor në shkollat e saj në Shqipëri. Furnizimi i shkollave me tekste dhe mjete të tjera mësimore bëhej nga Vjena. Në kryeqytetin austro-hungarez shtypeshin librat shkollorë dhe shpenzimet mbuloheshin nga Ministria e Punëve të Jashtme. Pastaj nëpërmjet Konsullatës së përgjithshme austro-hungareze në Shkodër shpërndaheshin nëpër shkolla. Gjithashtu, mësuesit dhe personeli teknik rrogat i merrnin nga qeveria e Vjenës. Në një raport, që nënkonsullata perandorake ruse në Prizren i dërgonte Shën Petersburgut, në fillim të shtatorit 1912, vihej në dukje se mësuesit e katër shkollave të atij rajoni konsullor, të cilat ishin nën mbrojtjen e qeverisë vjeneze, merrnin rroga nga konsullata austro-hungareze e atij qyteti.¹⁷

Në pamundësi të hapjes së mjaftueshme të shkollave kombëtare shqipe, për shkak të ndjekjes së një politike të ashpër të Portës së Lartë kundër arsimit shqip, mbylljes së shpeshtë edhe të atyre pak shkollave të hapura më parë, atdhetarët tanë do të përpiqen që t'i shfrytëzojnë shkollat e mbajtura nga Perandoria Habsburge, duke dërguar në to edhe fëmijët shqiptarë myslimanë dhe ortodoksë.¹⁸

Sipas studiuesit J. Kastrati, rezulton se deri në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, qeveria e Vjenës, vetëm në Vilajetin e Shkodrës financonte 47 shkolla filllore, nga të cilat 10 ishin shkolla për vajza.¹⁹ Edhe Donat Kurti, thekson se në prag të shpalljes së Pavarësisë, në Shqipëri, vepronin 47 shkolla shqipe katolike të financuara nga qeveria austro-hungareze, prej të cilave 10 ishin shkolla për vajza.²⁰

Deri në shkëputjen përfundimtare nga Perandoria Osmane, shqiptarët përballeshin me vështirësi të mëdha edhe në fushën arsimore, prandaj, politika që ndoqi në këtë fushë Austro-Hungaria në Shqipëri, ishte shumë e dobishme për popullin tonë. Këto shkolla, do të

viteve 1908-1912, *Shqiptarët e Maqedonisë*. Shkup: BFIM, f. 298.

¹⁷ *Dokumente ruse për kryengritjen shqiptare më 1912*, Instituti i Historisë në Prishtinë, Përgatitur për botim nga M. Shatri dhe R. Abdyl, Prishtinë, 2006, f. 221.

¹⁸ *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar, vëllimi I*, 2003, Tiranë: Nënë Tereza, f. 166, 137, 161; Shih dhe Asllani, Uran, 2000, *Studentët shqiptarë në Austri dhe kontributi i tyre për shtetin shqiptar*, Tiranë: Ilar, f. 62; Schwanke, Robert. December 1971, Roli i Austro-Hungarisë në Kongresin e Manastirit në vitin 1908, *Përpjekja jonë*- e përkohshme fetare e kulturore, vol. II, No. 3. New York, f. 88.

¹⁹ Asllani, Uran, *vep. e përm.*, f. 63.

²⁰ P. Donat Kurti O. F. M., *Vepra kulturave...*, f. 16.

ndihmojnë sadopak, në zbutjen e nevojave të popullit shqiptar për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe. Shkollat e financuara nga qeveria austro-hungareze, ishin mjaft të përparuara për kohën. Në to jepnin mësim, mësues të përgatitur, përgjithësisht në shkollat e Austro-Hungarisë, të cilat ishin të një niveli të lartë, për atë kohë.

Fehari RAMADANI & Gjyla ÇELIKU

SUMMARY

AUSTRO-HUNGARIAN SCHOOLS IN THE VILAYET OF KOSOVA (1911-1912)

The interest of the Austro-Hungarian government for the development of the Albanian education and culture, dates back to the mid of the 19th century. The interest of the Viennese government, for the Albanian education and culture in particular and in general for the Albanian question, was, primarily, a result of its geostrategic interests in the Balkan Peninsula. Austro-Hungary was interested in extending its influence in the eastern Adriatic coast and, to achieve this goal, it was necessary to ensure, first of all, the friendship of the Albanian people.

An important place in the Balkan policy of the Viennese government occupied the Vilayet of Kosova. Through the territories of the Vilayet passed the road to Thessaloniki, one of the most important maritime ports of that time. Vienna had interest to secure an exit to this harbour, and therefore was interested that the Kosovo territory becomes involved in its sphere. In the framework of this policy, Austro-Hungary opened and funded schools in Albania. Generally, these schools functioned in the Albanian territories inhabited by members of the Catholic faith, although the Austro-Hungarian government never denied the right to education in its schools also for children of the Muslim and Orthodox Albanians.

By the time they faced many difficulties in their efforts to open national schools, the Austro-Hungarian schools, though few in number, played an important role in the development of the education, language and in general of the Albanian culture. The importance of these schools lies in the fact that they are distinguished from other foreign schools. In the Austro-Hungarian schools the teaching generally has been conducted in the Albanian language, which was not practical for other schools funded by foreign states. Austro-Hungary funded the teachers, the technical staff of the schools, the care for their maintenance, etc. It also took care for the supply of those schools with textbooks and other school materials.

Marenglen VERLI

**LUHATJET E FUQIVE TË MËDHA DHE QËNDRIMI
SHQIPTAR PAS KONGRESIT TË LUSHNJËS**

Periodha dhjetor 1919-janar 1920, ishte periudhë shumë e vështirë për Shqipërinë. Në Konferencën e Paqes në Paris, delegacioni shqiptar, pasi e kishin injoruar i kishin bërë të qartë se Shqipëria pavarësisht asnjësisë gjatë Luftës së Parë Botërore, jo vetëm nuk do t'i rimerrte trevat copëtuara me vendimet e Konferencës së Londrës më 1913, po do të pësonte përsëri copëtime e kufizime në territorin dhe sovranitetin e vet. Traktati i Fshtë të Londrës, i 26 prillit 1915, me anën e të cilit Fuqitë e Mëdha të Antantës, joshën Italinë të kalonte në anën e tyre në konfrontimin e madh botëror, e copëtonte shprehimisht Shqipërinë e 1913, në veri e në jug, në interes të Serbisë e Greqisë dhe në përfundim në interes të Italisë. Përveç qytetit dhe krahinës së Vlorës, që do të kalonin në sovranitetin italian, Roma siguronte edhe protektoratin mbi shtetin shqiptar të rrudhur midis luginave të Drinit dhe të Vjosës. Edhe pse me këmbënguljen e SHBA-së u duk sikur traktatet e fshtëta nuk do të zbatoheshin, përsëri negociatat në Konferencë, preknin rëndë interesat e shqiptarëve dhe në bazën e tyre kishin përmbajtjen e Traktatit të 26 prillit. Situata e vitit 1919 është trajtuar jo pak nga historiografia shqiptare. Atë çfarë ndodhte në Paris, në rajon dhe në terrenin shqiptar e kanë bërë objekt të punës dhe botimeve të tyre profesorë të njohu si A. Puto, P. Milo, M. Çami etj. Ata kanë argumentuar se ngjarjet dhe veprimtaria e diplomacisë midis autorit, kur u hartua Memorandumi i SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Francës dhe 13-14 janarit 1920 kur u arrit kompromisi midis kryeministrave të Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë, praktikisht nxorën edhe një herë në dritë projektin ogurzi të 26 prillit 1915. Shqipëria ishte në prag të asgjësimit nëse do të sigurohej edhe miratimi i SHBA-së. Por,

kundërshtimi amerikan dhe një varg faktorësh të tjerë si dyzimi i diplomacisë jugosllave, përparësia e Greqisë dhe Italisë në drejtime të tjera, destabiliteti politik e social në këto vende, veçanërisht në Itali dhe, së fundi, aktivizimi masiv i shqiptarëve dhe radikalizmi i qëndrimeve për të shmangur rrezikun kryesor, e shpëtuan Shqipërinë.

Kongresi i Lushnjës, me vendimet e rëndësishme të njohura, që mori, është dëshmia më e plotë për evoluimin e situatës në Shqipëri. Ndër aktet e para që miratoi ky kongres, ishte telegrami që i dërgoi më 30 janar, ditën e parafundit të punimeve, Konferencës së Paqes. Në të protestohej kundër vendimit të marrë nga Britania e Madhe, Franca dhe Italia, për copëtimin e Shqipërisë midis Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë¹. Në vijim, në telegram theksohej se Kuvendi kërkonte për Shqipërinë “një pavarësi të plotë me kufijtë etnografikë dhe natyralë, duke korrigjuar kështu padrejtësitë që janë bërë nga Kongresi i Berlinit dhe nga Konferenca e Ambasadorëve më 1913”. Theksohej gjithashtu se “Kuvendi vendosi të mos pranojë asnjë mandat ose protektorat të huaj”². Në paragrafin e fundit të tekstit të telegramit dëshmohej vendosmëria për vendimet e marra. “Shqiptarët janë të gatshëm të bëjnë të gjitha sakrificat, thuhej në telegram, të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut të tyre kundër çdo vendimi që mund të verë në rrezik tërësinë tokësore dhe pavarësinë e tyre të plotë”³.

Në të njëjtën ditë, më 30 janar, Kongresi i Lushnjës, i drejtoi një protestë të ngjashme edhe senatit italian. Në të shprehej zemërimi kundër planeve antishqiptare në Konferencën e Paqes dhe njëkohësisht vendosmëria për të mbrojtur me çdo kusht të drejtat kombëtare⁴. “Lajmi i frikshëm... ndezi kudo zemërimin e tërbuar dhe mërinë e shenjtë të popullit shqiptar, theksohej në protestën drejtuar senatit italian, Kuvendi i kombit i mbledhur në Lushnjë... i dha fund me një zë t’u thotë përfaqësuesve të ndershëm të Italisë se në dejtë e popullit shqiptar s’ka pushuar akoma së lëvrituri gjaku i kulluar i Skënderbeut, që të mundin pra stërnipat e tij të unjin kokën e të poshtërohen, aq sa të bëhen

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi MPJ, dos. 7. Telegrami i firmosur nga kryetari i Kuvendit Kombëtar të Shqipërisë, Aqif pashë Elbasani, 30 janar 1920; Shih edhe *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar (1919-1920)* (Përmbledhje dokumentesh), redaktor përgjegjës M. Çami, botim i Institutit të Historisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, vëll. II, dok. 46, f. 58-59.

² Po aty.

³ Po aty.

⁴ Kuvendi, Romë, viti III, nr. 70, 21 shkurt 1920, f. 3.

një koloni e përvuajtur italiane e të përdoren si shpërblim për të ngopur lakmitë imperialiste të fqinjëve të tyre lakmonjës; ... shqiptarët dinë të vdesin për të mos shkuar nga njëra dorë në tjetrën si tufë delesh, e të bëhen plaçka e atyre që drejtojnë sot diplomacinë e Europës”⁵.

Më 31 janar, Aqif pashë Elbasani, në emër të Kongresit të Lushnjës, informoi për vendimet e marra edhe presidentin e SHBA-së, Uillson dhe, me një telegram të dytë, Kongresin Amerikan. Në këto telegrame kërkohej mbështetja e fuqisë përtej Atlantikut për të shpëtuar pavarësinë e Shqipërisë dhe integritetin e saj territorial. Një telegram tjetër i adresoi U. Uillsonit edhe kryeministri Sulejman Delvina, i porsazgjedhur nga Kongresi i Lushnjës. Telegramet nga Lushnja shkuan gjithashtu në drejtim të kryeqyteteve të Fuqive të tjera të Mëdha⁶.

Në emër të delegacionit shqiptar në Paris, dërgoi nga Parisi telegrame për presidentin e SHBA-së dhe Kongresin Amerikan, edhe L. Bumçi⁷. Për njohjen e opinionit publik botëror dhe të qarqeve politike të Fuqive të Mëdha, posaçërisht të SHBA-së, Italisë etj., me vendosmërinë e shfaqur në Shqipëri për të mos pranuar vendimet e Konferencës së Paqes në dëm të popullit shqiptar, shërbyen në këtë kohë një mori protestash, thirrjesh e deklaratash të nisura nga kolonitë shqiptare dhe nga miqtë e Shqipërisë.

Në telegramin e kryesisë së kolonisë shqiptare të Rumanisë, dërguar Senatit të SHBA-së, kërkohej prej tij të dëgjohej thirrja e “dëshpëruar për të ndaluar një krim të tillë kundër popullit të lashtë shqiptar, pavarësia e të cilit u njoh më parë në Londër më 1913”⁸.

Më 29 janar, Edit Durham shkruante në gazetën, që botohej në Londër, “Daily Herald”, se Fuqitë Aleate në Paris “ndodhen në pikën e kryerjes së një krimi ndërkombëtar, të vjedhjes së pavarësisë së një vendi të vogël”⁹. Kurse më 12 shkurt Komiteti i Punëtorëve Shqiptarë në SHBA dhe në Kanada, në një letër drejtuar Komitetit Drejtues të Partisë Socialiste Italiane, i bënte thirrje të luftonte kundër synimeve imperialiste të qeverisë italiane ndaj Shqipërisë. Pasi vinte në dukje apatinë dhe mosangazhimin e socialistëve italianë për t’i prerë rrugën “marrëzisë ekspansioniste, etjes për pushtime të imperializmit italian”,

⁵ *Po aty*.

⁶ P. Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë (1912-1939)*, vëll. I, Tiranë: Toena, 2013, f. 456.

⁷ *Po aty*, Telegramet të dt. 30 janar 1920.

⁸ AQSh, Fondi Kol. e Rumanisë, dos.125; Shih edhe *Lufta e popullit...*, Vëll.II, dok. 51, f. 67.

⁹ AMPJ, viti 1920, dos. 34, f. 127.

letra përfundonte se të ngresh zërin kundër “krimit të përbindshëm që po bën qeveria italiane e Romës, do të thotë... t’i shërbesh më shumë sesa Shqipërisë, demokracisë dhe Italisë”¹⁰.

Jo të gjithë e morën seriozisht reagimin e shqiptarëve, publikuar përmes përfaqësuesve të tyre në Lushnjë, Paris apo nga kolonitë e diasporës. Por, në qarqet më të interesuara për zgjidhje sa më realiste të çështjeve të Ballkanit, zëri i shqiptarëve nuk kaloi pa jehonë. Në rrethanat komplekse, kur kishin reaguar edhe jugosllavët dhe kur SHBA-ja ndihej e fyer nga anashkalimi i aleatëve evropianë në marrjen e vendimeve për “Çështjen e Adriatikut”, presidenti amerikan U. Uillson, më 10 shkurt u ktheu përgjigje kolegëve evropianë për memorandumit e tyre të 23 janarit. Ai theksonte si zgjidhjen më të mirë Memorandumit e 9 dhjetorit 1919 dhe kundërshtonte kompromisin e 14 janarit 1920, që i siguronte Italisë sovranitet në Fiume dhe në Istria. Për sa i përket Shqipërisë, Uillsoni i qëndronte pikëpamjes se Memorandumit i 9 dhjetorit “ruan në një masë të gjerë unitetin e shtetit shqiptar”, kurse kompromisi i 14 janarit “e ndan popullin shqiptar midis tre fuqive të huaja pavarësisht nga protestat e tij të fuqishme”¹¹. Presioni i SHBA-së dukej qartë, kur u kujtonte kolegëve evropianë se Memorandumit i 9 dhjetorit ishte caku i koncesioneve që mund të ofronin amerikanët¹².

Ndërkohë që shkëmbimi i pikëpamjeve të kundërta midis amerikanëve dhe evropianëve për “Çështjen e Adriatikut” e, në kuadër të saj, për çështjen shqiptare, do të vijonin gjatë shkurtit të vitit 1920 dhe më pas^{*}; shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë bënë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur rrezikun e asgjësimit të atdheut. Gjatë shkurtit 1920 një varg protestash të tjera pasuan ato të janarit. Në një protestë të fillimit të shkurtit, dërguar komandës italiane në Durrës,

¹⁰ AQSh, Fondi MPJ, dos. 322. Letër e dërguar nga Lozana më 12 shkurt 1920, në emër të Komitetit të punëtorëve shqiptarë në SHBA dhe Kanada.

¹¹ Adriaticus. *La Question Adriatique, Recueil de documents officiels*, Paris 1920 ..., f. 123-129; T. Tittoni, V. Scialoja, *L'Italia alla Conferenza della Pace. Discorsi e lettere*, Roma: 1921, f. 157-161.

¹² Po aty.

^{*} Përgjigje e dr. Lloid Zhorxhit dhe A. Mileranit e 17 shkurtit; reagimi i U. Uillsonit i 25 shkurtit; kundërpërgjigjja e franko-britanikëve e 26 shkurtit, etj.; Shih Adriaticus. *La question Adriatique*..., f. 130-133, 138-144, 145-147; Shih edhe A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit: Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik*, Vëll. I (1876-1912), Tiranë: “8 Nëntori”, 1984, dok. 24, f. 148-250, dok. 25, f. 250-253, dok. 26, f. 254-255.

qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës kërkonte të mos pengohej vendosja e saj në Durrës¹³. Më 3 shkurt përfaqësuesit e kolonive shqiptare të Rumanisë dhe të Turqisë, që ndodheshin në Paris, i kërkonin kryetarit të delegacionit qeveritar shqiptar aty, që një pjesë e anëtarëve të tij të kthehej në Shqipëri për të informuar popullin mbi projektet e hartuara në Konferencën e Paqes për copëtimin e vendit “me qëllim që vetë populli të mund të shprehë mendimin e vet dhe të veprojë si duhet”¹⁴.

Nga letra bëhet e qartë se qysh në një mbledhje të organizuar më 21 janar ishte miratuar vendimi që delegacioni të zvogëlohej në tre vetë dhe të tjerët do të duhej të niseshin sa më shpejt në Shqipëri për të sqaruar popullin mbi situatën e vështirë të krijuar nga politika e Fuqive të Mëdha. “Mirëpo, thuhej në letër, na duket se një vendim i tillë nuk është marrë parasysh. Përpara një ngurrimi të tillë dhe këtyre shtyrjeve me sot e me nesër, në çastin më vendimtar dhe më kritik në të cilën ndodhet Shqipëria, e quajmë për detyrë, theksonin përfaqësuesit e kolonive, t’i parashtrojmë vëmendjes suaj se një qëndrim i tillë mund të ketë pasojë shumë të dëmshme për vendin tonë...”¹⁵

Nuk dimë nëse delegacioni shqiptar në Paris me L. Bumçin, M. Konicën dhe M. Turtullin në përbërje kishte dijeni për qëndrimin e presidentit amerikan pasqyruar në përgjigjen për kryeministrat e Britanisë së Madhe dhe Francës, të datë 10 shkurt 1920, lidhur me memorandumun e tyre të 23 janarit. Sidoqoftë ai tashmë ishte nën presion gjithnjë e më të madh të përfaqësuesve të kolonive të diasporës shqiptare dhe të ngjarjeve politike në Shqipëri.

Pavarësisht nga faktorët nxitës, delegacioni shqiptar më 11 shkurt tentoi sërish të ndikonte te Fuqitë e Mëdha. Në këtë datë ai i dërgoi një telegram të ri kryeministrit britanik D. Llojd Xhorxh, njëherësh kryetar i Konferencës së tre kryetarëve të qeverive aleate, që vepronte në Londër në vijim të punëve të Konferencës së Paqes të Parisit të mbetura për t’u zgjidhur. Në telegram kërkohej të hiqej dorë nga plani për copëtimin e Shqipërisë dhe për asgjësimin e pavarësisë së

¹³ AQSh, Fondi Prefektura e Durrësit, dos. 1; Shih edhe *Lufta e popullit ...*, dok.56, f. 70.

¹⁴ AQSh, Fondi MPJ, dos. 2. Letër e dt. 3 shkurt 1920, firmosur nga Pandeli Evangjeli për koloninë e Bukureshtit dhe Halil Gjirokastra për koloninë e Turqisë; Shih edhe *Lufta e popullit...*, Vëll. II, dok. 59, f. 72-73.

¹⁵ *Po aty*.

saj¹⁶. Pasi përsëriste argumentet që provonin të drejtat e shqiptarëve për t'u vetëqeverisur, për të mbrojtur pavarësinë dhe për të mos lejuar prekjën e kufijve të tyre, nga fqinjët që kishin pasur “gjithnjë qëllime aneksioniste” e që “s’kishin lënë salvime e rrëtime pa kryer”, delegacioni theksonte: “Po i drejtohem pra për herën e mbrame edhe një thirrje të nxehtë ... kryeqeveritarëve të tri kombeve të mëdha ... që në zgjidhjen e çështjes shqiptare të mos pranojnë masa të tjera përveç atyre që përkojnë me drejtësinë e me vullnetin e popullit shqiptar...”¹⁷. Në telegram tërhiqej vëmendja se shqiptarët besonin në aftësitë e tyre për t'u vetëqeverisur dhe ndihmën e kërkonin “të kufizohet vetëm në dërgimin në Shqipëri të disa ekspertëve civilë e ushtarakë të caktuar prej Shoqërisë së Kombeve, por që të mos jenë prej shteteve të interesuar”. Vetëm zgjidhja e drejtë e çështjes shqiptare, shkruanin në fund të telegramit delegatët shqiptarë, do t'i shërbente “forcimit të paqes në Ballkan dhe sigurimit të së mbarës e së mirës për të gjithë popujt që rrojnë aty”¹⁸.

Në të njëjtën ditë, më 11 shkurt, delegacioni shqiptar, përsëri me firmën e kryetarit L. Bumçi i dërgonte një notë proteste përfaqësuesve të fuqive kryesore evropiane, me anën e së cilës hidhte poshtë pretendimin e përsëritur se populli shqiptar ishte “i papjekur” për vetëqeverim. “Me notat e 15 dhe 19 janarit, theksonte L. Bumçi, delegacioni shqiptar pati rastin të protestojë para Konferencës së Paqes kundër projektit të [14 janarit] hartuar nga tre Fuqitë e Mëdha, lidhur me zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut”, projekt që parashikon copëtimin e Shqipërisë.... i cili është në kundërshtim flagrant me klauzolat e Konferencës së Londrës të vitit 1913...”¹⁹.

Nota e sipërpërmendur jepte gjerësisht argumentet përse duhej ndryshuar qëndrimi në zgjidhjen e çështjes shqiptare. Aty përmendeshin këmbëngulja italiane, e pamotivuar realisht, për të aneksuar Vlorën dhe për të marrë mandatin mbi Shqipërinë, mandej shkatërrimet që kishte

¹⁶ *Shqipnia përpara Konferencës së Paqës*, Blë i dytë, Dokumenta zyrtarë të paraqitun nga ana e Dërgatës Shqiptare qyshë prej 24 Korrik 1919 e deri më 11 Shkurt 1920 e të botuem nga ana e Qeverriës Shqiptare, Shkodër: Shtypëshkroja Françiskane, f. 65-67.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *AQSH*, Fondi MPJ, dos. 6(26). Notë e delegacionit shqiptar, dt. 11 shkurt 1920, dërguar Mileranit, kryeministër dhe ministër i Jashtëm i Francës. Nga përmbajtja e notës ajo është përgatitur e dërguar edhe krerëve të Fuqive të tjera të Mëdha evropiane.

sjellë pushtimi i përkohshëm i trupave jugosllave e greke në viset që pretendonin për t'i aneksuar Beogradi e Athina.

Te argumentet e karakterit “moral”, sikurse shënohej në notë, numërohej edhe shkelja e dispozitave ligjore të Lidhjes së Kombeve (neni 220, lidhur me kriteret që përcaktonin vendosjen e një popullit nën mandat).

Në notën e 11 shkurtit adresuar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha, delegacioni shqiptar nënvizonte edhe argumentet politike, për të cilat duhej respektuar pikëpamja shqiptare për zgjidhjen e çështjes. Ndër to renditej ruajtja në të ardhmen e paqes në Ballkan, dhe për pasojë paqes në mbarë botën”.

Duke arsyetuar përse Shqipëria nuk kishte pasur stabilitet në vitet pas krijimit të saj, çka kishte frymëzuar mendimin se shqiptarët nuk ishin të zot të vetadministroheshin delegacioni shqiptar numëronte gjashtë faktorë. Sipas tij, Shqipëria pas krijimit, edhe në kufijtë e përcaktuar në Londër, nuk ishte zbrazur kurrë nga ushtritë e huaja, të cilat me terror të vazhdueshëm kishin shkatërruar vendin e kishin sjellë destabilitet. Përveç ballkanasve në këtë drejtim kishte ndikuar edhe rivaliteti midis Austro-Hungarisë dhe Italisë për dominim, që kishin sjellë përçarje me propagandën e zhvilluar në Shqipëri. Presioni i tyre mbi Princ Vidin dhe qeverinë e tij e kishte paralizuar qeverisjen efikase të vendit dhe kishte rrënuar autoritetin e kryetarit të shtetit. Për të njëjtën gjë kishte ndikuar edhe veprimtaria e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, arsyetonte në notë delegacioni shqiptar, pasi anëtarët e tij u pozicionuan sipas interesave të kundërta të shteteve që përfaqësonin.

Tejkalimi i kompetencave nga kreu i misionit të oficerëve holandezë dhe mosbindja e tij ndaj urdhrave të qeverisë, theksohej më tej në notë, ishte gjithashtu faktorë që kishte ndikuar në destabilitetin e vendit. Përmendej gjithashtu, edhe ndikimi negativ që përcolli mosrealizimi i premtimit që Fuqitë e Mëdha i bënë shtetit të ri, për ta kredituar me një hua prej 70 milionë frangash. “Shkurt, në të tilla kushte të mjerueshme u ndodh Shqipëria në çastin kur shpërtheu Lufta Botërore, që pati si pasojë dhunimin e asnjësisë dhe pushtimin e territorit të saj nga ushtritë e huaja, shprehej delegacioni shqiptar. Çdo vend tjetër, që do të ndodhej në hapin e parë të jetës së tij politike në të tilla kushte, nuk kishte si t’u shpëtonte pasojave të hidhura ...”²⁰

Së fundi, delegacioni shqiptar i lutej Fuqive të Mëdha, t’i kishin parasysh faktet e paraqitura para se t’i konsideronin shqiptarët “të paafte

²⁰ *Po aty.*

të vetëqeverisen” dhe para se të vendosnin “të dënojnë një popull të tërë të humbë pavarësinë dhe kombësinë e tij”. Nota përfundonte me konstatimin se “e vetmja mënyrë për të ruajtur paqen në Ballkan dhe rendin e qetësinë në Shqipëri, është dhënia e pavarësisë ... ruajtja e tërësisë së saj tokësore ... zbrazja e plotë... e tokave të saj nga ushtritë e huaja, si edhe ripohimi i asnjësisë së Shqipërisë, duke e garantuar atë nga Lidhja e Kombeve ...”²¹

Nota, sikurse shihet, nuk përmbante elementë të rinj të paparaqitur më parë, por çështja kishte hyrë në një rreth vicioz dhe delegacionit shqiptar nuk i ngelej veçse të këmbëngulte, duke shpresuar në mosmarrëveshjen italo-jugosllave dhe veçanërisht në diskordancën e diplomacisë amerikane me atë të tre Fuqive të Mëdha të Evropës.

Më 11 shkurt 1920, anëtarët e delegacionit zyrtar shqiptar në Paris, L. Bumçi dhe M. Turtulli, dërguan edhe një raport tjetër, këtë herë në adresë të Aqif Pashë Elbasanit. Përmes tij ata informonin për situatën në të cilën ndodhej çështja shqiptare për momentin²².

Në raport theksohej se Konferenca e Paqes nuk e pati biseduar kurrë çështjen shqiptare në mënyrë të veçantë, por të lidhur me çështje të tjera, duke e trajtuar si një mjet shpërblimi për të sheshuar mosmarrëveshjet midis fqinjëve të Shqipërisë. Rreth një vit, raportonin më tej L. Bumçi e M. Turtulli, u kapërcyen disa herë rreziqe të mëdha, por deri kohët e fundit nuk ishte marrë ndonjë vendim.

Gjatë kësaj periudhe delegacioni sipas raportuesve, kishte vepruar gjithnjë në mbrojtje të të drejtave të kombit shqiptar, të përmbledhura në kërkesat për integritetin brenda kufijve etnikë, në independencën dhe në sovranitetin dhe “nuk kishte pranuar kurrë as ma të voglin lëndim të këtyre të drejtave”²³.

Delegatët, raportonin më tej, se situata ndryshoi pas Memorandumit të SHBA-së, Britanisë dhe Francës, të 9 dhjetorit 1919, paraqitur Italisë si opsion për zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut” e në kuadër të saj edhe të çështjes shqiptare. Duke i dërguar Aqif Pashës në zarin që përmbante raportin edhe kopjen e Memorandumit, të cilin dr. Turtulli e kishte siguruar prej delegatit jugosllav Trumbiq, dy delegatët shënonin se pikërisht me Memorandumin në fjalë tri Fuqitë e Mëdha i

²¹ Po aty.

²² AQSH, Fondi MPJ, dos.8 (26). Raport i L. Bumçit dhe M. Turtullit, 11 shkurt 1920, dërguar nga Parisi Aqif Pashë Elbasanit; Shih edhe *Lufia e popullit...*, vëll. II, dok, 68, f. 86-87.

²³ Po aty.

njihnin Italisë pushtimin e Vlorës dhe mandatin mbi Shqipërinë. Pasi trajtonin përfitimet që siguronte Jugosllavia e Greqia nga Memorandumi i 9 dhjetorit, përmbajtja e të cilit është bërë e njohur në këtë monografi në kapitujt e mëparshëm, L. Bumçi dhe M. Turtulli i vinin në dukje Aqif Pashës se, lidhur me kufijtë jugorë dhe veçanërisht me rivënien në diskutim të fatit të Korçës, deri para disa ditësh u kishte munguar informacioni.

Në mbledhjet e mbajtura fillimisht në Londër e pastaj në Paris, krerët e Britanisë, Francës dhe Italisë, thuhej më tej në raport, nuk e morën parasysh Memorandumin e 9 dhjetorit dhe preferuan një projekt të 13 janarit, të përgatitur nga D. Llojd Xhorxhi, i cili vendoste për copëtimin e Shqipërisë²⁴.

Për sa i përket qëndrimit të Jugosllavisë, theksohej se ishte kundër projektit të 13 janarit, por ajo njëherësh i përmbahej idesë që, nëse Shqipëria copëtohej, do të kërkonte pjesë, madje nuk do të kënaqej me territorin deri në lumin Drin, por do të donte “edhe ma tepër”.

L. Bumçi dhe M. Turtulli vinin në dijeni Aqif Pashën, se eksperti i delegacionit britanik, Liper, më 22 janar u kishte thënë atyre dhe Mehdi Frashërit, që të bëhej një kërkesë, sipas së cilës Korça e Shkodra të mos aneksoheshin nga Greqia e Jugosllavia, “por të liheshin nën mandatin e këtyre mbretërive”. Ndërkohë, eksperti amerikan Harrison, të cilin e kishin pyetur për këtë çështje i kishte këshilluar jo zyrtarisht që mos lëviznin nga qëndrimi i parë dhe të mos pranonin asnjë lëshim ndaj tërësisë së vendit. Më vonë edhe eksperti italian Kastoldi u kishte thënë se Italia ishte gati të bënte disa lëshime në interes të Shqipërisë, që t’i detyronte edhe fqinjët e tjerë të hiqnin dorë nga kërkesat e tyre, por ata nuk i besonin pa marrë siguri nga qëndrime zyrtare. Raportuesit i dërgonin Aqif Pashës, bashkëngjitur me raportin, edhe notën e 11 shkurtit dërguar kryeministrave të tre Fuqive të Mëdha që ishin mbledhur prapë në Londër, të cilën tashmë e kemi përmendur.

Rreth dy javë më vonë, më 29 shkurt L. Bumçi dhe M. Turtulli i raportonin sërish Aqif Pashë Elbasanit rreth bisedimeve të fundit për çështjen shqiptare²⁵. Në këtë letër dy delegatët pranojnë se kanë dijeni për vendimet e Kongresit të Lushnjës, nga një letër të dërguar, më 28 janar 1920, nga Eshref Frashëri, zëvendëskryetari i qeverisë së dalë nga

²⁴ Po aty. Bashkëngjitur raportit, Aqif Pashës i dërgohej, krahas Memorandumit të 9 dhjetorit, edhe projekti i 13 janarit, sipas versionit të botuar në gazetën “Le Temps”.

²⁵ AQSH, Fondi MPJ, dos. 5 (26). Letër e L. Bumçit dhe M. Turtullit, datë 25 shkurt 1920 për Aqif Pashën; Shih edhe *Lufta e popullit...*, Vëll. II, dok. 94, f. 132-133.

Kongresi, por që atyre ajo u kishte mbërritur më 16 shkurt. Kjo do të thotë se ata e dinin nga data 16 shkurt, se ishin zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës, anëtarë të Këshillit të Lartë*. Gjithashtu, e dinin se kolegu i tyre Mehmet Konica, i cili ndodhej në Londër, ku ishte zhvendosur trojka e *Të Mëdhenjve të Evropës* për të diskutuar çështjet e mbetura ende nga Konferenca e Parisit, ishte emëruar ministër i Jashtëm dhe se për të tre ata ishte vendosur se duhej të qëndronin aty ku ishin, për të mbrojtur çështjen shqiptare.

Është disi e paqartë përse në letrën e datës 25 shkurt flitet për njoftime të marra nga letra e datës 28 janar e Eshref Frashërit kur vendimet e sipërpërmendura të Kongresit të Lushnjës i përkasin datave 30 dhe 31 janar. Gjithashtu, duket e çuditshme që vendimet e Kongresit t'u kenë mbërritur vetëm përmes kësaj letrë që udhëtoi për dy javë.

Gjithsesi, përmes prononcimit të dy delegatëve, që e përfundojnë letrën adresuar Aqif Pashës duke paraqitur vendimin e tyre “të premë e të patundshëm” për dorëheqjen si delegatë të Shqipërisë në Konferencën e Paqes dhe lutjen “për të emnue sa më shpejt delegatë të tjerë”²⁶, krijohet përshtypja se ata e konsideronin të mbyllur misionin e tyre diplomatik në Paris, ku kishin shërbyer në emër të qeverisë së mëparshme të Durrësit, por, ndoshta, edhe për faktin se Konferenca e Paqes e Parisit tashmë ia kish lënë vendin takimeve të Trojkës së kryeministrave evropianë në Londër, Konferencës së Ambasadorëve në Paris dhe veprimtarisë së Lidhjes së Kombeve.

Në letrën e 25 shkurtit, L. Bumçi dhe M. Turtulli theksonin ndër të tjera se kishin vepruar në përputhje, “një me një, me programin e vendosur prej mbledhjes së Lushnjës” dhe se në “këtë udhë do të vijojmë për sa kohë do të mbetemi këtu”. Më tej ata informonin për bisedimet që po zhvilloheshin në Londër midis kryeministrave të Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë dhe për dy nota që presidenti i SHBA-së u kishte dërguar partnerëve evropianë²⁷. Të informuar me sa duket prej M. Konicës, që ndodhej në Londër, L. Bumçi dhe M. Turtulli i bënin të ditur Aqif Pashës se nota e parë përmbante kundërshtimin amerikan për shkeljen nga franko-britanikët të Memorandumit të përbashkët të 9 dhjetorit 1919. Por, shpreheshin dy delegatët shqiptarë,

* Përbëhej nga Aqif Pashë Elbasani, imzot Luigj Bumçi, dr. Mihal Turtulli dhe Abdi bej Toptani.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ Owen Pearson, *Albania and King Zog Independence, Republic and Monarchy 1908-1939*, London: The Center for Albanian studies IB Tauris Publishers, 2004, f. 141.

“dhantë zoti, u baftë ndonjë ndryshim me rranjë, pse edhe zgjidhja e parapame prej mendores së përmendun, e që ka pëlqimin e Amerikës, Shqipërisë i sjell dëm të madh”²⁸.

Konferenca e Paqes në Paris pas një viti veprimtarie, i mbylli punimet në Paris pa i përfunduar të gjitha çështjet që duhet të zgjidhte. Konferenca e kryeministrave të tre Fuqive të mëdha evropiane, e mbledhur për çështjet kryesore në Londër e San Remo, dhe Konferenca e Ambasadorëve në Paris, do të vijonin të merrnin vendime. Do të duhej të angazhoheshin më tej, ndër të tjera, edhe për çështjen shqiptare, apo vargun e problemeve të ndryshme të saj. Do të angazhohej gradualisht edhe Lidhja e Kombeve. Çështja shqiptare do të trajtohej në këto instanca edhe për disa muaj, madje ndonjë problem edhe për disa vjet, por kjo periudhë nuk është objekt i kësaj monografie.

Shkurtimisht mund të përmendet se delegacioni shqiptar në Paris, tashmë përfaqësues i qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, i vijoi përpjekjet për një zgjidhje sa më të drejtë të çështjes shqiptare. Në këtë kuadër nuk u ndalën takimet, dërgimi i telegrameve, letrave, notave e memorandumeve ndaj përfaqësuesve të fuqive botërore vendimmarrëse.

Në një letër të datës 24 shkurt 1920, dërguar nga Parisi kryeministrit të Britanisë së Madhe, njëherazi kryetar i Konferencës së tre kryetarëve të qeverive aleate në Londër, D. Lloid Xhorxhit, kryetari i delegacionit shqiptar L. Bumçi, e vinte në dijeni mbi mbledhjen e Kongresit të Lushnjës dhe vendimet e tij.

Më 2 mars 1920 pasoi një notë në adresë të presidentit të SHBA-së²⁹. L. Bumçi këtë herë shprehej kundër zgjidhjes që Memorandumi i 9 dhjetorit 1919, i iniciuar nga diplomacia amerikane, i jepte çështjes shqiptare. Në telegram, shkruhej se delegacioni shqiptar shprehte “përshtypjen e tij të hidhur lidhur me planin për t’i dhënë Gjirokastrën Greqisë dhe për të vënë në diskutim trevën e Korçës”. Pasi bënte prezantimin e përkatësisë etnike dhe fetare të rajonit në fjalë, tashmë të përsëritur shpeshherë, se ndër 290 mijë banorë, 170 mijë ishin shqiptarë myslimanë dhe të tillë ishin edhe shumica e 120 mijë të krishterëve, nota theksonte se “provincat në fjalë ishin njohur si shqiptare nga

²⁸ AQSH, Fondi MPJ, dos. 5 (26). Letra e L. Bumçit dhe M. Turtullit, dt. 26 shkurt 1920.

²⁹ AQSH, Fondi MPJ, dos. 5 (26). Notë e delegacionit qeveritar shqiptar në Paris, datë 2 mars 1920 për presidentin e SHBA; Shih edhe *Lufta e popullit ...*, Vëll. II, dok. 102, f. 139-140.

Konferenca e Londrës më 1913”, madje ishin pranuar si të tilla edhe nga ish ministrat grekë Zografos e Karapanos, në Konferencën e organizuar më 1914 në Korfuz, në prani të Komisionit Ndërkombëtar³⁰. Prandaj nënvizohej në notë, kalimi i tyre nën sovranitetin grek, do të sillte “skllavërimin e së paku dyqind mijë shqiptarëve”, që do të futeshin “nën zgjedhën e padurueshme të grekëve”.

Duke konsideruar të padrejtë copëtimin e shumë viseve shqiptare më 1913 dhe pasojat për rreth një milion banorëve shqiptarë të tyre, L. Bumçi në notën e 2 marsit nënvizonte se po të ndodhnin cungime të tjera “sakrificat e imponuara Shqipërisë do të ishin vdekjeprurëse”.

Përfaqësuesit shqiptarë në Paris e dinin se diplomacia amerikane, duke firmosur Memorandumin e 9 dhjetorit 1919, ishte pajtuar me humbjen e Gjirokastrës në favor të Greqisë dhe me diskutimin e të ardhmes së Korçës, prandaj ofronin një gjetje, apo formulë të re kompromisi. “Shteti shqiptar është gati t’u njohë popullsisë të këtyre viseve, nën garancinë dhe mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve, të gjitha të drejtat që u përkasin bashkësive etnike ose që kanë të bëjnë me besimet e tyre”³¹ shkruhej në notën e 2 marsit. Më tej atje ripërsëritej, apo i ritërhiqej “vëmendja dashamirëse” presidentit Uillson, se aneksimi i Vlorës dhe krahinës së saj nga Italia ishte “në kundërshtim me të drejtën dhe vullnetin e popullit shqiptar, që u shprehë në mënyrën më të qartë edhe një herë në Asamblenë Kombëtare të Lushnjës më 28 të janarit ...”. Propozimi i delegacionit shqiptar për sa i përkiste ndërtimit të hekurudhës në Shqipërinë e Veriut që do t’i shërbente Jugosllavisë, konsistonte në ndërtim nga shteti shqiptar me kapitale të huaja, kurse përdorimin e lirë të saj do ta garantonte Lidhja e Kombeve.³²

Një ditë më pas më 3 mars, L. Bumçi së bashku me M. Turtullin i nisën një letër tjetër Aqif Pashës, me të cilën e njoftonin për gjendjen në të cilën ndodhej çështja shqiptare në atë moment në optikën e Fuqive të Mëdha. Fillimisht ata e informonin se ishin “tue vazhdue gjithnjë në punë” dhe do të vijonin të punonin derisa të emëroheshin zëvendësit e tyre. Më tej i dërgonin notat e shkëmbyera midis Uillsonit dhe Ll.

³⁰ Është fjala për bisedimet që filluan në Korfuz më 9 maj 1914 midis Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, të autorizuar nga qeveria shqiptare, dhe përfaqësuesve të “Lëvizjes së Vorio-Epirit”, që përfunduan më 17 maj 1914 me nënshkrimin e Protokollit të Korfuzit.

³¹ *Po aty.*

³² *Po aty.*

Xhorxhit e A. Milerandit, të cilat ato ditë ishin botuar nga media. Në tekstin e letrës duket qartë zhgënjimi i thellë, që u kishte sjellë Konferenca e Pages, me mënyrën se si i kishte nëpërkëmbur interesat e Shqipërisë e të kombit shqiptar, deri me diskutimet dhe projektet më të fundit. “Sikurse keni për ta pa edhe ju vetë, shkruanin dy delegatët, dyshimet dhe frikën që rrokull një vjeti kemi pasë mbi qëllimet e liga të qeverive të mëdha kundër nesh, po vërtetohen mjerisht, një nga një të gjitha”.³³

Trajtimi i çështjes shqiptare në projektin apo kompromisin e 14 janarit 1920, theksonin më tej dy delegatët, ishte vazhde e qëndrimit të Francës dhe Britanisë së Madhe, që nga marsi i vitit 1919. Qysh atëherë Parisi dhe Londra kërkonin t’i kalonte Greqisë, Korça dhe Gjirokastra. Por, Shqipëria pësonte edhe nga Memorandumi i 9 dhjetorit 1919, firmosur nga dy fuqitë e sipërpërmendura dhe SHBA-në. Humbja e Gjirokastrës dhe Vlorës, vënia në diskutim e Korçës dhe caktimi i mandatit etj., gjithashtu do të ishin katastrofë për Shqipërinë. Por, notat e fundit midis krerëve të shteteve të sipërpërmendura, të cilat e trajtonin çështjen midis këtyre dy opsioneve, tregojnë se për ne situata mbetet “fort e rrezikshme”, konkludonin L. Bumçi dhe M. Turtulli. Gjithsesi, arsyetonin ata, “mbasi nuk kemi tjetër mbrojtje përveç Z. Uillon, nuk kemi mund të kundërshtohemi drejt projektit të tij; po jemi përpjekë që t’i japim të kuptojë se sipas atij projekti Shqipëria do të futet nën zgjedhë të huaj”.³⁴

Dy delegatët informonin gjithashtu se po bënë të pamundurën të lobonin “me të gjitha mënyrat pranë miqve të paktë”, që mund të gjendeshin. Ishte fjala për personalitete të jetës publike e politike të Francës e të Britanisë, dashamirës të kombit shqiptar, ose miq personalë të tyre “që merren me punët e Ballkanit”. Nesër do të duhet të shkojmë në Londër për pak ditë, informonin më tej L. Bumçi dhe M. Turtulli, “që të veprojmë në mes të qarqeve politike angleze me anën e miqve që kemi atje e të kardinalit të Londrës”.³⁵

Të bënë përshtypje fakti, se me gjithë kushtet e vështira në të cilat vepronin, delegatët shqiptarë arrinin të siguronin një informacion të vlefshëm mbi hapat që ndërmerre diplomacia e Fuqive të Mëdha për

³³ AQSH, Fondi MPJ, dos. 5 (26). Letër e L. Bumçit dhe M. Turtullit për Këshillin e Lartë (Aqif Pashën), datë 3 mars 1920; Shih edhe *Lufta e popullit ...*, Vëll. II, dok. 103, f. 141-143.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ *Po aty*.

çështjen shqiptare. “Konferenca e Londrës, ndërmjet kryetarëve të tri qeverive të besëlidhuna po vijon gjithnjë, i shkruanin ata Aqif Pashës; disa gazeta thonë se në këto ditë do të përndahet për t’u mbledhur prapë në fund të marsit”. Mandej e vinin në dijeni, se në bazë të lajmeve që jepnin gazetatat amerikane kishin mësuar se presidenti i SHBA-së kishte përgatitur një notë rreth “Çështjes së Adriatikut” mbi bazën e qëndrimit të Memorandumit të 9 dhjetorit, e cila pritej të mbërrinte shpejt në Londër.

Nuk dihet nëse nota e sipërpërmendur e 2 marsit e dërguar telegrafisht nga L. Bumçi, mbërriti në duart e U. Uillsonit, por dihet se më 6 mars presidenti amerikan dha një përgjigje përfundimtare për “Çështjen e Adriatikut”³⁶. Është nota për të cilën kishte pasur njoftime në shtypin amerikan e për të cilën i raportonin Aqif Pashë Elbasanit më 3 mars, dy delegatë shqiptarë.

Duke përkrahur propozimin për bisedime direkte italo-jugosllave, që të rrafshonin kontradiktat midis tyre, kreu i Shtëpisë së Bardhë, kishte theksuar se çështja shqiptare “nuk duhet futur në diskutimin e propozuar midis Italisë e Jugosllavisë” dhe se ai “nuk do të miratonte asnjë plan që do t’i jepte Jugosllavisë një kompensim territorial në pjesën veriore të Shqipërisë, për atë që mund t’i shkëputej gjetiu”.

Për sa i përkiste kërkesës jugosllave për një dalje ekonomike në Shqipërinë Veriore, U. Uillsoni deklaronte se qëndronte në linjën e Memorandumit të 9 dhjetorit 1919, “i cili, sipas pikëpamjes së tij, ka dispozitat e nevojshme për t’iu përgjigjur nevojave të Jugosllavisë”³⁷.

Vendosmëria e presidentit të SHBA-së, i detyroi aleatët evropianë të tërhiqen. Këmbëngulja e tij për rreth dy muaj i erdhi në ndihmë njëherësh si Jugosllavisë edhe Shqipërisë. Jugosllavia kishte tani rastin të negocionte drejtpërdrejtë me Italinë, kurse për Shqipërinë rreziku i copëtimit u shtua dhe shqiptarët fituan një kohë shumë të vlefshme, që ditën ta shfrytëzonin. Pas ditëve të para të marsit nuk do të kishte më përpjekje kolektive të Fuqive të Mëdha për të marrë vendime për statusin dhe kufijtë e Shqipërisë. Italia dhe Jugosllavia hynë në negociata të drejtpërdrejta për të gjetur një zgjidhje kompromisi për “Çështjen e Adriatikut”, kurse Britania e Madhe dhe Franca, u ndjenë të

³⁶ O.Pearson, *Albania and King Zog...*, f. 142.

³⁷ *Po aty; Adriaticus. La Question Adriatique ...*, f. 149 150; Shih edhe A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, dok. 26, f. 255-257. Notë e Uillsonit e datës 6 mars, në përgjigje të notës së aleatëve të datës 26 shkurt 1920.

lehtësuara që e lanë gjetjen e marrëveshjes në mirëkuptimin midis dy të interesuarve problematikë. Deri në marrëveshjen e Rapallos që do të arrihej në nëntor³⁸, shqiptarët patën kohën dhe fatin të eliminonin rreziqet e shumta. Pasi kishte nënshkruar protokollin e gushtit me qeverinë shqiptare, që u shoqërua me heqjen dorë nga pretendimet në Shqipëri, qeveria italiane nuk mund të lejonte të realizoheshin aty pretendimet e Jugosllavisë dhe Greqisë.

Çështja shqiptare do të vijonte të mbetej kështu e pazgjidhur edhe pas mbylljes së punimeve të Konferencës së Paqes të zhvilluar në Paris deri në janar 1920, edhe pas Konferencës së Londrës në vijim, të kryeministrave të Britanisë së Madhe, të Francës dhe të Italisë, dhe pas Konferencës së San Remos që mblodhi sërish, Ll. Xhorxhin, A. Milerandin dhe F. Nitin, më 18-25 prill 1920.

Ngecja në zgjidhjen e “Çështjes së Adriatikut”, që u tentua të realizohej nga negociatat midis Italisë e Jugosllavisë mbi bazën e përmbajtjes së Memorandumit të 9 dhjetorit 1919, vijoi të mbante pezull edhe zgjidhjen e çështjes shqiptare.³⁹

Ndërkohë që delegacioni shqiptar në Paris dërgonte drejt San Remos një telegram me të cilin i bënin thirrje përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha evropiane të respektonin pavarësinë dhe integritetin territorial të Shqipërisë⁴⁰, qeveria e Sulejman Delvinës dhe Regjenca, të dala nga Kongresi i Lushnjës, përpiqeshin përmes përsëritjeve e falënderimeve të ndikonin te krerët e diplomacisë amerikane, te U. Uillsoni, R. Lansingu etj.

Përparësia që Shqipëria dhe diaspora shqiptare në Amerikë u dha marrëdhënieve me SHBA-në, u shfaq edhe në caktimin e një komisioneri në Uashington (Kostandin Çekrezi), i cili u pranua në kontakte jozyrtare nga Departamenti i Shtetit. Në fillim të majit 1920 Mehmet Konica, ministër i Jashtëm i qeverisë Delvina ndërkohë, kryetar i delegacionit shqiptar, i bënte thirrje U. Uillsonit të mos e kërkonte më zbatimin e Memorandumit të 9 dhjetorit 1919.

³⁸ Vuk Vinaver, *Jugosllavija i Francuska između dva svetska rata: Da li je Jugosllavija bila francuski "satelit"*. Beograd: Institut za savremenu istoriju, 1985, f. 26-27.

³⁹ Pietro Pastorelli, *L'Albania nella politica estera italiana 1914-1920*, Napoli, 1970, f. 284-285; Shih edhe P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 469.

⁴⁰ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti 1920, dos. 34/1, f. 407. Telegram i Mehmet Konicës në cilësinë e kryetarit të delegacionit shqiptar, dërguar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në San Remo.

Këmbëngulëse në synimin për ruajtjen e pavarësisë dhe tërësinë territoriale, të vendit qeveria shqiptare bëri demarshe për të paraqitur kërkesat e veta kombëtare e për të propozuar vendosjen e marrëdhënieve diplomatike edhe në Beograd, Athinë e Romë⁴¹.

Ndërkohë në Britaninë e Madhe po shtohet interesi për Shqipërinë. Prania jo pasive e kryediplomatit britanik në Shqipëri, Iden (Eden) gjatë përgatitjeve dhe zhvillimit të punimeve të Kongresit të Lushnjës në dhjetor 1919-janar 1920⁴², misionet e Harold Temperlit (Harold Temperley)* në Tiranë, në maj dhe në shtator 1920, tregonin interesimin e Londrës, jo thjesht për të pasur një informacion të besueshëm për gjendjen e brendshme në Shqipëri. Të bën përshtypje se raportet e britanikëve të dërguar në Shqipëri ishin realiste, madje A. Temperli rekomandonte njohjen e qeverisë shqiptare. Në të njëjtën linjë bënin punën e tyre pranë Foreign Office, miqtë e Shqipërisë, Obri Herbert etj. Por, kthesa e dukshme në qëndrimin britanik do të merrej në nëntor. Shqiptarët ndërkohë kishin bërë luftën e Vlorës, Italia që dërguar matanë Otrantos dhe Jugosllavia e Greqia, pa të nuk mund të realizonin synimet e tyre në Shqipëri. Britania ishte tani në situatë komode të konfirmonte interesin e saj për Shqipërinë, çka u duk qartë në dhjetor, kur inicioi dhe mbështeti pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Shqipëria kishte mobilizuar të gjitha forcat e saj për të ruajtur pavarësinë dhe territorin e saj, por i kishte ndihmuar edhe fati.

Pakësimi i interesimit të SHBA-së për Evropën për shkak të problemeve politike të brendshme, dhe në kuadër edhe për Shqipërinë u pasua kështu nga rritja e interesimit të Britanisë së Madhe për këtë vend. Por, vakuumin në muajt prill-nëntor 1920 e mbushën vetë shqiptarët me mobilizimin e madh për të shpëtuar vendin e tyre që fatmirësisht rezultoi i efektshëm.

⁴¹ P. Milo, *Politika e jashtme...*, vëll. I, f. 471-473.

⁴² S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942 (Kujtime dhe vlerësime historike)*, Tiranë: Marin Barleti, 1995, f. 184, 194. Sipas S. Vllamasit në dhjetor 1919, në takimin në Gjirokastrë me Javer Hurshitin dhe Beso Gegën, kryetari i Bashkisë, deklaroi konfidencialisht se qeveria britanike dëshironte formimin e një qeverie kombëtare në vend të asaj të Durrësit “që është vegël e italianëve”. Po ky bashkëkohës shënon në kujtimet e tij se diplomati Eden, njëherësh i “Inteligjencies Services”, prezent në Kongresin e Lushnjës, “kaloi disa orë ankthi, derisa u kuptua mirë, qëllimi i milicisë shqiptare kundër Kongresit”; Shih edhe M. Verli, *Kosova, sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: 2007, f. 90.

* Nëpunës i legatës britanike në Beograd.

Shqipëria kishte shpëtuar nga rreziku që i qëndroi mbi kokë gjatë gjithë zhvillimit të Konferencës së Paqes së Parisit. Mbetej të mbroheshin rezultatet e arritura në vitin 1920 dhe të konsolidohej e demokratizohej shteti i brishtë, që i kishte shpëtuar asgjësimit.

Marenglen VERLI

SUMMARY

THE VOLATILITY OF THE GREAT POWERS AND THE ALBANIAN POSITION AFTER THE CONGRESS OF LUSHNJE

The Congress of Lushnja, with the known important decisions that were made, is the most complete evidence for the evolution of the situation in Albania. Among the first passed acts of this Congress was the telegram that was sent on January 30 to the Peace Conference, on the penultimate day of his work. In it was a protest against the partition of Albania between Yugoslavia, Greece and Italy. Furthermore, "The Assembly decided not to accept any foreign mandate or protectorate." Inside the telegram, the determination of the made decisions was proven. The Congress of Lushnja, addressed a similar protest also to the Italian Senate, and informed the US president about the decisions that were taken. The telegrams from Lushnja went also towards the capitals of the other Great Powers.

For a better understanding of the Albanian issue in the world public opinion and the political circles, served also a number of protests, appeals and statements by Albanian colonies and the friends of Albania. The Albanian delegation in Paris on February 11, tried again to influence the great powers with a new telegram addressed to the British Prime Minister D. Lloyd George, in which was demanded to give up the plan for the division of Albania and for the disposal of its independence. It followed a note of protest, which was sent to representatives of the major European powers. Arguing why Albania had not had stability in the years after its creation, which had inspired the opinion that the Albanians were not capable of self-administration, the Albanian delegation numbered the responsible factors. On February 11th and 25th of 1920, members of the official Albanian delegation in Paris, L.Bumçi and M.Turtulli reported again to Akif Pasha Elbasani about the recent talks in the Albanian issue. The Albanian delegation in Paris, now representatives of the government which emerged from the Congress of Lushnja, continued their efforts in the coming weeks for a fairer solution of the Albanian issue.

Hasan BELLO

**REPUBLIKË APO MONARKI? ARGUMENTET E
DEPUTETËVE REPUBLIKANË DHE MONARKISTË LIDHUR
ME FORMËN E REGJIMIT TË SHTETIT SHQIPTAR
NË VITIN 1924**

Ky artikull mbështetet mbi dy raportet e hartuara nga komisionet e deputetëve republikanë dhe monarkistë të parlamentit shqiptar. Ai synon të krahasoi argumentet dhe kundërargumentet themelore që këto dy grupime paraqitën pranë kryesisë së parlamentit lidhur me përcaktimin e formës së regjimit në statutin e ri të shtetit shqiptar.¹ Ajo që të bie në sy është se ato reflektojnë një shkallë të lartë përgjegjshmërie, nivel intelektual dhe përgatitje juridiko-konstitucionale të deputetëve. Pavarësisht se si rrodhën zhvillimet politike, duhet theksuar se të gjithë përfaqësuesit e grupimeve në fjalë ishin të prirur ndaj gjetjes së formës më të përshtatshme të regjimit, i cili do t'i

¹ Diskutimet lidhur me formën e regjimit të shtetit shqiptar kanë vijuar në mënyrë permanente. Në prag të zgjedhjeve për Kuvendin Kushtetues të vitit 1923, u diskutua edhe për formën e regjimit. Ajo që vihet re është fakti se për të dy format kishte përkrahës të shumtë. Kështu, një autorë shkruan se forma e regjencës nuk e kishte përmbushur misionin e saj. Ajo, sipas tij, ishte një zgjidhje që më tepër i shërbente disa personave për të përmbushur ambiciet e tyre politike. Ndërsa, pro-monarkistët, të cilët këmbëngulnin për një mbret evropian me qëllim për të zhvilluar frymën oksidentale, ishin të pakët në numër. Autori i këtij shkrimi e hidhte poshtë këtë tezë me justifikimin se asnjë komb i madh evropian nuk kishte për t'i sakrifikuar interesat e tij në emër të një personi. Në qoftë se ai do të ishte mysliman, atë nuk do ta donin të krishterët, duke aluduar se Shqipëria ishte kthyer në një Turqi të vogël; e në qoftë se ai do të ishte i krishterë, nuk do ta donin myslimanët. “Kuvendi Kushtetues”, *Drita*, nr. 145, 8.11.1923, f. 2. Por, diskutime më serioze për formën e regjimit u zhvilluan në mars-prill 1924, periudhë së cilës i përkasin edhe dy raportet e mara në shqyrtim në këtë artikull.

siguronte shtetit shqiptar stabilitet, prosperitet dhe demokraci të brendshme kushtetuese.

Argumentet themelore të deputetëve republikanë lidhur me formën e regjimit të shtetit shqiptar

Në hyrje të raportit justifikues Komisioni Republikan paraqiste si argument themelor për formën e regjimit të shtetit shqiptar arsyet historike. Sipas tyre, monarkitë kishin si bazë parimin teokratik, traditat e një familjeje mbretërore që kishte sunduar në të kaluarën, ose shkaqe historike. Ndërsa në Shqipëri nuk kishte asnjë familje mbretërore, që të kishte pretendime teokratike, nuk kishte as ndonjë dinasti kombëtare që të kishte të drejta historike.² Pretendimet e Vidit mbi fronin e Shqipërisë, me të drejtë ky grupim i hidhte poshtë me argumentin se ai ishte larguar nga Shqipëria për të marrë pjesë në LPB nën flamurin e një kombi tjetër.³ Ky veprim kishte shkelur vendimet e Konferencës së Ambasadorëve, e cila kishte vendosur në akord me Fuqitë e Mëdha asnjësinë e Principatës Shqiptare.⁴ Ky argument përbënte një precedent të fortë juridik për të kundërshtuar pretendimet e Vidit⁵ dhe përkrahësve të regjimit monarkist. Kjo, sipas këtij grupimi kishte vërtetuar se shpëtimtarët e një kombi përherë kishin dalë nga gjiri i popullit dhe asnjëherë nuk kishin ardhur nga jashtë.

Një argument tjetër ishte se në periudhën bashkëkohore krijimi i dinastive të reja nuk ishte aspak në modë. Përkundrazi, një numër i konsiderueshëm i dinastive të vjetra, me rrënjë shekullore, ishte duke u zhdukur.⁶ Ky argument, i cili e lidhte formën e regjimit republikan me

²Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi: Parlamenti, Viti. 1924, Dosja. 5, fl. 12. Raport i Komisionit Republikan të Deputetëve mbi formën e regjimit të shtetit shqiptar paraqitur Komisionit për Hartimin e Statutit dhe Kryesisë së Parlamentit, 3.4.1924.

³Po aty, fl. 12.

⁴HHSt.A.P.A.A. në AIH, Vj. 24-44-4413, Raport mbi statusin e shtetit shqiptar, paraqitur nga Austro-Hungaria dhe Italia në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, 29.7.1913.

⁵Në prag të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Princ Vidi i dërgoi Fuqive të Mëdha një memorandum ku paraqiste historikun e ardhjes dhe largimit të tij nga Shqipëria, si dhe kërkesën për t'u rikthyer në fron. Ai i përmbahej pikëpamjes se kishte qenë i detyruar të largohej dhe se nuk kishte abdikuar. Shih: *Memorandum Përmbi Shqypënië prej Wilhelmi, Mbret i Shqypënie Princ Wid*, (përgatiti për botim Hasan Bello) Tiranë: Arbëria, 2008.

⁶Po aty, fl. 12. Republikanët këtu kishin parasysh se pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore nga skena e historisë ishin zhdukur tre nga perandoritë më të mëdha të botës

rrjedhat historike të qytetërimit tregon se elita politike shqiptare ishte nën influencën ideologjike të Revolucionit Borgjez Francez të 1789. Ai nuk ishte argument i qëndrueshëm për faktin se shtete dhe kombe si Britania, e cila ishte avangardë e zhvillimit ekonomik, industrial, shkencor e kulturor, megjithëse ishte monarki, nuk e kishte penguar të ishte model i parlamentarizmit. Këtu nuk duhet harruar se pjesa dërrmuese e shteteve evropiane, e sidomos fqinjët e Shqipërisë, ishin monarki. Megjithatë, kjo nuk i pengoi përkrahësit e republikës të parashtronin se Shqipërisë i mungonte një dinasti vendase, se traditat e vjetra të racës shqiptare dhe gjendja historike, e çlironte vendin tonë nga barra e monarkisë. Ata theksonin se shqiptari në shpirt ishte demokrat.

Kjo, sipas tyre, ishte konstatuar edhe në librat e udhëpërshkruesve të huaj. Ata shkruanin se as pushtimet e gjata paraosmane dhe as Perandoria Osmane nuk kishin mundur që të ç'rrenjosnin nga shpirti i shqiptarit bindjen e përvetshme që ai kishte ndaj pleqësisë.⁷ Megjithëse, ato nuk kishin patur në dispozicion fuqi ekzekutive, vendimet e tyre krahasuar me gjykatat e huaja që gëzonin mbështetjen e autoriteteve ushtarake, zbatoheshin më me kënaqësi nga populli shqiptar. Kjo tregonte se një sistem pleqësimi, d.m.th. republikan ishte një sistem që buronte nga shpirti dhe jeta shoqërore e popullit shqiptar. Ndërsa, monarkia ishte në kundërshtim të plotë me natyrën e tij. Gjendja shoqërore e Shqipërisë, sipas republikanëve, tregonte se e vetmja formë shtetërore që mund t'i përshtatej shqiptarit, ishte republika. Këto argumente megjithëse pretendonin se mbështeteshin mbi një bazë historike, binin ndesh me të kaluarën e popullit shqiptar. Kjo për faktin se shqiptarët si në antikitet ashtu edhe në mesjetë ishin qeverisur nga mbretërit dhe principatat, pa harruar perandoritë: Romake, Bizantine, Sllave, Bullgare dhe Osmane.

Ky grupim ishte i mendimit se zgjedhja e një mbreti mysliman në krye të Shqipërisë do të kishte pasoja katastrofike. Por, ky parashikim rezultoi i gabuar. Mbreti Zog megjithëse ishte mysliman ndërmoi reforma modernizuese, të cilat synonin oksidentalizimin dhe futjen e vendit në familjen e qytetërimit evropian. Vendosi e një mbreti katolik ose ortodoks në krye të Shqipërisë ky grupim e shihte si burim ngatërresash. Ndërsa, eksperimentin e një mbreti protestant, ata e

(Perandoria Osmane, Perandoria Austro-Hungareze dhe Perandoria Ruse).

⁷Po aty, fl. 13. Një argument i tillë ishte parashtruar edhe nga rilindësit, e sidomos nga Sami Frashëri në traktatin politiko-filozofik "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet". Kjo tregon për një kontinuitet të mendimit republikan.

konsideronin hipokrizi.⁸ Sipas republikanëve, asnjë mbret nuk do të ishte në gjendje që të kënaqte të gjithë elementët. Kjo ilustron me Lëvizjen Vorioepiriotë dhe Kryengritjen në Shqipërinë e Mesme të 1914. Ky grupim propozoi një formë origjinale të drejtimit të Republikës, e cila konsistonte në drejtimin e saj nga katër përfaqësues (një mysliman, një ortodoks, një katolik, një bektashi). Ata duhet ta drejtonin republikën në mënyrë kolegjiale, duke e kryesuar atë me rrotacion. Ky model, kishte rezultuar efikas në vitet 1920-1924 kur vendi drejtohej nga Këshilli i Naltë. Republika, sipas tyre, ishte një sistem që përputhej edhe me përbërjen religjioze të shtetit shqiptar.

Zgjedhja e një mbreti nuk mund të bëhej pa ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha. Republikanët, sillnin shembullin e Vidit sundimi i të cilit kishte rezultuar fatal. Këtyre pikëpyetjeve i shtohet edhe mungesa e një personi, i cili mund të gëzonte aftësitë e duhura për t'u vendosur në krye të Shqipërisë. Sidoqoftë, republikanët i përmbaheshin bindjes se, vendosja e një mbreti do të shkaktonte pakënaqësi si tek faktori i brendshëm ashtu edhe tek faktori i jashtëm. Me ndryshimin e rrethanave ndërkombëtare, vendosja e një mbreti të huaj, sipas tyre nuk përputhej më me interesat e shqiptarëve. Këto interesa parashtronin nevojën imediate që, Shqipëria të qeverisej si republikë.

Një argument tjetër ishte edhe mundësia e kufizuar financiare e shtetit shqiptar. Sipas tyre, me një buxhet prej 14 milionë franga ari në vit, Shqipëria nuk mund të mbante një oborr mbretëror. Ai së bashku me personelin dhe familjen mbretërore ishin një barrë e rëndë për arkën e shtetit. Aq më tepër që Shqipëria ishte një vend i vogël, i cili nuk mbulonte as shpenzimet e nevojshme për mbajtjen e një aparati të thjeshtë administrativ. Kjo do të shkaktonte mos balancimin e buxhetit e për rrjedhojë një oborr mbretëror qesharak. Ndërsa, republika konsiderohej një sistem me kosto të vogël financiare, ajo “ka me qenë petka që i vjen trupit tonë”.⁹ Sipas tyre, forma republikane e regjimit ishte më modeste në aspektin financiar dhe më e afërt me realitetin socio-ekonomik. Argumentin e paraqitur nga monarkistët se “Mbreti ka me qenë i paanshëm dhe për mbi gjithë partinat, në kohën të vështirë bahet një fuqi paqtuese dhe gjithë partinat mblidhen rreth mbretit”¹⁰, ndonëse në pamje të parë dukej i arsyeshëm, republikanët e hidhnin poshtë duke sjellë si shembull historinë e mbretërve ballkanike. Ajo

⁸Po aty, fl. 13.

⁹Po aty, fl. 14.

¹⁰Po aty, fl. 15.

kishte treguar se shpeshherë mbretërit e këtyre shteteve kishin shkelur parimin e mësipërm, duke u bërë palë më këtë apo atë parti dhe si rezultat i ambicies së tyre politike ishte derdhur gjak i panevojshëm. Për të konsoliduar pozitën dhe pushtetin e tyre mbretëror, në shumicën e rasteve, ata ishin mbështetur tek familjet e mëdha feudale dhe tek kleri. Kjo mund të ndodhte edhe në vendin tonë, duke i hapur rrugën një konflikti klasor, i cili do të trashëgohej nga gjenerata në gjeneratë.

Republikanët bënë thirrje se forma e regjimit të shtetit shqiptar duhej sanksionuar një orë e më parë. Sipas tyre bota ndodhej para ngatërresave të ndryshme politike, të cilat do të interferonin herët ose vonë edhe në vendin tonë. Prandaj, zgjidhja e këtij problemi duhej bërë sa më shpejt. Kjo do të shmangte farën e kryengritjeve dhe vëllavrasjes ndërmjet popullit shqiptar. Frikës së atyre që mendonin se nga republika mund të rridhte ndonjë diktaturë, ata i përgjigjeshin se ato ishin pjellë e rrethanave historike dhe se mund të lindnin edhe nga monarkitë e mëdha, por edhe nga republikat e vogla. Kjo mund të shmangej duke vendosur në statut garante kushtetuese, të cilat do t'i prisnin rrugën vendosjes së diktaturës dhe do të garantonin sovranitetin e popullit.¹¹

Për të përforcuar argumentet për avantazhet politike të këtij sistemi, republikanët i referoheshin dy personaliteteve të njohura për kombin shqiptar. Njëri prej tyre ishte politikani dhe nobelisti francez Desturnel de Kostansi, i cili në fjalën e hapjes së dhomës së tregtisë franko-shqiptare në Paris, i këshilloi shqiptarët e pranishëm që si formë regjimi të zgjidhnin republikën. Personaliteti tjetër të cilit i referoheshin ishte Sami Frashëri, një njohës i mirë i mentalitetit dhe i problemeve shqiptare. Arsyet e paraqitura më sipër i kishin bindur ata se forma më e përshtatshme për shtetin shqiptar ishte republika. Kjo formë garantonte sovranitetin dhe prosperitetin ekonomiko-politik të mbarë vendit. Ajo siguronte nderin, jetën, pasurinë dhe të drejtat e popullit shqiptar. Republika, sipas tyre, lindi në një vend ku individ i kishte njohur veten dhe ishte koshient se duhet të jetonte i lirë. Raporti i republikanëve për Komisionin e Hartimit të Statutit dhe Kryesinë e Parlamentit mbyllej me një thënie të Sami Frashërit. Aty argumentohej se pse vendi ynë nuk duhej drejtuar nga një mbret ose princ, por duke iu referuar Strabonit*, sipas të cilit ilirët qeveriseshin nga plakoni (pleqësitë), ai ishte i mendimit se forma e duhur për shtetin e ardhshëm shqiptar ishte

¹¹Po aty, fl. 15.

*Straboni gjeograf dhe historian i Greqisë së lashtë. Ai është autor i veprës "Gjeografia" e cila përbëhet nga 17 libra.

republika.¹² Ky raport mban firmën e kryetarit të Komisionit Republikan, juristit dhe deputetit Petro Poga*.

Argumentet themelore të deputetëve monarkistë lidhur me formën e regjimit të shtetit shqiptar

Në hyrje të raportit justifikues të Komisionit Monarkist artikulohej se shteti si produkt i ngjarjeve historike, si shfaqje e nevojave më të forta shoqërore, kishte si detyrë parësore:

- 1) Sigurimin e qetësisë së brendshme dhe të jashtme;
- 2) Zhvillimin nga çdo pikëpamje e njerëzve që përfshinte në gjirin e vet.

Sipas monarkistëve shtetet ballkanike, evropiane dhe të mbarë botës kishin forma të ndryshme politike. Por, forma më e mirë ishte ajo e cila në përputhje me nivelin e zhvillimit dhe qytetërimit të një kombi i siguronte atij stabilitet; ajo formë e cila duke shmangur tronditjet politiko-sociale dhe cenimin e lirisë së popullit siguronte zhvillimin gradual, por të shpejtë të të gjitha fakulteteve mendore dhe shpirtërore të atij kombi. Këto cilësi të formës së një shteti i nevojiteshin edhe popullit shqiptar, i cili po hidhte hapat e para drejt qytetërimit dhe jetës politike.¹³ Sipas monarkistëve, lumturia, përparimi dhe liria e një populli nuk siguroheshin duke adaptuar formën më moderne dhe më liberale të imagjinuar në teori, por duke aplikuar atë sistem qeveritar i cili korrespondonte më mirë me nivelin e zhvillimit politiko-social. Ky përcaktim tregon se monarkistët ishin njohës të mirë jo vetëm të teorive të historisë së shtetit dhe së drejtës, por edhe të nevojave, problemeve politike, social-psikologjike e juridiko-kushtetuese të popullit shqiptar. Ata niseshin nga prirje pozitive për të gjetur zgjidhjen më të mirë, e cila do t'i siguronte vendit stabilitet politik. Sipas tyre, një formë e shtetit ultra-liberal për një popull të pazhvilluar, mund të kishte rezultat të

¹² *Po aty*, fl. 17-18.

*Petro Poga (1890-1944), u lind në qytetin e Gjirokastrës ku mori edhe mësimet e para. Ai përfundoi gjimnazin "Zosimea" të Janinës dhe më pas vijoi studimet për drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Stambollit. Petro Poga u aktivizua që herët në Lëvizjen Kombëtare duke dhënë një kontribut të çmuar. Me Shpalljen e Pavarësisë ai u bë pjesë e administratës shqiptare, si kryetar gjykate, ministër, deputet, etj.

¹³ AQSH, Fondi: Parlamenti, Viti. 1924, Dosja. 5, fl. 40. Raport i Komisionit Monarkist të Deputetëve mbi formën e regjimit të shtetit shqiptar paraqitur Komisionit për Hartimin e Statutit dhe Kryesisë së Parlamentit, 3.4.1924.

kundërt. Ajo mund të krijonte premisa për të sjellë në fuqi, nën maskën e lirisë e të sovranitetit të popullit, diktatura dhe oligarkia parlamentare, të cilat do të shtypnin të drejtat më elementare të një kombi.¹⁴

Ky konkluzion, ishte fryt i një vështrimi analitik i historisë së parlamentarizmit shqiptar në vitet 1920-1924. Ai ishte përfundim logjik i kaosit politik që kishte prodhuar brishtësia e demokracisë parlamentare në këtë periudhë. “Për këtë arsye ajo jo vetëm dështoi, por ishte edhe një nga faktorët që prodhoi destabilitet dhe kriza të rënda e të rrezikshme për vetë ekzistencën e shtetit shqiptar”.¹⁵ Kjo nuk ka nevojë për argumente, mjafton të shihen bisedimet e Këshillit Kombëtar, ose grushtet e shtetit që u realizuan në këtë segment kohorë për të kuptuar se termi “oligarkia parlamentare” është një koncept i gjetur. Ai tregon se ekzistenca e pushtetit legjislativ (parlamentit), nuk do të thotë se tek disa shoqëri të pazhvilluara shkalla e demokratizimit të jetës politike është e mjaftueshme.¹⁶ Përkundrazi, historia e shoqërisë njerëzore (dhe e popullit shqiptar) ka dëshmuar se në shoqëritë e paemancipuara politikisht dhe kulturarisht ky institucion mund të kthehet në arenë debatesh e konfliktesh të ashpër politike, deri tek përdorimi i armëve kundër pozitës dhe opozitës.¹⁷ Këto përplasje në vend që të prodhonin konsensus dhe alternativa politike, në shumicën e rasteve kanë prishur paqen sociale, duke thelluar hendekun midis shtresave të ndryshme shoqërore. Kjo histori është pak a shumë edhe trashëgimia e parlamentarizmit shqiptar në vitet 1921-1924.

¹⁴ Po aty, fl. 41.

¹⁵ Beqir Meta, “Procesi i ndërtimit kombëtar në vitet 1920-1930”, *100 vjet pavarësi: Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare Tiranë, më 26-27 nëntor 2012*, Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2014, f. 17.

¹⁶ Ky fenomen ndodhi në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX në Perandorinë Osmane, ku megjithëse me shpalljen e kushtetutës dhe hapjen e parlamentit (1876-1877 dhe 1908), shkalla e demokratizimit të jetës politike mbeti mjaft e ulët. Parlamenti prodhoi efekte të kundërta me atë që pritej, duke krijuar destabilitet politik dhe prishje të paqes sociale. *Shih*: Hasan Kayalı, “Elections and the Electoral Process in the Ottoman Empire, 1876-1919”, *International Journal of Middle East Studies*, Vol. 27, No. 3 (Aug., 1995), p. 265-286. Por pak a shumë e njëjta gjë ndodhi edhe me parlamentet e vendeve ballkanike. Atentatet dhe vrasjet politike brenda parlamentit, si dhe lufta e ashpër politike nuk ishte tregues i demokracisë. Në këto vende ishin diktaturat dhe monarkitë ato që siguruan unitetin e brendshëm kombëtar.

¹⁷ Këtu kemi parasysh edhe atentatin e Beqir Valterit ndaj kryeministrit të vendit Ahmet Zogut, më 23 shkurt 1924, vetëm pak ditë pas përfundimit të punës së këtyre komisioneve. *Shih*: Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: Neriada, 2000, f. 358-362.

Sipas monarkistëve, populli shqiptar përgjithësisht dhe veçanërisht përfaqësuesit e udhëheqësit e tij intelektualë duhet të ishin të ndërgjegjshëm se me përcaktimin e formës së shtetit do të jepnin provën më të fortë të zotësisë e aftësisë së tyre shtetërore, duke gjetur atë formë që korrespondonte me shkallën morale dhe intelektuale të kombit shqiptar.

Historikisht format e shtetit, sipas monarkistëve ndaheshin esencialisht nga pikëpamja e sovranitetit në dy kategori kryesore: monarki ose perandori absolute në të cilat fuqia sovrane rridhte nga lart poshtë, si një e drejtë trashëgimtare e dhuruar nga Zoti një familjeje mbretërore të sundoi e të drejtoi si sovran një komb. Një shembull konkret sipas tyre ishte Perandoria Osmane në periudhën e Abdylhamitit II dhe Franca në periudhën Burbone. Një kategori e veçantë e këtyre formave ishin monarkitë kushtetuese, në të cilat familjet mbretërore, si rezultat i presionit nga populli detyroheshin të delegonin një pjesë së fuqisë së tyre. Kjo rregullohej me anë të statuteve ose kushtetutave. Një shembull i tillë ishte Rusia cariste pas krijimit të Dumës, Perandoria Austro-Hungareze, etj., të cilat konsideroheshin forma arkaike dhe të dala jashtë mode.

Kategoria e dytë e formave shtetërore nga pikëpamja e sovranitetit, sipas monarkistëve ishin demokracitë republikane ose monarkiste, në të cilat fuqia rridhte nga poshtë lart dhe fuqia sovrane qëndronte krejtësisht në popull. Ndërsa populli, sipas të drejtave të përcaktuara në statut, delegonte një pjesë të këtij sovraniteti tek mbreti. Ky i fundit gëzonte disa prerogativa, të cilat ishin të trashëgueshme. Një shembull tjetër ishin republikat aristokratikë, tek të cilët sovraniteti qëndronte në duart e disa familjeve (Venediku). Por, edhe kjo formë ishte *démodé*. Prandaj, format kryesore të periudhës bashkëkohore që rivalizonin me njëra-tjetrën ishin monarkitë parlamentare dhe republikat demokratike.¹⁸ Në gjykimin e monarkistëve, nga pikëpamja e sovranitetit të popullit këto dy forma nuk kishin asnjë ndryshim nga njëra-tjetra. I vetmi ndryshim ishte se ndërsa tek njëra formë kryetari i shtetit ishte i zgjedhur, tek tjetra ai ishte i trashëgueshëm. Sipas tyre, forma e regjimit nuk ishte tregues i shkallës së emancipimit dhe demokratizimit të një shoqërie. Ata e argumentonin këtë me rastin e popujve më të qytetëruar të botës siç ishin belgët, holandezët,

¹⁸AQSH, F: Parlamenti, V. 1924, Dos. 5, fl. 41. Raport i Komisionit Monarkist të Deputetëve mbi formën e regjimit të shtetit shqiptar paraqitur Komisionit për Hartimin e Statutit dhe Kryesisë së Parlamentit, 3.4.1924.

skandinavët, të cilët megjithëse ishin monarki, nuk ishin më pak sovran se populli i Republikës së Meksikës. Sipas monarkistëve midis kushtetutës franceze dhe asaj britanike nuk kishte asnjë ndryshim nga pikëpamja e sovranitetit të popullit. Madje, kishte raste, siç ishte presidenti i SHBA-së, që në bazë të kushtetutës gëzonte më shumë të drejta se sa mbreti i Italisë. Prandaj, fjalët e përhapura se monarkia cenonte lirinë dhe sovranitetin e popullit shqiptar, ishin mendime qesharake. Ato ishin shfaqur nga njerëz të cilët ose nuk kishin aspak njohuri mbi shkencën konstitucionaliste ose kishin si qëllim që me anë të propagandës të shkaktonin konfuzion midis monarkisë absolute dhe monarkisë parlamentare. Shqipëria, sipas tyre që nga kohët e lashta e deri në periudhën e Skënderbeut, ishte sunduar nga mbretërit.

Për të përforcuar këtë pikëpamje, monarkistët i referoheshin edhe përvojës ndërkombëtare. Ata e pranonin se pas përfundimit të LPB-së regjimi republikan për shumë vende ishte kthyer në modë. Por kjo, sipas tyre, ishte rezultat i ngjarjeve historike apo i zhvillimeve politike, që shpeshherë nuk ishin produkt i dëshirës së përgjithshme të popullit për të aplikuar republikën. Si shembull ata merrnin SHBA-në, e cila ishte republika më demokratike dhe më funksionale e kohës. Sipas këtij modeli ishin themeluar edhe disa republika në Amerikën e Jugut.

Por, përveç SHBA-së, në të cilat, si kudo, instinkti i racës anglo-saksone kishte treguar cilësi natyrale për rregullimin me liri të plotë sipas sistemit parlamentar, në shtetet e tjera forma republikane e regjimit nuk kishte dhënë prova të mira. Përkundrazi, në shumicën e rasteve atje kishin mbretëruar grushtet e shtetit dhe diktaturat e kryetarëve të republikës, të cilët me përkrahësit e tyre kishin rrëmbyer drejtimin e vendit. Modeli më negativ që ata sillnin ishte Republika e Meksikës. Më tej, ky grupim merrte në shqyrtim format e regjimit të disa kontinenteve: Australisë, ku edhe aty ku ekzistonte republika nuk mund të thuhej se kishte sovranitet të plotë pasi ajo varej nga Mbretëria e Anglisë. Azia ishte një mishmash i vërtetë regjimesh, të cilat nuk shquheshin për shtete demokratike dhe funksionale, së bashku me Afrikën ajo ishte në shumicën e rasteve koloni e mbretërive perëndimore. Këtu një farë përjashtimi bënte Egjipti, i cili kishte një qytetërim e trashëgimi historike nga periudha e antikitetit. Por edhe ky ishte monarki.¹⁹ Modeli më i mirë për republikanët ishte kontinenti evropian, ose më saktë Franca. Kjo e fundit pas kryengritjesh të gjata, duke nisur që me Revolucionin e 1789 kishte derdhur gjak pa fund.

¹⁹Po aty, fl. 42.

Megjithatë ndryshimi i formës së regjimit në Francë kishte ndryshuar brenda 80-vjetësh nëntë herë: tre herë perandori, tre herë monarki dhe tre herë republikë. Kjo tregonte se ky shtet i njohur për shkallën e lartë të qytetërimit, kulturës dhe filozofisë kishte eksperimentuar periodikisht derisa kishte gjetur në mënyrë evolutive formën më të përshtatshme të regjimit. Pas Francës, një shtet tjetër evropian që kishte aplikuar republikën, ishte Portugalia. Por, ajo nuk përbënte një shtet model, sepse lëvizjet kryengritëse që shpërthenin herë pas here kishin krijuar një situatë të pastabilizuar. Ndërsa, rasti i Zvicrës e ndarë në kantone ishte përjashtim, në përputhje me përbërjen etnike dhe sociale të këtij shteti. Përqafimi i republikës nga disa shtete evropiane pas LPB-së, sipas monarkistëve duhej kërkuar në arsyet historike dhe politike. Kështu, Gjermania e cila e kishte arritur kulmin e zhvillimit në periudhën e Hohenzolerëve, në shpirt nuk e donte aspak republikën.

E njëjta gjë vlente edhe për Austrinë. Hungaria në pamundësi për të rikthyer mbretin, mbante një regjencë. Çekosllovakia, Polonia dhe shtetet e vogla të Baltikut të krijuara në Konferencën e Versajës, nën influencën franceze, padyshim që anonin nga republika. Ndërsa, Rusia përbënte një rast specifik, ajo kishte lindur nga një kryengritje që ende nuk e kishte përfunduar evolucionin, e për rrjedhojë nuk ishte stabilizuar. Pjesa tjetër e popujve më të qytetëruar të Evropës, si: anglezët, skandinavët, holandezët, belgët, etj., ishin monarki dhe karakterizoheshin nga një jetë e stabilizuar politike.

Një shembull konkret i cili ishte më afër mentalitetit dhe kushteve social-politike të popullit shqiptar ishin shtetet ballkanike. Sipas monarkistëve, pothuajse i gjithë Ballkani ishte monarki. Kush mund t'i mohonte shërbimet që i kishte bërë mbreti Karol i Rumanisë? Ai kishte qenë faktor kryesor për zhvillimin dhe emancipimin e këtij kombi. Ferdinandi i Bullgarisë megjithëse ishte me origjinë gjermane dhe shkaktar kryesor në futjen e saj në luftë përkrah Antantës, kishte luajtur rol të pazëvendësueshëm. Madje, edhe pas lufte, kur në pushtet erdhi Stamboliski, nuk e ndryshoi dinastinë dhe si trashëgimtarë njohu të birin e Ferdinandit. Kjo, sipas monarkistëve, tregonte hapur se populli bullgarë e ndjente të nevojshme këtë formë regjimi. Një tjetër shtet, i cili duhet të ishte shembull për një popull me ndërgjegje kombëtare të pazhvilluar ishte Jugosllavia. Prandaj, ata e vinin theksin se populli shqiptarë kishte nevojë më tepër se kushdo për mbështetje morale tek një mbret. Ai, sipas tyre do të ishte personifikimi i bashkimit

kombëtarë.²⁰ Rasti i Greqisë, me gjithë problemet e viteve të fundit, në thelb ishte histori suksesi. Këtu, ata kishin parasysh kontributin historik të monarkisë për themelimin dhe konsolidimin e shtetit grek.

Një rast tipik ishte edhe Republika turke e themeluar nga Mustafa Qemali. Ai ishte modeli që kishte ndikuar më shumë se kushdo tjetër tek elita politike shqiptare. Por, ky rast ishte produkt i zhvillimeve politike dhe historike që kishin ndodhur në Turqi. Mustafa Qemali e kishte shpëtuar atë nga copëtimi dhe pushtimi i forcave të huaja, kishte pas vetës ushtrinë dhe kishte abroguar Kalifatin. Ndërsa, një kurorë mbretërore oksidentale, sipas monarkistëve, do të ishte burim i qytetërimit evropian. Për popullin shqiptar, argumentonin ata, një mbret evropian nuk ishte shenjë konservatorizmi. Përkundrazi, një provë liberalizmi. Një arsye tjetër përse monarkistët e kundërshtonin republikën ishte se ata shihnin tek ajo burimin e anarkisë. Ndërsa monarkia, sipas tyre, do të krijonte kushtet e nevojshme për stabilitetin dhe zhvillimin e popullit shqiptar.²¹

Ky grupim merrte në shqyrtim edhe kritikën teorike që i bëheshin monarkisë parlamentare. Sipas tyre, argumenti se trashëgimi i pushtetit mund të sillte në krye të shtetit një person me probleme psiko-morale, nuk përbënte asnjë rrezik për vendet e qytetëruara dhe me ndërgjegje kombëtare të konsoliduar. Madje, në vende të tilla sado i pazoti të ishte një mbret, do të ishte më i aftë se sa kryetarët e republikës që kishin mbërritur deri aty duke përdorur influencën personale, turbullirat politike ose kryengritjet. Sipas tyre, një princ i cili ishte edukuar për të qeverisur dhe për të drejtuar një popull, sado të meta që të kishte, krahasuar me një kryetar republike në një vend me shumicën e popullsisë analfabete, ishte më i aftë në sytë të popullit. Prestigji i tij moral do të ishte më i lartë krahasuar me atë të kryetarit të republikës.

Ndryshe nga monarkia, zgjedhja e përkohshme e kryetarit të shtetit në sistemin republikan krijonte destabilitet politik. Në shoqëritë e pazhvilluara dhe me institucione të pakonsoliduara ajo i hapte rrugën grushteve të shtetit, rebelimeve dhe personave me ambicie të shfrenuar për të rrëmbyer drejtimin e shtetit në rrugë ilegjitime. Prandaj,

²⁰Po aty, fl. 43.

²¹Ky argument u konfirmua. Historia dhe zhvillimi i ngjarjeve politike treguan se në vitet 1928-1939 kjo formë regjimi funksionoi, duke krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin politik, ekonomik, dhe emancipimin kulturor të popullit shqiptar. Për këtë arsye, me të drejtë historiani amerikan Bernd Fischer studimin e tij e ka titulluar, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, (*King Zog and the struggle for stability in Albania*, Tiranë: Albanian Institute for International Studies, 2012).

përzgjedhja e formës së regjimit nga populli shqiptar do të përcaktonte në njëfarë mënyre të ardhmen e tij politike. E drejta kushtetuese, sipas monarkistëve, ishte një shkencë e cila duhej marrë në konsideratë.

Sigurisht, ajo që kishte më shumë rëndësi, ishte gjendja reale e shoqërisë. Në përputhje me nevojat e saj duhej përcaktuar edhe forma e regjimit. Ata bënë thirrje për t'iu shmangur ideve dogmatike të filozofëve të shek. XVIII apo idealizmave që kishin vetëm vlerë teorike. Kjo nënkuptonte se forma e regjimit duhej gjetur në përputhje me interesat politike dhe shkallën e zhvillimit social që kishte populli shqiptar. Ky grupim nuk ishte aspak kundër iluminizmit dhe parimeve republikane të Revolucionit Francez. Përkundrazi, në argumentet që parashtronin ata i përmbaheshin arsyetimit juridiko-filozofik të teorisë së shtetit dhe së drejtës. Shkolla pozitiviste e shek. XX, e cila sipas tyre dominonte shkencat sociale, pasi këqyrte nevojat materiale të një shoqërie jepte edhe zgjidhjen në përputhje me këto nevoja. Në rastet kur tek një popull ekzistonte një fuqi politike dhe patriotike e shëndetshme; kur tek ai ekzistonin elementë të aftë për të mbajtur fuqi ekzekutive, sigurisht që forma më e mirë e regjimit ishte republika. Ndërsa, po të këqyrej temperamenti politik i popullit shqiptar, niveli arsimor dhe tradita, do të konstatohej se ai ishte i papjekur politikisht. Prandaj, sipas tyre forma republikane e regjimit do t'i hapte rrugën një oligarkie politike dhe përdorimit të instrumenteve institucional në kundërshtim me interesat e popullit.

Megjithatë monarkistët tregoheshin të hapur, duke bërë thirrje se kjo nuk do të thoshte se duhej hequr dorë nga teoria, mendimet internacionaliste dhe idealiste të kohës. Ata kërkonin që, të kihej parasysh gjendja reale e popullit shqiptar dhe prapambetja e tij sociale. Nuk duhej harruar pozita gjeopolitike e Shqipërisë, e cila ndodhej në Gadishullin Ballkanik ku korrentet e nacionalizmit dhe shovinizmit kishin arritur kulmin. Gjithashtu nuk duhej harruar se Shqipëria ishte e rrethuar nga fqinjë të fortë, të cilët kishin pretendime territoriale dhe ndiqnin një politikë aneksioniste. Kjo politikë synonte destabilizimin dhe shkatërrimin e shtetit shqiptar. Sipas monarkistëve, në Ballkan ende nuk kishte përfunduar evolucioni politik dhe krijimi i shteteve kombëtare me kufij të qartë etnikë, siç ishte rasti i Evropës. Në këtë rajon mbretëronte militarizmi dhe forca brutale. Nuk duhej harruar se populli shqiptar ishte më i dobëti, më i vogli dhe më i paorganizuari i të gjithë rajonit. Ai kishte nevojë më tepër se çdo komb tjetër, jo vetëm për të përmbushur detyrat dhe idealet e bashkimit kombëtar, por për të siguruar sovranitetin dhe integritetin territorial. Monarkistët bënë

thirrje që, të gjithë shqiptarët të lidheshin me njëri-tjetrin, duke gjetur një mënyrë ku të ekuilibroheshin aspiratat dhe të drejtat e çdo elementi.

Prandaj, sipas tyre ishte i nevojshëm krijimi i një institucioni të lartë dhe të shenjtë në sytë e popullit të paditur; të krijohej një ideal moral rreth të cilit të bashkoheshin të gjithë, duke formuar e konsoliduar dalëngadalë ndërgjegjen kombëtare. Ky institucion duhet të ishte bipartiak, duke qëndruar jashtë grindjeve politike. Në rast se vendi përfshihej nga trazirat, ai duhej të luante rolin e arbitrit, për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Ai duhej të ishte një shtyllë e afrit dhe e bashkimit vëllazëror. Kjo mund të realizohej vetëm nga monarkia dhe një mbret i zoti. Historia kishte treguar se aty ku regjimi ishte përcaktuar nga vullneti i popullit, ekzistonte monarkia parlamentare. Një shembull konkret ishte rasti i Greqisë, Italisë, Belgjikës, Norvegjisë, Rumanisë, etj.

Monarkistët merrnin në shqyrtim edhe kritikën që ekzistonte lidhur me dobësitë e këtij sistemi, si:

- 1) Çështja e fesë;
- 2) Çështja e bejlerëve;
- 3) Çështja ekonomike;
- 4) Cenimi i lirisë dhe i sovranitetit të popullit;
- 5) Qenia në krye të shtetit të një të huaji dhe problemet e një krimi të një dinastie për brezat e ardhshëm;
- 6) Antagonizmi i mentalitetit të mbretit me gjendjen sociale të vendit;
- 7) Ngatërresat lidhur me gjetjen e mbretit;
- 8) Intrigat që mund të bënin të huajt me anë të mbretit;
- 9) Mbreti mund të ishte pengesë për zhvillimin e Shqipërisë;
- 10) Mbreti do të krijonte një militarizim të panevojshëm të Shqipërisë.

Lidhur me çështjen e fesë, republikanët mendonin se Shqipëria në të cilën ekzistonte katër religjione, nuk mund të bëhej monarkia. Kjo bazohej në argumentin se përkatësia fetare e mbretit do të ngjallte pakënaqësinë e elementëve të ndryshëm.²² Me qëllim që mbreti të kishte influencë morale, ai duhej t'i përkiste fesë së popullit. Kjo ishte e sanksionuar edhe në kushtetutat e monarkive ballkanike. Por, rasti i Shqipërisë përbënte një specifikë më vete. Vendosija e një mbreti

²²AQSH, F: Parlamenti, V. 1924, Dos. 5, fl. 46. Raport i Komisionit Monarkist të Deputetëve mbi formën e regjimit të shtetit shqiptar paraqitur Komisionit për Hartimin e Statutit dhe Kryesisë së Parlamentit, 03.04.1924.

mysliman, sipas tyre, do të kishte pasoja politike. Ekzistenca e disa religjioneve e vështirësonte situatën. Ndërsa, importimi i një mbreti evropian, kishte rezultuar një eksperiment i dështuar. Ky veprim kishte ngjallur pakënaqësinë jo vetëm të myslimanëve, por edhe të krishterëve. Ata nuk e dëshironin vendosjen e një protestanti në krye të Shqipërisë. Ky argument, sipas monarkistëve, nuk qëndronte. Ata sillnin si shembull rastin e Ferdinandit të Bullgarisë dhe të Karolit të Rumanisë, të cilët megjithëse nuk ishin ortodoksë, përsëri gëzonin respekt dhe simpati të madhe në popull. Monarkistët ishin të mendimit se tek shqiptarët nuk ekzistonin paragjykime lidhur me përkatësinë fetare të mbretit. Ngjarjet e 1914, ata i shpjegonin me interferimin e agjenturave të huaja dhe të koniunkturave që ishin krijuar në prag të shpërthimit të LPB-së. Nga kjo periudhë kishte kaluar një kohë e gjatë, gjë, e cila kishte ndikuar në emancipimin politik të shqiptarëve.

Monarkistët preferonin që në krye të Shqipërisë të vendosej një mbret evropian. Kjo, do ta shpejtonte procesin e modernizimit dhe unifikimit të kombit shqiptar. Ai do të ndikonte në afrimin e të gjithë elementëve brenda vendit. Një mbret evropian do ta ndihmonte Shqipërinë edhe në arenën ndërkombëtare. Mendimi se një mbret i krishterë do të kundërshtojë nga myslimanët ishte fryt i propagandës së huaj. Përkundrazi, një mbret i krishterë në një vend me shumicë myslimane, ishte tregues dhe një ndihmesë e madhe në politikën e jashtme. Fakti që myslimanët ishin shumicë efektive, me një mbret të krishterë në krye do ta rriste kohezionin social. Madje, kjo do të shmangte disa grupime të krishterësh me pikëpamje kantoniste, të cilët këtë ekuilibër mendonin ta realizonin nëpërmjet autonomisë administrative.²³

Ky qëndrim tregon haptazi se monarkistët nuk ishin një grupim konservator, regresist, por personalitete me horizont të emancipuar politik. Qëllimi i tyre ishte vendosja e stabilitetit politik, konsolidimi i shtetit shqiptar, si dhe arritja e kohezionit të brendshëm social. Në rend të parë ata vinin interesin kombëtar, duke larguar çdo paragjykim me karakter fetar. Propozimi i tyre për vendosjen e një mbreti të krishterë në krye të Shqipërisë është treguesi më i qartë. Monarkistët nuk e mohonin faktin se e kaluara historike kishte krijuar klasa të privilegjuara në Shqipëri. Por, frikën e pajustificuar të republikanëve se monarkia do të ishte strehë e feudalëve apo e klasës së bejlerëve, ata e hidhnin poshtë. Kjo sipas tyre ishte fryt i propagandës së huaj. Monarkistët

²³*Po aty*, fl. 47.

çuditëshin se në ballë të kësaj rryme qëndronin persona që në shpirt ishin më feudale se vetë feudalët. Ajo që i shtynte për të mbajtur këtë qëndrim ishte se ata mezi prisnin që vendi të përfshihej në trazira të brendshme, me qëllim që uzurpimi i pushtetit të ishte diçka lehtësisht e realizueshme. Monarkistët sillnin shembuj nga Franca e pas Revolucionit, e cila ishte kthyer në kundërshtaren kryesore të klasës feudale. Sipas tyre, në Greqi, Itali, Serbi, Bullgari, për shkak të monarkisë nuk ekzistonte asnjë parti aristokratike. As Musolini, as Venizelosi dhe as Pashiqi nuk ishin përfaqësues të klasës feudale.

Pretendimin e republikanëve se pas ardhjes së Vidit, ai ishte rrethuar nga bejlerët, monarkistët e quanin diçka normale për kohën edhe sikur të ishte shpallur republika. Influencën e aristokracisë në politikën shqiptare, monarkistët e konsideronin si diçka reale. Madje, deri diku normale, kur ajo nuk i kalonte caqet. Por çështja e monarkisë nuk duhej konsideruar si lëvizje sociale. Ata sillnin si shembull Britaninë, e cila megjithëse ishte monarki, atje sundonin punëtorët. Një mbret i zgjuar do të bëhej përkrahës i intelektualëve dhe demokratëve, që gëzonin mbështetjen e popullit dhe jo i interesave personale të individëve të caktuar. Me mbështetjen e ushtrisë, mbreti do të thyente influencën e bejlerëve dhe të atyre që dëshironin të bëheshin bejlerë, duke siguruar sundimin e plotë të ligjit. Fjalët e përhapura se mbreti do të bëhej krijues i një klase të re feudale, ata i konsideronin si biseda kafeneje për të impresionuar të pamendët.²⁴

Argumentin se mbreti dhe monarkia lypnin shpenzime disa herë më shumë, monarkistët e kundërshtonin me fakte konkrete nga e kaluara historike e Shqipërisë. Megjithëse edhe po të ishte pjesërisht e vërtetë, ajo justifikohet me prestigjin e lartë moral, unitetin e brendshëm dhe rolin e mbretit për bashkimin kombëtarë në raste trazirash. Cenimi i sovranitetit të popullit nga mbreti, për monarkistët ishte rrjedhojë e një koncepti të gabuar që republikanët e kishin si rezultat i ngatërimit të monarkisë absolute me monarkinë parlamentare. Ky argument ishte lehtësisht i kundërshtueshëm nëse kihej parasysh se kombet më të qytetëruara, si: anglezët, skandinavët dhe holandezët ishin monarki. Megjithëse mbreti mund të ishte i huaj, në momentin që do të vihej në krye të Shqipërisë, ai do të natyralizohej dhe do të punonte si shqiptar. Kjo ishte në interesin e tij personal, por edhe të trashëgimtarëve të dinastisë.²⁵ Argumentin se mbretëria do të ishte një barrë për brezat e

²⁴Po aty, fl. 48.

²⁵Po aty, fl. 49.

ardhshëm, duke i shtyrë që ta rrëzonin me kryengritje, monarkistët e kundërshtonin me faktin se nëse kjo do të ishte legjitime ishte plotësisht e drejtë. Por, sipas tyre më mirë një kryengritje pas 50 apo më shumë viteve se sa shpërthimi i një kryengritjeje për çdo vit. Ata e konsideronin monarkinë si institucion i cili do të prodhonte stabilitet politik; si mjetin më efikas për ta futur vendin në rrugën e përparimit. Në mënyrë konsistente ata sillnin si shembull rastin e Britanisë, Holandës, Belgjikës dhe vendeve më të zhvilluara të Evropës.

Një mbret i huaj qoftë edhe evropian, sipas republikanëve do të binte në kundërshtim me mentalitetin dhe gjendjen sociale të popullit shqiptar. Ai mund të binte lehtësisht pre e intrigave të brendshme. Por, ky argument hidhej poshtë nga monarkistët, të cilët ishin të mendimit se nuk ishin të rralla rastet kur shumë evropianë brenda një kohe të shkurtër ishin bërë njohës të shkëlqyer të psikologjisë dhe problemeve të shqiptarëve. Një pjesë e tyre i frikësohej faktit se ardhja e një mbreti evropian do të prishte zakonet dhe traditat e popullit. Kjo sipas monarkistëve, ishte frikë e pajustificuar e individëve që kërkonin të ruanin traditat orientale. Ky grupim ishte i mendimit se vendi ynë duhej futur në rrugën e modernizimit dhe oksidentalizimit, qoftë edhe në mënyrë të dhunshme siç po vepronte Mustafa Qemali.²⁶ Pallati mbretëror, sipas tyre, do të ishte një oazë qytetërimi. Aty do të emancipoheshin ndjenjat dhe zakonet e popullit shqiptar.

Pikëpamjen e republikanëve se për shkak të gjendjes socialo-ekonomike ishte shumë e vështirë për të gjetur një princ evropian, monarkistët e kundërshtonin me faktin se me që Princ Vidi nuk kishte abdikuar, në mos personalisht, mund të vinte i biri. Nëse edhe ai nuk mundej për shkak të pengesave politike, atëherë të vazhdonte regjencia, derisa të gjendej një kandidaturë serioze. Madje, nëse nuk gjendej asnjë princ për t'u vendosur në fronin e Shqipërisë, monarkistët propozonin vendosjen e një pinjolli nga familjet e aristokracisë londineze.

Argumentin se një mbret i huaj do të bëhej vegël politike e shtetit nga kishte ardhur, monarkistët e konsideronin të drejtë dhe parimisht korrekt. Po ata propozonin që mbreti të zgjidhej nga një shtet i cili nuk kishte interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri. Mbreti sipas republikanëve do të ishte pengesë e zhvillimit të vendit. Kjo tregon se republikanët e shihnin monarkinë si simbol të konservatorizmit dhe si institucion mesjetar. Ndërsa monarkistët ndanin mendim të kundërt, duke e konsideruar monarkinë dhe një mbret evropian në krye të saj si

²⁶Po aty, fl. 50.

mbështetësin kryesorë të elitës intelektuale. Ai, sipas tyre do të ishte shembulli më i mirë, influenca morale e të cilit do të ishte orientues për futjen e vendit në rrugën e oksidentalizimit.

Argumentin se mbreti do të krijonte një militarizim të panevojshëm, monarkistët e kundërshtonin duke theksuar se Shqipëria nuk ishte Zvicra, e cila gëzonte një neutralitet të garantuar. Vendi ynë ndodhej në zemër të Ballkanit, i rrethuar nga shtete të cilat aspironin ta aneksonin, të armatosur gjerë në dhëmbë. Prandaj, sipas tyre, Shqipërisë i nevojitej një ushtri e vogël, në raport me mundësitë e vendit. Por, ajo duhej të ishte e mirë organizuar dhe e disiplinuar, nën komandën e mbretit evropian. Në këtë mënyrë ushtria shqiptare do të bëhej garant për stabilitetin e brendshëm politik dhe për paqen ballkanike.

Një nga arsyt kryesore përse ky grupim përkrahte monarkinë ishte fakti se vetëm kështu do të shmangej ndikimi i ushtrisë në politikë. Kjo sipas tyre do të ishte siguria më e madhe drejt lumturisë dhe përparimit. Ky qëndrim është plotësisht i justifikueshëm po të kihet parasysh se nën shembullin e elitës politike xhonturke, si në Turqi ashtu edhe në vendin tonë, ushtria ishte përdorur si instrument për marrjen e pushtetit në mënyrë ilegjitime. Monarkistët aspironin se vetëm në këtë mënyrë ushtria do të vendosej në funksion të interesave kombëtare; se vetëm kështu ajo do të mbahej larg politikës e partive, të cilat luftonin për të ardhur në pushtet.

Arsyet përse monarkistët ishin kundër republikës:

- 1) Ngatërresat që do të lindnin për zgjedhjen e kryetarit të shtetit;
- 2) Mungesa e një vështrimi dhe veprimi të përbashkët;
- 3) Mundësia për ndonjë grusht shteti dhe për diktatura për shkak se ende mungonte moraliteti politik dhe civil.

Sipas monarkistëve arsye kryesore që ata ishin kundër republikës ishte se në vendin tonë kishte një mungesë të theksuar të personaliteteve që ishin të gatshëm për një detyrë kaq të lartë. Por, edhe nëse kishte individë të zotë, korrentet e partive politike do të synonin që të zgjidhnin individë të cilët mund të përdroreshin lehtësisht si vegël e tyre. Nga ana tjetër opinioni publik ashtu si në vendet e qytetëruara do të trembej se mos njerëzit e zotë në krye të shtetit mund ta përdornin pushtetin për të shpallur diktaturën.²⁷ Përvoja kishte treguar se në Shqipëri parlamentarizmi ishte kthyer në oligarki parlamentare. Në dukje vihej re një lloj lirie e popullit, ndërsa në thelb ishin shtypur dhe

²⁷ Po aty, fl. 51-52.

po nëpërkëmbeshin të drejtat më elementare. Prandaj, sipas monarkistëve nevojitej një organ bipartiak. Këtë nuk mund ta bënte as Këshilli i Naltë dhe as kryetari i Republikës, të cilët të zgjedhur nga parlamenti do të ishin nën presionin dhe nën shërbim të oligarkisë parlamentare.

Zgjedhja e kryetarit të shtetit në një vend ku ndjenja fetare ishte më e fortë se ndjenja kombëtare ishte një problem më vete. Sipas monarkistëve nëse kryetari ishte mysliman do të ngjallte pakënaqësinë e të krishterëve dhe anasjelltas. Ky problem do të ripërsëritej sa herë që të kishte zgjedhje, duke shkaktuar përçarje në vend të bashkimit aq të nevojshëm për kombin shqiptar.

Zgjedhja e një kryetari kolegjal nën shembullin e Kongresit të Lushnjës, gjeneronte problemin nëse ai duhej zgjedhur nga parlamenti apo nga populli? Nëse zgjidheshin nga parlamenti katër përfaqësuesit e kryesisë së republikës do të ishin vegla të partive politike që i kishin zgjedhur. Nëse zgjidheshin nga populli duhej bërë votim i përgjithshëm apo sipas përkatësisë fetare? Myslimanët duke qenë shumicë do të zgjidhnin ata të krishterë që nuk korrespondonin me dëshirën e të krishterëve. Kështu, në kryesi do të përfaqësoheshin fetë, por jo dëshirat e të krishterëve. Në këtë mënyrë kryesia e republikës në vend që të ishte një organ prestigjioz dhe kollonë e bashkimit kombëtar do kthehej në burim i përçarjes së elementëve fetarë.²⁸ Me sistemin kolegjal mund të formohej një mazhorancë dhe një minorancë, e cila mund të ndryshonte vazhdimisht në varësi të rrethanave politike. Kjo do të shkaktonte një burim të pazëvendësueshëm destabiliteti. Një shembull i tillë ishte Franca, e cila kishte dështuar kur kishte aplikuar këtë sistem. Me përjashtim të Zvicrës që përfaqësonte një nivel të lartë zhvillimi politik, pothuajse me të gjitha shtetet kishte ndodhur e njëjta gjë. Por, Shqipëria nuk e kishte luksin që të bënte eksperimente politike. Kjo do të thotë të luhej me fatet e kombit dhe të popullit. Arsyeja tjetër që monarkistët ishin kundër republikës ishte se popullit shqiptar i mungonte pjekuria dhe moraliteti politik. Në kushte të tilla, republika mund të bëhej terren i favorshëm për anarki ose diktaturë. Ata bënë thirrje se shqiptarët kishin nevojë më shumë se çdo gjë tjetër për stabilitet, e jo për aventura. Me dorë në zemër - parashtronin monarkistët - sado të forta që të ishin korrentet e idealizmave që i tërhiqnin drejt republikanizmit, ata nuk ishin për aplikimin e këtij sistemi në Shqipëri. Megjithatë ata nuk donin të merrnin përgjegjësi as përpara historisë dhe as përpara mendimit të

²⁸*Po aty*, fl. 53.

përgjithshëm. Prandaj, i bënin thirrje Asamblesë Kombëtare që para se të ndërmernte një vendim kaq të rëndësishëm t'i drejtohej për plebishit popullit shqiptar. Kjo sipas tyre do të ishte mënyra më e mirë për të bashkuar mendimet dhe për të shkarkuar partitë politike nga përgjegjësia ndaj historisë.²⁹ Ky raport mban firmën e kryetarit të Komisionit Monarkist, juristit dhe deputetit Milto Tutulani*.

²⁹ *Po aty*, fl. 54-55.

*Milto Tutulani (1897-1933) u lind në qytetin e Beratit ku mori edhe mësimet e para. Në vitin 1910 përfundoi shkollën trevjeçare për tregti në Vlorë për të vijuar më tej studimet në gjimnazin franko-grek të Selanikut për financë. Studimet e larta për drejtësi i nisi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Stambollit dhe i përfundoi në Athinë. Milto Tutulani ka mbajtur disa herë detyrën e deputetit, ministrit të Financave dhe Drejtësisë në vitet '20-'30, duke luajtur një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për ngritjen e administratës shqiptare.

Hasan BELLO

SUMMARY

REPUBLIC OR A MONARCHY ? SIGNS OF DEPUTIES REPUBLICANS AND MONARCHIST REGIME REGARDING THE FORM OF THE ALBANIAN STATE IN 1924

This article is based on two reports drafted by committees of Republicans and monarchists deputies of parliament. It aims to compare basic arguments and counterarguments that these two groups presented at the parliament's presidency regarding the final determination of the regime in a new statute of the state. What's striking is that they reflect a high degree of accountability, intellectual level and juridical preparation konstitucionale deputies. Regardless of how political developments proceeded , it should be noted that all the representatives of the groups in question were prone to finding the most suitable form of the regime , which will provide the Albanian state t`i stability, prosperity and democracy within constitutional.

Beqir META

**MINORITETI BULLGAR (MAQEDONAS) NË VITET
1925-1939**

Minoriteti bullgar gjatë periudhës së Zogut njohu një zhvillim të qetë dhe paqësor të identitetit të tij etnik e kulturor. Marrëdhëniet me qeverinë shqiptare ishin përgjithësisht të mira. Një problem delikat që u fut në marrëdhëniet mes këtij minoriteti dhe qeverisë shqiptare ishte lëvizja nacionaliste bullgare (maqedonase) që vijonte të ishte aktive në këtë periudhë. Qysh në vitin 1925 administrata e Zogut vijoi të përballej me problemin e lëvizjes bullgare që zhvillohej në Jugosllavi dhe në Greqi. Ajo mori masa energjike dhe mbajti qëndrime të prera për të ndaluar veprimtarinë e komitëve bullgarë që hynin në territorin shqiptar nga Jugosllavia dhe nga Greqia, e cila drejtohej kundër këtyre dy shteteve fqinjë. Për t'i shpëtuar ndjekjes së autoriteteve jugosllave, komitet bullgarë, zakonisht u vetëdorëzoheshin autoriteteve kufitare shqiptare në postën e Goricës. Pasi merreshin në pyetje, ata dërgoheshin në portin e Sarandës nga ku largoheshin prej territorit shqiptar¹.

Këto masa nuk synonin goditjen e lëvizjes maqedonase, por ishin rezultat i përpjekjeve për inagurimin e një politike miqësore me Jugosllavinë e Greqinë. Sigurisht që kjo politikë e qeverisë shqiptare nuk u prit mirë nga popullsia bullgarofone në Shqipëri. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare nuk tregoi predispozicion pozitiv për të shtuar shkollat bullgare. Kështu nuk u plotësua një kërkesë e pleqësisë së katundit Vernik për hapjen e një shkolle të tillë. Arsyeja ishte se mungonin mësuesit që të jepnin mësimet në gjuhën bullgare, por edhe ngaqë nevojë parësore konsiderohej mësimi i gjuhës zyrtare (shqipe) nga

¹ Arkivi qendror i Shqipërisë (AQSH), F. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), viti 1925, dos. 91.

fëmijët e këtij fshati². Prefektura e Korçës propozoi që në Vernik të çelej një shkollë shtetërore shqiptare dhe një mësues të jepte orë mësimi në gjuhën bullgare³. Të pakënaqur nga kjo ofertë, iniciatorët e kësaj kërkesë, Simon Iliev e Nako Dhimitri Pisoderi i dërguan një telegram Legatës Bullgare në Tiranë, në të cilin kërkonin çeljen e shkollës bullgare. Autoritetet shtetërore nuk e toleruan këtë veprim dhe i internuan ata në Berat⁴. Si lëvizja e komitëve maqedonas ashtu dhe kërkesat për zgjerimin e gjeografisë së shkollave bullgare duket se ishin reminishenca të periudhës së qeverisë së Nolit, kur figura të rëndësishme të regjimit të tij dhe, veçanërisht pjesëtarët e Komitetit të Kosovës, kishin pasur marrëdhënie miqësore me komitetet maqedonase dhe, për rrjedhojë, edhe me qarqet nacionaliste në minoritetin bullgarofon që jetonte në territorin shqiptar.

Në vijim të politikës së ruajtjes së marrëdhënieve miqësore dhe korrekte me Jugosllavinë dhe Greqinë, gjatë vitit 1926 u morën masa të shumta ndalimi dhe dëbimi të pjesëtarëve të lëvizjes maqedonase nga territori shqiptar, shumica e të cilëve u ekstraduan në Greqi. Gjithashtu u morën masa shtrënguese ndaj pjesëtarëve të minoritetit bullgarofon në Shqipëri që merrnin pjesë në këtë lëvizje ose që strehonin komitet maqedonas që vinin nga Greqia dhe Jugosllavia, pasi këto veprime kishin shkaktuar konflikte të vazhdueshme me Jugosllavinë e Greqinë. Kështu u bastis shtëpia e Filip Dhimitrefit në Korçë, sepse ky kishte strehuar komitë maqedonas. Ai u shpërngul në Berat me qëllim që të mos ishte pranë kufirit⁵.

Qeveria shqiptare ishte e shqetësuar edhe nga disa akte grabitjesh e vjedhjesh që po bëheshin në territorin grek nga disa bullgarë, banorë të 14 fshatrave që i ishin dhënë Shqipërisë, pasi ajo donte të ruante marrëdhëniet miqësore me Greqinë. Prandaj dha udhëzime që të bëhej kujdes nga autoritetet vendore⁶. Në vitin 1928 popullsia e katundeve bullgarofone kërkoi që kishat e veta të merrnin një karakter bullgar. Disa djem hynë natën në kishën e Vernikut dhe

²AQSH, F. MPB, viti 1925, dos. 461, fl. 5, Ministria e Arsimit (MA) - MPB, 6 shkurt 1925.

³AQSH, F. MPB, viti 1925, dos. 91, fl. 12-13, Prefektura e Korçës - MPB, 27 shkurt 1925.

⁴AQSH, F. MPB, viti 1925, dos. 91, fl. 12-13, Prefektura e Korçës - MPB, 27 shkurt 1925.

⁵AQSH, F. MPB, viti 1926, dos. 88, fl. 1-172.

⁶AQSH, F. MPB, viti 1926, dos. 108, fl. 2, MPB - Prefekturës së Korçës, 27 shkurt 1926.

fshinë emrat e shenjtorëve që ishin shkruar në greqisht në kohën e pushtimit grek. Ata deklaruan se dëshironin që emrat të shkruheshin bullgarisht dhe, në qoftë se kjo nuk do të lejohej, të shkruheshin në gjuhën shqipe⁷. Në vitin 1928 u vu re një ulje e presionit të qeverisë ndaj komiteteve irredentiste bullgare. Sigurisht që qeveria shqiptare përpigjej të shmangte polemikat dhe tensionet me qeveritë greke e jugosllave për këtë çështje, por ajo i zbuti masat ndaj komitëve bullgarë. Kështu komiti bullgar Boris Stajanov, bashkë me 10 shokë të tij, pasi mori vizë tranzit për në Itali, u largua në mënyrë të fshehtë nga Shqipëria⁸. Përfaqësuesi i Komitetit Revolucionar Maqedonas, Buzhardoff iu lut qeverisë shqiptare të linte të lirë komitetin maqedonas që ishin dorëzuar tek autoritetet shqiptare për të kaluar në Itali.

Kjo kërkesë u pranua. A. Zogu urdhëroi që komitetin bullgarë, të burgosur në Berat, të largoheshin në fshehtësi nga ndonjë liman shqiptar, ku nuk kishte konsullata greke e jugosllave, për në Itali⁹. Por, nga ana tjetër, Ministria e Brendshme dha udhëzime që të mbaheshin nën mbikëqyrje të rreptë elementët turbullues maqedonas, me qëllim që të mos lihej shteg për ndonjë propagandë apo lëvizje të dëmshme. Ata që vlerësoheshin si të dyshimtë, do të nxirreshin menjëherë jashtë kufirit¹⁰. Mund të supozohet se ky ndryshim i politikës së qeverisë shqiptare erdhi pas konsolidimit të pozitave të saj të brendshme dhe pas afrimit me Italinë.

Ka shumë mundësi që qeveria e Romës të ketë kërkuar një tolerancë më të madhe ndaj aktiviteteve të komitëve bullgarë. Qeveria shqiptare vijoi të përballej me presionin e Jugosllavisë lidhur me lëvizjen maqedonase. Legata Jugosllave u ankua se Komiteti Maqedonas kishte një çetë dhe disa agentë në rrethin e Elbasanit, të cilët strehoheshin dhe përkraheshin nga fshatarët vendas¹¹. Legata Jugosllave këmbëngulte se agentët e Komitetit Maqedonas po gjenin përkrahje të madhe në Korçë për të formuar banda kundër Jugosllavisë. Sipas saj, këto banda strehoheshin në fshatrat, Vernik, Bitinckë, Goricë, Zvezdë, Borje, Zëmlak, Leshnicë, Çezmë e në Pogradec.

⁷AQSH, F. MPB, viti 1928, dos. 42, fl. 9, Komanda e Përgjithshme e Xhandarmërisë-MPB, 24 prill 1928.

⁸AQSH, F. MPB, viti 1928, dos. 84, fl. 7, MPB - Prefekturës së Vlorë, 4 janar 1928.

⁹AQSH, F. MPB, viti 1928, dos. 84, fl. 7, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) - MPB, 18 dhjetor 1927.

¹⁰AQSH, F. MPB, viti 1928, dos. 84, fl. 19, MPB - Prefekturave, 13 shkurt 1928.

¹¹AQSH, F. MPB, viti 1928, dos. 84, fl. 32, MPB - Prefekturës së Elbasan, 26 shkurt 1928.

Ajo akuzonte mësuesit e Vernikut, Gllomboçit dhe të fshatrave të tjera se ishin agjentë të Komitetit Maqedonas dhe se po punonin për formimin e bandave e për shpërndarjen e armëve. Këta thuhej se ishin përkrahur jo vetëm prej bullgarëve por edhe prej shqiptarëve të Korçës¹². Këto ankesa nxitën edhe hetime të reja dhe kryerjen e disa kontrolleve në shtëpitë e banorëve të fshatit Gllomboç, por nuk u gjet ndonjë material komprometues. Megjithëkëtë në verë të vitit 1928 u burgosën disa bullgarë të cilëve iu gjetën bomba dhe armë lufte, gjë që solli reagimin e qeverisë bullgare¹³.

Shteti shqiptar vijoi të mbetej në pozita disi kontradiktore ndaj pakicës bullgarofone. Në njërën anë ai duhej t'u jepte zgjidhje kërkesave të nacionalistëve bullgarë, të cilët kërkonin zgjerimin e arealit të minoritetit bullgar në Shqipëri dhe të drejtave të tij, në anën tjetër, duhej të mbante një qëndrim ndaj aktiviteteve të komitëve bullgarë në territorin shqiptar dhe të përballonte presionin në rritje të vendeve fqinje. Jugosllavët u përpoqën të sensibilizonin qeverinë britanike për tolerimin e aktiviteteve të komitëve maqedonas në Shqipëri.

I ngarkuari me Punë i Jugosllavisë, Kassidolatz, i tha përfaqësuesit britanik Seeds se i kishte tërhequr vëmendjen qeverisë shqiptare që të ndalonte aktivitetin e komitëve në zonën kufitare të Korçës, pasi përpjekjet e forcave shqiptare për t'i parandaluar këto aktivitete kishin qenë joefektive për shkak të qëndrimeve të zyrtarëve lokalë. Kassidolatz deklaroi se nuk kishte qëllim që të krijonte grindje me qeverinë shqiptare, por se ishte i shqetësuar nga formimi i një grupi të përbërë nga revolucionarë maqedonas dhe nga pjesëtarë të Komitetit të Kosovës.¹⁴ Kassidolatz ishte i bindur për vullnetin e mirë të presidentit A. Zogu dhe të prefektit të ri mysliman të Korçës. Por, ai konstatonte se nëpunësit e vegjël lokal ishin përfshirë në intriga dhe ishin të plogësht. Ai ju betua Seeds se “kjo ankesë nuk ishte si ato që kishte bërë Legata Jugosllave në të kaluarën, e cila kishte ngritur male përtej kodrinave. Por, këto intriga të vogla mund të krijonin incidente serioze kufitare.”¹⁵ Seeds përfitoi nga rasti dhe i kërkoi qeverisë jugosllave të merrte masa për të mbajtur nën mbikëqyrje të arratisurit

¹²AQSH, F. MPB, viti 1928, dos. 84, fl. 33, MPB - Prefekturës Korçë, 26 shkurt 1928.

¹³AQSH, F. MPB, viti 1928, dos. 84, fl. 185, Prefektura e Korçës - MPB, 14 korrik 1928.

¹⁴British National Archives, Kew, London, Foreign Office, (me tej: FO) 371/ 12847, Seeds për A. Chamberlain, Durrës 27 shkurt 1928.

¹⁵Po aty.

shqiptare në Jugosllavi. Ai i tha të ngarkuarit jugosllav se ishte gati të pranonte vullnetin e mirë të qeverisë jugosllave, por shumë zyrtarë të vegjël serbë po inkurajonin të arratisurit shqiptarë, duke mos zbatuar urdhrat e qeverisë qendrore. Kështu kufiri verior ishte veçanërisht delikat. I gjithë informacioni tregonte se Shqipëria e Veriut ishte në gjendje të tensionuar, disi më e acaruar dhe e pakënaqur se sa zakonisht. Ndoshta Tirana kishte arsye më të forta për që qenë e nervozuar për këtë rajon se sa kishte Beogradi për rajonin e Korçës. Ai i kujtoi Kassidolatz se dyshimet e qeverisë shqiptare kishin qenë arsyeja kryesore për incidentin e pranverës së kaluar, kur Jugosllavia ishte akuzuar nga Italia si një kërcënuese e paqes.

Seeds i shkruante Chamberlainit se tani Ahmet Beu ishte bërë i ndruajtur ashtu si vitin e kaluar. Gjeneral Percy do të fillonte një turne një mujor në Shqipëri, por presidenti e ndaloi atë në momentin e fundit dhe e kishte udhëzuar të qëndronte në Veri. Kassidolatz i dha në mënyrë konfidenciale përfaqësuesit britanik një informacion, që ai e konsideronte si më seriozin që dispononte. Sipas tij, në Tiranë ishte formuar një grup me emrin “Komiteti Ballkanik”, i cili ishte një bashkim i revolucionarëve maqedonas me Komitetin e Kosovës dhe që po mbështetej nga disa oficerë italianë në ushtrinë shqiptare. Ky informacion mund të ishte ose jo i vërtetë, por ai kishte mësuar se Abdurrahman Dibra, ministër i Brendshëm, ishte anëtar i këtij Komiteti. Irredentistët shqiptarë dhe agjitorët maqedonas mund të llogarisnin mbështetjen e ministrit të Brendshëm. Në këtë rast, çfarë vlere kishte nota jugosllave drejtuar ministrit të Jashtëm? Në notën e tij ai kishte përmendur veprimet e zyrtarëve lokalë se ishin fajtorë për plogështi, por çështja e Abdurrahman Dibrës ishte një çështje tjetër.¹⁶

Qeveria shqiptare ju përgjigj notës jugosllave, duke vënë në dyshim faktet e paraqitura nga Legata Jugosllave. Zëvendëskonsulli britanik në Korçë, Purcell i tha Seeds se akuzat jugosllave ishin kryesisht shpikje të agentëve të shumtë, që dihet se paguheshin nga konsulli lokal serb. Këta njerëz duhej të informonin për diçka që të justifikonin pagat e tyre. Ai pohoi se, në asnjë rast konsullata jugosllave nuk kishte qenë në gjendje të informonte prefektin për një veprim konkret dhe aktual. Me fjalë të tjera, akuzat lidheshin me ngjarje të së shkuarës të cilat ishte e pamundur të kontrolloheshin. Si presidenti i Republikës ashtu dhe zyrtarët e MPJ-së i deklaruan Seeds se ishin gati të plotësonin kërkesat serbe. Ata nuk donin të ngatërroheshin në

¹⁶Po aty.

çështjen maqedonase. Këto revolucionarë nuk ishin asgjë për ta. Përkundrazi ata përbënin një shqetësim për Shqipërinë. Zyrtarët e lartpërmendur shqiptarë deklaruan se, për më tepër, ishte e paarsyeshme që të vihej në dyshim qeveria shqiptare se po inkurajonte fshehurazi një organizatë, programi i së cilës për një shtet maqedonas, përfshinte edhe tjetërsimin e territorit shqiptar, të banuar nga sllavët në zonën fqinje të Korçës.¹⁷ Presioni mbi qeverinë shqiptare po amplifikohet edhe nga shtypi jugosllav, i cili bëri protesta të forta për mbylljen e kufirit në zonën e Ohrit, me justifikimin se kishte rënë epidemia e tifos. Autoritetet jugosllave kishin deklaruar se ekzistonin vetëm dy raste të tilla në këtë zonë. Shtypi akuzonte qeverinë shqiptare se arsyeja e vërtetë e mbylljes së kufirit ishte përgatitja e rrugëve për penetrimin e komitëve maqedonas dhe kosovarë, raportet për veprimet e të cilëve po bëheshin çdo ditë më të qarta.¹⁸

Edhe Ministri jugosllav në Londër u tha zyrtarëve të Forin Offisit se mbyllja e kufirit ishte bërë që të favorizoheshin lëvizjet e komitëve brenda në Jugosllavi. “Ministri Gjuriçiç, shkruanin ata, vjen gjithmonë në Foreign Office, flet për Shqipërinë dhe demonstroi pikëpamjen e tij se qeveria britanike po bën gabim që po toleron aktivitetet italiane në Shqipëri. Ai e kupton mirë se qeveria britanike nuk është e interesuar për këtë vend, por ai është i bindur se italianët po vijnë politikën e penetrimit dhe, në fund, kjo do të çojë në trazira në Ballkan. Ai asnjëherë nuk e pranon pikëpamjen tonë se nuk ka arsye që, meqë italianët po investojnë para në Shqipëri, kjo të shkaktojë pakënaqësi dhe mosmarrëveshje me Jugosllavinë”.¹⁹

Në fund të marsit të 1928, konsulli jugosllav në Korçë u dha autoriteteve lokale shqiptare një rast për të provuar gatishmërinë e tyre për të goditur aktivitetin e komitëve. Ai u tha autoriteteve se në disa vende në Korçë ishin strehuar disa revolucionarë maqedonas. Prefekti bashkë me komandantët e policisë e xhandarmërisë, bëri hetime personalisht. Pas kërkimeve, rezultoi se nuk kishte as revolucionarë dhe as mbështetës të tyre. Hetime të njëjta u bënë njëkohësisht në fshatin Bilisht dhe në disa fshatra të Korçës, por nuk rezultoi asgjë.²⁰ Seeds informonte se autoritetet shqiptare në Tiranë mbajtën një qëndrim

¹⁷ FO 371/ 12847, Seeds për A. Chamberlain, Durrës, 12 mars 1928.

¹⁸ FO 371/ 12847, Kennard për A. Chamberlain, Beograd, 5 prill 1928.

¹⁹ FO 371/ 12847, Shënime të Howard Smith dhe Orme Sargent rreth një bisedë me Ministrin e Mbretërisë së SKS në Londër.

²⁰ FO 371/ 12847, Seeds për A. Chamberlain, Durrës, 4 prill 1928.

energjik ndaj Bojan Danovski, një korrespondent i shtypit bullgar, i cili pretendonte se përfaqësonte gazetën fashiste “Il Lavoro d’Italia”. U provua pa dyshime se ky individ po punonte për organizatën maqedonase, por tha se nuk ishte angazhuar në aktivitete antishqiptare. Atij ju kërkua të largohej nga Shqipëria dhe ju deklarua se propaganda maqedonase ishte kundër interesave shqiptare. Ai kundërshtoi të largohej vullnetarisht dhe kështu u dëbua me forcë.²¹

Në vitin 1929 disa bullgarë të lindur në katundet bullgarofone të Shqipërisë dhe që banonin në Sofje formuan një shoqëri me emrin “Sveti Jovan Krestitel”, me qëllim që të ndihmonin bullgarët e Shqipërisë për të hapur shkolla e kisha dhe për t’i furnizuar me librat e nevojshme. Në fakt, kjo shoqëri nuk ishte gjë tjetër veçse një formë e re e shoqërisë “Debra” dhe një degë e Komitetit Maqedonas²². Konsullata Jugosllave vijonte të ushtronte presion ndaj Prefekturës së Korçës për të ndjekur çetat bullgare që vepronin në tokën jugosllave²³. Edhe autoritetet greke po ushtronin të njëjtin presion. Komandanti i kufirit grek në zonën e Pisoderit, Georgos Zoglllopitis, dhe togëkomandanti i Smerdeshit, togeri Kafaqis, u ankuan se komitetet bullgare që strehoheshin në katundet Vernik e Zagradec po përkraheshin nga oficerë të xhandarmërisë shqiptare²⁴.

Nën presionin e Greqisë dhe nga shqetësimi se lëvizja e çetave bullgare mund të provokonte një konflikt shqiptaro-grek, me propozimin e Prefekturës së Korçës, Këshilli i Ministrave miratoi internimin për një vit në Krujë të Kristo Andon Dinoff, priftit Llazo Tole, Diço Llazo Tole, Kristo Diko dhe të Nikolla Ilia Popoffski, banorë të Vernikut, të cilët ishin anëtarë të një organizate kryengritëse dhe njerëz të rrezikshëm për qetësinë në zonën kufitare²⁵. Por ata u ankuan, duke mohuar se kishin zhvilluar propagandë të huaj. Përkundrazi pohuan se ishin thjesht shqiptarë që ushqenin ndjenja kombëtare shqiptare²⁶.

²¹Po aty.

²²AQSH, Fondi MA, viti 1929, dos. 134, fl. 2, Legata e Shqipërisë Sofje - MPJ, 3 qershor 1929.

²³AQSH, Fondi MPB, viti 1929, dos. 102, fl. 26, Prefektura e Korçës - MPB, 22 korrik 1929.

²⁴AQSH, Fondi MPB, viti 1929, dos. 67, fl. 50, Komanda e kompanisë kufitare, Bilisht - komandës së Batalionit II kufizor të Korçës, 29 gusht 1929.

²⁵AQSH, Fondi MPB, viti 1929, dos. 102, fl. 63, Vendimi i Këshillit të Prefekturës së Korçës dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave, 19 tetor 1929.

²⁶AQSH, Fondi MPB, viti 1929, dos. 102, fl. 78, Ankesë e 5 të dënuarve - MPB, 8

Në anën tjetër edhe qeveria bullgare po ushtronte presion, duke u ankuar se autoritetet shqiptare nuk po silleshin miqësisht me ata pak bullgarë që jetonin në Shqipëri. Si shembull, sillej gjobitja e disa fshatarëve të Vernikut pasi ata kishin fshirë në kishën e fshatit mbishkrimet greke dhe i kishin zëvendësuar me ato bullgare²⁷.

Zhvillimi i arsimit në fshatrat bullgarofone ishte në një nivel më të ulët se sa në minoritetet e tjera kombëtare në Shqipëri. Shkaqet e kësaj situatë ishin komplekse por, kryesore ishin kapacitetet e ulëta intelektuale të kësaj popullsie të varfër fshatare për të siguruar kuadrin arsimor. Në vitin 1929 në 11 fshatrat bullgarofone të Prefekturës së Korçës (Zaroshka 180 banorë, Lajthiza 70 banorë, Shulini 430 banorë, Posteci 510 banorë, Gllomboçi 380 banorë, Bezmishti 290 banorë, Gorica 305 banorë, Cerja 98 banorë, Shejvci 20 banorë, Zagradeci 50 banorë dhe Verniku 484 banorë) kishte 3 shkolla, në Gllomboç, Postec e Vernik. Vetëm tre mësues të këtij qarku dinin të flisnin gjuhën bullgare²⁸. Inspektoria e arsimit të Korçës propozoi çeljen e tre shkollave të reja në Bezmisht, Shulin dhe Zaroskë me qëllim që të kënaqej popullsia vendase. Ajo dëshironte të krijonte një imazh më të mirë se sa serbët e grekët të cilët kishin kundërshtuar arsimin bullgar. Prirja për të favorizuar arsimin e kësaj pakice në gjuhën amtare fuqizohej edhe më tepër, sepse këto fshatra kishin shprehur gjithmonë dëshirën që të ishin pjesë e Shqipërisë²⁹.

Megjithëkëtë qeveria bullgare nuk ishte e kënaqur. Ajo u ankua se bullgarofonët e Shqipërisë në Prefekturën e Korçës nuk ishin lejuar të çelnin shkolla fillore bullgare, ndërsa grekofonët kishin shumë liri në këtë fushë³⁰. Ministria e Arsimit informonte MPJ-në se ishte e gatshme të shqyrtonte menjëherë çdo kërkesë të këtyre fshatrave, por shtonte se ende nuk ishte bërë ndonjë kërkesë për hapjen e shkollave bullgare nga katundet bullgarofone³¹. Ministria e Jashtme e udhëzoi Legatën Shqiptare në Sofje se pikat 5, 6, 7 të notës së MPJ-së të Bullgarisë të 14 dhjetorit 1929 kishin të bënin me çështje tërësisht të brendshme të shtetit shqiptar dhe një qeverie, me ndërgjegjen e pavarësisë së saj, nuk

dhjetor 1929.

²⁷AQSH, Fondi MPB, viti 1929, dos. 67, fl. 22, MPJ - MPB, 16 dhjetor 1929.

²⁸AQSH, Fondi MA, viti 1929, dos. 76, fl. 4, Inspektoria e Arsimit Korçë - MA, 31 tetor 1929.

²⁹AQSH, Fondi MA, viti 1929, dos. 76, fl. 4, Inspektoria e Arsimit Korçë - MA, 31 tetor 1929.

³⁰AQSH, Fondi MA, viti 1929, dos. 76, fl. 5, MPJ - MA, 16 dhjetor 1929.

³¹AQSH, Fondi MA, viti 1929, dos. 76, fl. 6, MA - MPJ, 31 dhjetor 1929.

mund ta toleronte, në asnjë mënyrë, ndërhyrjen e një fuqie të huaj. Megjithëkëtë, qeveria shqiptare, duke dashur të tregojë vullnetin e saj të mirë dhe trajtimin miqësor që u rezervonin autoritetet shqiptare nënshtetasve bullgarë dhe bullgarëve që ishin nënshtetas shqiptarë, kërkonte që të informohej qeveria e Sofjes se bullgarët, nënshtetas shqiptarë, që ishin arrestuar në katundin Vernik nuk ishin arrestuar sepse kishin fshirë shkronjat greke dhe i kishin zëvendësuar me shkronja bullgare, por sepse ata kishin hyrë natën në kishë, pasi kishin thyer portën dhe ky veprim ishte në kundërshtim me ligjet e shtetit shqiptar³².

Qeveria shqiptare kishte një vullnet pozitiv për çeljen e shkollave bullgare, por ajo ndeshte vështirësi, veçanërisht në sigurimin e kuadrit mësimor. Kështu, në fshatrat Shulin, Postec e Gllomboç funksiononin shkolla shqipe. Në këto shkolla gjuha bullgare nuk jepej vetëm për arsyen se mungonin mësuesit e përshtatshëm që mund ta jepnin atë. Qeveria u kishte akorduar bursë në Shkollën Normale të Elbasanit dy bullgarofonëve dhe po priste që t'i emëronte ato si mësues të gjuhës bullgare në këto shkolla³³.

Nga ana tjetër, qeveria shqiptare vazhdonte të ishte nën presionin e fortë të fqinjëve për strehimin e çetave maqedonase në territorin e saj. Madje çështja ishte aq serioze saqë u përfshi edhe qeveria britanike. Në shkurt të vitit 1930 i ngarkuari i Jashtëzakonshëm i Britanisë së Madhe në Jugosllavi i tha ministrit shqiptar në Beograd se qeveria jugosllave kishte informata se Komiteti Maqedonas kishte vendosur të dërgonte agjentë të tij në Shqipëri për të organizuar turbullira kundër Jugosllavisë. Ai tha se drejtuesit e Beogradit i jepnin një rëndësi të posaçme kësaj çështje dhe, nëse komiteti maqedonas, vërtet do ta përdornin tokën shqiptare si bazë operacioni, atëherë çështja mund të merrte një ngjyrë serioze dhe Jugosllavia do të kishte të drejtë të justifikonte marrjen e disa masave kundër Shqipërisë³⁴. Të njëjtin paralajmërim i bëri ministrit të Jashtëm të Shqipërisë edhe ministri britanik në Tiranë, Hodgson. Qeveria shqiptare u dha britanikëve siguri të forta e kategorike se nuk do ta toleronte një veprimtari të tillë³⁵. Në vitin 1931, banorët e Goricës i kërkuan Ministrisë së Arsimit çeljen e një shkolle bullgare dhe u ankuan se fshati i tyre nuk kishte as edhe

³²AMPJ, viti 1930, dos. 191, MPJ - Legatës Shqiptare në Sofje, 17 janar 1930.

³³AMPJ, viti 1930, dos. 288, fl. 11, MA - MPJ, 21 maj 1930.

³⁴AQSH, Fondi MPB, viti 1930, dos. 100, fl. 1, MPJ - MPB, 25 shkurt 1930.

³⁵AQSH, Fondi MPB, viti 1930, dos. 100, fl. 1, MPJ - MPB, 25 shkurt 1930.

shkolla shqipe, megjithëse kishte një godinë shumë të mirë për shkollë³⁶. Ndërsa, delegatët bullgarë që kishin marrë pjesë në “javën ballkanike”, bënë një deklaratë shumë miqësore për Shqipërinë. Ata deklaruan se qarqet kompetente në Tiranë kishin premtuar se çështja e shkollave dhe e kishave bullgare do të zgjidhej, gjë që do të konsolidonte edhe më tej marrëdhëniet midis dy vendeve³⁷.

Në vitin 1931, dukej qartë se gjendja e shkollave në fshatrat bullgare ishte përmirësuar por, kishte ende shumë punë për të bërë. Në një raport të Ministrisë së Arsimit kjo gjendje paraqitej si më poshtë:³⁸

A. Qarku i Korçës

1. Goricë - 45 nxënës, ndërtesa shkollore e mirë, shkolla ishte hapur në vitin 1925-1926.

2. Bezmishta - 20 nxënës, nuk kishte ndërtesë shkollore, nxënësit kishin vazhduar shkollën në Goricë.

3. Posteci - 55 nxënës, ndërtesa e mirë, shkolla ishte çelur më 1929-1930.

4. Shulini - 30 nxënës, s’kishte ndërtesë, nxënësit kishin vazhduar shkollën në Postec.

5. Lajthizë - 8 nxënës, s’kishte ndërtesë shkollore, nxënësit kishin vazhduar shkollën në Postec.

6. Zaroshka - 10 nxënës, s’kishte ndërtesë shkollore, nxënësit kishin vazhduar shkollën në Postec.

7. Gllomboç - 35 nxënës, ndërtesa e shkollës ishte e mirë, shkolla vijonte të ishte e çelur.

B. Qarku i Bilishtit

8. Cerja - 20 nxënës, ndërtesa e shkollës në gjendje jo shumë të mirë, më parë s’kishte pasur shkollë. Tani kishte shkollë private.

9. Vernik - 35 nxënës, ndërtesa e shkollës në gjendje të mirë, shkolla kishte funksionuar në vitet 1929-1930, tani nuk funksiononte.

Por, kjo situatë reflektohej tërësisht në një sens negativ në relacionet e Legatës Bullgare në Tiranë. Ajo i dërgonte një relacion

³⁶ AQSH, Fondi MA, viti 1931, dos. 31, fl. 2, Lutje e fshatrave të Goricës - MA, 27 janar 1931.

³⁷ AMPJ, viti 1931, dos. 197, fl.1, Legata Shqiptare në Sofje - MPJ, 4 maj 1931.

³⁸ AQSH, Fondi MA, viti 1931, dos. 31, fl.1, Pasqyrë mbi shkollat minoritare në Shqipëri në vitin shkollor 1930-1931.

qeverisë së Sofjes në të cilin jepeshin këto të dhëna për popullsinë bullgare dhe për gjendjen e shkollave dhe kishave të saj:

Qyteti	Familje	Anëtarë	
Tiranë	15	68	Nuk ka bullgarë, nuk ka as kishë as shkollë
Shkodër	20	85	
I. Rrethi i Dibrës:			
Kërçishtë	22	112	popullsi e pastër bullgare
Erbel	15	70	ka edhe popullsi shqiptare
Pasink	12	63	7 familje torbeshe
Toçep	1	3	50 torbeshë
Ostreni i Vogël	14	69	60 torbeshë
Vërmica	38	191	popullsi shqiptare
Trebica	6	31	450 torbeshë
Gjinevicë	21	98	25
Klenjë	29	112	3
Steblovë	10	44	7
II. Rrethi i Strugës:			
Fshati Lin	15	73	20
III. Rrethi i Prespës:			
Qyteti Bilisht	30	143	
Fshati Vernik	70	328	
Tumenencë	40	281	
Gllomboç	45	290	
Gorica e Vogël	5	29	
Shulin	37	215	
Pustec	70	505	
Liska	15	118	
Zërnovcë	20	143	
Cërvë	15	112	
IV. Rrethi i Korçës Boboshticë	300		

Cilësohej si fshat i pastër Dërnova (Drenova) me 75 familje me popullsi bullgare e cila e kishte humbur identitetin kombëtar, por që e flisnin shumë mirë gjuhën bullgare me një dialekt të vjetër bullgar. Gjithsej - në tre qytete dhe 19 fshatra pa Boboshticën dhe Drenovën ishin 560 familje dhe 3 154 banorë. Legata Bullgare pohonte se askund në Shqipëri nuk kishte shkollë bullgare, e as kishë bullgare. Vetëm në fshatin Tumenencë thuhej se kishte një klerik të cilin e paguante

Ministria dhe, sipas të dhënave, në Tiranë ishte një mësues i cili paguhej nga Ministria, por, nuk kishte nxënës.³⁹

Viti 1932 filloi me një ngjarje të bujshme pozitive në marrëdhëniet shqiptaro-bullgare. Në zbatim të vendimit të marrë në Konferencën Ballkanike të Stambollit, që shtetet pjesëmarrëse të arrinin marrëveshje dypalëshe për të zgjidhur çështjet midis tyre, përpara se të nënshkruhej Pakti Ballkanik, delegacionet kombëtare joqeveritare bullgare e shqiptare dhanë të parët shembullin për jetësimin e këtij rekomandimi. Më 9 janar 1932, delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Mehmet Konica dhe ai bullgar, i kryesuar nga Janko Sakazoff, nënshkruan në Sofje një protokoll,⁴⁰ sipas të cilit të dy delegacionet njihnin juridikisht ekzistencën e pakicave shqiptare e bullgare në vendet e tyre dhe angazhoheshin të ndërmjetësonin pranë qeverive të tyre që ato të hapnin dhe të mbanin shkolla shqipe dhe bullgare, në ato fshatra ku popullsia shqiptare dhe bullgare ishte predominante. Në këto shkolla mësimet do të zhvilloheshin në gjuhën amtare të pakicave, ndërsa gjuha zyrtare ishte e detyrueshme. Gjithashtu, qeverive përkatëse do t'u kërkohej që në ato shkolla bullgare ose shqiptare, ku mësonin mjaft nxënës të pakicës shqiptare ose bullgare, të jepeshin orë mësimi të gjuhës së pakicës përkatëse.

Ndërsa, çështja e statusit të kishave bullgare që ndodheshin në tokën shqiptare u la që të diskutohej në një takim të ardhshëm. Delegacionet do të nxisnin qeveritë e tyre që të realizonin shkëmbimin e lirë të çdo lloj botimi prej të dyja palëve, përveç atyre botimeve që ndaloheshin nga ligjet e dy shteteve. Gjithashtu, në këtë protokoll, të dy delegacionet angazhoheshin të nxisnin qeveritë e tyre për nënshkrimin e një pakti miqësie, arbitrazhi dhe mossulmimi dhe për nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare. Sipas komenteve të shtypit shqiptar, ky protokoll nuk do të kishte fuqi në rastin e një sulmi nga një fuqi joballkanike⁴¹. Gjatë vizitës në Sofje, Mehmet Konica u pranua në audiencë nga kryeministri Mushanoff dhe nga Mbreti Boris.

³⁹Централен Државен Архив-Блгарија (Arkivi Qendror Shtetëror i Bullgarisë) Фонд (Fondi) 176K, опис (Dosja) 32, архивска единица (Dokument) 80, листа (fleta) 1. (Lista e vendbanimeve në Shqipëri me popullsi bullgare është hartuar nga diplomacia bullgare në Tiranë (pa vit) sipas të gjitha gjasave midis viteve 1930-1932. Emërtimi i vendbanimeve është dhënë si në dokument.

⁴⁰AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 2-3, Protokolli final i delegacioneve joqeveritare shqiptare e bullgare, nënshkruar në Sofje, më 9 janar 1932.

⁴¹“Marrëveshja e Sofjes midis Shqipërisë e Bullgarisë për çështjen e pakicave”, *Ora*, Tiranë, 15 janar 1932.

Delegacioni bullgar kërkoi që të zhvillonte bisedime për nënshkrimin e një marrëveshje të ngjashme edhe me delegacionin serb, mirëpo ndërhyri qeveria serbe e cila bëri që këto negociata të shtyheshin për një kohë të pacaktuar⁴². Lajmin për arritjen e marrëveshjes midis delegacioneve joqeveritare, shqiptare e bullgare e konfirmonte edhe Legata Shqiptare në Sofje, e cila nënvizonte se të dy delegacionet pranuan ekzistencën e pakicave shqiptare e bullgare në vendet e tyre dhe morën përsipër t'u rekomandonin qeverive të tyre çeljen e shkollave minoritare në katundet e viset e banuara prej këtyre pakicave. Delegacioni bullgar ishte përpjekur të diskutonte edhe disa kërkesa të tjera që bullgarët kishin kundrejt shtetit shqiptar por, me propozimin e palës shqiptare, ky diskutim u la për një takim tjetër⁴³.

Shtypi bullgar i bëri jehonë pozitive kësaj marrëveshje. Gazeta gjysmë zyrtare "La Bulgare", më 11 janar 1932 dhe gazeta "Zname", organ i Partisë Demokrate Bullgare, duke i bërë jehonë pozitive marrëveshjes, shkruanin se marrëveshja kishte provuar vlerësimin që kishte bërë, 17 vjet më parë, një politikan i njohur bullgar, i cili kishte deklaruar se vetëm dy popuj kishin simpati për bullgarët dhe këta ishin hungarezët dhe shqiptarët. Në shtypin bullgar evokohej miqësia tradicionale e të dy popujve dhe vihej në dukje se në Lidhjen Ballkanike, Bullgaria, ndryshe nga serbët dhe grekët, kishte kërkuar krijimin e një Shqipërie të pavarur⁴⁴. Gjithashtu shtypi bullgar nënvizonte faktin se këto dy kombe ishin të vetmit, trojet e të cilave ishin copëtuar, 25% e kombit bullgar dhe 50% e kombit shqiptar kishin mbetur në zotërimin e huaj dhe nuk kishin as të drejtat më elementare të jetës njerëzore. Pasi vlerësonte politikën e dy shteteve që nuk kishin parashtruar kërkesa për revizionimin e kufijve, gazeta "Ora" i referohej deklaratës së M. Konicës në Konferencën e Stambollit i cili kishte thënë: "Zbatoni kërkesat për minoritetet dhe ne do ta nënshkruajmë me symbyllur Paktin Ballkanik", duke e vlerësuar atë si kyçin e zbutjes së marrëdhënieve në Ballkan, që ishte edhe në favor të shteteve të tjera ballkanike⁴⁵.

⁴²"Marrëveshja e Sofjes midis Shqipërisë e Bullgarisë për çështjen e pakicave", *Ora*, Tiranë, 15 janar 1932.

⁴³AMPJ, viti 1932, dos. 72, fl. 45, Legata Shqiptare-Sofje - MPJ.

⁴⁴"Bullgarët flasin për lidhje midis Shqipërisë dhe Bullgarisë", *Ora*, Tiranë, 21 janar 1932.

⁴⁵"Bullgarët flasin për lidhje midis Shqipërisë dhe Bullgarisë", *Ora*, Tiranë, 21 janar 1932.

Shqiptarët e Bullgarisë e përshëndetën nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Federata “Dëshira” e konsideroi atë si një hap të parë në rrugën e marrëveshjes ballkanike⁴⁶. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, Legata Shqiptare në Sofje informoi qeverinë shqiptare se identifikimi i shqiptarëve në Bullgari ishte i vështirë dhe një çështje delikate, sepse një pjesë e shqiptarëve ishte bullgarizuar, një pjesë tjetër, me origjinë nga viset shqiptare në Jugosllavi, kishte frikë të deklaronte identitetin e saj shqiptar. Legata informonte se në Bullgari mund të kishte 25 000-40 000 shqiptarë⁴⁷. Më vonë Legata Shqiptare e Sofjes informoi MPJ-në se në Bullgari kishte 726 vetë të regjistruar si shtetas shqiptarë dhe 7 724 shqiptarë që ishin me nënshtetësi jugosllave. Një pjesë tjetër e shqiptarëve me nënshtetësi jugosllave konsideroheshin prej autoriteteve bullgare si maqedonas. Gjithashtu, në Bullgari banonin edhe mjaft shqiptarë që kishin nënshtetësinë bullgare. Po të llogariteshin së bashku të gjitha këto kategori, numri i shqiptarëve në Bullgari mund të arrinte mbi 20 000 vetë⁴⁸.

Ministria e Jashtme e udhëzoi Legatën në Sofje që të jepej informacion i detajuar mbi numrin e shqiptarëve që ishin emigrantë në Bullgari dhe që i përkisnin kolonisë shqiptare dhe numrin e shqiptarëve që ishin autoktonë në këtë vend⁴⁹. Në përgjigje të këtij udhëzimi, Legata e Sofjes informoi se shqiptarët autoktonë të vendosur prej disa shekujsh në Bullgari ishin ata të katundit Mandrica, numri i të cilëve arrinte në 450-500 vetë⁵⁰. Nga pikëpamja sasiore e pakicave që përfitonin prej kësaj marrëveshje nuk mund të thuhet se ajo kishte ndonjë vlerë të konsiderueshme. Po kështu ajo nuk kishte ndonjë rëndësi të madhe as nga pikëpamja e interesave politike që dy shtetet kishin për grupet e pakicave respektive. Megjithëkëtë marrëveshja ishte një model i frymës së tolerancës dhe mirëkuptimit, e cila mund të shërbente si një nxitje për të përmirësuar, deri diku, pozitën e minoriteteve në vendet e tjera ballkanike, duke angazhuar në këtë proces organizata jo qeveritare por që kishin influenza në qeveritë e tyre. Por marrëveshja u prit shumë keq nga shtypi dhe opinioni nacionalist i vendeve fqinje. Protokolli shqiptaro-bullgar u sulmua ashpër nga shtypi grek dhe jugosllav i cili e cilësoi atë si një intrigë që do të kishte si efekt dështimin e përpjekjeve

⁴⁶ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 7, Deklaratë e Federatës “Dëshira”, Sofje.

⁴⁷ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 8, Legata Shqiptare në Bullgari - MPJ, 25 janar 1932.

⁴⁸ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 9, Legata Shqiptare në Bullgari - MPJ.

⁴⁹ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 14, MPJ - Legatës në Sofje, 10 qershor 1932.

⁵⁰ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 20, Legata Shqiptare në Sofje - MPJ, 29 tetor 1932.

për bashkimin ballkanik. Gazeta “Vreme” e Beogradit shkruante se Shqipëria dhe Bullgaria, me bisedime të fshehta e të dyshimta midis tyre, janë përpjekur të nxjerrin pengesa në procesin e afrimit të popujve ballkanike. Gazeta zyrtare greke “Messenger d’Athens” shkruante se ky protokoll ishte “një akt tradhtie i qepur me penj të bardhë”⁵¹. Delegacioni serb i drejtoi një protestë kryetarit të Konferencës Ballkanike kundër Protokollit bullgaro-shqiptar, në të cilën shkonte gjerë atje sa të mos u njihte të dyja palëve të drejtën të merrnin vendime të tilla⁵².

Meqë shtypi serb mohoi ekzistencën e pakicës bullgare në Shqipëri (“La Macedoine”, 15 janar 1932), qeveria shqiptare botoi këtë statistikë të hollësishme të vitit 1913 të fshatrave bullgarofone dhe institucioneve të tyre kulturore⁵³:

Emri i fshatit	Numri i shtëpive	Numri i banorëve	Mësues	Nxënës	Kisha	Manastire
1. Vernik	95	469	2	52	1	1
2. Tzernë	25	200	-	-	1	1
3. Zarnovsko	16	106	-	-	-	-
4. Lesko	8	85	-	-	-	-
5. Pustec	65	499	1	30	1	1
6. Shahin	23	375	1	20	1	-
7. Glatebatshani	33	319	1	25	1	-
8. Gorna Gorica	33	404	1	27	1	-
9. Goricë e Epërme (Douma)	5	67	-	-	-	-
10. Tumenec	23	220	1	12	1	1
11. Biglica	20	106	1	13	-	-
12. Boboshticë	250	1471	-	-	-	-
13. Drenovë	140	678	-	-	-	-
14. Lin	65	325	1	62	1	1
15. Arbele	38	190	1	15	1	1
16. Deovolani	10	69	-	-	1	-
17. Obaki	25	125	1	13	1	1
18. Makellarë	32	160	-	-	1	1
19. Kerçishte	45	245	1	30	1	-
20. Verbicë	37	196	1	18	1	-
21. Malestrani	30	189	-	-	-	-
22. Golemi	12	60	-	-	-	-

⁵¹Protokolli bullgaro-shqiptar dhe Pakti Ballkanik, Besa 17 mars 1932.

⁵²Protokolli bullgaro-shqiptar dhe Pakti Ballkanik, Besa 17 mars 1932.

⁵³AQSH, Fondi MA, viti 1932, dos. 110, fl. 13.

Ostrelzi						
23. Pasinkë	12	56	-	-	-	-
24. Tucep	10	60	-	-	-	-
25. Trebisht	10	75	-	-	-	-
26. Klenjë	40	286	1	29	1	-
27. Gunec	35	176	1	21	1	-
28. Sebisht	45	180	1	30	1	1
29. Stenlevë	40	224	1	28	1	1

Edhe qeveria shqiptare bëri një regjistrim të plotë të popullsisë bullgarofone në Shqipëri e cila paraqitej si më poshtë:⁵⁴

Prefektura e Korçës

Fshati Vernik	83 shtëpi	402 banorë
Fshati Cerje	14 shtëpi	190 shtëpi
Fshati Postec	74 shtëpi	596 banorë
Fshati Goricë	62 shtëpi	558 banorë
Fshati Shulin	39 shtëpi	531 banorë
Fshati Bezmisht	46 shtëpi	303 banorë
Fshati Gllomboç	39 shtëpi	409 banorë
Fshati Zaroshkë	16 shtëpi	154 banorë
Fshati Lajthizë	10 shtëpi	93 banorë
Pogradec (qytet)	4 shtëpi	22 banorë
Fshati Lin	61 shtëpi	162 banorë

3 420 banorë

Prefektura e Dibrës

Fshati	Shtëpi ortodokse	Banorë	Shtëpi myslimane	Banorë
Vernik	40	192	0	0
Trebisht-Muçino	0	0	77	336
Trebisht-Çelepi	5	30	73	816
Trebisht i Epërm	1	9	205	918
Gjinovec	23	101	60	775
Klenjë	31	112	60	314
Steblevë	10	42	120	697
Ostren i Madh	0	0	179	860

⁵⁴AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 11, Lista e katundeve ku ka bullgarofonë.

Ostren i Vogël	14	69	103	537
Tuçep	1	5	47	414
Lladëmiricë	0	0	82	380
Radovesh	0	0	64	284
Lejçan	0	0	115	552
Smonelik	0	0	49	242
Herbel	23	92	24	107
Kërçisht e Epërm	19	81	15	76
Gjithsej		773		7841

Por, vihej në dukje se myslimanët e qarkut të Dibrës, megjithëse flisnin bullgarisht, e konsideronin veten e tyre shqiptarë dhe nuk donin të konsideroheshin si pakicë bullgarofone⁵⁵. Në vitin shkollor 1931-1932 vërehej edhe një rritje e numrit të nxënësve të shkollave bullgarofone në qarkun e Korçës. Gjendja e tyre ishte si më poshtë:⁵⁶

Fshati	Numri i popullsisë	Numri i nxënësve
1. Goricë	500	50
2. Bezmisht	200	25
3. Gllomboc	450	54
4. Postec	550	68
5. Shulin	420	50
6. Lajthize	70	14
7. Vernik	400	50
8. Cerje	120	19
9. Zaroshke	110	19

Mirëpo, pikërisht në këtë kohë, kur delegacionet shqiptare e bullgare dhanë një mesazh shumë pozitiv edhe për kombet e tjerë të rajonit, ndodhi një ngjarje e pakëndshme e cila e prishi disi atmosferën e krijuar. Midis bujqve të fshatit bullgarofon Gorice dhe pronarit të tyre Maliq Frashëri, shpërtheu një konflikt pronësie. Qysh në fillim të këtij konflikti autoritetet shtetërore shqiptare ndërhyjnë për të nxitur dhe për të arritur në një “modus vivendi” e për t’i pajtuar të dyja palët⁵⁷. Por, intrasigjenca e goricarëve e bëri të pamundur arritjen e një marrëveshjeje dhe çështja shkoi në gjyq. Shkaktar i këtij qëndrimi intrasigjent ishte sekretari i Legatës Bullgare në Tiranë, Minkoff. Ai, siç i pohoi përfaqësuesi bullgar Mintcheff, Dhimitër Beratit, “u kishte

⁵⁵ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 11, Lista e katundeve ku ka bullgarofonë.

⁵⁶ AMPJ, viti 1932, dos. 149fl. 9, 11, Inspektorja e Arsimit Korçë - MA, 21 janar 1932.

⁵⁷ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 38, MPJ - Legatës së Shqipërisë në Sofje, 16 dhjetor 1932.

hapur syrin fshatarëve të Goricës, të cilët besuan se qeveria bullgare do t'u jepte para për të blerë tokat e Maliq Frashërit⁵⁸. Mirëpo, qeveria bullgare nuk mori përsipër ta paguante këtë shumë. Nga ana tjetër, Gjykata mori vendim në favor të pronarit, Maliq Frashëri.

Megjithëkëtë, qeveria shqiptare ndërhyri disa herë në mënyrë administrative dhe e pengoi zbatimin e vendimit të Gjykatës. Ajo gjithashtu e detyroi pronarin që të tregohej sa më i pajtueshëm. Vlera e çifligut arrinte në afro një milion fr. ari. Me anë të arbitrazhit, ky çmim u zbrit deri në gjysmën e tij, por bujqit e Goricës nuk pranuan të paguanin më shumë se 240 mijë fr. ari. Kështu që marrëveshja nuk u arrit⁵⁹. Autoritetet shqiptare ishin të shqetësuara se largimi i goricarëve do të bënte përshtypje të keqe dhe do të dëmtonte imazhin e mirë që kishte shteti shqiptar, si një shtet që ndiqte politika miqësore e korrekte ndaj pakicave. Në çështjen e Goricës, ndërhyri dhe qeveria bullgare, e cila shprehu pakënaqësinë për konfiskimin e tokave që punoheshin nga bujqit e Goricës. Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së të Bullgarisë thirri Mehmet Konicën dhe e paralajmëroi atë se, një masë e tillë, mund të dëmtonte marrëdhëniet e mira midis dy shteteve⁶⁰.

Këto ankesa iu përsëritën edhe Legatës Shqiptare në Sofje e cila, nga ana e saj, nuk ngurroi të shprehte pakënaqësinë për udhëtimet e dyshimta e të shpeshta të disa maqedonasve, nënshtetas bullgarë dhe anëtarë të Komitetit Maqedonas në Shqipëri. Ajo theksonte se ata po përpiqeshin ta bënë Shqipërinë urë dhe bazë operacionesh kundër shteteve fqinje, gjë e cila, pavarësisht nga simpatia që ushqente populli shqiptar për çështjen maqedonase, cenonte politikën paqësore dhe korrekte të shtetit shqiptar ndaj fqinjëve⁶¹. Qeveria bullgare vijoi të ushtronte edhe presion politik mbi shtetin shqiptar. Zyrtarët e MPJ-së së Bullgarisë e kërcënuan Legatën Shqiptare në Sofje se do të merreshin masa hakmarrëse kundër shqiptarëve të Bullgarisë nëse nuk gjendej një zgjidhje e kënaqshme për fshatarët e Goricës⁶². Qeveria shqiptare, gjithmonë me dëshirën që të gjente një zgjidhje të arsyeshme dhe të pajtueshme me interesat e fshatarëve të Goricës, vendosi t'i instalojë ata në toka shtetërore. Ajo ngarkoi Prefekturën e Korçës të arrinte një marrëveshje me goricarët për instalimin. Për të gjitha këto masa u

⁵⁸ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 126, Dhimitër Berati - MPJ, 30 gusht 1932.

⁵⁹ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 38, MPJ - Legatës në Sofje, 16 dhjetor 1932.

⁶⁰ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 27, Mehmet Konicë - MPJ, Sofje, 6 shtator 1932.

⁶¹ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 29, Legata Shqiptare në Sofje - MPJ, 13 tetor 1932.

⁶² AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 39, Popa - MPJ, 21 nëntor 1932.

njoftua edhe përfaqësuesi bullgar në Tiranë⁶³. Legata Shqiptare e Sofjes kërkoi me këmbëngulje që të shmangej emigrimi i goricarëve në Jugosllavi e cila, me sa dukej, po punonte për t'ia arritur këtij qëllimi. Ministri shqiptar shprehej se “urtësia politike, ndjenjat humanitare dhe interesi jonë i mirëkuptuar impononin që të evitohej emigrimi i tyre në Jugosllavi”. Ai informonte se kësaj çështje po i jepnin një rëndësi të madhe në Bullgari, autoritetet e të cilës e lidhnin këtë problem me politikën minoritare ndaj Jugosllavisë e Greqisë. Sofja ishte veçanërisht e shqetësuar ngaqë ikja e goricarëve në Jugosllavi e jo në Bullgari do të ishte për Beogradin një argument i shëndoshë në mbështetje të tezës së njohur jugosllave për ekzistencën e një minoriteti bullgar në Maqedoninë irredente, “çështje kjo që formonte “le pivot” dhe që sundonte politikën e jashtme të këtij shteti”.

Qeveria bullgare i konsideronte sllavët e Korçës të racës bullgare me qëllim që të rrëzonte pretendimet e Jugosllavisë se sllavët e Maqedonisë dhe të Jugosllavisë Jugore, përgjithësisht, ishin prej gjaku e race serbe. Prandaj, qeveria bullgare i jepte kësaj një rëndësi të jashtëzakonshme. “Nga ana tjetër, vinte në dukje Legata shqiptare, duke patur parasysh se midis çështjes së Kosovës sonë irredente dhe asaj maqedonase, *de facto*, kishte një lidhje solidariteti, është dhe interesi jonë kombëtar, i tërthortë, që të mos u japim rast jugosllavëve ta shfrytëzojnë këtë konflikt në kurrizin dhe në dëmin tonë”. Legata e Sofjes ishte e shqetësuar se qeveria bullgare, nën presionin e Komitetit Maqedonas, mund të merrte masa kundër shqiptarëve të Bullgarisë⁶⁴.

Pas përpjekjeve që bënë autoritetet shqiptare, në fillim të vitit 1933, u duk se çështja e goricarëve po merrte një përfundim të pëlqyeshëm. Ministria e Jashtme e Shqipërisë njoftoi përfaqësuesin bullgar Mintcheff se çështja e goricarëve ishte në zgjidhje e sipër dhe se shumica e tyre ishin bindur të mos emigronin nga Shqipëria, por të instaloheshin në çifligjet e shtetit. Qeveria dërgoi në Goricë, drejtorin e Zyrës Agrare, Salih Vuçiternin për t'i bindur edhe të tjerët të cilët ende mendonin të shpërnguleheshin në Jugosllavi⁶⁵. Mirëpo, autoritetet bullgare kërkuan që fshatarët e Goricës të instaloheshin në rrethin e Korçës dhe jo në Myzeqe siç kishte planifikuar qeveria shqiptare. Përveç shqetësimit se këtë çështje do ta shfrytëzonte qeveria jugosllave, drejtori

⁶³AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 38, MPJ - Legatës në Sofje, 16 dhjetor 1932.

⁶⁴AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 40- 42, Legata Shqiptare në Sofje - MPJ, 23 nëntor 1932.

⁶⁵AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 44, MPJ - Legatës në Sofje, 19 mars 1933.

Politik i MPJ-së së Bullgarisë, Pavlov, përmendi edhe klimën jo të shëndetshme të Myzeqesë. Megjithatë, qeveria shqiptare nuk kishte toka të lira në zonën e Korçës. Diplomatët shqiptarë në Sofje informuan Pavlovin se gjendja e Myzeqesë ishte përmirësuar nga bonifikimet që ishin bërë atje, se malarja ekzistonte në të gjitha viset e Ballkanit dhe se në këtë rajon qeveria shqiptare kishte vendosur edhe vëllezërit tonë kosovarë⁶⁶. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, as goricarët dhe as qeveria bullgare nuk pranuan instalimin në zonën e Myzeqesë. Më së fundi më 22 prill 1933 goricarët emigruan në Jugosllavi. Shtypi jugosllav njoftoi se ata u vendosën në Vardar ku u ishin dhënë shtëpi banimi, vegla dhe toka⁶⁷. Por, disa ditë më vonë konsullata shqiptare në Manastir informoi MPJ-në, se goricarët ishin vendosur nga autoritetet jugosllave në Mitrovicë të Kosovës⁶⁸.

Ashtu siç pritej, ngjarjen e shfrytëzoi shtypi dhe diplomacia jugosllave, të cilët vinin në dukje se, me gjithë përpjekjet e Legatës Bullgare në Shqipëri, goricarët refuzuan të emigronin në Bullgari, duke deklaruar se nuk ishin bullgarë, por, jugosllavë dhe do të shkonin në Jugosllavi. Duke speculuar me identitetin etnik të goricarëve, gazeta “Novosti” shkruante: “Sjellja e Bullgarisë dhe e Shqipërisë kundrejt pakicave nacionale jugosllave në Shqipëri ka provokuar një lëmsh të pashoq. Ky është sistemi i një politike që bëhet në Ballkan kundër Jugosllavisë. Qeveria shqiptare, pakicën tonë nacionale, e ka njohur si pakicë bullgare dhe i ka dhënë lejen me çel disa shkolla bullgare në Shqipëri, me qëllim që ta shkombëtarizojë elementin tonë⁶⁹”.

Largimi i goricarëve nga Shqipëria zemëroi opinionin publik dhe shtypin bullgar. Kongresi XI i shoqatave maqedonase miratoi një rezolutë e cila kërkonte mbrojtjen e të drejtave etnike e kulturore të bullgarofonëve të Shqipërisë. Kjo rezolutë u botua në shtypin bullgar në mars të vitit 1933⁷⁰. Në këtë atmosferë ndërhyne edhe shoqatat shqiptare në Bullgari. Me anë të një deklarate publike shoqata “Dëshira” e Sofjes protestoi kundër dëbimit të fshatarëve të Goricës prej Meleq Frashërit. Ato pohonin se edhe ato vetë kishin emigruar si rezultat i

⁶⁶ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 54, Legata shqiptare në Sofje - MPJ, 14 mars 1933.

⁶⁷ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 45, Lajm i gazetës “Vreme”, 22 prill 1933.

⁶⁸ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 71, Konsullata shqiptare në Manastir - MPJ, 5 maj 1933.

⁶⁹ AMPJ, viti 1932, dos. 149, fl. 73, Përkthim i artikullit të gazetës “Novosti”, 9 maj 1933.

⁷⁰ AMPJ, viti 1933, dos. 162, fl. 8, Rezolutë e Kongresit XI të Rregullt të Shoqatave Maqedonase, botuar në shtypin bullgar.

grabitjes së tokave të tyre dhe kërkuan që goricarët të qëndronin në vatrat e tyre e të zbatohej sa më parë reforma agrare, në mënyrë që edhe ata të ktheheshin në tokat e stërgjyshërve të tyre⁷¹. Me këtë protestë u bashkuan edhe shqiptarët e Rumanisë të cilët i shprehën pikëpamjet e tyre në gazetën “Shqipëria e Re”. Kjo gazetë shkruante: “Nuk është as e drejtë as e nderhme që populli shqiptar i cili konsiderohet prej të huajve si një popull fisnik dhe mirënjohës, për hatrin e Maliq Beut dhe të disa vetëve që qeverisin sot Shqipërinë, të hyjë në armiqësi me popullin bullgar. Qeveritarët tonë nuk duhet të harrojnë se shqiptarët që punuan për ngritjen e kësaj Shqipërie janë ndihmuar tërë kohën prej shtetit bullgar gjithashtu dhe prej bullgarëve të Maqedonisë. Të mos harrojmë se mbi një milion shqiptarë rrojnë si pakica etnike në shtetet fqinje. Me ç’sy e faqe do të ngrihem ne të kërkojmë të drejta për këta vëllezër, kur, për hatrin e një beu, i ramë në qafë pakicës bullgare në Shqipëri?”⁷².

Në vjeshtën e vitit 1933 edhe një fshat tjetër bullgarofon, Gllomboci kërkoi të emigrohej në Jugosllavi. Ata justifikoheshin se nuk kishin pasuri të luajtshme ose të paluajtshme në katund dhe se po vuanin nga papunësia dhe kriza ekonomike⁷³. Sipas porosive të Ministrisë së Brendshme, gllomboçarët u lejuan të emigronin në Jugosllavi⁷⁴. Në vitin 1935, nga një statistikë e Ministrisë së Brendshme, jepej kjo popullsi bullgarofone rezidente në Shqipëri⁷⁵:

Bashkia Korçë	23 vetë
Pogradec	19 “
Tushemisht	3 “
Vernik (N/P. Bilisht)	402 vetë
Cerje “	190 vetë
Bezmisht	303 vetë
Gllomboc	409 vetë
Goricë	558 vetë
Lajthizë	93 vetë
Posteci	596 vetë

⁷¹AQSH, Fondi MPB, viti 1933, dos. 166, fl. 3, Deklaratë e Shoqërisë “Dëshira”-Sofje; Letër e Federatës “Dëshira” të Sofjes, dërguar Mbretit, “Shqipëria e Re”, 25 maj 1933.

⁷²Letër e hapur e gazetës “Shqipëria e Re”, drejtuar A. Zogut, 25 maj 1933.

⁷³AQSH, Fondi MPB, viti 1933, dos. 307, fl. 2, Kërkesë e Pleqësisë së Gllombocit - MPB, 22 shtator 1933.

⁷⁴AQSH, Fondi MPB, viti 1933, dos. 307, fl. 2, Prefektura e Korçës - MPB, 6 tetor 1933.

⁷⁵AQSH, Fondi MPB, viti 1935, dos. 310.

Shullin	531 vetë
Zarashke	154 vetë

Në statistikat e Ministrisë së Punëve të Brendshme jepeshin të dhëna edhe për popullsinë e Prefekturës së Dibrës, që flisnin përveç shqipes edhe gjuhën bullgare sipas përkatësisë së saj fetare⁷⁶.

	Ortodoksë	Myslimanë
Vernik	192	
Trebisht (Muqino)		336
Trebisht (Çelepi)	30	816
Trebisht i Epërm	9	918
Gjinovec	101	775
Klenjë	212	314
Steblevë	42	697
Ostren i Madh	0	860
Ostren i Vogël	69	537
Tuçep	5	214
Llademirice	0	380
Radovesh	0	284
Lejçan	0	552
Smanllenik	0	242
Herbel	92	107
Kerçishti i Epërm	81	76

Por, myslimanët e qarkut të Dibrës megjithëse, krahas shqipes, flisnin edhe gjuhën bullgare, e konsideronin veten e tyre si shqiptarë dhe nuk donin të konsideroheshin si pakicë bullgare⁷⁷.

Në fillim të vitit 1935 italianët shfaqën dyshime se ende nuk ishin shuar bazat e mbështetjes që kishin pasur organizatat maqedonase në Shqipëri, veçanërisht gjatë viteve '20. Legata Italiane i dërgonte Romës një listë me disa emra të cilët i konsideronte si anëtarë të një komiteti maqedonas në Tiranë në të cilën bënë pjesë edhe disa shqiptarë.⁷⁸ Por, më vonë Legata Italiane e Sofjes pasi bëri hetime për

⁷⁶AQSH, Fondi MPB, viti 1935, dos. 310.

⁷⁷AQSH, Fondi MPB, viti 1935, dos. 310.

⁷⁸AMAE, Affari Politici, 1931-1945, Albania, Busta 49. questionebulgaro-macedone e bulgaro-albanese (posiz.1-3), Legata Italiane në Tiranë për MPJ-në në Romë, pa datë. Në këtë dokument si anëtarë të komitetit maqedon jepeshin: Aleks Kamburi, Mitro Radoja (Radoviç), Llambo Kristiç, kancelari i Legatës Bullgare, Petseff, Llambo Markuli (për të cilin thuhej se ishte arrestuar në Tiranë në vitin 1928, sepse kishte

këtë çështje e hodhi poshtë mundësinë e ekzistencës së një komiteti maqedonas në Tiranë. Ajo pohonte se personat e shënuar ishin emigrantë bullgarë nga Maqedonia serbe së bashku me disa persona shqiptarë. Gjithsesi Legata e Sofjes nuk përjashtonte mundësinë e kontakteve të komiteteve maqedonase në Bullgari me simpatizantë të tyre në Jugosllavi, Itali dhe në Shqipëri dhe si pikë lidhëse të tyre cilësonte një person të punësuar nga Legata Bullgare në Romë që quhej Assenkoff.⁷⁹

Gjatë viteve 1936-1937 në minoritetin bullgar nuk pati ndonjë zhvillim të veçantë. Ai vijoi të trajtohej me dashamirësi nga qeveria shqiptare. Këtë gjë e pranonte edhe gazeta bullgare “Posledna Posta” e cila, megjithëse e ekzagjeronte numrin e bullgarëve, duke e çuar në 56 000 veta, pranonte se “bullgarët në Shqipëri gëzonin gjithë kujdesin e autoriteteve shqiptare, ishin trajtuar gjithmonë mirë dhe kishin lirinë që të ndërtonin kisha e shkolla, por nuk kishin mjetet e duhura”⁸⁰.

Në prag të agresionit italian duket se pati përprjekje të reja për nxitjen e lëvizjes maqedonase brenda territorit shqiptar, megjithëse autoritetet shqiptare ishin vigjilente dhe po e kontrollonin mirë situatën. Në janar të vitit 1939, Prefektura e Peshkopisë informoi Ministrinë e Brendshme, se jugosllavët ishin tepër të shqetësuar ngaqë kryetari i komitëve bullgaro-maqedonas, Vançe Mjalloff, ishte pritur mirë e me shumë nderime nga qeveria shqiptare dhe se ai synonte të krijonte çeta me komitë shqiptarë e maqedonas që do të vepronin në territorin jugosllav. Ndonëse ky ishte një lajm jo i vërtetë, Ministria e Brendshme e Shqipërisë dha porosi që, nëse ai hynte në territorin shqiptar, të ndalohej për të shmangur ndonjë aktivitet terrorist⁸¹.

pasur marrëdhënie të fshehtë të komiteteve maqedonase dhe më vonë ishte liruar nga Koço Kotta nën përgjegjësinë e tij personale si ministër i Brendshëm, ndërsa kreu i bandës maqedonase ishte riatdhesuar), Petro Anastasi, Kristo Luarasi, Pekmezi, Anastas Llosja, Ramizbej Dibra (kolonel shqiptar), Ali Fehmi Kosturi (kolonel shqiptar), Mitrush Kristo, Ilori Georgieff, Ibrahim Nuri, Shahin Cami, Hamdi Daci, Dimiter Mihaloff, Mustafa Baroti, Zijabëj Ohri, Hydarverdi Ohri dhe Shefqet Efendi.

⁷⁹AMAE Affari Politici, 1931-1945, Albania, Busta 49. questionebulgaro-macedone e bulgaro-albanese(posiz.1-3), MPJ në Romë për Legatën Italiane në Tiranë, 1 shkurt 1935.

⁸⁰AQSH, Fondi MPB, viti 1937, dos. 110, Përkthim i një artikulli të gazeta bullgare “Posledna Posta”, 18 nëntor 1937.

⁸¹AQSH, Fondi MPB, viti 1938, dos. 140, Prefektura e Peshkopisë - MPB, 13 janar 1939.

Beqir META

SUMMARY

BULGARIAN (MACEDONIAN) MINORITY IN THE YEARS 1925 TO 1939

The Bulgarian minority during the period of Zogu, recognized a calm and peaceful development of its ethnic identity and culture. The relations with the Albanian government were generally good. A delicate problem that was introduced in the relations between this minority and the Albanian government was the Bulgarian (Macedonian) nationalist movement that followed to be active in this period. Since 1925 the administration of Zogu continued to face the problem of the Bulgarian movement that took place in Yugoslavia and Greece. It undertook a crackdown and maintained a sharp positions to prevent the activity of the Bulgarian armed guerillas who entered the Albanian territory from Yugoslavia and Greece, which was directed toward these two neighboring countries. To escape prosecution of Yugoslav authorities, the Bulgarian comitadjis, usually handed over themselves to the Albanian border authorities in Gorica. Once interrogated, they were sent to the port of Saranda from where they left the Albanian territory.

These measures were not aimed to strike on the Macedonian movement, but were the result of efforts for the beginning of an amicable policy with Yugoslavia and Greece. Of course, this policy of the Albanian government was not well received by the Bulgarian speaking population in Albania. In 1928 a decrease of government pressure on the Bulgarian irredentist committees was observed. Of course the Albanian government tried to avoid controversy and tensions with the Greek and the Yugoslav governments on this issue, but she softened the measures against the Bulgarian armed guerillas. It can be assumed that the change of the Albanian government policy came after the consolidation of its domestic positions and after approaching Italy. It is likely that the government of Rome has sought a greater tolerance towards the activities of the Bulgarian armed guerillas.

Marbona CUKA

**E DREJTA PENALE SHQIPTARE NË PERIUDHËN
1939-1945**

Objekt trajtese e këtij punimi është zhvillimi i legjislacionit penal shqiptar në periudhën 1939-1945. Arsyeja e përzgjedhjes së kësaj periudhe është se, ende Shqipëria e fillimit të mijëvjeçarit të ri vazhdon të ndikohet nga ngjarjet dhe çështjet e kësaj periudhe që përkon me Luftën e Dytë Botërore. “Për të kuptuar shqiptarët e vitit 2000 e tutje, është e rëndësishme të zbulosh kush kanë qenë ata gjatë viteve 1939-1945”, shkruan profesor Bernd Fischer në një nga librat e tij, duke dashur të evidentojë në këtë mënyrë sa rëndësinë, por dhe diskutimet e pranishme mbi këtë periudhë lidhur me krijimin e imazhit të shqiptarëve si popull dhe si shtet. Ky punim synon të sjellë nëpërmjet gjurmimit, analizës, krahasimit e shpjegimit në mënyrë shkencore, legjislacionin penal, por dhe më gjerë sistemin ligjor dhe gjyqësor shqiptar, nën ndikimin e rrethanave historike të kohës.

Sistemi ligjor dhe gjyqësor

Komentimi siç duhet mbi kompetencën e sistemit ligjor dhe gjyqësor në vitet 1939-1945 paraqet vështirësi, pasi ai nuk ka funksionuar në qëndrueshmëri apo në një gjatësi kohore të tillë që të shërbejë për të arritur në konkluzione përfundimtare.

Sistemi ligjor

7 prilli i vitit 1939 shënon pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste. Në qytete dhe në zona të tjera të pushtuara, formalisht u la në fuqi Kodi Penal Shqiptar i vitit 1928. Krahas tij dolën edhe ligje penale

të posaçme, në mbrojtje të interesave të zaptuesve fashistë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre.¹

Kodi Penal i vitit 1928 zgjodhi si model, Kodin Penal të Italisë të vitit 1889, i cili ka qenë një nga më të përsosurit të Evropës. Ky Kod i ndan fajet në delikte dhe kontraversione (kundërvajtje), duke u themeluar në karakterin e veprave të dënueshme, të cilat i sistematizon dhe i klasifikon racionalisht, duke i përcaktuar fajet e ndryshme me kritere shkencore. Si risi më kryesore të Kodit Penal Italian mund të përmendim: benefitin e pezullimit të dënimit, dënimin me kusht, qortimin gjyqësor, pagimin vullnetar të gjobës së lehtë etj., të pranuar nga shumë shtete të ndryshme,² të asaj kohe. Ndër dënimet kryesore të parashikuara nga Kodi Penal i vitit 1928 përmendim: dënimin me vdekje, me burgim të përjetshëm, burgimin e rëndë, burgimin, internimin, gjobën e rëndë, ndalimin nga ofiqet për deliktet, dhe dënim me burgim të lehtë, gjobë të lehtë, pezullim të ushtrimit të një profesioni ose të një mjeshtërie për kundërvajtjet.³ U nxorën edhe ligje e dekrete të veçanta për vepra kundër okupacionit fashist, për t'i dalë përpara lëvizjes së rezistencës që nuk do të vonojë të shfaqet.

Më 2 qershor 1939, dolën dy dekrete: njëri mbi arrestimin dhe internimin e personave të rrezikshëm për sigurimin publik, tjetri mbi denoncimin dhe dorëzimin e armëve. Më 29 janar 1940, doli dekreti mbi krimet kundër “personalitetit të shtetit”, që godiste vepra kundër administratës shqiptare dhe italiane.⁴ Këto ligje dallonin për ashpërsinë e tyre ku mbizotëronin dënimet e rënda me burgim dhe me vdekje. Në qëllim të tyre ishte mposhtja e çdo qëndrese ndaj pushtuesit fashist. Këto masa represive të ndërmarra nga pushtuesi nuk arritën të ndrydhnin luftën e popullit shqiptar kundër fashizmit e cila u kurorëzua me çlirimin e vendit. Elementët e parë të së drejtës penale të re shqiptare, shfaqen me krijimin nga ana e partizanëve të organeve të luftës, në përputhje me nevojat dhe frymën e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Ndër burimet kryesore⁵ të së drejtës penale në këtë periudhë, përmendim: Rezolucioni i Konferencës së Pezës (16 shtator

¹ I. Elezi, “Zhvillimi historik i legjislacionit penal shqiptar”, Albin, Tiranë, 1998, f. 57.

² 10(dhjetë) vjet mbretni 1928-1938, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë, Shtator 1938, f. 120.

³ Kodi Penal i Shtetit Shqiptar 1928, Neni 11, Fletorja Zyrtare Nr. 1 datë 1 janar 1928.

⁴ A. Puto, Shqipëria politike 1912-1939, Botimet Toena, Tiranë 2009, f. 653.

⁵ Për më shumë, shih: I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal shqiptar, Albin, Tiranë 1998, f. 55-56.

1942), Statuti i Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe Rregullorja e Këshillave Nacionalçlirimtare.

Në këto dokumente me rëndësi për qeverisjen e vendit buronin edhe detyrat e së drejtës penale, të cilat konsistonin në mbajtjen e rregullit e qetësisë, në luftën kundër tradhtarëve e armiqve të popullit, në luftën kundër kriminalitetit, në organizimin e kuvendeve për të pajtuar gjaqet në kohë lufte etj.

Kongresi i Parë, Antifashist Nacional Çlirimtar i Shqipërisë, i mbajtur në maj 1944, ndër të tjera mori një vendim i cili sanksiononte si organin suprem që bën ligjet në Shqipëri, “Këshillin Antifashist Nacional Çlirimtar”, duke i dhënë kështu atributet e përfaqësuesit të sovranitetit të popullit dhe të shtetit shqiptar me kompetenca, përveç legislative edhe ekzekutive.⁶ Sipas ligjit nr. 61, datë 17 maj 1945, ligjet në fuqi janë⁷:

1. Statutet, ligjet, dekretet, urdhrat dhe rregulloret e autoriteteve shqiptare që ishin në fuqi para 7 prillit 1939 e që nuk janë në kundërshtim me ligjet, deklaratat dhe parimet demokratike të regjimit të tanishëm, ku përfshihet dhe Kodi Penal i Shqipërisë i vitit 1928, si dhe;
2. Ligjet, dekretet, urdhrat dhe rregulloret e shpallura nga regjimi i tanishëm. (Deri më sot janë shpallur 93 të tilla)⁸. Nga këto, ata që i përkasin sferës penale, spikasin: “Krijimi i Komisionit të Krimeve të Luftës”⁹, “Ndalimi i eksportit të metaleve të çmuara”¹⁰, “Konfiskimi i pronave të të dënuarve politikë”¹¹, “Krijimi i Gjykatës së Posaçme për kriminelët kryesorë të luftës”¹², “Konfiskimi i pronave të subjekteve italiane dhe gjermane në Shqipëri”, “Funksionet dhe organizimi i gjykatave ushtarake”¹³, etj.

⁶ Gazeta Zyrtare nr. 1, datë 21.12. 1944, Ligj. Nr. 2, datë 27.05.1944, “Krijimi i Këshillit Nacional Çlirimtar”.

⁷ Neni 1, Ligji nr. 61, datë 17 maj 1945, Gazeta Zyrtare nr. 12, datë 22 maj 1945.

⁸ B. Fischer, Shqipëria 1943-1945, Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore, AIIS, Tiranë 2012, f. 74.

⁹ Ligj nr. 8, datë 28.05.1944, Gazeta nr. 1, datë 21.12.1944.

¹⁰ Ligj. Nr. 20, datë 15.12.1944, Gazeta Zyrtare nr. 2, datë 23.12.1944.

¹¹ Ligj. Nr. 25, datë 15.12.1944, Gazeta Zyrtare nr. 2, datë 23.12.1944.

¹² Ligj Nr. 26, datë 15.12.1944, Gazeta Zyrtare nr. 2, datë 23.12.1944.

¹³ Ligj Nr. 41, datë 14.01.1945, Gazeta Zyrtare nr. 3-bis, datë 24.01.1945.

Nga studimi në tërësi i dispozitave të ligjeve penale të lartpërmendura, konkludojmë se përmbajtja e tyre ishte krejt në funksion të Luftës Nacional Çlirimtare duke kriminalizuar çdo sjellje që paraqiste rrezikshmëri për interesat e kësaj lufte.

Sistemi gjyqësor

Kushtetuta e vitit 1939 e njohur dhe si Statuto Fondamentale, *de jure* vendoste monarkinë kushtetuese, por *de facto* përfaqësonte një diktaturë ushtarake, fashiste dhe antidemokratike. Gjykatësit emëroheshin nga mbreti dhe jepnin drejtësi në emër të tij. “Në përgjithësi, italianët ruajtën organizimin e vjetër gjyqësor të regjimit të Zogut i cili përfshinte: 1) institucionin e gjykatësit të paqit bashkangjitur pranë çdo zyre bashkiake; 2) gjykatat e prefekturave, të cilave u bashkëngjitej dhe një prokuror, si dhe; 3) gjykatat e apelit, të cilat pranonin apelimet mbi çështjet penale dhe civile që vinin nga gjykatat më të ulëta të prefekturave.¹⁴ Paditë për çështjet politike trajtoheshin përpara një gjykate të posaçme, ndërsa krimet ushtarake gjykoreshin përpara gjykatave ushtarake¹⁵.

Studiues të ndryshëm¹⁶ kanë evidentuar se në fushën juridike, pushtuesit italianë në përgjithësi ruajtën organizimin e vjetër gjyqësor të Zogut, megjithëse çdo gjë ishte e kontrolluar nga autoritetet italiane, deri edhe në qelizat më të imëta të pushtetit lokal. “Ligjet që këto gjykata zbatonin buronin kryesisht prej Kodit Penal Italian të vitit 1930. Kodi trajtonte me hollësi të gjitha figurat e krimeve kundër shtetit”¹⁷. Më andej, në vitet 1943-1945, ministri i Drejtësisë z. Manol Konomi, që kishte studiuar për drejtësi në Francë, ishte tejet i interesuar për drejtimin e kënaqshëm të drejtësisë dhe ligjeve shqiptare¹⁸. Por, shkalla e suksesit kushtëzohej shumë nga stabiliteti i qeverisë dhe nga fakti se sa autoritetet ushtarake do të hiqnin dorë përfundimisht nga juridiksioni i mjaft çështjeve gjyqësore që gjykoreshin prej tyre. Sistemi gjyqësor synonte të siguronte gjyqtarë, që përzgjidhen nga Ministria e Drejtësisë, si njerëz të formuar, që veprojnë si gjyqtarë, prokurorë dhe sekretarë

¹⁴ B. J. Fischer, Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945, “ÇABEJ MÇM”, Tiranë 2000, f. 73.

¹⁵ L. Omari, Revolucioni popullor në Shqipëri dhe çështja e pushtetit, Tiranë 1977, f. 25-26.

¹⁶ V. Duka, Historia e Shqipërisë 1912-2000, Kristalina KH, Tiranë 2007, f. 211.

¹⁷ B. J. Fischer, Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945, “ÇABEJ MÇM”, Tiranë 2000, f. 73.

¹⁸ B. Fischer, Shqipëria 1943-1945, Një vështrim përmes dokumenteve përëndimore, AIIS, Tiranë 2012, f. 75

dhe me zgjedhjen e gjyqtarëve popullorë, që shërbejnë krahas personelit të përgatitur që më parë.

Teorikisht kjo mund të konsiderohet si një zgjidhje e mirë, por nën dritën e sistemit njëpartiak, i cili nuk duronte opozitë apo kritika, ishte e pashmangshme që gjyqtarët e zgjedhur të caktoheshin nga partia dhe për këtë arsye, kishte mundësi gjithmonë që të merreshin vendime kundër kujtqo që nuk ishte me regjimin, pa përfillur faktet. “Zhvillimi i gjyqeve ndaj kriminelëve të luftës nga gjykatat ushtarake, duket sikur ka qenë i mirë dhe nuk ka pasur “gjakderdhje” ashtu siç pritej. Megjithatë, këto gjyqe iu kanë futur frikën në palcë grupeve opozitare të moderuara, që duket se ishin të terrorizuar nga policia e fshehtë”¹⁹. Ligji nr. 59 i vitit 1945 “Organizimi i Përkohshëm i Gjykatave”²⁰ e ndante juridiksionin e çështjeve penale dhe civile në tre lloje gjykatash: a) Gjykatat popullore; b) Gjykatat e prefekturave, dhe; c) Gjykata e Lartë. Ndërkohë që sistemi gjyqësor ka ndjekur, ashtu siç ka ndodhur gjithnjë në Shqipëri sistemin e zakonshëm kontinental.

Gjykata Speciale Ushtarake

Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar me krijimin e Gjykatës Speciale Ushtarake në Tiranë për gjykimin e kriminelëve të luftës përbën hapin e parë të regjimit të ri drejt organizimit të një sistemi gjyqësor. Kjo gjë u vendos me ligjin nr. 26, të datës 15. 12. 1944 të botuar në Gazetën Zyrtare nr. 2. të datës 23. 12. 1944. Disa javë më vonë, më 14 janar 1945, Këshilli shpalli Ligjin nr. 41²¹ që përcaktonte organizimin, juridiksionin dhe funksionet e gjykatave ushtarake në të gjithë vendin. Ligji mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake, është ilustrim i faktit se si legjislacioni në çdo kohë ka prirjen për t’iu përgjigjur nevojave të shoqërisë në përputhje me situatën e krijuar. Në këtë gjykatë do të gjykoreshin të gjitha krimet e drejtuara kundër Luftës Nacional Çlirimtare të popullit shqiptar, kundër fitoreve dhe interesave të kësaj lufte.²²

¹⁹Po aty.

²⁰ Gazeta Zyrtare nr. 12, datë 22 maj 1945, Ligj. Nr. 59, datë 17. 05. 1945.

²¹ Gazeta Zyrtare nr. 3-bis, datë 24. 01.1945, Ligj. Nr. 41, dt. 14.01.1945, “Funksionet dhe organizimi i gjykatave ushtarake”.

²² Neni 2 i Ligjit nr. 41, datë 15.12.1944, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake”.

Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar (KANÇI) u kujdes që nëpërmjet këtij ligji të parashikonte një organizim të mirëstrukturuar të pushtetit ushtarak gjyqësor, i cili do të ushtrohej nga: 1. Gjykata Ushtarake e Korpusit; 2. Gjykata Ushtarake e Krahinës Ushtarake të Korpusit, dhe nga; 3. Gjykata e Naltë. Kjo e fundit do të gjykonte aktet më me rëndësi të kriminelëve të luftës dhe armiqve të popullit, aktet penale të oficerëve më të lartë dhe të gjeneralëve të Ushtrisë Nacional Çlirimtare.

Nga studimi në tërësi i dispozitave të ligjit vërehet Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional Çlirimtare i vënë pranë pushtetit ushtarak gjyqësor duke ndërvepruar në veprimtarinë e tij. Kjo gjë shprehet më qartë në nenet 3/2, 7 dhe 34, sipas të cilave:²³

Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm, Gjykata e Lartë Ushtarake mund të gjykonte edhe çdo akt që i përkiste gjykatave të tjera ushtarake më të ulëta. Gjykata e Lartë Ushtarake formohet pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional Çlirimtare.

Shtabi i Përgjithshëm, me propozim të kryetarit të Gjykatës emëronte këshillat gjyqësore. Shtabi i Përgjithshëm, pranë divizioneve që veprojnë jashtë tokës shqiptare, mund të krijonte gjykata ushtarake, të cilat mund të urdhëronin ekzekutimin e ndëshkimit me vdekje pa pritur aprovimin e Gjykatës së Lartë Ushtarake. Megjithatë në raste të tilla, Gjykatës së Lartë i dërgohej më vonë dosja përkatëse bashkë me shpjegimet për një veprim të tillë.

Në përbërje të këshillave gjyqësorë të gjykatave ushtarake qëndronin kryetari, dhe 2 anëtarë të cilët posedonin grada ushtarake.

Pranë çdo këshilli gjyqësor ishte sekretari që duhet të ishte mundësisht gjyqtar karriere ose jurist dhe duhet të ishte nga radhët e personave besnikë të Luftës Nacional Çlirimtare.²⁴ Roli i konsiderueshëm i Shtabit të Përgjithshëm, përzgjedhja e anëtarëve të këshillave gjyqësorë nga personat e cilësuar besnikë të Luftës Nacional Çlirimtare, marrja e vendimeve në emër të popullit shqiptar²⁵, dhënia peshë e organeve të shërbimit për mbrojtjen e popullit²⁶ dhe goditja e kujtëdo që cilësohej se

²³ Për më shumë shih: Nenet: 3, 7, 34 të Ligjit nr. 41, datë 15.12.1944, "Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake".

²⁴ Neni 11 i Ligjit nr. 41, datë 15.12.1944, "Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake".

²⁵ Neni 30 i Ligjit nr. 41, datë 15.12.1944, "Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake".

²⁶ Neni 20 i Ligjit nr. 41, datë 15.12.1944, "Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake".

vepronte kundër interesave të Luftës Nacional Çlirimtare, na orienton të kemi dyshime mbi paanshmërinë dhe pavarësinë në marrjen e vendimeve të drejta.

Në pjesën e dytë të ligjit parashikohen: llojet e akteve penale që gjykojnë gjykatat ushtarake, të cilat rezultojnë të kenë qenë indikative, kushdo të konsiderohej kriminel luftime dhe armiq të popullit (qofshin shqiptarë a të huaj), rrethanat lehtësuese dhe rastet kur nuk përfitohet nga to etj. Gjykata Ushtarake caktonte këto ndëshkime dhe masa sigurimi:²⁷ vërejtje e ashpër, gjobitje (në të holla, në natyrë, në punë), internim, degradim ose pushim nga puna, heqje nga përgjegjësia, punë e detyrueshme prej një muaji deri në dy vjet, punë e detyrueshme e rëndë prej tre muaj deri në njëzet vjet, konfiskim tërësisht ose pjesërisht i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, burgim, ndëshkim me vdekje, etj. Bashkë me këto ndëshkime Gjykata mund të vendosë humbjen e nderit ushtarak, humbjen e të drejtave qytetare dhe politike për një kohë të caktuar ose përgjithmonë, si dhe konfiskimin e të gjithë ose të një pjese të pasurisë.

Me interes për t'u sjellë në vëmendje konsideroj edhe nenin 20 të Ligjit i cili parashikon procedurën dhe dënimin. Aty thuhet shprehimisht se: "Procedura e gjykatave ushtarake duhet të jetë e shpejtë, pa shumë hollësira, por e plotë". Gjithashtu thuhet se: "Kurkush nuk mund të arrestohet në bazë të provave të pabesueshme por mund të merret në pyetje përdhunisht". Procedura e gjykimit "pa shumë hollësira", "marrja në pyetje përdhunisht", etj., janë elementë që tregojnë se ky ligj kishte hapësira të mjaftueshme për cenim të një procesi të rregullt ligjor dhe mosrespektim të të drejtave të të pandehurit. Dhunimi i këtyre të drejtave është i një rëndësie të tillë aq sa nuk mund të justifikohen dhe nën atmosferën e luftës për të cilën po flasim. Për të mos mbetur thjesht në kufijtë teorikë të dispozitave të ligjit, nëpërmjet këtij punimi kam sjellë raste praktike të zbatimit të tij nga gjykatat ushtarake të botuara në "Zëri i Vlorës", në një botim të veçantë për Gjykatën Ushtarake kundër kriminelëve të luftës.

Tipare të përgjithshme të këtyre proceseve gjyqësore²⁸:

- Fjalët kyçe të aktakuzave janë: "Ke qenë agjent i kolonës së pestë..., ke bashkëpunuar me okupatorin fashist..., ke penguar

²⁷ Neni 18 i Ligjit nr. 41, datë 15.12.1944, "Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake".

²⁸ Për më shumë: "Zëri i Vlorës", Botim i veçantë për Gjykatën Ushtarake kontra kriminelëve të luftës", Vlorë 1944.

luftën Nacional Çlirimtare, fajet e tua dëshmohen nga opinion publik, etj.

- Të pandehurit i lihej pak kohë për t'u mbrojtur dhe për të kundërshtuar akuzat.
- Dënimet ishin të ashpra, ku dominonin ato me vdekje dhe konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Në procesin e H. GJ.²⁹, prokurori këndon këtë aktakuzë: “Nga rrjedhimi i gjykimit, rezultoi plotësisht e provuar se H. GJ., që në ditët e para të daljes në shesh të organizatës tradhtare Balli Kombëtar, ky e përqafoi vullnetarisht këtë dhe u vu në shërbim të sa... ka sjellë efekt të math në përçarjen e popullit të Dukatit, sepse me misionin e tij si fetar, ka propaganduar në dëm të Lëvizjes NÇ... I pandehuri ka pasur influencë në Dukat dhe këtë e përdori në interes të Ballit dhe të okupatorit. Përgjegjësia morale e mbetjes së Dukatit jashtë luftës NÇ duhet të bjerë mbi H. GJ. me shokë që si njerëz të kulturuar nuk zgjodhën rrugën e nderit por atë të turpit e të tradhtisë... Prandaj, për fajet e sipërme të provuara rregullisht para gjyqit të cilat parashikohen prej nenit 15 të Ligjit mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Ushtarake, në bazë të nenit 18, paragrafi g) kërkoj të vendoset dënimi i tij me 10 (dhjetë) vjet burgim.” Gjykatat ushtarake që u ngritën, ishin gjykatat e vetme që funksionuan për disa muaj pasi në vend u vendos regjimi i forcave Nacional Çlirimtare. Praktikisht, autoritetet mendonin se të gjitha çështjet gjyqësore kishin njëfarë rëndësie ushtarake, ndaj ato ishin nën juridiksionin e gjykatave ushtarake.³⁰

Sistemi i burgjeve

Gjatë pushtimit italian liria e individit nuk ekzistonte në Shqipëri, pasi çdo qytetar mund të burgosej si rrjedhojë e një vendimi të marrë nga komitetet e posaçme të internimit policor. Këto komitete, një në Tiranë dhe disa të tjerë të shpërndarë në krahina, ishin të mbushur me përfaqësues të policisë italiane dhe milicisë fashiste. Aty nga fundi i vitit 1942 u nxorën edhe disa ligje të posaçme kundër akteve të sabotimit - veçanërisht ato që drejtoheshin kundër rrugëve dhe

²⁹ “Zëri i Vlorës”, Botim i veçantë për Gjykatën Ushtarake kontra kriminelëve të luftës”, Nr. 7, Vlorë 1944, f. 7.

³⁰ B. Fischer, Shqipëria 1943-1945, Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore, AHS, Tiranë 2012, f. 72.

shërbimeve të telekomunikacionit (këto plotësonin Kodin Penal). Sipas dekretit, të gjithë banorët e fshatrave që jetonin brenda një rrezeje prej rreth 1 500 metrash nga vend i aktit sabotues konsideroheshin kolektivisht përgjegjës. Në kësi rastesh, mbi të gjithë kryefamiljarët rëndonin gjoba të rënda dhe dënime me burgosje, të cilat ekzekutoheshin nga komitetet e posaçme të policisë së internimit.³¹

Edhe qeveria e Mustafa Krujës (3 dhjetor 1941-4 janar 1943) po ndërmerre përherë e më tepër masa të ashpra represive. Është i njohur urdhri drejtuar prefektëve për të vrarë në vend, sepse është krejt e panevojshme të mbushen burgjet e t'u shtohet puna gjyqtarëve, duke iu ngarkuar çështjet e elementëve kriminelë, vendi i të cilëve është në litar’’³² Sistemi i burgjeve i kësaj periudhe njihet pak, pasi praktikisht të gjitha burgjet ishin në duart e autoriteteve ushtarake. Në kohën e pushtimit italian dihej se në Shqipëri kishte 40 burgje, një në çdo prefekturë dhe nënprefekturë, si dhe një burg i përgjithshëm i tipit modern në Tiranë.³³

Gjatë pushtimit nazist, në disa rrethe të vendit, përveç burgjeve të ndërtuara më parë, kanë funksionuar edhe qeli të ndërtuara pranë komandove gjermane. Sipas një raporti të Drejtorisë Penitenciare, në vitin 1943, në Shqipëri kishte 17 burgje, nga të cilat disa prej tyre ishin jashtë kufijve të Shqipërisë (Tetovë, Prizren, Gostivar).³⁴ Sipas të dhënave³⁵, kushtet në këto burgje ishin të këqija, tortura për të detyruar të rrëfeshesh dukej se ishte ende në modë, ndërsa të burgosurit duhet të merrnin ushqime dhe hera-herës edhe ujë nga të afërmit e tyre ose përndryshe kishte gjasa të vdisnin nga uria. Gjithsesi këto kushte ndoshta nuk ishin më të këqija se sa në Jugosllavi dhe vendet e tjera të Ballkanit, ku këto kushte ishin afërsisht të njëjta dhe të tilla do të ishin dhe për njëfarë kohe, deri sa të futeshin të ashtuquajturat “parimet demokratike” dhe populli të kërkonte ndryshim.

³¹ B. J. Fischer, “Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945, Botimet Çabej MCM, Tiranë 2000, f. 73.

³² N. Smirnova, Histori e Shqipërisë përgjatë shek. XX, Botimet Ideart, Nëntor 2004, f. 239

³³ B. Fischer, Shqipëria 1943-1945, Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore, AIIS, Tiranë 2012, f. 74.

³⁴ V. Hysi, “Penologjia”, KRISTALINA-KH, Tiranë 2009, f. 74.

³⁵ B. Fischer, Shqipëria 1943-1945..., vep. cit., f. 74.

Marbona CUKA

SUMMARY

THE ALBANIAN CRIMINAL LAW IN THE PERIOD OF 1939-1945

The nearly six-year period of 1939-1945, reflects the three different 'Albania': the Italian, the German and the Stalinist, each of which displays the specific features of the criminal legislation, judicial and legal system. With the occupation of Albania by fascist Italy in April 1939, the Criminal Code of 1928 remains formally upright, but to protect the interests of the invaders there were many pro-fascist criminal norms established, which were characterized by severity and aggressiveness against the resistance of the Albanian people. In this situation we see on one side the Albanian judicial authorities trying to enforce the Penal Code and on the other side the Military Courts of the invaders who enforce the pro-fascist laws.

By strengthening the fascist National Liberation Movement, appear the first elements of the new criminal law expressed mainly in the Resolution of the Conference of Peza, in the Statute of the National Liberation Movement and the National Liberation Council Regulation. The criminal laws of this period protect the struggle of the people against foreign invaders, but at the same time reflect the extremist politics of the Communist Party in connection with the definition of political crimes followed often by harsh and unfair penalties. However, other criminal norms with an apolitical character gave significant contribution to the fight against crime. In the light of the historical and political circumstances, a considerable importance was given to the military judiciary. After putting in place the regime of the National Liberation Forces, the military courts that were raised were the only courts functioned for several months. Practically, the authorities felt that all court cases had some military importance, so they were under the jurisdiction of military courts. The Albanian Criminal Law took a very comprehensive form with the establishment of the People's Government all around Albania, after the liberation of the country.

Alban DOBRUNA

**BASHKËSIA ISLAME E GJAKOVËS, GJATË LUFTËS SË
DYTË BOTËRORE (1941-1945)**

Në prill të vitit 1941, shtetet e Bllokut fashist sulmuan Jugosllavinë duke e shpërbërë dhe copëtuar atë¹. Fatin e saj e përjetuan edhe trevat shqiptare që ishin nën sundimin jugosllav. Në kuadër të pushtimit nazifashist, viset shqiptare u ndanë në tri zona pushtimi: gjermane, italiane dhe bullgare. Pjesa më e madhe e Kosovës, së bashku me trevat veriperëndimore të Plavës, Gucisë, Rozhajës, Tutinit, Ulqinit, Tuzit; trevat lindore etnike shqiptare dhe pikërisht Tetova, Gostivari, Dibra, Kërçova e Struga, u përfshinë në zonën italiane të pushtimit². Zonës okupuese gjermane iu bashkëngjitën Qarku i Mitrovicës, ku u përfshinë edhe rrethet e Podujevës, Vushtrrisë dhe Tregut të Ri, që hynë në kuadër të Serbisë së Nediqit. Bullgarisë fashiste veç rrethit të Shkupit e Kumanovës, i takoi një pjesë e rrethit të Gjilanit, Kaçanikut, Vitisë si

¹ Xhelal Gjeçovi, “Çështja Kombëtare Shqiptare në vitet e Luftës së Dytë Botërore”, *Studime historike*, 3-4, (2005), 147; Muharrem Dezhgiu, “Kombi shqiptar në planet strategjike të fuqive ndërluftuese gjatë Luftës II Botërore”, *Studime historike*, 3-4, (2005), 160; Lefter Nasi, “Kosova dhe problemi kombëtar në vitet 1941-1943”, *Kosova*, 28, (2006), 213.

² *Arkivi Qendror Shqiptar* (më tej: AQSH), Fondi (F). 266, Ministria e Tokave të Lirume, f. 1-25; Kuadri i Personelit të Nënprefekturave: Dragash, Rahovec, Suharekë, Gjakovë, Istog, Drenicë, Plavë, Cucinjë, Rozhajë, Gjilan, Ferizaj, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Rekë, Carisver (Prespë e madhe); AQSH, F. 266, Ministria e Tokave të Lirume, V. 1943, Nr. 32, f. 2: Koncept Mbretinija Shqiptare, Komisariati i Naltë Civil për Kosovë, Dibër e Strugë, Prizren 27 gen 1943; Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1997), 19; Muharrem Dezhgiu, “Përpyekjet e forcave politike shqiptare për bashkëpunim gjatë Luftës së Dytë Botërore”, *Studime historike*, 1-2, (2000), 189.

dhe Presheva e Bujanoci³. Edhe pse bashkimi u bë nën kapelën fashiste, megjithatë për popullsinë shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore kishte rëndësi të madhe historike. Forcat pushtuese vendosën që qeverisja lokale në rajonet e populluara nga shqiptarë duhej drejtuar nga shqiptarë⁴, dhe gjuha shqipe u shpallë si gjuhë zyrtare bashkë me atë italiane. Për herë të parë u rihapën shkolla fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe, u legalizua përdorimi i simboleve kombëtare, u lejuan gazetat shqip, u lejua shënimi i festave shqiptare⁵ dhe u realizua bashkimi i komuniteteve islame në një komunitet të vetëm⁶.

Me ndarjen e lartpërmendur u bë edhe ndarja e re administrative e Bashkësisë Islame në Kosovë, pra ajo që u bashkua me Shqipërinë nën okupimin italian u lidhë me kryeqendrën e re në Tiranë. Në zonën bullgare organizimi i Bashkësisë Islame mbeti i pa ndryshuar. Ulema Mexhlisi e Shkupit, ishte një ndër qendrat e islamit që përfshinte tërë viset shqiptare në jugosllavi e themeluar më 1921 për t'u reformuar dhe marrë nën kontroll shqiptarët pas vitit 1936⁷. Nën okupimin bullgar kjo bashkësi u lidhë me qendrën e Myftinisë Supreme në Sofje, ndërkaq, në zonën gjermane, përkatësisht nga viti 1942 u lidhën me kryeqendrën e formuar në Novi Sad, që lidhej me Beogradin. Në zonën e administrimit italian në Kosovë u formuan dy qendra të kryemyftinjve: Prizren dhe Prishtinë. Në qendrat e kësaj zone ekzistonin kryemyftinjtë dhe myftinjtë, ndërsa në vendbanimet më të vogla, nënmyftinjtë dhe xhematët e imamëve⁸. Gjakova bënte pjesë në kryemyftininë e Prizrenit, e cila përfshinte edhe vakëfet e: Suharekës, Rahovecit dhe

³ Fehmi Rexhepi, "Lufta e shqiptarëve për vetëvendosje e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore", *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë, Instituti i Historisë-Tiranë, 2014), 136-137.

⁴ Stefan Karastojanov, *Kosova (Një analizë gjeopolitike)*, (Shkup: Serembe, 2007), 152.

⁵ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, (Tiranë: 55, 2006), 450; Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), 213.

⁶ AQSH, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 115: Letër e Ministrisë së Drejtësisë, Kryesisë së Komunitetit Mysliman, Tiranë, 27. XII. 1941; Alexandre Popovic, *Islamizmi ballkanik; Myslimanët e Evropës juglindore gjatë periudhës pasosmane*, (Tiranë: Dituria, 2006), 53.

⁷ Qerim Lita, "Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi 1937-1941 dhe roli i Bashkësisë Fetare Islame në pengimin e saj", *Zani i Naltë*, 7(160), (2014), 39-43.

⁸ Jusuf Osmani, "Burimet arkivore për veprimtarinë e institucioneve myslimane në Kosovë", *Dituria islame*, 63, (1994), 40.

Dragashit⁹, kurse kryemyftinia e Prishtinës përfshinte: Gjilanin, Drenicën (Skenderaj) dhe Ferizajn¹⁰. Peja, për arsye se nuk ishte parashikuar në buxhet për kryemyftinj, mbeti myftini dhe komunikonte drejtpërdrejt me Këshillin e Ulemave. Myftinia e Pejës përfshinte: Istogun, Plavën, Gucinë, Rozhajën dhe Tutinin. Në kuadër të kësaj ndarje administrative të vakëfeve, Gjakova kishte edhe 10 këshilla të xhematit, të lagjeve dhe fshatrave të cilat kishin qendra selinë në: Cermjan, Raniq, Deçan, Skivjan, Junik, Ponoshec, Lagjja Qerim, Lagjja Hadum, Lagjja e Xhamisë së Mahmut Pashës, Lagjja e Xhamisë së Mulla Jusufit¹¹.

Gjakova zinte një vend të rëndësishëm në ndarjen administrative në kuadër të ristrukturimit të Komunitetit Mysliman Shqiptar për shkak të rrethanave të reja që u krijuan në kulmin e Luftës së Dytë Botërore, ku si qendër kryesore në përfundim të Kosovës, por edhe viset përreth çmoheshin lartë në faqet e revistës “Kultura islame”, e cila ishte organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Në një artikull të kësaj reviste ndër të tjera shkruhej: *“Përveç kësaj asht edhe pllaja e Priszrendit e Gjakovës dhe ajo e Pejës. Këto ndahen prej fushës së Madhe vetëm me anën e Malësisë së Drenicës dhe at të Sërmollës, dhe kufizohen si në very ashtu edhe në jug-përfundim me Alpet e nalta të Shqipnis dhe me malësinë e Gjakovës, të Lumës e të Gorës. Pra, të gjitha qytetet e Kosovës mbarë gozhdohen me rradhë në ate fushë të bekueme sikurse me qenë një varg inxhish”*¹². Vlerësime të tilla për këto treva vinin për shkak se ishin të pasura me trashëgimi islame-orientale si me xhami¹³, teqe¹⁴, mektebe¹⁵,

⁹ AQSH, F. 482, V. 1943, D. 23, f. 3: Lista që tregon emrat e komunave të qarkut të prefekturës së Prizrenit.

¹⁰ Haki Kasumi, “Qëndrimi i Bashkësisë Fetare Islame ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kosovë (1941-1945)”, Kosova, 12, (1983), 47.

¹¹ AQSH, F. 482, V. 1944, D. 80, f. 26: Përkthim; Rradhuer i Këshilleve të Xhemateve në rrethveprimin e Këshillit të Ulemave në Shkup me numrin e shtëpive të perbamë në bazë të raportave të marruna nga zyrat e rrethveprimit për vitin 1935. Përkthyesi Zav. Inspektori, Tiranë, 23. VI. 1944.

¹² Avni Zaimi, “Kosova asht hambari arbënuer i frithnavet”, Kultura islame, 1(49), (1943), 16.

¹³ Dragan Ćukić, Kosova monumentet dhe bukuritë, (Nish: Lidhja Turistike e Kosovës Prishtinë, 1971), 140-141; Mexhid Yvejsi, Ylematë e Gjakovës mburojë e Kosovës, (Gjakovë: Urtësia, 2003), 17-19; Fejaz Drançolli, Xhamia e Hadumit, Çarshia e Gjakovës, (Prishtinë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 2007), 8.

¹⁴ AQSH, F. 482, V. 1944, D. 80, f. 16; Letër e Inspektorisë, Komunitetit Mysliman Shqiptarë, Tiranë 27. VI. 1944; Sheh Muhamed Shehu, Sheh Shefqeti dhe Teqeja e Madhe në shërbim të Zotit në shërbim të popullit, (Gjakovë, 1414/1998), 36-70; Sheh Adem Nuri Gjakova, Principe e Rregulla të Dervishizmit, (Gjakovë: Teqeja Asitane e

por në veçanti me Medresenë e Madhe (e vitit 1700) dhe Medresenë e Vogël (1815), të cilat ishin institucionet kryesore të arsimit, nëpër të cilat përveç që mësoheshin gjuhët osmane, arabe dhe perse, shpjegimi i lëndëve mësimore bëhej edhe në gjuhën shqipe¹⁶. Kjo është edhe arsyeja se pushtimi serb midis dy luftërave botërore nuk arriti të shtrinte ndikimin dhe influencën e vetë, pasi organet administrative fetare islame ishin të vetmet institucione, që mund të quhen organe institucionale legale për shqiptarët myslimanë të viseve të okupuara, ku ata mund të komunikonin jozyrtarisht në gjuhën amtare, shqipe¹⁷. Kështu, edhe Partia Komuniste Jugosllave (PKJ) në Gjakovë nuk ka qenë gjerë në prill të viti 1941 parti masovike, kryesisht malazezë dhe disa serbë¹⁸.

Gjatë kësaj periudhe u bë edhe riemërimi i imamëve. Dekretet e emërimit lëshoheshin nga kryeqendra përkatëse në Tiranë. Imamët ndaheshin në dy kategori, në shtetërorë dhe privatë. Meqë imamët shtetërorë paguheshin me rroga të larta (imami shtetëror në zonën okupuese italiane merrte 600, vaizi 400, mësuesi i besimit 500, myezini 400 lekë etj.), kurse imamët privatë mbaheshin nga kontributet e besimtarëve kjo gjë nuk hetohet në veprimtarin e tyre profesionale¹⁹. Në kuadër të këtij riorganizimi, Komunitetit Mysliman Shqiptar me qendër në Tiranë, me kërkesë të nënprefektit Sulejman Kryeziu, kërkohej emërimi si myfti në Gjakovë i Fahri Iljazit Myderriz²⁰, i cili kishte

Rrifaive për Kosovë e Shqipëri në Gjakovë, 2000), 116.

¹⁵ Ismail Rexhepi, Sadik Mehmeti, "Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Gjakovë me rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore (2)", *Dituria islame*, 143, (2002), 50.

¹⁶ Mexhid Yvejsi, "Objektet material, kulturore dhe shpirtëror të trashëgimisë orientale-islame në Gjakovë", *Trashëgimia Orientale-Islame në Ballkan*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare e mbajtur në Prishtinë më 15 qershor 2015. (Prishtinë: Instituti për Shkenca Humane "Ibni Sina", 2015), 204.

¹⁷ Haki Kasumi, "Gjendja organizative e bashkësisë islame te shqiptarët nën okupimin jugosllav 1912-1941", *Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*, Simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1992, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 1995), 463.

¹⁸ Ali Hadri, "Gjakova prej themelimit deri më 1941", *Kosova*, 1, (1972), 455.

¹⁹ Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë*, (Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1988), 11.

²⁰ Myderrizi, hafiz *Fahri Efendi Iljazi* ishte njëri prej hoxhallarëve më të ditur në tërë Kosovën.

Lindi në vitin 1906, në Gjakovë. Shkollimi fillestar e kreu në Gjakovë, ku e mësoi Kur'anin përmendësh, dhe në moshën 11-vjeçare dhe e fitoi titullin e hafiz. I vijoi

filluar detyrën më 9 maj 1941, mirëpo nënprefektura dëshironte dekretimin e tij zyrtar nga Kryesia e Komunitetit Mysliman, pasi e konsideronte atë: *“Nji fetarë i zoti në çdo pikpamje e ma i nderit intelektual i këti qyteti”*²¹. Përkushtimin e tij si fetar dhe intelektual gjatë Luftës së Dytë Botërore e dëshmon edhe angazhimi nga kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Behxhet Shapati, për të zhvilluar hetimet për parregullsitë e shfaqura në Myftinin e Gjilanit²², ku Shaip Rexhepi ishte shkarkuar nga pozita e myftiut për shkak të pazotësisë së në disa fetva të lëshuara gabimisht. Në vend të tij ishte emëruar Idriz Hajrullahu²³.

Në vazhden e organizimeve dhe emërimeve në kuadër të Bashkësisë Islame, filloi të promovohet aktivisht pjesëmarrja e të rinjve në nivele të ndryshme lokale e regjionale. Kështu, Ismajl Agush Gashi, banues në Gjakovë i drejtohet, me një kërkesë Kryesisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar, i cili pasi potencon kualifikimin e tij si i diplomuar në Medresenë të drejtuar prej myderrizit Fahri Iljazit, kërkonte që nëse shfaqet nevoja e emërimit të një nënmyftije në nënprefekturën e Rahovecit, ishte i gatshëm të shërbente, pasi me këtë vend ishte në kontakt prej shumë kohësh²⁴.

studimet në Medresenë “Mehmed Pasha” në Prizren. Që nga janari i vitit 1930 e deri në vitin 1948, kur e mbyllën komunistët, hafiz Fahri Efendi Iljazi ka qenë myderriz, udhëheqësi kryesor, në Medresenë e Madhe të Gjakovë. Ka shërbye si imam në disa xhami, dhe ka shërbye si kryeimam i Gjakovës, edhe i një pjese të Kosovës që quhet Dukagjin, duke përfshi Pejë, Istogun deri në Klinë. Ka qenë kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës, gjithashtu, ka shërbye në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës. Hafiz Fahriu ndërroi jetë më 19 nëntor 1985, në moshën 82-vjeçare. Shërbimet e fundit mortore, në këtë jetë të përkohshme tokësore, i kreu kushërinë i tij, nxënësi i tij, Hafiz Selim Yvejsi: *AQSH*, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 41; Mexhid Yvejsi, *Hafizët e Gjakovës-krenaria e Kosovës*, (Gjakovë: EPRO PRINT, 2013), 79-90; Mexhid Yvejsi, *101 personalitete fetare-atdhetare-kulturore-letrare*, (Prishtinë: Instituti për shkencat humane “Ibni Sina”, 2013), 348-356; Mexhid Yvejsi, “Në përkujtim të 110-vjetorit të lindjes së dijetarit të famshëm - hoxhës së hoxhallarëve Myderriz, hafiz Fahri Ef. Iljazi (103-1985)”, *Edukata islame*, 104, (2013), 251-264.

²¹ *AQSH*, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 30; Letër e Sulejman Kryeziut, Kryesisë së Komunitetit Mysliman, Gjakovë, 26. VI. 1941.

²² Aliriza Selmani, “BI e Gjilanit gjatë Luftës së Dytë Botërore”, *Edukata islame*, 82, (2007), 82.

²³ *AQSH*, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 2; Letër e Bahxhet Shapatit, Idriz Hajrullahut, Tiranë, 19. XII. 1941.

²⁴ *AQSH*, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 75; Letër e Ismajl Alush Gashi, Kryesisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar, Gjakovë, 26. XI. 1941.

Në këtë kuadër të riorganizimit, teqetë në qytetin e Gjakovës u lidhën me kryeqendrën e re në Tiranë. Sipas dokumenteve arkivore vërtetohet që kryetari i sektit halveti ishte Shejh Qerim Kavaja, kurse kryetar i Organizatës “Drita Hynore” ishte Ferdi Vokopola. Lidhjet e vjetra të teqeve të Shqipërisë dhe Kosovës u ripërtërinë dhe bashkëpunimi midis tyre u intensifikua. Në vitin 1942 u bë organizimi i rendeve aleviane. Shehlerët e teqeve nga Gjakova, që u përfshinë në Kryesinë e Sekteve Aleviane të Shqipërisë²⁵, ishin: Sheh Ramadani, Sheh Ahmeti, Sheh Haliti, Sheh Osmani, Sheh Jakupi, Sheh Rexhep Marina, kurse anëtarë në organizatën “Drita Hynore”, nga Gjakova ishte shehu i Teqesë Rifa’i, Sheh Danjoll Shehu²⁶.

Po ashtu, përveç lidhjeve administrative u intensifikuan edhe lidhjet dhe kontaktet e afërme ndërmjet prijësve fetar dhe popullsisë myslimane. Për të krijuar një fizionomi më të plotë për vakëfet, xhamitë dhe pasuritë e tyre dhe për të fituar një ide të qartë mbi të gjitha problemet fetare që do të rregullohen në të ardhmen, kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Behxhet Shapati, i shoqëruar nga Muharrem Mullahi, Sulejman Bakalli, Hafiz Muhameti, Hasan Tahsini, Vexhëhi Buhara etj., realizoi një vizitë zyrtare në Kosovë, duke u nisur nga Tirana për të përfunduar në Gjiilan. Në vizitën e tyre në Gjakovë, më 20 nëntor 1941, kishin dalë për t’i pritur prijësit fetarë si edhe të gjithë autoritet qeveritare e ushtarake të vendit dhe një numër i madh i popullatës së Gjakovës. Fjalën përshëndetëse të mirëseardhjes e mbajti Myderrizi Fahri Effendi Ilijazi, ku ndër të tjera tha: *“Shkëlqesi, me arritjen e Personit t’Uaj fort të lartë e të dashur, kjo turmë qytetarësh të Gjakovës së bashku me ata të krahinave të sajë, më kanë ngarkuar t’Ju shpreh mirëseardhjen. Na që të gjithë ndiejmë në zemrat t’ona ngushëllimet më të madha kur shohim pranë nesh personin t’Uaj të lartë, i cili duke marrë parasysh udhëtimin e lodhshëm e të gjatë, denjoi të na vizitojë, pas sa vjet mundimesh, vuajtjesh dhe torturimesh të Kosovës së robëruar. E tërë kjo turmë që ka dale këtu për t’Ju pritë ndien në shpirtin e saj gëzim të madh për këtë vizitë që na bëtë. Tash që na u bashkuam me Mëmën Shqipëri, me të cilën na bashkon gjuha, gjaku, dhe feja, e ndiejmë vetveten më se të lumtur, e sidomos kur shohim pranë nesh Kryetarin e Fesë s’onë, që është një vëlla i ynë, i gjakut e i gjuhës s’onë. Prandaj, Ju shprehim Shkëlqesë dashurinë më të*

²⁵ AQSH, F. 482, V. 1942, D. 18, f. 1; Lista që përmban emrat e fetarëve në tokat e çliruara të Shqipërisë, Tiranë, më datë 21. X. 1942.

²⁶“ Haxhi Shejh Danjoll Shehu “Rufai” Gjakovë”, *Buletin “HU”*, 3-4, (1981), 40.

sinqertë, nderimet më të gjalla si edhe çmimet më të zgjedhura, si në emën të Klerit ashtu edhe të këtij grumbulli qytetarësh. Shkelqësi, zemrat t'ona kullojshin gjak për të parë një ditë të realizuar ëndrrën t'onë të madhe, Bashkimin me Mëmën Shqipëri në të gjitha fushat e sidomos në atë fetare e shpirtërore. Por sot që u realizua kjo nuk na mbetet veçse të duamë, të nderojmë dhe të çmojmë njeri-tjetrin. Të zhvillohemi në pikëpamje shpirtërore, intelektuale dhe patriotike”²⁷. Me këtë rast, kryetari i Komunitetit Mysliman, Behxhet Shapati, shprehu konsideratat e tij për mikpritjen e parisë dhe e popullatës së Gjakovës, duke vlerësuar: “Të nderçëm zotërinj, i prekur thellësisht për mikpritjen që patët nderin të më bëni, ju shpreh të gjithëvet me gjithë zemër e me gjithë shpirt falënderimet e mija më të zjarrta. Na ishim të ndarë prej njeri-tjetrit vetëm me trup, ndërsa shpirtërisht ishim tërësisht të bashkuar”²⁸. Pastaj, delegacioni nga Tirana vizitoi Medresenë e Gjakovës, ku u prit nga një numër nxënësish të kësaj Medreseje. Kryemyftiu i zonës së Tiranës, Muharrem Mullahi, foli me një gjuhë të mprehtë mbi vëllazërimin myslimanë shqiptarë. Këtij iu përgjigj menjëherë Myderriz Hasan Islami (Hasan ef. Nahi A. D.) duke përshkruar vuajtjet e popullit të Gjakovës gjatë kohës së pushtuesve serbë, ku ndër të tjera potencoi se si malazezët kishin grabitur tokat shqiptare, e sidomos në Gjakovë.

Kryetari i Komunitetit, Behxhet Shapati, foli përsëri duke këshilluar për të zënë udhën e mbarë se kështu do të qetësoheshin edhe shpirtat e atyre që ranë dëshmorë për atdhe e për fe. Më tej Shapati ishte shprehur se duhet të përparojmë në mënyrë që të meritojmë të trashëgojmë vlerat morale e patriotike të atyre burrave që lan eshtrat e tyre dhe që e lyen çdo pëllëmbë të këtij vendi me gjak për të na dhënë lirinë, që po e shfrytëzojmë sot. Në fund ai porosi: “*Le t'i a dimë vleftën asaj*”²⁹. Po atë ditë në mbrëmje, në Medrese, kryetari i Komunitetit bisedoi për çështjet fetare me një ndër hoxhallarët më në zë të Gjakovës, Asim ef. Luzha, mbi kurset fetare, mbi ligjet fetare në fuqi, mbi çështjet që kanë të bëjnë me imamët, mbi problemet e 150 studentëve që kishin studiuar në Medresenë “Isa Begu” në Shkup. Shumë prej këtyre studentëve, pasi medreseja është mbyllur, kishin

²⁷ Sadik Bega, “Reportazh mbi vizitën e kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Kosovë; Kryetar i Komunitetit Mysliman në Gjakovë”, *Kultura islame*, 3-4, (1941), 80.

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

shkuar nëpër gjimnaze. Ata biseduan edhe për zgjerimin dhe reformimin e Medresesë së Përgjithshme në Tiranë, në të cilën do të gjenin strehë disa nga këta studentë. Populli gjithashtu kërkonte mësues t'u përshtaten shkollave fillore të atjeshme. Këta mësues duhet t'u dhënë një hov të shpejtë gjeneratës së re, si nga pikëpamja kombëtare ashtu edhe fetare.

Ditën e nesërme, më 21 nëntor 1941, delegacioni pak para se të falen në xhaminë kryesore të Gjakovës "Hadumit" apo siç e quanin ata "*faltore madhështore të Gjakovës*", Myderrizi Fahri ef. Iliazi mbajti një predikim të bukur, kurse hytben e këndoi Asim ef. Luzha me një melodi të këndshme. Pas faljes së xhumasë delegacioni u kthye në medrese, ku u shtrua një drekë, me ç'rast u njohën edhe me programin mësimor të medresesë, së cilëve ju bëri përshtypje disa mësim si në: filozofi, etikë, jurispodencë islame etj., të cilat sipas tyre duhet të vihen edhe në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë. Delegacioni përfundoi vizitën në Gjakovë për të vazhduar në qytetin e Pejës.

Hoxhallarët e Gjakovës, të pasur me tradita fetare, atdhetare dhe kulturore, dekada me radhë ishin angazhuar për ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e këtyre traditave. Kjo shihet edhe nga pjesëmarrja e tyre në Kongresin e Klerit Mysliman të Kosovës, të mbajtur më 22 nëntor 1941 në Prizren. Si përfaqësues të Gjakovës, ishin: Hasan Islami (Hasan ef. Nahi A. D.) e Asim Luzha. Kongresi ngarkoi si kryetar të përkohshëm, Hafiz Abdulla Hëzirin. Kongresi kishte si qëllim bashkimin kombëtar, perfeksionimin e organizimit fetar për realizmin e parimeve islame.

Përderisa të stabilizohej gjendja juridike e vendeve të çliruara, Kongresi e mendoi të nevojshme që administrimi fetar në këtë vend të dirigjohet prej një myftiu të përgjithshëm dhe i përbërë prej 4 anëtarëve të zgjedhur nga ky Kongres, me qendër në Prizren. Myftinia e përgjithshme mund të varen në Kryesinë e Komunitetit Mysliman Shqiptar, ndërsa Këshilli i Naltë i Sheriatit do të kishte kompetenca për organizimin fetar të këtyre vendeve, moralisht dhe materialisht. Këshilli i Naltë për rregullimin e mësim-besimit dhe të gjitha kompetencat e "Ulema Mexhlis-it" të Shkupit, i vishen Këshillit të Naltë të Sheriatit në Prizren³⁰. Kjo u bë për shkak se Shkupi mbeti jashtë Kosovës, të paktën për momentin. Iniciatorët e kësaj lëvizjeje deshën të formojnë një "Ulema Mexhlis" për Kosovën. Përfaqësuesi i Gjakovës në këtë Kongres, Hasan Islami, më vonë u njoh me emrin Hasan Efendi Nahi,

³⁰ Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Prishtinë (1912-1967)*, (Tiranë: 2011), 330.

dijetari i madh, myderriz, studiues, mendimtar³¹ dhe përkthyes i Kuranit³², aftësitë e të cilit, kontributi familjar³³, puna, aktivitetit i tij nëpër Kosovë bënë që në prill 1943, të emërohej drejtor i Medresesë “Mehmet Pasha” në Prizren (1943-1948)³⁴. Paralelisht me këtë emërohet edhe kryemyfti i Prizrenit dhe i Dukagjinit³⁵, për t’u bërë pastaj ndër hoxhallarët kryesorë në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore, në një kohë shumë të vështirë për popullin shqiptar, në aspektin fetar e kombëtar.

Gjatë vitin 1939-1945 në Shqipëri u botua revista “Kultura islame”, e përmuajshme fetare³⁶, filozofike, letrare, morale e shoqërore³⁷, pasardhëse e revistës së njohur “Zani i Naltë” (1923-1939)³⁸, që ishte organ zyrtar i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Revista

³¹ Naim Tërnavë, “Hasan efendi Nahi personaliteti islam i shekullit të njëzet”, *Myderriz Hasan ef. Nahi Jeta dhe vepra (1905-1991)*, Konferencë shkencore mbajtur në Prishtinë, më 5 shkurt 2011, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2012), 9.

³² Resul Rexhepi, “Hasan ef. Nahi-përkthyes i Kuranit fisnik”, *Myderriz Hasan ef. Nahi Jeta dhe vepra (1905-1991)*, Konferencë shkencore mbajtur në Prishtinë, më 5 shkurt 2011, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2012), 101.

³³ Nehat Krasniqi, “Reflekse të traditës kulturore të vendlindjes në personalitetin e Hasan efendi Nahit”, *Edukata islame*, 89, (2012), 157-168.

³⁴ Sadik Mehmeti, “Hasan ef. Nahi myderriz i Medresesë “Mehmet Pasha” në Prizren (1943-1948)”, *Myderriz Hasan ef. Nahi, Jeta dhe vepra (1905-1991)*, Konferencë shkencore e mbajtur në Prishtinë më 5 shkurt 2011, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2012), 37.

³⁵ Qemajl Morina, “Hasan ef. Nahi-student në Universitetin “AL-Azharit” në Kajro”, *Myderriz Hasan ef. Nahi, Jeta dhe vepra (1905-1991)*, Konferencë shkencore e mbajtur në Prishtinë, më 5 shkurt 2011, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2012), 33.

³⁶ Sadik Bega, “Ç’vend zë Kurani në pikëpamje legjislacioni?”, *Kultura islame*, 1, (1939), 15-19.

³⁷ *Fjalor enciklopedik shqiptar 2*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008), 1407.

³⁸ Fahrush Rexhepi, *Periodiku shqiptar islam; Gjysma e parë e shekullit XX*, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, 2013), 162; Ali Musa Basha, “Tematika e revistës “Zani i Naltë”-1923-1939”, *Zani i Naltë*, 5(158), (2013), 6; Gentiana Skura, “Zani i Naltë”, dhe kontributi për vetëdijesimin kombëtar shqiptar”, *Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar*, Konferencë shkencore mbajtur në Tiranë më 28-29 shtator 2012, (Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë: Bashkësia Islame e Kosovës; Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, 2013), 243; Mark Marku, ““Zani i Naltë, je model etik dhe përgjegjës i komunikimit fetar shqiptar”, *Zani i Naltë*, 13(166), (2015), 115; Resul Rexhepi, ““Zani i Naltë” Revistë e mendimit dhe emancipimit fetar e kombëtar”, *Zani i Naltë*, 15(168), (2016), 44-49.

kishte si qëllim edukimin fetar të tyre në përputhje me të gjitha normat e fesë islame.

Autorë të këtyre shkrimeve ulema, hoxhallarë e fetarë të shquar, paraqisnin përpara besimtarëve rrënjët historike të islamit, shtrirjen e tij, pejgamberet myslimanë, festat e ritet fetare, detyrimet islame etj. Por, mbi të gjitha, vend të dukshëm zënë, në faqet e revistave, shkrimet që kultivojnë moralin dhe normat islame, që kanë si synim të edukojnë te njeriu virtytet më të mira, që mund të sintetizohen te një njeri i vlefshëm për shoqërinë dhe për atdheun³⁹. Prandaj, pas unifikimi të bashkësive fetare islame në trevat shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore, kjo revistë, pati jehonë dhe sukses në qytetin e Gjakovës, në mbajtjen me rregull të revistës me shërbimin e saj duke plotësuar misionin që i kishte besuar Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Kështu, Ismail H. Muçaj nga Gjakova, në një letër drejtuar redaksisë së kësaj reviste, më 15 prill 1944, çmonte lartë punën e saj në frymëzimin me ndjenja fetare të popullatës, shprehë përkushtimin e tij ndaj detyrave fetare, dhe ofron gatishmërinë e tij, për të ndihmuar revistën që me mundësi të tij, të bëjë përkthime nga gjuha angleze, franceze, arabe dhe italiane⁴⁰. Ai kontribuoi në këtë revistë me shkrime si: “Kontributi i Islamizës? për një paqë botnore”⁴¹, “Shkodër i këputet një Hoxhë i njoftun për kulture e shpirtbardhësi”⁴², “Feja dhe nevoja e saj”⁴³, “Feja dhe nevoja e saj II”⁴⁴, “Qytetnimi islam; Fjala e vepra e Zotit”⁴⁵ dhe “Kur’ani e Hadithi”⁴⁶.

Me këto artikuj, duke pas parasysh burimet e pakta për kohën në literaturë dhe publicistikë, autori na njehë në mënyrë më të plotë me islamin dhe kulminacionet e tij dhe veçanërisht, për paqen botërore. Ai synonte që islami të mos jetë i kufizuar vetëm për hoxhallarët, dijetarët,

³⁹ Muharrem Dezhgiu, “Uniteti i luftës për atdhe e fe në revistën “Kultura islame”(1940-1944)” , *Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*, Simpozium ndërkombehtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1992, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 1995), 427.

⁴⁰ Ismail H. Muçaj, “I dashur dhe i ndershmi Z. Drejtor”, *Kultura islame*, 11 (59), (1944), 304.

⁴¹ *Po aty*, 304-309.

⁴² *Po aty*, 322-323.

⁴³ Ismail H. Muçaj, “Feja dhe nevoja e saj”, *Kultura islame*, 2 (62), (1944), 36-40.

⁴⁴ Ismail H. Muçaj, “Feja dhe nevoja e saj”, *Kultura islame*, 3-4 (63-64), (1945), 69-71.

⁴⁵ Ismail H. Muçaj, “Qytetnimi Islam; Fjala e vepra e Zotit”, *Kultura islame*, 10-11 (70-71), (1945), 142-144.

⁴⁶ Ismail H. Muçaj, “Kur’ani e Hadithi”, *Kultura islame*, 1-2 (73-74), (1946), 10-12.

mendimtarët apo shkrimtarët, por çdo besimtar të jetë i ditur, misionar dhe thirrës i mirë në misionin e fesë së tij. Kur mbaron së lexuari artikujt, ajo që të bie në sy është se autori ia ka arritur qëllimit të shtrojë, të analizojë në mënyrë të argumentuar organizimin e fesë islame, rritjen dhe fuqizimin e saj, si në shtrirje dhe në përmbajtje, masivizimin e gjerë, mbështetjen dhe udhëheqjen e bazuar në Kur-an dhe Hadith, për të bërë realitet misionin e islamit si një fe monoteiste.

Në korrik 1942, mëkëmbësi i Italisë fashiste në Shqipëri, Jakomoni, filloi një riorganizim të ri të Komunitetit Mysliman. Ishte si një nismë për t'i dhënë një vulë më shumë unitare Shqipërisë së bashkuar⁴⁷. Italianët, të kujdesshëm ndaj ndryshimeve politiko-fetare, të shkaktuara nga gjendja e re që ishte krijuar, në qershor të 1942, e zëvendësuan Behxhet Shapatin me Hafiz Sherif Langu⁴⁸, edhe pse ai, siç shkruante Jakomoni në raportin e tij për Romën: "*Sado që i kryente detyrat duke më kënaqur, nuk gëzonte, megjithatë në këtë mjedis islam, për shkaqe personale, atë kredi që unë e mendoj të nevojshëm për një personalitet në funksion aq të lartë*"⁴⁹. Pushteti italian bëri një riorganizim të fesë islame në Shqipëri, duke zëvendësuar Këshillin e Përgjithshëm të Komunitetit, me një organ kolegjal drejtues, i quajtur Këshilli i Ulemave⁵⁰, pesë anëtarët e të cilit emëroheshin që të gjithë nga mëkëmbësi⁵¹. Kjo ishte një mënyrë për të shtuar kujdesin për institucionet e fesë islame në Shqipëri⁵² dhe për të krijuar një hapësirë përfaqësimi të myslimanëve të territoreve tjera, që deri në ato kohë ndodheshin jashtë kufijve të Shqipërisë⁵³. Prandaj, kryetari Hafiz Sherif Langu, për të krijuar një pasqyrë më të qartë, në kuadrin e administrimit të përbashkët të Komunitetit Mysliman Shqiptar në një njësi të vetme, kërkoi informacione të hollësishme mbi gjendjen e popullsisë myslimane, xhamitë dhe teqetë e tokave të liruar të Kosovës⁵⁴. Në bazë

⁴⁷ Robertao Moroco dela Roka, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, (Tiranë: Elena Gjika), 203.

⁴⁸ AQSH, F. 482, V. 1943, D.5, f. 37; Këshilli i Ulemave të Komunitetit Mysliman Shqiptar, Vendim Nr. 7, Tiranë. 5. I. 1944.

⁴⁹ Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri...*, 298.

⁵⁰ Shyqyri Hysi, "Legjislacioni fetar në Shqipëri në vitet 1929-1949", *Studime historike*, 1-2, (2006), 171.

⁵¹ "Reforma e Statutit së Komunitetit Mysliman Shqiptar"; "Pushteti i Këshillit t'Ulemasë", *Kultura islame*, 10-11, (1942), 289-290.

⁵² Xhelal Gjeçovi, "Kleri Mysliman dhe Çështja Kombëtare në vitet e Luftës së Dytë Botërore", *Studime historike*, 3-4, (2006), 171.

⁵³ Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri...*, 298.

⁵⁴ AQSH, F. 482, V. 1944, D. 80, f. 16: Letër e Zav. Inspektori i Kryesisë së Këshillit

të informacioneve të regjistruara, Gjakova rezulton të kishte shtëpi myslimane 4 848, meshkuj 18 307, femra 16 578 gjithsej 34 885 frymë⁵⁵; kishte 14 teqe të tarikateve të ndryshme: 2 rifa'i, 3 kaderi, 1 bektashi, 3 halveti, 1 nakshibendi dhe 4 sadi⁵⁶; kishte 39 xhamia⁵⁷.

Po ashtu, në qytetin e Gjakovës dhe rrethinës gjatë kësaj kohe personeli i shërbyesve të xhamive përkatëse ishin: Idriz Shaqiri, Xhamia e Mulla Jusufit; Hasan Dashi, Xhamia e Mahmut Pashës; Asim Luzha, Xhamia e Qerimit; Mustafa Canhasi, Xhamia e Hadumit; Bajram Agani, Xhamia e Irzniçit; Halil Sulejmani, Xhamia e Cermjanit; Sadik Jusufi, Xhamia e Junikut; Ismajl Abdurrahmo, Xhamia e Deçanit; Imer M. Guta, Xhamia e Ponoshecit dhe Xhamia e Skivjanit, Selim Abdurrahimi⁵⁸. Sikurse shihet, Gjakova nëpërmjet objekteve të saj të proveniencës islame dhe funksionarëve klerikalë, në rrethanat e zhvillimeve historiko-politike gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe riorganizimit institucional të Komunitetit Mysliman Shqiptar, kishte rëndësi gjeostrategjike si qytet, ishte vend kryqëzim i lidhjeve qarkulluese të shumta të karakterit rajonal dhe ndërrajonal⁵⁹, me tokë pjellore, fusha, male, si dhe bjeshkë që rrethojnë në jugperëndim⁶⁰. Këto kushte nxitën dhe favorizuan zhvillimin dhe funksionimin ekonomik,⁶¹ të cilat i dhanë mundësi ndërtimit të xhamive⁶², bibliotekave⁶³, mejtepeve⁶⁴ e medreseve⁶⁵ dhe krahas tyre edhe të

t'Ylemave. Tiranë. 27. VI. 1944.

⁵⁵ *Po aty*, f. 17.

⁵⁶ *Po aty*, f. 18.

⁵⁷ *Po aty*, f. 19.

⁵⁸ AQSH, F. 482, V. 1944, D. 80, f. 35: Fahri Iljazit, Ramiz Riza, Mahmut Canhasi, Ahmet Korenica, Komuniteti Mysliman, Gjakovë, 15. 7. 1944.

⁵⁹ Muharrem Çërrabregu, "Lashtësia e Gjakovës", *Rilindja*, (E enjte, 6. XII. 1979), 13.

⁶⁰ Ali Hadri, *Gjakova në LNÇ*, (Prishtinë: Enti i Historisë së Kosovës, 1974), 2; Jusuf Bajraktari, *Gjakova me rrethinë (1878-1912)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998), 13; Nesim Vala, *Kjo është Gjakova*, (Gjakova: Ardi-Graphic, 2015), 22.

⁶¹ Hasan Kaleshi, Hans Jorgen, "Vilajeti i Prizrenit II", *Përparimi* 3, (1967), 280-281; Skënder Rizaj, "Disa të dhëna mbi Gjakovën me rrethinë në kohën e sundimit osman", *Kosova* 15, (1986), 348; Masar Rizvanolli, "Çarshia e Madhe - vatër e zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe kulturor të rajonit të Gjakovës", *Vjetar* 39-40, (2008), 221-259; Nehat Krasniqi, "Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit islam në trojet shqiptare gjatë periudhës osmane", *Vjetar*, XXXV-XXXVI (2006), 216.

⁶² Pleurat Krasniqi, *Aspekte kulturo-historike të Gjakovës dhe ixhazetlinjtë 1870-1940*, (Gjakovë: Litografia, 2002), 37-55; Fejaz Drançolli, *Trashëgimia monumentale në Kosovë*, (Prishtinë: 2011), 127-140.

⁶³ Tefik Morina, "Monumentet e kulturës islame në Kosovë dhe mbrojtja e tyre gjatë

institucioneve të tjera me karakter ekonomik, social dhe shoqëror⁶⁶, ku edhe gravitonte një numër të madhe të besimtarëve dhe nxënësve nga trevat e ndryshme që dëshironin të arsimoheshin në medresetë e Gjakovës. Mirëpo, Bashkësia Islame e Gjakovës dhe i aktivitetet e saj fetare në përfundim të Luftës së Dytë Botërore filloi të marrë tatëpjetën, sepse qendra e Luftës Nacionalçlirimtare e Kosovës ishte në qytetin e Gjakovës. Të rinjtë të brumosur me idetë komuniste në shkollat e Shqipërisë në qytetet si: Tirana, Shkodra dhe Elbasani, u kthyen në vendlindje për zhvillime e vrullshme të Luftës Antifashiste, prandaj këto ide ishin shumë të ashpër ndaj Bashkësisë Islame në Gjakovë dhe veprimtarinë e tyre e kishte cilësuar si primitive dhe të prapambetur, gjë që më vonë, solli edhe mbylljen e Medresesë së Vogël më 1947, me myderrizin e fundit, Jahja efendi Bakalli⁶⁷.

Periodha në fund të Luftës së Dytë Botërore ishte e vështirë edhe për popullatën gjakovare. Lufta për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë nuk solli ndryshime në statusin e shqiptarëve të Kosovës dhe të tokave të tjera në përbërje të Jugosllavisë solli ripushtimin e saj. Madje ndaj tyre u shtua më shumë shtypja nga shteti policor i Serbisë. Atyre iu mohuan të drejtat nacionale dhe shoqërore, mirëpo në rrethana të tilla, dijetarët myslimanë nuk mbetën duarkryq, por shfrytëzuan potencialet e tyre, si intelektuale dhe njerëzore, për t'i dalë krah popullatës së pambrojtur shqiptare. Njerëz me influencë si: hoxha Mustafa Canhasai e Sheh Danjoli u zgjodhën këshilltarë të Këshillit Popullor Krahinor, për rrethin e Gjakovës⁶⁸. Kjo ishte preludi i një periudhe shumë të vështirë

periudhës 1945-1992”, *Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët*, Simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1992, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 1995), 523.

⁶⁴ Haki Kasumi, “Shkollat fetare islame në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore”, *Gjurmime albanologjike: seria e shkencave historike* 12/1982, (1983), 160; Mexhid Yvejsi, *Kështjellat e gjakut tonë*, (Gjakovë, 2002), 11.

⁶⁵ Ali Iljasi, “Medreseja e Madhe e Gjakovës”, *Dituria islame*, 100, (1998), 49-51; Feti Mehdiu, “Medreseja Alauddin”, *Frymëzimi*, 2, (2000), 28.

⁶⁶ Feti Mehdiu, “Kosova në “Kamus al “alam”” të Sami Frashërit”, *Kosova*, 3, (1974), 477-478; Skender Rizaj, “Ekonomia dhe shoqëria e Kosovës në gjysmën e dytë të shekullit XIX sipas burimeve osmane, angleze dhe shqiptare”, *Kosova* 5, (1976), 23-24; Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1984), 139; Bedrush Shehu, “Një raport i J. Müllerit për Kosovën në vitin 1838”, *Kosova*, 5, (1976), 68.

⁶⁷ Krasniqi, *Aspekte kulturo-historike të Gjakovës...*, 29.

⁶⁸ Fahmi Pushkolli, *Fronti Popullor-Lidhja Socialiste e Kosovës (1935-1975)*, (Prishtinë: 1983), 97.

për fenë islame jo vetëm në Gjakovë por edhe në tërë Kosovën, ku për më tepër se gjysmë shekulli në viset shqiptare, u sfidua nga ideologjia komuniste. Sistemi shtetëror i cili u instalua, pengoi zhvillimin, ruajtjen dhe përhapjen e fesë ndër gjeneratat e reja. Por megjithatë, populli, të devotshmit, i ruajtën dhe i kultivuan vlerat e saj deri në ditët e sotme⁶⁹. Kështu e përshkruan gjendjen në Gjakovë e rrethinë disa nga intelektualët e kohës, gjë që mendoj se përshkrimi i tyre i përgjigjet të vërtetës objektive shkencore historike.

⁶⁹ Adem Zejnullahu, *Aspekte të islamit te shqiptarët*, (Prishtinë: Meshari, 2016), 29.

Alban DOBRUNA

SUMMARY

THE ISLAMIC COMMUNITY OF GJAKOVA DURING WORLD WAR II (1941-1945)

In April 1941, the fascist bloc countries attacked Yugoslavia, disintegrated and dismembered it. The fate of Yugoslavia suffered also the Albanian territories that were under its rule, they were divided into three occupation zones: German, Italian and Bulgarian. The occupying forces decided that the local governance in the areas populated by Albanians should be directed by Albanians, where in this context the merging of the Islamic communities into a single community was realized. With the aforementioned changes a new administrative division of the Islamic Community in Kosovo was undertaken, therefore what was under Italian occupation was given under the administration of the new capital Tirana. In the Italian part of Kosovo two zones of head mufti were created, one in Prizren and the other in Prishtina.

Gjakova was part of the mufti of Prizren. Gjakova had a geostrategic importance as a town through its facilities that belong to the Islamic provenience and through clerical functionaries. In the context of the historical-political developments during WWII, as well as the institutional reorganization of the Albanian Muslim Community, Gjakova was a cross-road of numerous circulating connections of regional and inter-regional character, with fertile land, fields, mountains, and surrounding mountains in the southwest. These conditions encouraged and favoured the development and economic functioning, which gave the opportunity to build mosques, libraries, mejteps, madrasas and along with them other institutions of an economic, social and societal character, which was frequented by a large number of believers and students from various regions who wanted to be educated in a madrasa in Gjakova.

Çlirim DURO

REFORMA ARSIMORE E VITIT 1946 NË SHQIPËRI

Me përfundimin e luftës, shteti shqiptar do të përballej me një gjendje mjaft të rëndë në fushën e arsimit, rrjedhojë kjo e shkatërrimeve, por edhe e trashëgimisë së varfër. Për më tepër edhe ajo infrastrukturë e ngritur më parë u dëmtua. Nga 2 500 fshatra që kishte vendi, në vitin 1945 afro 1 850 ishin në gjendje të shkatërruar. Mbi 123 shkolla ishin rrafshuar dhe po kaq të tjera rezultonin të dëmtuara pjesërisht apo të papërshtatshme për zhvillimin e mësimi, pa përmendur mungesën e mjeteve më elementare, mungesën e teksteve e sidomos ato të kuadrove.¹ Problemet që duheshin zgjidhur ishin të shumta dhe natyrisht do të kërkonin një angazhim serioz si të strukturave shtetërore ashtu edhe të të gjithë shtresave të shoqërisë shqiptare.

Në zgjidhjen e tyre dhe sigurimin e progresit të vendit do të ndikonin shumë faktorë: politikë, ekonomikë, socialë etj., por më dominanti do të ishte ai politik. Udhëheqja komuniste me marrjen e plotë të pushtetit politik do ta inkadronte Shqipërinë në radhët e vendeve që zbatuan sistemin socialist totalitar. Deri në rënien e këtij sistemi në fillimin e viteve '90, për afro pesë dekada do të ndërmerren transformimet radikale që përpos të tjerave luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin arsimor të vendit në përgjithësi dhe atij të lartë në veçanti. Dy dekadat e para do të ishin përcaktuese për hedhjen e bazave dhe konsolidimin e tij si një kategori shkollore masive dhe njëherit edhe të orientuar drejt një ideologjie të vetme, atë marksiste-leniniste. Në hedhjen dritë të ecursisë së këtij procesi mendojmë se është me interes një analizë e shkurtër e ndryshimeve të para ku kulmon Reforma Arsimore e vitit 1946.

¹ H. Beqja, "Në themelet e arsimit popullor", Tiranë, 1976, f. 34.

Në përpjekje për të zgjidhur problemet emergjente gjatë dy viteve të para 1945 dhe 1946 me fondet e vëna në dispozicion nga shteti, por edhe kontributin e gjithanshëm të qytetarëve, u meremetuan, u ndërtuan dhe u përshtatën një numër i madh godina shkollorë të cilat u vunë në dispozicion të arsimit. Kjo bëri të mundur që në vitin e parë të pasluftës të hapen rreth 450 shkolla fillore të reja duke e çuar numrin e tyre në 928, të nxënësve në 54 360, dhe mësuesve në 1743. Në vitin shkollor 1945-1946 treguesit do të pësojnë një rritje tjetër duke arritur në 1 097 shkolla, 77 240 nxënës dhe 2 069 mësues².

Angazhimi i organeve shtetërore i masave dhe i organizatave shoqërore ishte i madh, në mënyrë të veçantë i Frontit demokratik si organizata më e gjerë për kohën. Në thirrjen drejtuar vendit në majin e vitit 1946 do të vlerësohej si problem mjaft i rëndësishëm për një zhvillim të shpejtë të arsimit “Të meremetohen dhe të pajisen me orëndi të gjitha shkollat e prishura dhe të dëmtuara, - do të thuhej në të, - e të jenë gati për 1 tetor 1946... Të ndërtohen dhe pajisen me orëndi 400 shkolla të reja...”³

Çështje e mprehtë mbetej ajo e sigurimit të personelit mësimor. “Problemi i arsimit po bëhet preokupim, - thuhej në një informacion të vitit 1945, drejtuar Ministrisë, për arsye se shumë shkollave u mungojnë arsimtarët. Kjo ngjet se nuk ka arsimtarë me diplomë, kur ka shumë elementë me 2-3 ose më shumë klasa të shkollës së mesme që kanë hedhur lutje për mësues”.⁴

Në kushtet e mungesës së mësuesve në radhët e arsimit do të tërhiqen mjaft elementë me shkollë profesionale apo të përfunduar, por që mund të kontribuonin në këtë fushë. Në verën e vitit 1946 do të organizohej gjithashtu një kurs i madh pedagogjik në Tiranë, në të cilin u përgatitën 400 mësues të rinj, përveç 150 mësuesve që përfunduan shkollat pedagogjike duke zbutur deri diku kërkesën për mësues të shkollave fillore që realisht përfaqësonte kategorinë arsimore më masive. Krahas meremetimit, hapjes së shkollave të reja dhe sigurimit të kuadrit mësimor, një problem i rëndësishëm do të ishte ai i ngritjes së nivelit të përgjithshëm të shkollimit të popullsisë e cila në masën kryesore ishte analfabete. Si rrjedhojë e prapambetjes socialo-ekonomike dhe kulturore niveli i analfabetizmit paraqitej mjaft i lartë. Sipas regjistrimit të 30 shtatorit 1945, në numrin e popullsisë prej

² H. Beqja, “Në themelet....”, f. 120.

³ E. Kambo, Arsimi në Shqipëri, fl. 48.

⁴ AQSH, Fondi 14, viti 1945, dos. 149, fl. 1-3.

1122.044 banorësh dinin shkrim e lexim përafërsisht vetëm 210 634 ose 17,78 % e saj. Numri i analfabetëve arrinte në 81, 22 % të popullsisë⁵.

Siç është theksuar nga studiues të kësaj fushe "... zgjidhja efikase e këtij problemi përbënte një sfidë të fortë për të ardhmen dhe njëherit një investim me rrjedhoja pozitive për rritjen e shkallës së përgjithshme të arsimit të popullsisë" dhe se "... interesat e individit për këtë çështje shkonin në kahje të njëjta me ato të shtetit, pavarësisht nga natyra e këtij të fundit". Kjo i jepte shpjegim edhe faktit që "masat e ndërmarra qoftë ligjore apo administrative u mirëpritën dhe u përkrahën nga shtresat e popullsisë, veçanërisht nga intelektualët që shpresonin në progresin demokratik të vendit"⁶.

Krahas shkollimit të rregullt si forma kryesore e aplikuar që në periudhën e luftës do të ishin kurset e shpejta që morën përhapje të gjera në fshat dhe qytet. Sipas të dhënave të vitit 1945 do të funksiononin në të gjithë vendin 566, kurse me 10 243 pjesëmarrës prej të cilëve 30 % ishin femra⁷. Në hapjen dhe mbarëvajtjen e kurseve një rol të rëndësishëm do të luanin mësuesit, por edhe shumë të rinj të cilët do t'i përgjigjeshin thirrjeve të bëra në shtypin e kohës për të kontribuar në likuidimin e kësaj plage të rëndë shoqërore. "Është detyrë e edukatorëve, - do të thuhej në një thirrje të tillë, - që t'i përvishen punës duke u mobilizuar vullnetarisht për të hapur kurse të rriturish në çdo vend të Shqipërisë, ku gjenden shkolla fillore"⁸.

Nga qershori i vitit 1946 brenda Ministrisë së Arsimit do të krijohet një strukturë e veçantë, Drejtoria e Arsimit Jashtëshkollor, e cila merrej me arsimin e të rriturve, detyra kryesore e të cilës ishte lufta kundër analfabetizmit. Në këtë periudhë ajo do të ishte ende një veprimtari shoqërore me baza vullnetare. Më tej lufta për çrrënjosjen e analfabetizmit do të merrte përmasa të gjera dhe kthehej në një veprimtari të organizuar shtetërore. Gjithsesi, zhvillimet e para ishin të rëndësishme dhe ndihmuan në futjen në rrugën e zgjidhjes së këtij problemi në vitet e mëvonshme duke ndikuar pozitivisht në procesin e arsimit të popullsisë. Krahas masave të para për masivizimin e shkollës nga opinioni publik, filluan të rrihen e të publikohen në shtyp mendime e pikëpamje të ndryshme, rreth të ardhmes së saj. Për rreth 2 vjet, u zhvilluan debate publike rreth rrugës së re të zhvillimit arsimor

⁵ Po aty, Fondi 511, viti 1947, dos. 6, f. 2.

⁶ E. Kambo, Arsimi në Shqipëri... f. 59.

⁷ Gazeta "Bashkimi", datë 30 mars 1946.

⁸ Po aty, 5 qershor 1946.

dhe politikave në këtë fushë. Kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e këtij debati dha revista “Shkolla e Re”, ku u angazhuan me përkushtim profesional shumë arsimtarë e intelektualë të njohur të arsimit e të pedagogjisë shqiptare.

Ata do të mbështetnin idenë që shkolla duhej të kthehej në një çerdhe e propagandës së kulturës e të qytetërimit. “Askush nuk mund të pretendojë se shkolla jonë e re, - do të thuhej në një artikull të saj - ka gjetur brenda një kohë kaq të shkurtër udhën e vërtetë që duhet të ndjekë”⁹. Në funksion të objektivave politike, PKSH-ja qysh në nëntor 1945, në forumet e veta të larta, do të hidhte piketat e përgjithshme mbi natyrën konceptuale të shkollës së re, ku krahas detyrave emergjente të luftës kundër analfabetizmit, do të shtronte nevojën e orientimit të rinisë në studimin e degëve të prodhimit. Ajo do t’i kundërvihej këtij opinionit dhe do ta konsideronte demagogji parimin bazë të shkollës demokratike mbi karakterin apolitik të saj dhe se nëpërmjet tij nuk bëhej gjë tjetër veçse realizoheshin interesat e borgjezisë dhe të klasave shfrytëzuese. Diskutimet e opinionit arsimor të vendit lidhur me ardhmërinë e shkollës do të ishin të shumta dhe do të preknin aspekte të ndryshme të saj. Pavarësisht thellësisë, njëanshmërisë dhe herë-herë edhe paqartësive, produkt ky edhe i situatave të kohës kur ato u shtruan, në thelb shprehnin një të vërtetë të pamohueshme që personalitete të arsimit por edhe mësues të thjeshtë “ishin të interesuar për ndryshime në emër të krijimit të një shkolle të avancuar të konceptuar gjithnjë brenda kuadrit të një shkolle borgjeze të demokratizuar”¹⁰.

Procesin e demokratizimit të arsimit, PKSH-ja do ta shihte në këndvështrimin e saj. Në kushtet e Shqipërisë së prapambetjes dhe përkundrejt ambicies të kësaj të fundit për një zhvillim të shpejtë të vendit në rrugën e një ekonomie të centralizuar socialiste, zgjerimi i arsimit do të ishte një nga prioritetet e politikës së saj. Por, si Parti Komuniste ajo do të luftonte për përmbushjen e misionit të saj historik, të shndërrimit të shkollës në institucionin kryesor për edukimin komunist të brezit të ri dhe më gjerë të të gjithë shoqërisë. Në këtë kuptim sistemi arsimor, përmbajtja e shkollës e gjithë veprimtaria e saj do të vihej në funksion të ndërtimit të shoqërisë socialiste duke u mbështetur fuqishëm në një ideologji të vetme atë marksiste-

⁹ Revista “Shkolla e re”, viti 1945, nr. 1, f. 4-5.

¹⁰ Eriketa Kambo, Arsimi në Shqipëri, f. 30.

leniniste¹¹. Politikat e saj arsimore PKSH-ja i bëri edhe më të qarta në Plenumin V të mbajtur në shkurt të vitit 1946. Vendimet e këtij plenumi u bënë bazë për Reformën e parë Arsimore në vendit tonë. Plenumi përcaktoi në vija të përgjithshme detyrat më emergjente në fushën e arsimit, si, luftën kundër analfabetizmit, rindërtimin dhe shtimin e numrit të shkollave, përgatitjen e kuadrove arsimore, tërheqjen e sa më shumë vajzave, krijimin e kushteve për arsimin pa shkëputje nga puna, përgatitjen e gjithë infrastrukturës për hartimin e Reformës Arsimore, përgatitjen e programeve dhe të teksteve të reja¹².

Për reformimin e gjithë sistemit arsimor e ndërtimin e një sistemi të ri, shteti do të ndërmernte masa për përgatitjen e një kuadri të gjerë ligjor. Siç dihet në marsin e vitit 1946 do të hartohej Kushtetuta e parë e pasluftës. Sipas saj shteti merrte në mbrojtje ligjore të gjithë fëmijët nën moshën e pjekurisë. Detyra e tij ishte t'i pajiste me njohuri të përgjithshme shkencore dhe t'u krijonte kushtet të gjithë shtetasve për të ndjekur shkollën, pavarësisht nga seksi, krahina a bindjet fetare, politike dhe ideologjike. Në nenet e saj sanksionohej karakteri laik i cili kufizoi në maksimum të drejtat për arsimimin privat të fëmijëve. Ndonëse nuk e ndaloj atë direkt, indirekt kërkoi kontrollin e plotë të shtetit mbi shkollat private dhe çeljen e tyre veçse me ligj¹³.

Në funksion të këtij legjislacioni fillestar, shteti komunist krijoi disa struktura më të specializuara për ndjekjen e problemeve arsimore, por edhe për përgatitjen e reformës në këtë fushë. Kështu, me vendim të qeverisë, në prill 1946 u ngrit pranë Ministrisë së Arsimit Këshilli i Përgjithshëm Arsimor. Në përbërje të tij merrnin pjesë 60 mësues dhe ekspert të arsimit si dhe një komision ekspertësh pedagogjikë¹⁴. Ky organ kryente funksione këshillimore dhe dha një ndihmesë të madhe në përgatitjen e kriterëve të Reformës Arsimore. Mbi bazën e këtyre masave paraprake, më 17 gusht të vitit 1946, doli ligji mbi Reformën Arsimore në Shqipëri. Kjo reformë i jepte sistemit arsimor përmasa të reja dhe një karakter demokratik, shtetëror, laik dhe njësor. Duke anashkaluar disa probleme në fushën e politizimit e ideologjizimit të përmbajtjes së shkollës, mund të thuhet se në disa aspekte, Reforma manifestoi disa tregues të rëndësishëm demokratik. Mjafton të përmendim faktin që ajo eliminoi çdo lloj diskriminimi social, racor,

¹¹ Po aty.

¹² PPSH, Dokumente kryesore, vëll. I, Tiranë, 1971, f. 346.

¹³ Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, mars 1946.

¹⁴ AQSH, F. 1011, viti 1946, dos. 32, Qarkore Nr. 675/27, datë 04. 04.1946.

gjinor e fetar, me të drejtën e arsimimit të qytetarit, sidomos të fëmijëve, të drejta këto që i mundësoi nëpërmjet aplikimit të detyrimit shkollor ligjor për arsimin fillor, monopolit të shtetit dhe dhënien e arsimit falas. Nga ana tjetër, shtroi nevojën e masivizimit dhe shtrirjes së tij në të gjithë territorin e vendit, përfshi dhe skajet më të largëta.

Reforma sanksiononte karakterin unik të sistemit arsimor dhe shkurttoi afatin e tij nga 13 në 11 vjet, duke bërë më të larmishëm sistemin arsimor parauniversitar. Reforma i hapi rrugën ndërkohë jo vetëm krijimit të një shkolle demokratike që do të realizonte arsimimin masiv të popullsisë, por edhe edukimit me ideologjinë socialiste, në përputhje me vetë rendin e vendosur pas lufte në Shqipëri. Në funksion të kësaj do të ndryshohej dora-dorës i gjithë dokumentacioni, planet, programet dhe tekstet mësimore të të gjitha kategorive. Synimet politike të saj do të kundërshtohen nga një pjesë e intelektualëve madje edhe nga radhët e deputetëve të Kuvendit Popullor. Si do të përmendej edhe në tekstin “Historia e Popullit Shqiptar” (botim i vitit 2007), pikëpamja e tyre në thelb ishte “... që të mos ndiqej një politikë arsimore e njëanshme që shkolla të mos politizohej dhe nxënësit të mos merrnin vetëm njohuri marksiste. Zëdhënës i këtyre pikëpamjeve u bë deputeti Shefqet Beja, kundërshtari i hapur i vijës së PKSH-së dhe i programit të qeverisë”¹⁵. Një pikëpamje e tillë e goditur me ashpërsi që në embrion fliste për faktin se shteti ishte i vendosur të ndryshonte para së gjithash përmbajtjen e shkollës, duke ia përshtatur qëllimeve politike të PKSH-së.

Si edhe është konkluduar edhe nga studiues të tjerë, sipas ligjit të Reformës, sistemi i ri arsimor, rrokte tre fusha kryesore: sistemin e edukimit parashkollor, atë shkollor me të gjitha hallkat duke nënkuptuar edhe ngritjen shpejt edhe të arsimit të lartë si pjesë integrale e tij dhe së fundi sistemin jashtëshkollor të arsimit dhe edukimit. Reforma do t’i hapte rrugën zgjerimit dhe konsolidimit të kategorive më kryesore të arsimit. Në këtë fazë të zhvillimit arsimor, kategoria bazë mbetej arsimi fillor. Krahës rëndësisë që ajo i jepte karakteri i detyrueshëm do të rregullohej me një ligj të veçantë po të 17 gushtit 1946, atë mbi “Arsimin fillor të detyrueshëm”. Mbi bazën e tij arsimi fillor ishte i detyrueshëm për fëmijët nga mosha 7-14 vjeç dhe jepej falas për të gjithë. Ai realizohej në shkollat fillore të çelura nga shteti në të gjithë vendin dhe përfshinte si do të thuhej që në nenin e tij të parë, “.....të gjithë djemtë dhe vajzat prej moshës 7 vjeç.

¹⁵ Historia e Popullit Shqiptar, Toena: Tiranë 2007, fl. 219.

Në lidhje me këtë, në vjeshtën e vitit 1946 duhet të shkojnë në shkollat fillore dhe të gjithë fëmijët në moshën 8, 9, 10 vjeç që gjer më sot nuk kanë mësuar në shkollë...”¹⁶. Për të shmangur vështirësitë për zbatimin e tij, ligji parashikonte sanksione detyruese për prindërit, kujdestarët apo institucionet nën kujdesin e të cilëve ishin fëmijët e moshës shkollore. Ky ligj bashkë me atë të Reformës do të kontribuonin për konsolidimin e kësaj kategorie arsimore mbi bazën e të cilave do të ngriheshin dhe ecnin ato më të larta, arsimi unik ose 7-vjeçar, ai i mesëm dhe deri ai i lartë.

Në kuadrin e Reformës do të sanksionohej në nenet e saj, një vend të rëndësishëm do t’i jepej zhvillimit të arsimit të mesëm e sidomos atij profesional. Ky i fundit do të ishte një nga burimet e rëndësishme të sigurimit të një numri të madh teknikësh aq të nevojshëm për zhvillimin ekonomik të një vendi të shkatërruar që dilte nga lufta dhe aspironte për një progres të shpejtë.

Në ligjin e Reformës do të thuhej se: “Krijohet arsimi profesional që ka për qëllim të përgatisë kuadro të mësuar mirë për degët e ndryshme të jetës ekonomike, shoqërore e kulturore të vendit. Ministria e Arsimit drejton dhe kontribuon zhvillimin e arsimit profesional në bashkëpunim me ministritë e tjera në bazë të një sistemi me shkolla teknike e pedagogjike 4-vjeçare, shkolla praktike profesionale 2-vjeçare, shkolla perfeksionimi të zëjtarisë 2-vjeçare dhe kurse të shpejta 6-12 muaj”¹⁷.

Pjesë e sistemit të ri i mishëruar në ligjin e Reformës do të ishte edhe krijimi i arsimit për të rritur. Në kushtet e Shqipërisë ku pjesa më e madhe e popullsisë ishte analfabete apo me nivel të ulët shkollor hedhja e bazave të një sistemi të rregullt për të gjithë ata që nuk kishin mundësi të ndiqnin shkollat e ditës, merrte një rëndësi të veçantë. Krijimi apo zhvillimi i një sistemi të plotë arsimor, me hallkat e tij themelore i hapte rrugën shkollimit masiv të gjeneratave të reja dhe rriste shanset për një progres të shpejtë të vendit.

Vendi, roli dhe rrjedhojat që ajo solli në ecurinë e shkollës shqiptare nga literatura historike e para dhe pas viteve 90-të janë parë nga këndvështrime të ndryshme. Pavarësisht dallimeve ajo çka bihet dakord duke konverguar në një mendim të përbashkët, është fakti që kjo reformë u hapi rrugën si shndërrimeve demokratike ashtu

¹⁶ Gazeta zyrtare e RPSH-së, nr. 85, 10 shtator 1946, Ligji nr. 282 “Mbi arsimin fillor të detyruar”, datë 17 gusht 1946.

¹⁷ Po aty, Ligji nr. 281, “Mbi Reformën Arsimore”, datë 17 gusht 1946.

edhe atyre socialiste dhe se ajo me të drejtë mund të konsiderohet si pikënisja e të gjitha ndryshimeve që përjetoi shkolla shqiptare e pasluftës së Dytë Botërore.

Lidhur me këtë reformë një çështje mjaft e debatueshme, që ka tërhequr mjaft historianë sidomos gjatë viteve të fundit, ka qenë problemi i raporteve që ajo vendosi lidhur me mësimin e fesë në Shqipëri. Në këtë drejtim duhen ndarë mirë dy gjëra. *E para* është se shteti shpalli karakterin laik të shkollës, d.m.th. aplikoi parimin e ndarjes së plotë të shkollës nga feja. Në thelbin e vet, ky përbënë një parim demokratik, i njohur dhe i zbatuar në shumë vende të qytetëruara.

Aspekti i dytë, që lidhej me vetë natyrën e shtetit komunist ishin masat për kufizimin dhe, mandej, ndalimin *de facto* të arsimit fetar dhe së bashku me të më vonë edhe të asgjësimit të institucioneve të besimit. Në këtë aspekt duhet hedhur më shumë dritë nga studimet tona historike dhe duhet adresuar një kritikë mjaft e fortë dhe e argumentuar historiografike ndaj literaturës historike të para viteve '90. Ndarja kategorike e shkollës nga kisha dhe nga feja, si për çdo vend edhe për Shqipërinë, përbënë një nevojë urgjente dhe një hap të madh përpara në zhvillimin e vendit. Por, laiciteti i shkollës dhe arsimimi fetar janë dy gjëra të ndryshme që me dashje janë konfrontuar nga kjo literaturë, e cila justifikonte politikën zyrtare antifetare të shtetit komunist, duke lënë të kuptohet se qëndrimi i saj ndaj mësimin të fesë nisej jo nga pozita ateiste, por nga politika laike e progresive, d.m.th. demokratike¹⁸.

Indoktrinimi politik i shkollës shfaqet qartë qysh në fillimet e aplikimit të Reformës. Në një qarkore publike të Ministrisë së Arsimit për këtë reformë do të thuhet tekstualisht: "...është parashikuar që brezi i ri të rritet dhe të edukohet në bazë të parimeve të Luftës Nacionalçlirimtare" dhe se mësimi i fesë përbënë një pengesë serioze për ngulitjen e këtyre parimeve¹⁹. Gradualisht më vonë do të ndërmerreshin akte ligjore e normative, që çuan në ndalimin e shkollave private fetare dhe në vendosjen e një represioni shtetëror ndaj arsimit jopublik sidomos ndaj arsimit fetar. Nonsenset demokratike të reformës arsimore u bënë më të theksuara nga propaganda zyrtare. Duhet thënë se thelbin e ekzistencës e të jetëgjatësisë së vet e gjeti tek propaganda, më saktë tek demagogjia propagandistike. Ishte pikërisht kjo propagandë që vlerat emancipuese e përparimtare të reformës i deklaronte vend e pavend, duke i lidhur vetëm me vijën politike, me meritat e PKSH-së.

¹⁸ Histori e Shqipërisë, vëll. IV, f. 82, Tiranë 1984.

¹⁹ AQSH, Fondi 511, viti 1946, Qarkore, nr. 480/2, 19.11.1946.

Kështu, për shembull, edhe pse vet ligji i reformës nuk kushtëzonte të drejtën e arsimit të fëmijëve me përkatësitë apo origjinat politike e fetare të familjeve të tyre, shtypi zyrtar e trajtonte vend e pa vend karakterin klasor të edukatës arsimore të mëshiruar në këtë reformë. Dhe kjo bëhej, sipas tij, për të provuar epërsitë arsimore që krijonte sistemi i ri socialist në krahasim me sistemin klasik demokratik. Kështu ai trumbetonte me të madhe se tashmë arsimi ishte bërë një armë në duart e klasës punëtore (më vonë të partisë) e të fshatarëve dhe se ajo tashmë “eliminonte” monopolin e shfrytëzimit të borgjezisë ndaj tyre.²⁰

Intensiteti i propagandës komuniste mbi nevojën e forcimit të luftës së klasave në arsim e në shkolla erdhi vazhdimisht duke u forcuar, në përputhje me vështirësitë në rritje dhe të kërkesave emancipuese të shoqërisë shqiptare. Ishte më se e qartë se vështirësitë buronin jo vetëm nga varfëria e skajshme arsimore e kulturore, jo vetëm nga kriza e rëndë ekonomike dhe shkatërrimet e jashtëzakonshme të luftës, jo vetëm nga paaftësia e shtetit për të ushtruar me kompetencë pushtet dhe qeverisje cilësore, por edhe nga prirjet konservatore patriarkale që mbanin të ngërthyer ndërgjegjen arsimore të një pjese të qytetarëve. Po t’i shtohet kësaj edhe mungesa e kuadrit arsimor, bëhej edhe më e qartë tabloja dhe kostoja që duhet të përballonte shoqëria shqiptare në kryerjen dhe përballimin e kësaj reforme.

I gjithë opinioni shoqëror, mësues dhe intelektualë u angazhuan për kryerjen e kësaj reforme duke shpresuar në efektet pozitive të saj për ecurinë e shkollës. Preokupimi themelor i tyre ishte kontributi me ide, platforma e mendime në favor të zgjidhjes arsimore. Nisur nga këto qëllime, intelektualë, mësues dhe të tjerë, shpejtuan të shfaqnin në shtypin e kohës mendime kritike (mendime ndryshe) rreth forcimit të karakterit demokratik të përmbajtjes së reformës. Disa prej tyre mundën të japin ndihmesë duke përfituar edhe nga fakti që ende nuk ishin konsoliduar pozitave diktatoriale të shtetit komunist, si edhe të shtypit zyrtar. Por mendimi i lirë do të luftohej me të gjitha format e mënyrat nga udhëheqja komuniste e vendit, e cila me forcimin e pozitave të saj politike do ta mbyste dhe asfiksonte.

²⁰ Gazeta “Bashkimi”, shtator 1946.

Çlirim DURO

SUMMARY

THE EDUCATIONAL REFORM OF 1946 IN ALBANIA

Historically, the development of education and teaching, from antiquity until nowadays, is treated as an issue of priority. Without doubt, the event of teaching and education, has been, and remains, among the irreplaceable elements of communication between people and the emancipation of any society. Education serves the nation, so any progress in this area is welcome. The Albanian school and education after the Second World War, was important because it was put to a historically established tradition.

Part of it was the attempt to develop writing and the Albanian school, which had become a powerful tool of the national awakening. In the long-term of the national development strategy of the outstanding people from the Albanian Renaissance, the ideas will be pick up and the first lines will be outlined, to build a platform for the creation of a “comprehensive teaching”, set in the encyclopedic work of the erudite Sami Frashëri "Albania what was, what it is and what it shall become."

In the multitude of inherent factors acting on the Albanian post-war society, unequivocally the most dominant was the political will. After the communist leadership took over full political power, Albania was incorporated among the countries that implemented a socialist system. For nearly five decades, until the collapse of the system in the '90s, Albanian schools will undergo radical changes. The first decade will be decisive for laying the groundwork and consolidation of the pre-university education, as one of the important categories of the education system, for its shaping into a school oriented towards a single ideology, that Marxist-Leninist.

Mrika LIMANI

**NJË ANALIZË KUANTITATIVE E VIKTIMAVE TË
PRIZRENIT DHE RRETHINËS GJATË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE, SIPAS LISTËS SË VIKTIMAVE TË LUFTËS,
LËSHUAR NGA KËSHILLI EKZEKUTIV FEDERAL I
JUGOSLLAVISË (PJESA E DYTË)**

Në vazhde të analizës së paraqitur paraprakisht,¹ analiza e plotësuar është kryer duke u bazuar në fletushkat zyrtare të viktimave të Jugosllavisë të lëshuara nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë. Si pasojë, fletushkat për rrethinën e Prizrenit përmbajnë të dhënat mbi viktimat që kanë qenë qytetarë të regjistruar në komunën e Prizrenit, cilësi në bazë të cilës edhe janë regjistruar si viktima në rrethinën e Prizrenit. Ngaqë kjo ka qenë kriteri i seleksionimit për regjistrimin e viktimave, vendvdekja e një numri të konsiderueshëm të viktimave ka qenë jashtë kufijve të Kosovës. Megjithatë, me seleksionimin e të dhënave, analizës kuantitative i janë nënshtruar të gjithë viktimat e regjistruara në Prizren pavarësisht vendvdekjes, posaçërisht në analizën statistikore për grupmoshat dhe kombësitë. Në anën tjetër, në analizën e shpërndarjes së dhunës janë marrë parasysh vetëm viktimat, vendvdekja e të cilëve është brenda territorit të Kosovës. Si rezultat i kësaj analize, punimit do t'i bashkëngjitet një aneks me harta relevante që ilustrojnë shpërndarjen e dhunës në territorin e Kosovës gjatë periudhës prill 1941-maj 1945.

¹ Vazhdim i punimit Mrika Limani, "Një analizë kuantitative e viktimave të Prizrenit dhe rrethinës gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas listës së viktimave të luftës, lëshuar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë," *Kosova*, no. 40 (2015): 245-56.

Me përmbylljen e leximit dhe regjistrimit të viktimave të fletushkave që janë në dispozicion, analizës i janë shtuar edhe 78 viktima të cilët nuk kanë qenë të regjistruar në analizën paraprake në mungesë të mundësive adekuate për seleksionimin e të dhënave. Regjistrimi i një numri shtesë të viktimave përforcon disa përfundime të analizës paraprake, por ndryshon disa të tjera në mënyrë më të theksuar sesa që është pritur, të dhëna këto që do të shtjellohen në vijim.

Në sondazhin e përpiluar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë janë regjistruar 1.1 milion viktima në tërë ish-Jugosllavinë, 597 000 prej të cilëve janë të vdekur. Sondazhi përmban 11 kategori të viktimave, që variojnë nga viktimat të vrarë në kampe, burgje, përgjatë deportimit, punë të dhunshme ose gjatë terrorit direkt (me ç'rast nënkuptohen masakrat ose dhuna me qëllim), deri të spektri i viktimave të cilët kanë rënë në luftime, përfshi dhe dy kategori "të tjera" dhe "të panjohur".²

Gjithashtu, duhet vënë sërish në theks se analiza e paraqitur në këtë punim i qëndron besnike referencave gjeografike në bazë të organizimit administrativ të Prefekturës së Prizrenit ashtu siç ishte instaluar në gusht të vitit 1941. Prefektura e Prizrenit brenda territoreve nën administrim përfshinte 4 nënprefektura me 38 komuna me një sipërfaqe prej 3 090 km² ku banonin rreth 230 000 banorë. Nënprefekuratat të cilat përfshiheshin brenda prefekturës së Prizrenit ishin ajo e Gjakovës, Suharekës, Rahovecit dhe e Dragashit.³ Për më tepër, analiza është plotësisht e bazuar në të dhëna arkivore të cilat qëndrojnë të pasuplementuara nga studimet historike për periudhën dhe çështjen, në mënyrë që t'i qëndrojë besnike përfundimeve të cilat janë nxjerrë papërgjashtim nga shifrat zyrtare të viktimave të ish-Jugosllavisë. Si e tillë, është e kufizuar brenda margjinave të natyrës statistikore, në bazë të së cilës analizë kuantitative, synohet të ilustrohen mekanizmat e dhunës me aq të dhëna burimore dhe të vërtetueshme sa ishin në dispozicion. Numri i plotë i viktimave që janë klasifikuar dhe përfshirë në analizë është 203 nga numri i plotë i fletushkave 311. Në analizën paraprake janë përfshirë 124 viktima të vdekur, ndërkaq në këtë pjesë të analizës numrit të viktimave i janë shtuar edhe 78, duke e ngritur numrin e viktimave të vdekura në Prizren gjatë luftës në 203.

² Tomislav Dulić, "Utopias of Nation : Local Mass Killing in Bosnia and Herzegovina, 1941-42" (Uppsala Universitet, 2005), 47.

³ Muhamet Shatri, "Prizreni dhe rrethina në Lëvizjen Nacional Çlirimtare (1941-1945)" (Dissertation, Universiteti i Kosovës, Fakulteti Filozofik, 1981), 110-11.

Të dhëna statistikore në bazë të grupmohave dhe kombësisë së viktimave

Të dhënat e reja të përfshira në analizë në mënyrë statistikore kanë konfirmuar pohimet e analizës së mëparshme sa i përket viktimave në bazë të grupmohës së tyre, në atë që pjesa dërmuese e viktimave i kanë përkitur grupmohës 1915-1930, që kanë qenë në moshë të përshtatshme për mobilizim ushtarak gjatë kohës kur kanë rënë, që në mënyrë indirekte e ndërlihd vdekjen e tyre me aksion ushtarak, ose targetim selektiv, si pasojë e mundësisë potenciale për veprimtari ushtarake.⁴

Në anën tjetër, çështja e kombësisë në kontekst të Luftës së Dytë Botërore në nivel lokal në Kosovë merr karakter tejet interesant. Lufta në Kosovë nga definicioni ushtarako-politik mund të nënvizohet si luftë civile, ndërkaq luftën vetvetiu mund ta ndajmë në disa faza. Faza e parë, i përket luftës pasive asimetrike ose guerile në kontekst lokal gjatë pushtimit italian. Meqë administrata italiane kishte kontroll më të pakët në territorin e Kosovë që kishte nën administrim, zgjerimi i luftës ideologjike nga ana e komunistëve - me theks të veçantë tek shqiptarët - mori hov ritmik. Është për këtë arsye pse Malësia e Gjakovës duket të ketë shërbyer si pikë e shkëlqyeshme gjeografike për shtab të partizanëve, njëkohësisht duke i ofruar qasje më të lehtë me luftëtarët guerilë shqiptarë në Shqipëri. Është periudha e viteve 1941-1943 që shënon fazat e definicionit të luftës guerile brenda suazave ideologjike dhe etnike. Mëdyshja që lind në këtë pikë i përket diskursit të hapur historik, edhe pse parimisht pranohet se lufta e nisur nga partizanët kishte karakter ideologjik së pari, e së dyti karakter nacional. Në këtë kontekst është edhe i kuptueshëm fakti që masat shqiptare në Kosovë kishin rezerva më të theksuara në raport me përfshirjen e tyre në këtë luftë⁵, posaçërisht krahas atyre serbe të cilat me gatishmëri dhe numër më të madh iu bashkëngjitën PKJ-së, këshillave nacionalçlirimtare në Kosovë e përfundimisht njësiteve partizane. Nuk është deri në fund të 1943 kur lufta e partizanëve shqiptarë të Kosovës definon karakterin kombëtar me Konferencën e Bujanit. Këto të dhëna duhet të merren

⁴ Mrika Limani, "Një analizë kuantitative e viktimave të Prizrenit dhe rrethinës gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas listës së viktimave të luftës, lëshuar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë," *Kosova*, no. 40 (2015): 249.

⁵ Hubert Neuirth, *Widerstand Und Kollaboration in Albanien 1939-1944* (Wiesbaden: Harrassowitz, 2008), 142.

parasysh në analizën statistikore të mëposhtme, ku numri më i madh i viktimave i përkasin kombësisë serbe, numër që pasohet nga viktimat e kombësisë shqiptare.

Pjesa që ndryshon në mënyrë drastike në këtë analizë të kompletuar krahas asaj së parës, është pikërisht sa i përket përqindjeve të kombësisë së viktimave. Edhe pse përfundimi i punimit paraprak rezultoi që viktimat i përkisnin kombësisë serbe në përqindje më të madhe⁶, rezultatet e analizës së shtuar e vlerësojnë këtë përqindje të jetë në mazhorancë absolute, gjegjësisht në 51.7%.⁷ Te të gjitha viktimat e regjistruara serbe nuk ekziston ndonjë periudhë karakteristike ku rënia e tyre kishte qenë më e shpeshtë - përkundrazi kombësive të tjera, viktimat e kombësisë serbe kishin rënë në mënyrë të vazhdueshme prej prillit të 1941 deri në maj të 1945.

Kjo statistikë është shumë e rëndësishme sepse dëfton që serbët ishin të përfshirë në luftë që nga fillimi dhe në të gjitha cilësitë - edhe si ushtarë, edhe si civilë. Një karakteristikë tjetër që dallohet nga statistikat, edhe pse nuk sjellë ndonjë risi historike, kallëzon që numri më i madh i viktimave serbe kishin rënë në cilësinë e formacioneve të LNÇ-së apo formacioneve bashkëpunuese, që e forcon argumentin e pakontestuar që serbët ishin simpatizantë më në numër të PKJ-së. Për të ilustruar këtë laramani cilësish në të cilat janë targetuar viktimat, e marrim shembullin e Dragolub Popoviqit⁸, një mësues nga Prizreni, i cili ishte marrë rob nga italianët që po tërhiqeshin nga Kosova në shtator të 1943. Viktimën e kanë ekzekutuar në Avio, Itali. Në anën tjetër, ka edhe viktima civile që nuk kanë pasur ndonjë lidhshmëri politike dhe si të tillë në fletushka janë të regjistruar si viktima civile.⁹ Karakteristikë

⁶ Limani, "Një analizë kuantitative e viktimave të Prizrenit dhe rrethinës gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas listës së viktimave të luftës, lëshuar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë" 150-51.

⁷ Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë (më tej *AIHP*), F. Regjistrimi i viktimave..., M 3, M 4, M 6, M 7, M 10, M 11, M 12, M 13, M 14, M 15, M 16, M 17, M 18, M 19, M 20, M 22, M 29, M 32, M 34, M 35, M 36, M 49, M 51, M 52, M 63, M 64, M 70, M 71, M 74, M 75, M 76, M 81, M 82, M 86, M 88, M 93, M 99, M 100, M 101, M 103, M 104, M 105, M 106, M 107, M 108, M 109, M 110, M 111, M 112, M 113, M 115, M 116, M 119, M 120, M 121, M 122, M 124, M 128, M 134, M 135, M 136, M 137, M 138, M 139, M 140, M 141, M 142, M 143, M 144, M 145, M 146, M 149, M150, M 151, M 153, M 155, M 156, M 157, M 158, M 159, M 161, M 177, M 217, M 218, M 219, M 220, M2 75, M 276, M 277, M 279, M 287, M 289, M 299, M 292, M 293, M 294, , 295, M 297, M 299, 300, M 301, M 307, M 303, M 304, M 305.

⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 4.

⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 6, M 7, M 12, M 18, M 19, M 20, M 22, M 29,

specifike që vërehet nga fletushkat janë viktimat e regjistruara me kategorinë e dhunës 9, si të rënë të LNÇ-së dhe formacioneve aleate.¹⁰ Se çfarë specifikisht nënkuptohet me këto formacione aleate është pak e megjullt, por nga emrat e viktimave të regjistruara në këtë kategori dallohet se shumica janë të kombësisë serbe. Nëse kanë qenë të armatosur dhe nëse kanë pasur uniformë nuk dihet, dhe andaj për përkatësinë e tyre ushtarake mund vetëm të spekulohet. Evidente është që nuk ekziston asnjë viktimitë e regjistruar si pjesëtar i njësiteve partizane nën kategorinë 7, që shënon në mënyrë eksplicite viktimat e formacioneve të LNÇ-së, por në kategorinë 9, që nënkupton viktimat e formacioneve të LNÇ-së dhe atyre aleate. Kjo gjë flet ose për pamundësinë e Këshillit për të verifikuar anësinë ushtarake/politike të viktimës, ose për qëllimin e fryrjes së numrit të viktimave të LNÇ-së qofshin viktimat të ndërlihdura apo jo me këtë të fundit.

Edhe pse në numër dukshëm më të vogël krahas atyre partizane, viktimat e kombësisë serbe i janë nënshtruar dhunës edhe në cilësi të civilëve.¹¹ Karakteristikë për këtë element është fakti që viktimat civile serbe duket të kenë rënë ekskluzivisht gjatë tri viteve të para të luftës, 1941-1943, kur edhe ushtarët shqiptarë të afilacioneve të ndryshme politike e ushtarake kishin pushtet më të theksuar në Kosovë.¹² Posaçërisht karakteristik është rasti i Mladen Stanjeviq, në fletushkën e të cilit figuron se kishte qenë i burgosur në Tiranë (01.04.1941-15.09.1941), Peqin (15.09.1941-20.9.1942), Fier (20.9.1942-8.8.1943) dhe në fund në Burrel (8.8.1943-12.10.1943), ku shkruan ta kenë ekzekutuar uniformat fashiste dhe balliste.¹³ Sa i përket viktimave të kombësisë shqiptare¹⁴, edhe këtu i dallojmë viktimat të cilët kanë rënë

M 32, M 49, M 70, M 75, M 86, M 93, M 106, M 111, M 134, M 275, M 276, M 277, M 279, M 287, M 293, M 295 (i vrarë në Kolashin), M 303,

¹⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 11, M 35, M 36, M 51, M 63, M 64, M 76, M 103, M 105, M 112, M 115, M 116, M 121, M 135, M 137, M 138, M 140 (i vrarë në Drenicë në shkurt të 1945), M 141, M 142, M 143, M 144, M 149, M 153, M 156.

¹¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 6, M 7, M 10, M 12, M 18, M 19, M 20, M 22, M 29, M 32, M 49, M 70, M 75, M 86, M 93, M 111, M 134, M 275, M 276, M 277, M 287, M 293, M 295, M 299, M 303.

¹² Me përjashtim të njërit i cili ishte vrarë në nëntor të 1944 në Mitrovicë, AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 75.

¹³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 287.

¹⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 1, M 2, M 5, M 8, M 9, M 21, M 23, M 24, M 25, M 26, M 27, M 28, M 30, M 31, M 33, M 37, M 38, M 40, M 45, M 46, M 47, M 48, M 50, M 53, M 56, M 57, M 58, M 59, M 60, M 61, M 62, M 65, M 66, M 67, M 68, M 69, M 72, M 73, M 77, M 79, M 80, M 83, M 84, M 85, M 94, M 97, M 98

në cilësinë e ushtarëve të LNÇ-së dhe formacioneve aleate,¹⁵ mirëpo, as afërsisht në proporcione të ngjashme me viktimat serbe të LNÇ. Një numër tjetër i viktimave kanë rënë në cilësinë e civilëve, në dhunë të drejtpërdrejtë (kategoria 5)¹⁶ ose në kategorinë luftime dhe bombardime (10).¹⁷ Të tjerët kanë rënë në cilësi të civilëve me punë të dhunshme, deportim dhe burg.

Tejet karakteristike për viktimat e kombësisë shqiptarë është fakti që fletushkat nuk kanë regjistruar asnjë shqiptar të Prizrenit të ketë rënë në vitin 1942. Një numër i konsiderueshëm kanë rënë më 1941, posaçërisht në prill, ku numri i viktimave ishte rritur gradualisht nga 1943 për të arritur apeksin në shkurt-maj 1945. Prej të gjitha kombësive të analizës, ajo malazeze është më karakteristika deri më tash.¹⁸ Përkundër viktimave serbe dhe shqiptare, viktimat malazeze duket të kenë rënë në mënyrë ekskluzive në cilësi të ushtarëve të armatosur. Për më tepër, viktimat malazeze kanë rënë në periudha shumë specifike - posaçërisht në pika luftimi - që dëfton shumë për përfshirjen e malazezëve në luftë në Kosovë. Së pari, kjo flet për pjesëmarrjen e tyre si partizanë kryesisht në luftën e Kosovës, por flet posaçërisht për përfshirjen e tyre në luftimet në Drenicë në shkurt e maj të 1945.¹⁹ Në anën tjetër, është edhe një fluks relativ i viktimave malazeze në Andrijevicë të Malit të Zi në maj të 1945 të cilët janë regjistruara nën kategorinë 11 të dhunës, që nënkupton “të tjera”, gjë kjo e cila jep pak kontekst për mënyrën se si kanë rënë këto viktimat.²⁰ Pjesa tjetër e viktimave malazeze në mënyrë proporcionale kanë rënë ose përmes dhunës (kategoria 5) si civilë, partizanë (kategoria 9) ose internim (kategoria 1).

(kombësia e shënuar gabim), M 114, M 152, M 154, M 286 (kombësia e shënuar gabim), M 288, M 290, M 298, M 306, M 307.

¹⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 24, M 28, M 31, M 33, M 38, M 40, M 53, M 56, M 57, M 58, M 59, M 61, M 62, M 65, M 67, M 68, M 69, M 73, M 79, M 85, M 97, M 114, M 152, M 154, M 306.

¹⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 1, M 2, M 5, M 8, M 9, M 23, M 27, M 30, M 83, M 84.

¹⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 47, M 60, M 77, M 78, M 80.

¹⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 41, M 42, M 43, M 44, M 55, M 91, M 95, M 126, M 127, M 129, M 130, M 131, M 132, M 133, M 147, M 148, M 178, M 214, M 215, M 231, M 272, M 273, M 274, M 278, M 283, M 284, M 285.

¹⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 41, M 42, M 44.

²⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 129, M 130, M 131.

Në analizën përfundimtare të viktimave të Luftës së Dytë Botërore në Prizren kanë rezultuar këto përqindje të viktimave në bazë të kombësisë: serbe 51.7%, shqiptare 27.5%, malazeze 13.7%, turke 2.4%²¹, hebre 1.6%²² dhe kroat vetëm një viktimë²³.

Dinamika dhe shpërndarja gjeografike e dhunës gjatë viteve 1941-1945

Vitet 1941 dhe 1942 paraqesin variacione shumë interesante të zhvillimit të luftës. Edhe pse analiza paraprake kishte sugjeruar që viti 1942 kishte qenë më pak i dhunshëm²⁴ në krahasim me të tjerat, sipas të dhënave të reja të regjistruara, vërehet një dinamikë tjetër e luftës. Në vitin 1941 muaji prill ishte më i dhunshmi. Kjo nuk është aspak e çuditshme duke e pasur parasysh okupimin e Jugosllavisë nga forcat e Aksit. Përkundër këtij muaji, viti 1941 duket kryesisht i qetë, me dhunë sporadike në gusht²⁵ dhe tetor²⁶. Përkundër rezultateve nga analiza e mëparshme, viti 1942 është ai që dëfton për një ndryshim të theksueshëm në zhvillimin e akterëve të ri me peshë për luftën. Fillimi i mobilizimit të partizanëve përkon me rritjen e dhunës në pika të caktuara. Fillimisht, meqë partizanët operonin në vise malore dhe posaçërisht pranë kufirit me Shqipërinë - luftë për të cilën e adoptojmë definicionin e Fearon ku e quan *insurgjencë periferiale*²⁷ - në vitin 1942 dhuna na shfaqet më së shumti në këto terrene. Edhe pse viktima të regjistruara ka në janar dhe mars të 1942,²⁸ që është plotësisht e pritshme kur marrim parasysh aksionet e aradhës “Zenel Hajdini”, është pikërisht prilli i 1942 ai që bie në sy me viktima më të shumta.²⁹ Duke analizuar vendvdekjen e viktimave, na bie në sy që viktima me mbiemër

²¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 39, M 54, M 96, M 216, M 239.

²² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 87, 89, 90.

²³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 123.

²⁴ Limani, “Një analizë kuantitative e viktimave të Prizrenit dhe rrethinës gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas listës së viktimave të luftës, lëshuar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë,” 253.

²⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 275, M 277.

²⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 10.

²⁷ James Fearon, “Why Do Some Civil Wars Last so Much Longer than Others?,” *Peace Research Abstracts* 41, no. 6 (2004): 277.

²⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M. 283, M. 106, M. 148

²⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M. 106, M. 109, M. 132, M 147, M. 219, M. 239.

Rakoviq (emri i palexueshëm)³⁰, paskësh rënë në Kolashin, në cilësinë e viktimës numër 9 dhe tipin e dhunës numër 2. Nga analiza e mëparshme shpjeguar se këto tipe të viktimës dhe dhunës përkojnë me LNÇ dhe formacione aleate (9), respektivisht i rënë në luftime (2). Një dilemë interesante na paraqitet te ky rast, meqë gjatë periudhës në fjalë, të dhënat historike nuk bëjnë të ditur për ndonjë aktivitet të formacioneve të LNÇ-së, e aq më pak në territorin e Kolashinit. Ajo çfarë dihet për këtë territor, dhe posaçërisht periudhën në fjalë, është se Kolashini ishte qendër veprimore e Aradhës Çetnike të Kollashinit.³¹ Regjistrimi i viktimës si luftëtar i LNÇ-së dhe formacioneve aleate shtron një çështje të rëndësishme për diskutim: saktësinë, por edhe subjektivitetin, e regjistrave.

Mes pasaktësisë së të dhënave që janë shtypur, gjithnjë duhet pasur parasysh që një dukuri e tillë e burimeve të njëanshme është tejet e zakonit për luftërat civile.³² Në diskurs më të gjerë historik, edhe lufta të cilën po e trajtojmë këtu në shumë raste i përket definicionit të luftës civile, siç u definua më sipër. Në këtë kontekst, nuk është e habitshme që të dhënat mund të jenë edhe të shtrembëruara.³³ Kur vijnë në diskutim luftërat civile, definicioni i dhënë nga Fearon se “luftërat civile paraqesin një medium për t’i zgjedhur konfliktet të çfarëdo natyre, nga cilido grup, përmes dhunës” përputhet plotësisht si maksimum me konfliktin që po trajtojmë këtu. Përgjatë të gjitha fazave të zhvillimit të luftës gjithherë vihet re dhuna në përmasë të vogël në nivel lokal që ekzekutohet në krah të xhandarmërisë së caktuar shqiptare, apo njërive serbe çetnike, të cilat në botëkuptim më të gjerë nuk i kanë shërbyer luftës ideologjike totale botërore.

Pjesa e dytë e vitit 1942 ishte relativisht paqësore, me viktima të regjistruara në shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor.³⁴ Një paraqitje graduale e dhunës në fund të vitit 1942 mund të interpretohet si prelud e dhunës që pasoi në 1943. Viti 1943 paraqet periudhën kur dhuna fillon të

³⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M. 147.

³¹ Izber Hoti, *Forcat e armatosura në Kosovë 1941-1945* (Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 1998), 112.

³² Stathis N. Kalyvas, “The Ontology of ‘Political Violence’: Action and Identity in Civil Wars”, *Perspectives on Politics* 1, no. 3 (2003): 475-76.

³³ Këtu e marrim për të mirëqenë vëzhgimin se lufta në studim nuk është binare - në kuptimin që ndasitë nuk janë vetëm klasore, etnike apo politike. Në fakt, është pikërisht kjo natyrë shumështrësore që e karakterizon Luftën e Dytë Botërore në Kosovë, specifikisht më atë se konflikti buroi nga kombinimi i të gjitha ndasive.

³⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M. 96, M. 34, M. 111, M. 100, M. 101.

shpeshtohet në kontekst kohor, ku ajo është e pranishme në të gjithë muajt e vitit.³⁵ Kjo është tejet karakteristike sepse flet për zgjerimin e luftës në nivel lokal nga të gjithë akterët e përfshirë në luftë. Nga të dhënat e fletushkave, shihet që viktimat e janarit të 1943 janë regjistruar në kategorinë 9, që i bie ushtarë të LNÇ-së dhe formacioneve aleate³⁶, që flet për prezencën e dhunës ushtarake në rrethinë të Prizrenit - dhe si pasojë zgjerimin e aktivitetit të LNÇ-së në këtë vend. Përkundër kësaj, në shkurt viktimat kanë rënë në cilësi të civilëve (kategoria 5), që flet për nisjen e reprezaljeve nga pushtuesit si pasojë e rritjes së dhunës nga partizanët.³⁷ Ky trend kishte vazhduar edhe në prill të 1943³⁸ dhe maj të atij viti³⁹.

Viktimat e qershorit ishin të karakterit politiko-ushtarak⁴⁰, sakaq viktimat e korrikut kishin rënë në cilësi të civilëve⁴¹ me përjashtim të njërit⁴². Gushti i vitit 1943 cilësohet gjithashtu me viktima civile⁴³, njëjtë si shtatori⁴⁴ me përjashtim të njërit i cili ka rënë në Kuçevë si luftëtar⁴⁵ dhe tetori me një viktima civile⁴⁶. Nëntori i vitit 1943 ishte më i dhunshmi. Përkundër muajve paraprakë, nëntori kishte shënuar edhe viktima civile⁴⁷ por edhe të rënë në cilësi të LNÇ-së dhe formacioneve aleate⁴⁸. Karakteristikë e viktimave të këtij muaj është se shumica kishin rënë në Prizren dhe ishin kombësi serbë. Edhe në dhjetor viktimat ishin civile.⁴⁹ Dinamika e dhunës lokale në 1943 është karakteristike, sepse paraqet dinamikën e dhunës të ushtruar ndaj civilëve, po edhe dinamikën e dhunës në kontekst ushtarak. Çka bie në sy më së shumti

³⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 3, M 4, M 11, M 13, M 18, M 25, M 29, M 32, M 49, M 53, M 70, M 71, M 83, M 84, M 88, M 92, M 93, M 94, M 99, M 102, M 103, M 104, M 105, M 112, M 115, M 116, M 118, M 121, M 123, M 126, M 127, M 134, M 161, M 215, M 217, M 279, M 284, M 287, M 290, M 293, M 295, M 299, M 303, M 306.

³⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 103, M 105, M 215, M 290.

³⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 29, M 93.

³⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 94, M 116, M 161, M 301.

³⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 18, M 217.

⁴⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 13, M 127.

⁴¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 3, M 25, M 84, M 118, M 123, M 134.

⁴² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 115.

⁴³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 102, M 284, M 295.

⁴⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 4, M 83, M 88, M 126, M 279,

⁴⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 112.

⁴⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 303.

⁴⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave... M 32, M 49, M 71, M 99, M 287, M 299.

⁴⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 53, M 121, M 306.

⁴⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 11, M 70, M 293.

është paraqitja më e madhe e viktimave civile pas regjistrimit të dhunës në kontekst ushtarak, që shpjegon ndërldhshmërinë mes të dyjave në kuptimin që sa herë kishin nisur aksion partizanët, pushtetarët iu kishin hakmarrë në civilë, mbase në mungesë të të dhënave adekuate për të targetuar në mënyrë selektive.

Të dhënat shtesë e konfirmojnë pjesërisht përfundimin paraprak se viti 1944 ishte më i dhunshmi gjatë luftës.⁵⁰ Të dhënat e reja që janë përfshirë në analizë dëftojnë se në fakt viti 1943, edhe pse me numër më të vogël të viktimave, ishte po aq i dhunshëm sa viti 1944 sa i përket përqendrimit të dhunës. Fillimi i vitit 1944 gjithashtu ishte shumë i dhunshëm. Janari shënon kombinim të viktimave civile dhe ushtarake,⁵¹ ndërkaq shkurti shënon plotësisht viktima që kanë rënë në cilësi ushtarake.⁵² Marsi⁵³ dhe prilli që pasuan,⁵⁴ shënuan dy dhe respektivisht një viktima, të rënë si civilë. Maji i vitit 1944 është karakteristik, ngaqë përpos viktimave të rënë në cilësi ushtarake⁵⁵, ka edhe viktima të rënë në cilësi civile nga bombardimet e aleatëve⁵⁶, dhe dy të tjerë si civilë të vdekur nga puna e dhunshme⁵⁷.

Këto të dhëna tregojnë se intensifikimi i ofanzivave kundër forcave pushtuese, rezultoi me reaksion nga këto të fundit ndaj civilëve, ose atyre që dyshonin se kishin lidhje me forcat e partizane. E njëjta natyrë e dhunës ishte prezente edhe në qershor të 1944, ku tre viktimat ishin të rënë përmes dhunës së drejtpërdrejtë në cilësi të civilëve.⁵⁸ Ndërkaq, në korrik të 1944 nuk ishte regjistruar dhunë. Gushti, në anën tjetër, është përplot viktima që kanë vdekur ose në burg⁵⁹ ose në dhunë të drejtpërdrejtë si civilë⁶⁰. Këtë dhunë të ekzekutuar ndaj civilëve pa ndonjë aksion paraprak partizan që do të nxiste këtë reagim e shohim si tipik për vitin 1944, ku edhe njësitet lokale progjermane kontribuan dukshëm në ushtrimin e dhunës. Çka është më tepër karakteristike për

⁵⁰ Limani, "Një analizë kuantitative e viktimave të Prizrenit dhe rrethinës gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas listës së viktimave të luftës, lëshuar nga Këshilli Ekzekutiv Federal i Jugosllavisë," 254.

⁵¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 91, M 107, M 146, M 153, M 157, M 218.

⁵² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 31, M 142, M 178.

⁵³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 124, M 231.

⁵⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 119.

⁵⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 74,

⁵⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 77, M 78, M 80.

⁵⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 139, M 289.

⁵⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 55, M 297, M 305.

⁵⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 54, M 72, M 216.

⁶⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 6, M 7.

gushtin e 1944, është mungesa e të dhënave të cilat flasin për ekzekutimin publik e 10 aktivistëve të LNÇ-së në Prizren, që i thekson edhe më tutje mangësitë e regjistrave të Këshillit Ekzekutiv.⁶¹ Në shtator aktiviteti i partizanëve kthehet sërish, ku ka dy viktima të LNÇ-së⁶² dhe katër të tjera civile⁶³, dinamikë kjo që flet për intensifikimin e luftës guerile. Në tetor regjistrohet fluksi më i madh i dhunës gjatë 1944, që flet për dhunë të dy anshme - të partizanëve dhe të pushtuesve.

Megjithatë, dhuna më e madhe është shkaktuar ndaj atyre që janë targetuar në baza politike (si simpatizantë të PKJ-së apo LNÇ-së).⁶⁴ Në rrjedhë të ngjarjeve, fluktuacionet e tilla të dhunës janë shumë të logjikshme - duke marrë në konsideratë lëvizjet e forcave ushtarake në vend, gjegjësisht tërheqjen e trupave gjermane. Duke qenë që trupat u tërhoqën nga Dukagjini gradualisht para se të tërhiqen nga pjesët tjera të Kosovës, është evidente që dhuna ka qenë më e spikatur në këtë regjion. Për këtë arsye, nëntori në vijim ishte më i pakët me viktima në këtë pjesë, por me më shumë viktima partizane,⁶⁵ - ngaqë një pjesë e forcave veç më ishin tërhequr e kishin depërtuar në pjesën veriore dhe verilindore të Kosovës. Pothuajse të ngjashme janë variacionet civilo-ushtarake në viktimat e dhjetorit të 1944⁶⁶, por këtu vërehet dorasi të ketë qenë i ndryshëm nga pushtuesit e mëparshëm, që do të thotë se, lufta në këtë pikë merr karakter tipik të luftës civile.

Në janar të 1945, shumica dërmuese e viktimave të regjistruara janë të kategorisë 9 (LNÇ dhe formacione aleate)⁶⁷, të cilët kanë rënë në mënyrë sekuenciale në Rrafshin e Kosovës, posaçërisht Drenicë. Të dhënat kuantitative të përdorura në këtë analizë e konfirmojnë se më 1945 filloi lufta për vendosjen e plotë të pushtetit në Kosovë, tentativë e cila hasi në kundërshtim në Rrafsh të Kosovës, përkundër Dukagjinit ku partizanët kishin vendosur pushtet në mënyrë sistematike më herët. E njëjta dinamikë është evidente edhe në shkurt⁶⁸ dhe mars⁶⁹ të 1945, ku

⁶¹ Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945* (Rilindja, 1971), 330.

⁶² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 28, M 108, M 177.

⁶³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 20, M 86, M 272, M 273, M 304.

⁶⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 38, M 59, M 60, M 85, M 110, M 133, M 136, M 156, M 286, M 288, M 300, M 307.

⁶⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 33, M 68, M 75, M 79, M 113.

⁶⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 58, M 73, M 98, M 114, M 294, M 302.

⁶⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 36, M 37, M 44, M 82, M 149, M 152, M 154M N 274M N 285.

⁶⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 26, M 35, M 41, M 42, M 65, M 81, M 140, M 141.

⁶⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 57, M 61, M 62, M 63.

të fundit dëftojnë për luftim në trekëndëshin Mitrovicë-Stan Tërg-Trepçë. Në po të njëjtin regjion duket të kenë ndodhur edhe luftimet e prillit të 1945, të paktën siç interpretohet nga viktimat e regjistruara në Prizren, të cilët në shumicë gjithashtu janë të regjistruar si LNÇ e formacione aleate⁷⁰, tri viktimat hebraike që janë përmendur edhe në analizën paraprake⁷¹, dhe dy të vrarë në luftime (pa anësim politik të specifikuar).⁷² Lufta përmbillet me variacion të ngjashëm viktimash në maj të 1945, të gjithë duke qenë me anësim të partizanëve.⁷³

Meqë fletushkat në fjalë kanë për bazë viktimat të cilat kanë qenë të regjistruar me prejardhje nga Prizreni dhe rrethina, është e natyrshme që numerikisht viktimat të jenë më shumë në regjionin e Prizrenit.⁷⁴ Megjithatë, viktimat të cilët kanë luftuar për LNÇ janë të pranishëm në të gjithë territorin e Kosovës. Në Prizren më së shumti viktimat kanë rënë në vitin 1941, pikërisht në Luftën e Prillit kur Ushtria Jugosllave po mbronte ofanzivën gjermano-italiane, ndërkaq pothuajse po aq viktimat kanë rënë në vitin 1945, kur partizanët po luftonin për vendosje të pushtetit. Ky ndryshim i ushtrimit të dhunës dëfton për një qetësi relative në Prizren gjatë pushtimit italian dhe gjerman si pasojë e bashkëpunimit më të gatshëm në nivel qendror me gjermanët e italianët, dhe mangësi e aktivitetit të partizanëve, gjë që ndryshon drastikisht kur këta të fundit luftojnë për pushtet në 1945. Në rajonin e Dukagjinit, fluksin më të madh të dhunës e shohim në vitet 1943-1944, me përjashtim të Suharekës⁷⁵, Damjanit⁷⁶, Zhurit⁷⁷, Vlashnjës⁷⁸ dhe Dragashit,⁷⁹ ku dhuna është e regjistruar në vitin 1941 duke qenë që luftimet e Ushtrisë së Jugosllavisë ishin kryer në atë aks. Në Gjakovë fluksin më të madh të dhunës e hasim në 1944⁸⁰ gjatë periudhës kur partizanët po forcoheshin në numër dhe armatim. Në Pejë⁸¹ dhe Istog⁸²,

⁷⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 56, M 64, M 69, M 144.

⁷¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 87, M 89, M 93.

⁷² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 150, M 151.

⁷³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 40, M 66, M 67, M 129, M 130, M 131, M 137, M 138, M 143.

⁷⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 1, M 8, M 9, M 17, M 26, M 29, M 30, M 32, M 35, M 48, M 51, M 52, M 53, M 62, M 82, M 83, M 85, M 86.

⁷⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 5.

⁷⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 22.

⁷⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 47.

⁷⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 46.

⁷⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 21.

⁸⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 80, M 20, M 38, M 77, M 78.

⁸¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 43, M 81.

në anën tjetër, kemi një fluks viktimash në 1945 (posaçërisht atyre partizane), që flet për përleshjet për vendosje të pushtetit nga ana e partizanëve. Në Dukagjin shohim dhunë edhe në fshatra malore si Gllareva⁸³ dhe Leshani⁸⁴. Në Rrafshin e Kosovës dhuna është më tepër e përhapur gjatë viteve 1944-1945, me përjashtim të Mitrovicës ku dhuna është regjistruar që nga viti 1942⁸⁵. Te Ferizaj gjithashtu paraqitet dhuna, aty madje shënohet vrasja e anëtarëve të PKJ-së që nga 1941.⁸⁶ Edhe në Prishtinë dhuna është shfaqur në mënyrë selektive ndaj anëtarëve të PKJ-së prej 1943 deri 1945.⁸⁷ Dinamika më karakteristike e dhunës është ajo e shfaqur në Drenicë dhe Runik. Te e para në mënyrë ekskluzive dhuna shfaqet në fund të 1944 dhe 1945, edhe atë të regjistruara janë vetëm viktimat partizane.⁸⁸ Në Runik, me përjashtim të njërit që ka rënë në 1943⁸⁹ të tjerët gjithashtu kanë rënë gjatë përleshjeve me grupet lokale shqiptare në 1945⁹⁰, njëjtë si në Vushtri⁹¹, Stan Tërg⁹², dhe Trepçë⁹³.

Nga të dhënat e parashtuara e shohim dinamikën e dhunës në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore, që njëkohësisht flet edhe për ngritjen e luftës së partizanëve dhe vendosjen e pushtetit. Analiza ka ilustruar dinamika interesante të dhunës të cilat flasin në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe për ndërlidhshmërinë e saj me politikën në nivel qendror. Në të njëjtën kohë, analiza gjithashtu ka vënë në pah edhe ushtrimin e dhunës në bazë të ndasive etnike dhe jo vetëm politike. Mbi të gjitha, analiza ka vërtetuar që qendrat urbane shërbyen si pika të kontrolluara pothuajse plotësisht nga italianët dhe gjermanët, përkundër qendrave rurale, të cilat shërbyen për grumbullimin dhe zhvillimin e akterve guerilë, gjë që dëshmohet edhe nga paraqitja sporadike e

⁸² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 67, M 154.

⁸³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 88.

⁸⁴ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 105.

⁸⁵ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 34, M 25, M 61, M 71, M 75.

⁸⁶ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 45, M 50 dhe një viktimë në qershor të 1944, M 55.

⁸⁷ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 40, M 54, M 84, M 6.

⁸⁸ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 28, M 31, M 36, M 39, M 41, M 42, M 44, M 63, M 64, M 69, M 140, M 141, M 142.

⁸⁹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 84.

⁹⁰ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 36, M 39, M 41, M 42, M 44, M 63, M 64, M 69, M 140, M 141, M 142.



⁹¹ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 66.

⁹² AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 56.

⁹³ AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 57.


luftimeve guerile në viset malore. Në fund, sipas të dhënave bazë, na është vërtetuar që më së shumti viktimat me anësim politik marksist kanë qenë të kombësisë serbe.

Aneks – shpërndarja e dhunës në regjionin e Kosovës (1941-1945)



⁹⁴ Në Prizren AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 1, M 8, M 9, M17, M 26, M 29, M 30, M 32, M 35, M 48, M 51, M52, M 57, M 62, M 82, M 83, M 85, M 86, në Dragash M 21, në Vlashnje M 46, M 59, në Zhur M 47, Në Krushë të Vogël M 9, në Rahovec M 70, në Suharekë M 5, M 7.

⁹⁵ Dhuna në Pejë AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 43, M 81, dhuna në Gjakovë M 80, M 20, M 38, M 77, M 78, dhuna në Dëcan M 37, dhuna në Istog M 67, M 154, dhuna në Lubinjë (pjesa e poshtme ana e djathtë e hartës) M 105.



⁹⁶ Dhuna në Mitrovicë AIHP, F. Regjistrimi i viktimave..., M 25, M 34, M 61, M 71, M 75, dhuna në Drenicë dhe Runik, M 28, M 31, M 36, M 39, M 41, M 42, M 44, M 63, M 64, M 69, M 140, M 141, M 142, M 74, M 76, M 139, M 144, M 289. Dhuna në Prishtinë, M 40, M 54, M 84, M 6, dhuna në Vushtri M 66. E pailustruar dhuna në Stan Tërg M 56, dhuna në Kolashin M 147. ,M 295. Dhuna në Trepçë M 57.

Mrika LIMANI

SUMMARY

A QUANTITATIVE ANALYSIS OF PRIZREN AND SURROUNDING VICTIMS DURING WORLD WAR II, ACCORDING TO THE LIST OF THE VICTIMS OF WAR ISSUED BY THE FEDERAL EXECUTIVE COUNCIL OF YUGOSLAVIA (PART TWO)

The World War II in Kosovo was hailed as civil war, and the conflict served for committing violence on political and ethnic grounds. As a result of divisions and enmities at the local level, violence was exercised improperly besides targeting of civilian casualties in particular as regards the period during Italian administration, while violence was exercised selectively to civilian casualties depending on the hint of partiality of their political affiliation during the administration of the Germans. In the meantime, liberties and the gaps of authority in rural areas, served primarily as an opportunity for violence against civilians under ethnic selection of the victims, interethnic conflict preceded the Second World War, and secondly the gaps of power served in certain rural areas for the development of the partisan guerrilla movement.

Although in the beginning of the war, the latter had no power or no activity highlighted in Kosovo, over time they grew stronger which is observed in the presentation of the sequential flows of violence in the areas where they were active, either as victims or as cause of violence. Finally, the analysis illustrates that the war in Kosovo during 1941-1945 served as a battle ground for ideological warfare, political and finally as inter-ethnic at the local level.

Sabile KEÇMEZI-BASHA

**DOKUMENTE TË RËNDËSISHME TË LËVIZJES
REVOLUCIONARE PËR BASHKIMIN E
SHQIPTARËVE, 1964**

Lidhja Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878, u dha shqiptarëve programin kombëtar për ruajtjen e tërësisë tokësore të atdheut dhe bashkimin kombëtar, kërkesat që përbënin themelin e programeve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në vijim. Ato mbetën të tilla edhe në përpjekjet e mëvonshme për liri dhe shtetëformim që vazhduan si të tilla edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore po ashtu edhe pas përfundimit të saj që u përfshinë në programet e lëvizjes ilegale të shqiptarëve që mbetën nën pushtimin jugosllav.¹ Në vazhden e shumë organizimeve ilegale atdhetare, duhet përmendur se në vitin 1963, në Kosovë formohet edhe një organizatë tjetër atdhetare me emrin, "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", e udhëhequr nga atdhetari i njohur Adem Demaçi.²

Mendoj se ky organizim ilegal në kuptimin e plotë të fjalës e meriton që të quhej lëvizje, ngase si në aspektin vertikal po ashtu edhe në atë horizontale i plotësonte të gjitha kriteret që e karakterizojnë një lëvizje politike. Sepse, nën: 1. LRBSH-ja ishte organizata më e njohur e kohës që kishte ndikim të pamohueshëm dhe programin e saj e kishin miratuar dhe përvetësuar edhe disa organizata ilegale më pak të njohura; 2. Numri i anëtarëve ishte i konsiderueshëm ngase pas formimit të komiteteve të qyteteve të LRBSH-së në Prishtinë, në Mitrovicë, në Pejë,

¹ Sabile Keçmezi-Basha, "Lëvizja ilegale Kombëtare në Kosovë (1945-1999)", Kosova, *Instituti i Historisë*, 40/ 2015.

² Sabile Keçmezi-Basha, *Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945-1990.*, Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logosi- A, 2010, 21.

në Gjakovë, në Gjilan, në Shkup dhe në Stamboll, parashihej që të vazhdohej me formimin edhe të komiteteve të tjera më të vogla; 3. *Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve* për një kohë të shkurtër do të ketë programin politik të saj po ashtu edhe Statutin, dhe, kjo bëri që LRBSH-ja të jetë një lëvizje që i karakterizonin të gjitha lëvizjet e mëdha. Andaj, si imperativ i kohës ishte shtruar domosdoshmëria që të shkruhej Statuti dhe Programi i Lëvizjes. Pas konsultimeve paraprake të kryetarit të LRBSH-së, me anëtarët e tjerë të Komitetit Revolucionar në nivel të vendit, fillojnë përgatitjet që t'i hyhet kësaj pune me shumë interes. Për t'i ikur përcjelljes nga Sigurimit Shtetëror Jugosllav dhe UDB-ja, u propozua që të shkohet në Pejë. Kryetari i Lëvizjes, Adem Demaçi, në bashkëpunim me Ramadan Shalën bëjnë përpilimin e dokumenteve.³

E veçanta e këtij programi ishte se kishte dy pika kryesore në të cilat prezantohet karakteri i luftës së kësaj lëvizjeje ishte me: 1. Karakter të bashkimit kombëtar; dhe, 2. Karakter të çlirimit kombëtar. Por, në katër pika të tjera ishte përfshirë plotësimi i kushteve themelore, që po ashtu kishin vazhdimësinë nga kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si:

“ 1. Me qenë i bashkuem territorialisht;
2. Me pas një treg të përbashkët ekonomik;
3. Me pas një gjuhë të përbashkët letrare;
4. Me qenë i përshkuam nga ndjenjat e dashurisë, përkatësisë dhe solidaritetit reciprok vëllazëror”.⁴

Programi politik i LRBSH-së veç që ka rëndësi historike, duhet shtuar se ai kishte vizion gjë që edhe sot ka rëndësi aty-këtu aktuale. Në hyrje të programit, lidhur me luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar thuhej, se: “Ndihma nga jashtë dhe nga naltë asht e Ramadan Shala domosdoshme, por jo kurrsesi themelore, kryesore e vendimtare; kushtet e jashtme fitojnë rëndësinë e vet, vetëm kur ato kombinohen me kushtet e brendshme dhe kur veprojnë si faktorë ndihmës dhe plotësues të tyre”.⁵ Prandaj, në program, Lëvizja do t'i kushtojë më shumë rëndësi analizimit dhe përpunimit të faktorëve, të kushteve e rrethanave të brendshme, por, pa i lanë krejtësisht mënjanë edhe faktorët, kushtet e rrethanat e jashtme. Mjafton të kujtojmë luftën e fundit të UÇK-së dhe

³ Hakif Bajrami, *Dosja Demaçi*, Prishtinë: Brezi 81, 2003, 73.

⁴ Programi i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, 1964, Gjykata e Qarkut, Prishtinë.

⁵ Po aty.

të bindemi se sa të drejt kishin hartuesit e programit kur shkruajmë për kombinimet dhe bashkëpunimin e ndërsjellë të faktorit ndërkombëtar dhe faktorit të brendshëm. Kjo do të thotë se çështja e zgjidhjes së statusit të Kosovës është vendimtare nga vetë rreshtimi i popullit dhe nga veprimi politik në kuadër të tij”.⁶

Që në fillim të Programit të LRBSH-së bëhet një analizë e përbërjes së popullsisë shqiptare në Kosovë, duke konstatuar se rreth 75% e numrit të përgjithshëm të popullsisë e përbënë fshatarësia, punësoria rreth 10%, pjesën tjetër të popullsisë e përbëjnë zanatlinjtë, kurse vetëm rreth 1% e përbën inteligjenca. Në Program, një vëmendje e veçantë i kushtohet inteligjencës, për të cilën thuhet: “Kjo për kah numri nuk kap ma shumë se 1% të popullsisë sonë, por ndërgjegjja dhe vetëdija e saj kombëtare - në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë - asht në shkallën ma të lartë, pjekuria e saj politike ka marrë zhvillim të madh brenda kësaj shtrese. Duhet theksua se inteligjenca e popullit tanë, dallohet për një arsye prej inteligjencies së mëparshme, sepse kjo nuk ka rrjedhë dhe nuk rrjedh prej familjeve t’agallarëve e bejlerëve, por kryesisht prej shtresave të gjana katundare, punëtore e prej zejtarëve, prandaj prej radhëve të tyre ka ma së paku - në krahasim me numrin e tyre - bashkëpunëtor me aneksuesit tanë, prandaj, prej radhëve të tyre ka ma së paku asish të cilët janë në gjendje me shitë interesin e përgjithshëm të mbar popullit për interesin e vet personal”.⁷ Në program shkruan edhe kjo: “Megjithatë në mes të kësaj inteligjencie të re bëjnë pjesë edhe t’atillë /sidomos ata që janë shkollua shkel e shko me favorizime e intervenime/, të cilët, në një ditë - edhe ata - ka me i gjet ajo që i ka gjet të gjithë tradhtarët e popujve të vet kudo që kanë qenë te ne dhe në botë”.⁸ Është interesante se të gjithë “intelektualët” që kanë arritur pa merita dhe pa punën e tyre hartuesi i programit politik i quan dhe i krahason me tradhtarë.

Pastaj vazhdon në program, se: “Me këtë rast duhet me e thanë pa mëdyshje se ata intelektualë të cilët u bishtnojnë dhe u shmangen detyrimeve që ua shtron përpara historia, janë në pakicë, kurse shumica e intelektualëve të ndershëm, atdhetarë e revolucionarë, janë vu në veprim qysh tash dhe po punojnë me mish e shpirt për ta qua matej

⁶ Ethem Çeku, *Shekulli i ilegales: proceset gjyqësore kundër ilegales në Kosovë: dokumente*, Prishtinë: Brezi 81, 2004, 155-156.

⁷ Programi i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, 1964, Gjykata e Qarkut, Prishtinë.

⁸ Hakif Bajrami, *Dosia Demaçi*, Prishtinë: Brezi 81, 2003, 93.

fitoren e popullit tanë, për ta bashkua mbarë popullin, tash, të ndamë e të shpërndamë. Ngritja kulturo-arsimore e inteligjencies shqiptare, pjekuria e saj mjaft e madhe politike asht, duhet dhe do të jetë një fener i domosdoshëm dhe shpëtimtar, për të ndriçua ma mirë e ma me mjeshtri rrugën e luftës së mbar popullit tanë drejt majave të çlirimit dhe bashkimit të tij përfundimtar”.⁹ Për të vazhduar në program “Në qoftë se inteligjencia jonë do të marri mbi vete matanë energjinë dhe forcat e veta, rolin e tharmit në lëvizjen tanë, për çlirim e bashkim, ajo do ta kryej ma së miri detyrën si para vetvetes, si para popullit të vet, ashtu edhe para historisë”¹⁰ - thuhej në program.

Programi i *Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve* është një dokument tepër i rëndësishëm në të cilin bëhen analiza detale, veç e veç, për rrethanat në tokat e okupuara shqiptare nën administrimin jugosllav, për Shqipërinë dhe për vetë Jugosllavinë. Kështu, në kapitullin e Programit të LRBSH-së “Analiza konkrete e situatës konkrete brenda nesh”, fokusohet në:

- a) Vështrimin e gjendjes politike;
- b) Vështrimin e gjendjes ekonomike;
- c) Vështrimin e gjendjes kulturore-arsimore; dhe,
- d) Vështrimin e gjendjes sociale-shëndetësore.¹¹

Por, në programin e LRBSH-së rëndësi e veçantë i kushtohet strategjisë së popullit shqiptar, në të cilën prezantohen tri pikëpamje për të arritur deri te bashkimi kombëtar:

a) Pikëpamja e parë ose pikëpamja arsimore, paraqitet dhe shihet si zgjidhje, arsimimi i popullatës shqiptare dhe komentohet në këtë mënyrë: “Neve mundet me na shpëtua vetëm arsimi; kur të nxjerrim mjaft njerëz të arsimuar na do të mundemi me zanë edhe vendet kyçe si në udhëheqjet politike, ekonomike etj., e prej këndej kemi me e pas fare të lehtë me e zgjidhë edhe çështjen e bashkimit tonë”. Për të vazhdua se: “Na nuk duhet të bëjmë asgjë kundër armikut, sepse ky mund të hidhërohet e të marri masa kundër nesh, të burgosi persona të ndryshëm, të përjashtojë arsimtarë nga detyra e kjo shkon në damë tonin, sepse na mbesin shkollat pa arsimtarë, entet e sipërmarrjet pa drejtues shqiptarë¹² etj.”

⁹ Po aty, 94.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Selatin Novosella, *Demaçi, Lëvizja për Bashkim*, 1. Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2012, 273.

¹² Po aty.

b) Pikëpamja e dytë është e kundërta e kësaj të parës, ose pikëpamja revolucionare- aventuriste, e cila ka për bazë luftën e përgjithshme popullore, ku thuhej, se: “Na duhet të ngrihemi të gjithë, t’i dalim armikut ballë për ballë dhe të luftojmë me ta për jetë ose vdekje. Lufta jonë duhet të jetë e vrullshme, e ashpër dhe e shkurtë - sa zgjatë një pranverë e një verë - na ose do të fitojmë shpejt ose në qoftë se lufta do të zgjas shumë na nuk mund të mundemi me fitua, do të të humbim”.

Në programin politik paraqitet edhe pikëpamja e tretë e që është edhe pikëpamja programore e lëvizjes me të cilën nuk pajtohen as me të parën e as me të dytën plotësisht “por prej të dy pikëpamjeve mund të marrim dhe ato çka janë të vlefshme e pozitive për të formua strategjinë tonë. Arsimimi dhe shkollimi i popullit asht një ndihmë kolosale, një forcë dhe përkrahje e paçmueshme, por na do të kënaqemi vetëm tue arsimua dhe shkollua popullin tanë pa i dhanë kësaj force një drejtim të caktuar, pa e përdorë për arritjen e një qëllimi të caktuar, kjo forcë do të mbetet qorre. Ndërsa, tek pikëpamja e dytë mendojmë se asht me vend mendimi se lufta jonë ka me qenë me të vërtetë e vrullshme dhe e ashpër është konkludim me vend”.¹³ Dhe në qoftë se dikush prej nesh, ose edhe të gjithë ne, mendojmë se lufta jonë ka me qenë e gjatë, ne duhet të përgatitemi për luftë të gjatë.

1. Lufta jonë ka me qenë e gjatë edhe për arsye se për fitoren e saj të sigurt dhe të plotë duhen plotësua edhe shumë kushte të brendshme dhe të jashtme.

2. Lufta jonë duhet të përfshijë në gjirin e vetë të gjitha shtresat dhe mbar popullin tonë.

3. Lufta jonë duhet të zhvillohet në pajtim me kushtet e rrethanat të cilat mbretërojnë brenda popullit tonë, në pajtim me kushtet e rrethanat të cilat mbretërojnë në Shqipëri, në pajtim me kushtet e rrethanat që mbretërojnë brenda aksionistëve tanë si dhe në pajtim me kushtet e rrethanat të cilat mbretërojnë në tërë botën e sotshme.

4. Lufta jonë duhet - kryesisht - të mbështetet në forcat tona të brendshme, kurse ndihmat që mund të na ofrohen nga jashtë mund të jenë vetëm si faktorë plotësues dhe ndihmës.¹⁴

¹³ Selatin Novosella, *Adem Demaçi në Gjykimin e dytë-1964*, Prishtinë, 2016, 263, SHBPK.

¹⁴ Dokumente të rëndësishme nga Dosja Demaçi, Gjykata e Qarkut Aktgjykimi, K. nr. 271/64.

Në qoftë se ne, Lëvizjen tonë do të mundemi ta orientojmë, zhvillojmë dhe drejtojmë në pajtim me katër pikat rreshtuese më lartë - në fund të fundit - populli ynë, me siguri, do të dali fitimtar.

Në pjesën e programit “Taktika jonë” në 6 pika, thuhej se, LRBSH-ja ishte e konsistuar në këto pozicione, të cilat pasqyrohen në Programin e *Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve*: mos të flihet asnjë çast; të punohet që sot e jo nesër; Lëvizja të drejtohet nga masat që e pranojnë; Lëvizja mos të ketë karakter kadrovik; mos me u marrë me premtime, gradime, mashtrime, kërcënime dhe me pasoja. Duhet ta bindim vetveten se armiku jonë ka me humbë luftën. Tek e fundit, çështja shqiptare nuk pritet të zgjidhet as nga pozicioni i demokracisë perëndimore, as nga pozicioni i demokracisë socialiste, por çështja shqiptare do të zgjidhet në pajtim të plotë me zhvillimin historik, sepse shqiptarët janë duke notuar ujit te poshtë, kurse robëruesit e shqiptarëve janë duke notuar jo drejt, turpshëm, prandaj, le të zgjasë lufta jonë sa të dojë, le të jetë ajo e vështirë dhe e përgjakshme sa të dojë, në fund të fundit - ne do të dalim ngadhënjimtarë, faqebardhë dhe, në fund të fundit, populli shqiptar do të bashkohet në flatrat e shqiponjës dy krenare legjendare.¹⁵

Në vazhdim, në program kërkesat kryesore të LRBSH-së ishin të ngjashme me programet e organizatave të mëhershme atdhetare: çlirimin nga pushtuesit sllav, pavarësia kombëtare dhe bashkimi i të gjitha trevave shqiptare. Se populli shqiptar nuk po kërkon asgjë më shumë se atë që gëzojnë gjithë kombet e Evropës - me qenë i bashkuar. Sepse, e tërë kjo buronte nga e drejta legjitime dhe e natyrshme për të qenë të bashkuar dhe të barabartë me popujt tjerë. Se nuk gjendet në Evropën e sotme ndonjë komb tjetër, i cili të jetë cunuar aq rëndë, dhe që t’i jetë bërë një padrejtësi aq e madhe sa ajo që pësuan shqiptarët në përfundim të Luftës së Dytë Botërore.

Populli shqiptar është i vetmi popull në Evropë, i cili për asnjë faj të vetin qëndron i ndarë në dy pjesë, përveç atyre bashkëkombësve tanë që janë shpërndarë në të katër anët e botës. Por, le të mos shkojmë më larg prej praktikës jugosllave. Popujt sllavë përbëjnë Jugosllavinë edhe pse janë formuar gjatë historisë si kombe në vete, vetëm pse kanë një origjinë të përbashkët dhe e shohin të arsyeshme me qenë të bashkuar, kurse neve shqiptarëve - një komb, një gjak, një asht, një

¹⁵ Programi i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, Dosja Demaçi, Arkivi i Kosovës, K. Nr. 271/64.

mish, një shpirt - na e mohojnë të drejtën tonë të patjetërsueshme për bashkim.

Gjithashtu, rëndësi të veçantë në program i japin edhe zhvillimeve patriotike tek shqiptarët, por vazhdimisht duke i dhënë edhe sqarimet se si pushtetarët mundohen të kamuflojnë realitetin në Kosovë. Megjithatë, formimi dhe zbulimi i organizatave ilegale atdhetare kanë porosi të qarta për pushtetin jugosllavë, se populli shqiptar me aneksimin e Kosovës Serbisë është i pakënaqur. Në program thuhej edhe kjo, se: “Populli shqiptar, i paepur si gjithmonë, nuk pushoi për asnjë çast luftën për çlirim e bashkimin e vet. Një statistikë edhe jo fort e përpiktë tregon se që prej 1945 e deri më 1960 kanë dalë para gjyqeve famëkëqij jugosllavë më se pesëqind organizata, grupe të mëdha e të vogla ose individë, të cilët janë akuzua për “orvatje me e shkëput Kosovën e Metohinë prej Jugosllavisë dhe me ia bashkua Shqipërisë”.¹⁶

Edhe pse në Kushtetutën e Jugosllavisë lidhur me vetëvendosjen e popujve shkruhej, se: “Popujt e Jugosllavisë, tue u nisë nga e drejta e çdo populli për vetëvendosje, tue përfshi edhe të drejtën për shkëputje, në bazë të luftës së përbashkët dhe të shprehjes së lirë të vullnetit në luftën nacionalçlirimtare dhe në revolucionin socialist dhe në pajtim me aspiratat e tyre historike, të ndërgjegjshëm se forcimi i mëtejshëm i vëllazërimit dhe bashkimit nën një republikë federative kombesh dhe popujsh të lirë dhe të barabartë e krijuan bashkësinë socialiste-federative të punonjësve”¹⁷. Kjo e dhënë mjafton që të supozohej se për shqiptarët premtimet e fjalët nga pushtetarët, fundja të futura edhe në Kushtetutë, që të gjitha ishin boshe. Këto fjalë të shkruara dëshmojnë, se: “populli ynë nuk ka kërkuar e as nuk po kërkon asgjë ma shumë përveç të drejtës së vet për vetëvendosje, tue përfshi edhe të drejtën për shkëputje? Por nuk duhet me harrua se kjo asht Kushtetuta jugosllave, dhe pikërisht pse asht jugosllave duhet me e ditë se ajo qëndron vetëm në letër, kurse zbatimi i saj gjendet nëntëqind pash nën dhe. Na u nisëm prej Kushtetutës - si dokument themelor dhe burimor - si shembull ma i spikatur për të pa se sa larg qëndrojnë njëra prej tjetrës - teoria dhe praktika Jugosllave dhe pikërisht - ky mospajtim rasor në mes të asaj se çka shkruajnë e të asaj se çka flasin e çka veprojnë aneksionistët jugosllavë - asht përveç tjerash - faktori kryesor, që shtynë popullin

¹⁶ Programi i LRBSH-së, 1963.

¹⁷ Pjesa hyrëse. Parimet themelore, f. 7 të Kushtetutës RSFJ, t’aprovueme më 7 prill 1963.

tanë të vazhdojë luftën deri në fund për çlirimin e vet nga zgjedha jugosllave”.¹⁸

Vëmendje e posaçme iu kushtonte edhe situatës politike e ekonomike, zhvillimit arsimor e shëndetësisë në Kosovë. Padrejtësitë e shumta që cekën në këtë program politik janë të shumta dhe të gjitha këto ilustrohen me fakte e shifra. Derisa në njërin anë makina propagandistike jugosllave trumbeton me të madhe Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në anën tjetër, çdokush prej nesh, që ka guxim ta kërkojë zbatimin e thelbit të saj - të drejtën për vetëvendosje dhe shkëputje - në qoftë se shpëton pa hëngër plumbin në ballë me siguri ka me u plakë nëpër burgjet e kazamatet jugosllave. Në qoftë se dikush prej nesh do të kërkojë zbatimin e Deklaratës për të Drejtat e Njeriut, aprovuar më 10 dhjetor 1950, po në OKB, e të cilën e trumbetojnë edhe pushtuesit jugosllavë, ai do t'i gjejë këto të drejta në selitë e errëta e të ftohta të burgjeve jugosllave.

Programi politik i LRBSH-së, në mënyrën më të argumentuar na prezanton të dhënat statistikore të marra nga shënimet zyrtare jugosllave nxjerrë prej broshurës, “Kosovo i Metohija” - pregled drushtveno-ekonomskog razvitka (vështrim i zhvillimit shoqëror-ekonomik), botua në Beograd, më 1963, nga “Sedma sila”. Ja si duket në praktikë vëllazërimi e bashkimi dhe barazia aq shumë e proklamuar dhe e trumbetuar në mes të shqiptarëve dhe në një anë, e serbëve e malazezëve, në anën tjetër. Më 1963 numri i përgjithshëm i këshilltarëve në Krahinë ishte 2 090. Prej këtyre, shqiptarë ishin 1 265, kurse proporcionalisht me numrin e shqiptarëve në Krahinë (shqiptarët së bashku me ata që i paraqesin si “turq” përbëjnë 70% të popullsisë), do të duhej të ishin 1 463, ndërsa serbë e malazezë do të duhej të ishin vetëm 664 e jo 754, sa janë. Lidhja komuniste më 1963 kishte gjithsej 40 127 anëtarë, prej të cilëve vetëm 19 370 shqiptarë, ndërsa proporcionalisht me përbërjen e popullsisë në Krahinë do të duhej të ishin jo më pak se 28 889, kurse serbë e malazezë janë 19 676, ndërsa do të duhej të ishin jo më shumë se 10 834. Këshilltar të Këshillit Popullor Krahinor, po në atë vit ishin gjithsej 165, prej të cilëve shqiptarë ishin vetëm 89 e do të duhej të ishin 115, kurse serbë e malazezë ishin 68, e do të duhej të ishin vetëm 50. Anëtarë të këshillave punëtore nëpër ndërmarrje kanë qenë gjithsej 3 869, prej të cilëve shqiptarë ishin vetëm 1 872 e do të duhej të ishin 2 708, ndërsa serbë e

¹⁸ Selatin Novosella, Adem Demaçi në Gjakimin e dytë-1964, Prishtinë, 2016, 287, SHBPK..

malazezë kanë qenë 1 798 e do të duhej të ishin në bazë të barabarësisë dhe bashkim-vëllazërimit të vërtetë jo më shumë se 1 045.

Anëtarë të këshillave drejtuese nëpër sipërmarrje kanë qenë gjithsej 1 349, prej të cilëve të kombësisë shqiptare, vetëm 641 e do të duhej të ishin 944, kurse serbë e malazezë do të duhej të ishin vetëm 364 e në të vërtetë kanë qenë rumbullak 663. Prej 28 komunave, sa ka gjithsej krahina, në 25 prej tyre shumica dërmuese e popullsisë është shqiptare, por prej 28 sish vetëm 17 prej tyre i kanë kryetaret prej kombësisë shqiptare.¹⁹ Këto janë fakte të cilat flasin vetë dhe nuk ka nevojë të bëhet kurrfarë shpjegimi në lidhje me to. Ndoshta do të duhej të përmendet vetëm edhe faktin (kësaj gjëje i ka bërë bisht gazetari-shërbëtor i aneksionistëve), se të gjitha pozitat kyçe si në Parti (sekretar i LK-së së Serbisë për Kosovë e Metohi, është malazezi, Dushan Mugosha), si në pushtet (kryetar i Kuvendit Popullor Krahinor është, Stanoje Aksiqi), dhe si në organet e sigurimit të brendshëm (në këto organe shqiptarët as nuk mund të afrohen), i kanë në duart e veta vetëm serbët e malazezët.²⁰

Në fund kishim thënë se, “mbasi lufta jonë është e drejtë, madhështore dhe e lavdishme, mbasi lufta jonë është në pajtim me ligjet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, mbasi lufta jonë është në pajtim të plotë me zhvillimin historik, ...le të zgjas lufta jonë sa të dojë, le të jetë ajo e pabarabartë sa të dojë, le të jetë ajo e vështirë dhe e përgjakshme sa të dojë, në fund të fundit, ne do të dalim ngadhënjimtar, faqebardhë, në fund të fundit, populli shqiptar do të bashkohet nën flatrat e shkabës dy krefshe legjendare”.²¹

Le ta ngrehim ballin lart me besim të patundur në zemër se mbas dimrit - sado i gjatë dhe i ashpër qoftë - do të vijë pranvera me behar e lule plot, përfundon programi politik i LRBSH-së.

Kryetari i LRBSH-së me shokë, kishte hartua edhe një dokument mjaftë të rëndësishëm për organizatën - Statuti i organizatës, “Lëvizja Revolucionare për Bashkim të Shqiptarëve” në të cilën në pjesën I të saj thuhej se: “Qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë asht siguri i të drejtave për vetëvendosje deri në shpëputje për viset e banuara me shumicë prej shqiptarësh, që gjenden ende nën administrimin e

¹⁹ Po aty.

²⁰ “Kosovo i Metohija” - pregled drushtveno- ekonomskog razvitka (vështrim i zhvillimit shoqëror-ekonomik) botuar në Beograd, më 1963, nga “Sedma sila”.

²¹ Arkivi i Kosovës, Kutia “Dësia Demaçi: Programi Politik i Organizatës “Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), 1964.

Jugosllavisë, d.m.th. qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë asht - çlirimi i krahinave shqiptare, t'aneksueme prej Jugosllavisë dhe bashkimi i këtyre krahinave me nënën e vet - Shqipërinë".²²

Në pjesën II, vazhdohet, se: "Lëvizja jonë, për me mbërrit qëllimin e naltë përmendur, ka me përdor të gjitha mënyrat dhe mjetet që i vijnë për dore - prej atyre politiko-propagandistike - mjete paqësore - e deri te lufta e armatosur dhe kryengritja e përgjithshme popullore - mjete jo paqësore".²³

Pjesa III, është e lidhur ngushtë me dy pikat e para dhe thuhej se: "Në realizimin e të drejtës së patjetërsueshme të popullit shqiptar, për çlirim dhe bashkim, Lëvizja jonë ka me pranua, me miradije të madhe, çdo ndihmë e përkrahje të sigurtë, materiale e morale - prej këdo dhe kudo që t'i vije e t'i afrohet".²⁴

Në pjesën IV të statutit, anëtarët e saj thonë, se: "Lëvizja jonë nuk drejton aktivitetin dhe luftën e vet kundër Jugosllavisë dhe sistemit të saj shoqëror-ekonomik - si tërësi - por aktiviteti dhe lufta e saj do të vazhdojë, do të shkojë deri në atë shkallë, sa t'i çlirojë dhe t'i bashkojë me Shqipërinë krahinat shqiptare - t'aneksueme prej Jugosllavisë".²⁵

Dhe në pjesën V të pjesës së përgjithshme, njofton, se: "Lëvizja jonë ka "Programin" dhe "Statutin" e vet".²⁶

Ndërsa në pjesën organizative bëhet fjalë për organizimin e brendshëm të Lëvizjes.

Anëtarë i Lëvizjes Revolucionare të Bashkimit të Shqiptarëve mund të jetë çdo kush që - tue vu interesin e përgjithshëm përpara interesit personal - përpiket e lufton me mish e shpirt, që përkrah, pa rezervë - në çdo kohë e kudo që të gjendet - si personalisht - tue flijue jetën e vet - si materialisht, si moralisht - çështjen e çlirimit dhe të bashkimit të shqiptarëve.²⁷

Organi kryesor i Lëvizjes është Komiteti Revolucionar i Bashkimit të Shqiptarëve. Zgjerimi i tij bëhet me kuptim, me pëlqim të njëzëshëm të anëtarëve tjerë. Detyrat e Komitetit Revolucionar të Lëvizjes janë: Koordinimi dhe drejtimi i mbarë Lëvizjes. Emëron dhe shkarkon të gjitha organet dhe të gjithë përgjegjësinë e Lëvizjes.

²² Po aty.

²³ Po aty.

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

²⁶ Statuti i organizatës "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", Kutia-Dosja Demaçi, Arkivi i Kosovës, 1964.

²⁷ Po aty.

Vendimet e tij merren me shumicë votash dhe janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Lëvizjes, kudo që të gjinden. Vetëm Komiteti Revolucionar i Lëvizjes së Bashkimit të Shqiptarëve ka të drejtë të plotësojë ose të ndryshojë “Programin” ose “Statutin” e Lëvizjes.

Ndërsa pika X e Statutit është edhe një lloj betimi që e hasim tek organizatat e mëhershme, siç ishte ONDSH-ja, Besa Kombëtare, Organizata nr. 2. etj., që thoshin, se: “Ai që tradhton - në një mënyrë ose në një tjetër - ai vetveten e dënon me vdekje. Komiteti Revolucionar i Lëvizjes, konstaton dhe vërteton tradhtinë e bërë, ku njëherit merr masa edhe për zbatimin e vendimit të pafalshëm²⁸.

Epoka e LRBSH-së është njëra ndër periudhat më të lavdishme e më të ndritura të historisë së lëvizjes ilegale në Kosovë, pas LDB-së. Ajo do të mbetet në kujtesën e shqiptarëve si simboli i Adem Demaçit dhe bashkimit kombëtar. Të mësojmë dhe të frymëzohemi nga përvoja historike dhe platforma kombëtare e tij. Të nxjerrim mësim të rëndësishme nga përpjekjet shekullore të popullit tonë, të marrim shembull nga bacë Adem Demaçi, dhe të ngremë lart vlerat tona kombëtare e njerëzore, kodin tonë të lartë etik e moral. Dhe krejt në fund, të mësohemi se atdheu të jetë partia e shqiptarit, shqiptarizmi të jetë ideologjia e tij. Së kështu na mësoi Adem Demaçi dhe epoka e tij e lavdishme.

²⁸ Po aty.

Sabile KEÇMEZI-BASHA

SUMMARY

IMPORTANT DOCUMENTS OF THE REVOLUTIONARY MOVEMENT ON THE UNIFICATION OF ALBANIANS, 1963

In the wake of many patriotic illegal organizations, it should be noted that in the year 1963 Kosovo formed another patriotic organization called "*Revolutionary Union Movement of Albanians*" led by well-known patriot Adem Demaçi. I think that this illegal organization literally deserves to be called a movement, because both in terms of vertical as well as horizontal it meets all the criteria that characterize a political movement. Therefore, as imperative of time the necessity was paved to write the Programme and Statute of the Movement. After prior consultation with the chairman of the RUMA, with other members of the Revolutionary Committee at the national level, they begin preparations to enter this work with great interest. To avoid being monitored by the Yugoslav State Security and the UDB, it was proposed to go to Peja. President of the Movement, Adem Demaçi, in association with Ramadan Shala make the compilation of documents.

The program should be noted that the *Revolutionary Union Movement of Albanians* treated the issue of national character, the cause of national liberation, the issue of territorial unity, the issue of a common market and the question of a spiritual sense for a common literary language with Albania. All these issues are analyzed in time and space, to draw lessons from these and to be oriented towards the historical future. The *Revolutionary Movement program for the Union of Albanians* is a very important document in which analysis are made in detail, separately, for the circumstances in the occupied Albanian lands under Yugoslav administration, Albania and Yugoslavia itself.

Shkodran IMERAJ

**REFERENDUMI PËR KOSOVËN SHTET SOVRAN DHE I
PAVARUR, 26-30 SHTATOR 1991, SIPAS GAZETËS
"BUJKU" NË KOSOVË**

Vendimi i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës i 23 shkurtit 1989, për miratimin e projekt-amendamenteve për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë dhe vendimi i Kuvendit të Republikës Socialiste të Serbisë, më 28 mars 1989, vendim ky që suspendoi Autonominë e Kosovës, shkaktuan pakënaqësi të madhe në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Në shumë qendra të Kosovës u organizuan dhe u mbajtën demonstrata dhe mitingje me të cilat u kundërshtuan ndryshimet kushtetuese. Në mesin e demonstruesve shqiptarë kishte shumë të vrarë dhe të plagosur.

Si rezultat i rritjes së pakënaqësisë ndaj vendimeve të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, dhe të Kuvendit të Republikës Socialiste të Serbisë, delegatët e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, më 2 korrik 1990¹, në një mbledhje të mbajtur në kushte të jashtëzakonshme para ndërtesës së Kuvendit të Kosovës, miratuan Deklaratën Kushtetuese, duke e shpallur Kosovën njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të Federatës-Konfederatës së ardhshme Jugosllave. Disa muaj më vonë, delegatët e Kuvendit të Kosovës të cilët më 2 korrik 1990 miratuan Deklaratën Kushtetuese, më 7 shtator 1990 në një mbledhje të Kuvendit e cila i zhvilloi punimet në qytetin e Kaçanikut miratuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës-

¹ Delegatët shqiptarë të cilët miratuan Deklaratën Kushtetuese, më 2 korrik 1990, dhe Kushtetutën e Kaçanikut më 7 shtator 1990, filluan detyrën pas mbajtjes së zgjedhjeve në Kosovë në fund të vitit 1989.

Kushtetuta e Kaçanikut², me të cilën statusi i Kosovës rregullohej me aktin me të lartë juridik të shteti - Kushtetutën.³ Delegatët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, miratuan edhe shumë vendime dhe akte të tjera burimore. I një rëndësie të veçantë ishte vendimi mbi Referendumin për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, i datës 22 shtator 1991.⁴

Referendumi për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, ishte një ngjarje shumë e rëndësishme për shqiptarët e Kosovës dhe për shtetësinë e tyre. Me këtë Referendum, shqiptarët e Kosovës u përcaktuan qartë për të ardhmen e tyre politike. Referendumi ishte një ngjarje e madhe e cila nuk kaloi pa i mbushur faqet e shtypit si në Kosovë po ashtu edhe më gjerë.⁵ Në këtë punim, do të pasqyrojmë gjendjen së si u trajtua procesi i Referendumit i organizuar dhe i mbajtur nga 26 deri më 30 shtator 1991 në Kosovë, sipas gazetës së përditshme “Bujku”, e cila botohej në gjuhën shqipe në Kosovë. Në gazetën “Bujku” të datës 24 shtator 1991, që në ballinë të saj gjejmë artikullin me titull: “Kosova - shtet sovran dhe i pavarur”, ku ndër të tjera nga ky artikull mësojmë së Kuvendi i Republikës së Kosovës⁶ ka marrë vendim

² Me miratimin e Deklaratës Kushtetuese më 2 korrik 1990, filloi faza e ngritjes së institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës. Sipas Kapitullit VII të Kushtetutës së Kaçanikut, organet e Republikës ishin: Kuvendi i Republikës, Kryesia e Republikës, Qeveria e Republikës, Gjyqet dhe Prokuroria Publike, Banka Popullore dhe Gjyqi Kushtetues i Kosovës. Shih më gjerësisht: Fehmi Rexhepi, *Ngritja dhe funksionimi i institucioneve të Republikës së Kosovës (1990-2000)*, punim në dorëshkrim..

³ Kuvendi i Kosovës i cili miratoi Deklaratën Kushtetuese më 2 korrik 1990 dhe Kushtetutën e Kaçanikut më 7 shtator 1990, miratoi edhe këto akte kushtetuese dhe politike të shtetësisë së Kosovës:

- Referendumin gjithëpopullor për Kosovën shtet Sovran dhe i pavarur, i mbajtur nga 26 deri më 30 shtator 1991;
- Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, miratuar më 18 tetor 1991;
- Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të miratuara më 19 tetor 1991; si dhe,
- Zgjedhjet e para të lira dhe shumë partiake për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës, të mbajtura më 24 maj 1992. Shih më gjerësisht: Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (më tej: ASHAK), Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 korrik 1990-2 maj 1992, Prishtinë 2005.

⁴ ASHAK, Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 korrik 1990 - 2 maj 1992, Prishtinë 2005, f. 99-101.

⁵ Gazeta “Bujku”, Prishtinë 26 shtator 1991, f. 4.

⁶ Duhet potencuar faktin se Kuvendin i Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 1991, me një Vendim (shih më gjerësisht: Kuvendi i Republikës, Vendimi KK Numër

për të shpallur Referendumin për mëvetësinë e Kosovës, në të cilin populli në bazë të shprehjes së lirë me të drejtën e votës, do të deklarohet për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, Referendum ky i cili do të organizohet dhe do të mbahet nga 26 deri më 30 shtator 1991.⁷

Në gazetën “Bujku” të datës 26 shtator 1991, në kryeartikullin me titull: “Nëpër kuvendet komunale të Republikës së Kosovës - u bënë përgatitje e fundit për Referendum”, theksohet se në të gjitha kuvendet komunale në Kosovë po behën përgatitjet për mbarëvajtjen e Referendumit për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran. Po ashtu, në këtë artikull jepet edhe informata se Komisioni Qendror Zgjedhor, më 25 shtator 1991, ka mbajtur mbledhje në të cilën janë sqaruar shumë çështje sidomos ato të anës teknike.⁸

Një informatë shumë e rëndësishme që del nga artikulli i lartcekur është se të gjitha kuvendet komunale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përkrahin vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për të organizuar dhe mbajtur Referendumin gjithëpopullor për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur. Më tej mësojmë se çdo Kuvend i Komunës ka të formuar Komisionin Zgjedhor si dhe Komisionin Votues, ku janë të përcaktuar për çdo vendvotim. Është me rëndësi të potencohet argumenti se Komisionet Votuese nga vendi i votimit duhej që të ju raportnin Komisioneve Qendrore të cilët vepronin në Komunë dhe më pas Komisioni Qendror i raportonte Komisionit Qendror të Republikës së Kosovës.⁹ Organizimi i Referendumit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, pati përkrahje nga instanca të shumta. Gazeta “Bujku”, e datës 26 shtator 1991, në artikullin “Përkrahje e plotë vendimeve të Kuvendit të Kosovës”, nëpërmjet komunikatës së Këshillit Koordinues të Partive Politike të Kosovës, mësojmë se Këshilli Koordinues përkrahë pa rezervë dhe shumë fuqishëm mbajtjen e Referendumit në Kosovë. Po ashtu, ky Këshill, i fton të gjitha subjektet politike, asociacionet si dhe të gjithë qytetarët e Kosovës për të marrë

3/91, Prishtinë, 22 shtator 1991), shkarkoi nga detyra kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Gjorgje Bozhoviq dhe në vend të tij emëroi Iliaz Ramajlin. Ndërsa, për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, u zgjodhën prof. dr. Skënder Skënderi dhe mr. Ramadan Kelmendi. Shih më gjerësisht: Gazeta “Bujku”, Prishtinë, 24 shtator 1991, f. 1-3.

⁷ Po aty, 24 shtator 1991, f. 1.

⁸ Po aty, 26 shtator 1991, f. 1.

⁹ Po aty.

pjesë në Referendum dhe për të shprehur lirshëm përcaktimin e tyre mbi të ardhmen e Republikës së Kosovës.

E shohim të nevojshëm të paraqesim Komunikatën e Këshillit Koordinues të Partive Politike të Kosovës për përkrahjen e vendimit të Kuvendit të Kosovës për Referendumin në të cilën thuhej: “Këshilli Koordinues i Partive Politike të Kosovës i shprehë përkrahje të plotë Kuvendit të Kosovës për miratimin e Rezolutës për Republikën e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur dhe njëkohësisht shprehë bindje të thellë se ky vendim i Kuvendit, me të cilin Kosova përcaktohet si republikë-shtet sovran, është shprehje e vullnetit të kamotshëm të popullit tonë dhe një aspiratë e tij historike. Një vendim i këtillë ka legjitimitet të plotë, sepse, në radhë të parë mbështetet në shprehje e lirë të vullnetit politik të qytetarëve dhe është një arritje e madhe në zhvillimin e mëtejme të proceseve demokratike tek ne.

Këshilli Koordinues, gjithashtu përkrah fuqimisht mbajtjen e Referendumit në Kosovë, përmes të cilit qytetarët në mënyrë të lirë dhe të drejtpërdrejtë do të shprehin përcaktimin e tyre politik për realizimin e të drejtës së tyre të patjetërsueshme. Ndonëse mbahet në kushtet e okupimit, besojmë se me përkrahjen tonë të përbashkët dhe të pakursyer, referendumi do të mbahet me sukses.

Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare të Kosovës, përgëzon Kuvendin e Kosovës për vendimet historike që shprehin synimet tona për liri, barazi dhe mëvetësi politike dhe njëkohësisht fton të gjitha subjektet politike, asociacionet dhe qytetarët t’i përgjigjen ftesës për referendum dhe në këtë mënyrë të shprehin vullnetin e tyre të lirë politik”, - thuhet në komunikatën e cila është nënshkruar nga dr. Ibrahim Rugova, kryetar i Këshillit.¹⁰ Është me rëndësi të potencohet fakti se edhe elita studentore përkrahu vendimin e Kuvendit të Kosovës për mbajtjen e Referendumit. Kështu, Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Kosovës, i bëri thirrje të gjithë studentëve se në ditët sa do të mbahet Referendumi, të jenë shumë të angazhuar dhe syçelë dhe të japin maksimumin që çdo gjë të shkoj me sukses të plotë.¹¹

Vendimin e Kuvendit të Kosovës për organizimin e Referendumit e përkrahu fuqishëm edhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (ASHAK). Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, nëpërmjet komunikatës për media, shprehu mbështetjen për Referendumin dhe theksonte se: “...Nisur nga parimet fundamentale

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty, 26 shtator 1991, f. 3.

demokratike për respektimin e vullnetit politik të popullsisë së Kosovës dhe në përgjithësi të popullit shqiptar në Jugosllavi, si dhe nisur nga qëndrimet dhe vizionet e saja përkatëse shkencore dhe shoqërore të shprehur në Deklaratën e saj mbi çështjet kushtetuese të muajit qershor 1990, përshëndet me përkushtim dhe e mbështet Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 22 shtator të këtij viti për Republikën e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur... Popullit shqiptar afër 2 milionësh në Kosovë dhe rreth 3 milionësh në Jugosllavi, si pjesë dominante numerike e popullsisë së Kosovës dhe ndër popujt më numerik në Jugosllavi, me asnjë kriter njerëzor dhe shkencor nuk mund t'i mohohet e drejta për vetëvendosje politike, aq më parë për barazi të plotë në kuadër të cilësdo zgjidhje politiko-institucionale në Jugosllavinë shumëkombëshe... Së këndejmi, Rezoluta për sovranitetin e pavarësinë e Republikës së Kosovës, e cila paraqet vazhdimësi të natyrshme të Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990 mbi pavarësinë dhe barazinë e Kosovës dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të 7 shtatorit, përveç që e ka vlerën burimore të dinjitetit dhe të përcaktimit politik të një populli, është njëherësh edhe rezolutë e dënimit të fuqishëm moral të okupimit të Kosovës e të dhunës shtetërore ndaj lirive dhe të drejtave njerëzore dhe kombëtare në Kosovë.

Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe Arteve e Kosovës, do ta njoftoi njëherësh dhe Konferencën e Hagës për Jugosllavi me tekstin e kësaj letre drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, me apel kryesuesit të Konferencës së Hagës, lordit Karington dhe kryetarit të Këshillit të Ministrave të Bashkësisë Evropiane Van den Brukut, që të pranohet urgjentisht kërkesa e përfaqësuesve politikë legjitim të Kosovës dhe e popullit shqiptar në Jugosllavi për pjesëmarrje të përfaqësuesve të tij legjitim në këtë Konferencë, e cila duhet të merret edhe me fatin politik dhe historik të Kosovës...”, thuhet ndër të tjera në letrën e Akademisë së Shkencave dhe Arteve e Kosovës, drejtuar Kuvendit të Kosovës.¹²

Po ashtu rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Referendum, e përkrahu edhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Këtë e mësojmë nga artikulli “E drejta e patjetërsueshme e vullnetit të lirë”. Ndër të tjera në komunikatën për opinion të LDK-së drejtuar Kuvendit të Kosovës,¹³

¹² Po aty, 26 shtator 1991, f. 3.

¹³ Po ashtu Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka përshëndetur zgjedhjen e Iljaz Ramajlit në krye të Kuvendit të Kosovës si dhe të Skënder Skënderit dhe të Ramadan Kelmendit për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Po aty, 26 shtator

shpreh përkrahjen e fuqishme ndaj vendimit dhe organizimit të Referendumit për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Më tej, nga ky artikull, mësojmë se Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për organizimin dhe mbajtjen e Referendumit për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran është edhe synim i LDK-së.¹⁴ Gazeta “Bujku” e datës 26 shtator 1991, në artikullin me titull “Referendumi, si shprehje adekuate e vullnetit politik”, publikonte komente të elitës së intelektualëve dhe të qytetarëve të Kosovës. Aty qartë shihej vullneti për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran.¹⁵

Gazeta “Bujku”, e datës 27 shtator 1991, në ballinë kishte artikullin me titull “Kosova filloi Referendumin për sovranitet”¹⁶. Nga ky artikull veçojmë: “...Republika e Kosovës, filloi referendumin për të nesërmen e vet: Shtet sovran dhe i pavarur. Referendumi i parë historik i Kosovës i shprehjes së vullnetit të lirë politik të popullit filloi në kushte e rrethana shumë të rënda që po përjeton Kosova nën pushtimin policor serb, prandaj vota për sovranitetin e pavarësisë është edhe votë e deklaramit demokratik e paqësor për liri e barazi të plotë për çka shqiptarët në Kosovë dhe Jugosllavi edhe para këtij referendumi janë deklaruar fuqishëm me shumë forma të shprehjes e të manifestimeve të vullnetit të lirë...”.¹⁷ Nga ky artikull mund të kuptojmë se sa i rëndësishëm ishte procesi i Referendumit për popullin e Kosovës. Është me rëndësi të ceket fakti se në Kosovë që nga ndarja e saj nga Shqipëria ishte kjo hera e parë që populli shqiptar si dhe të gjitha nacionalitetet e tjera që jetonin në Kosovë, u drejtuan kutive të votimit për të hedhur votat e tyre dhe për të deklaruar, “Po” ose “Jo”, për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Më poshtë po japim tekstin e plotë në gjuhën shqipe të fletëvotimit për Referendum.¹⁸

1991, f. 3.

¹⁴ Po aty, 26 shtator 1991, f. 3.

¹⁵ Po aty, f. 4.

¹⁶ Po aty, 27 shtator 1991, f. 1.

¹⁷ Po aty, 27 shtator 1991, f. 1.

¹⁸ Fletëvotimi për Referendumin për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran ishte i përpiluar në tri gjuhë: në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën turke.

REPUBLIKA E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës

Numër 01

Prishtinë, më 22 shtator 1991

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 7, alineja 1, pika 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 1991, shpallë:

REFERENDUM

për Republikën e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur.

Ju lutemi që, në bazë të shprehjes së vullnetit Tuaj politik përmes deklaramit të lirë (duhet rrethuar “po” ose “jo”) të përcaktoheni se:

A jeni për Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për shpalljen e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur, me të drejtë për pjesëmarrje konstituive në lidhjen e shteteve-republikave sovrane (në Jugosllavi)?

“PO”

“JO”¹⁹

Po ashtu, në numrin e datës 27 shtator 1991, të gazetës “Bujku”, nuk munguan udhëzimet për Referendum. Kështu, në artikullin me titull “Udhëzime për mbajtjen e Referendumi - Referendumi është legal dhe legjitim”, mësojmë se në të gjitha qendrat e votimit në Kosovë, vendet se ku do të votojnë qytetarët janë publike. Po ashtu, nga ky artikull behët e ditur se nëse vjen deri te intervenimi i strukturave të policisë në qendrat e votimit, mbyllën dhe arrestohen komisionarët si dhe konfiskohet materiali që përdoret për procesin e Referendumi, atëherë personat që janë kompetent për procesin e votimit në qendër të votimit rekomandohen që të mos rezistojnë.²⁰

Po në gazetën “Bujku” të datës 27 shtator 1991, shumë faqe ishin të mbushura me raporte nga vendet të ndryshme të Kosovës. Më poshtë po japim disa raporte nga pjesë të ndryshme të Kosovës:

¹⁹Po aty, 27 shtator 1991, f. 3.

²⁰Po aty, f. 1.

- Mitrovicë:

Në artikullin me titull: “Përkrahje vendimeve të Kuvendit të Kosovës”, thuhet se delegatët e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 1991, ku merrnin pjesë delegatët nga komuniteti shqiptar, turq dhe romë, të cilët përbënin tri dhomat e Kuvendit të komunës, përkrahnin Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Po ashtu, nga raporti mësojmë se u morë vendim dhe u caktuan 28 vendvotime si dhe u emëruan komisionarët komunalë dhe mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e referendumi. Në artikujt e gazetës mësojmë së Referendumi zhvillohej normalisht edhe në komunën e Vushtrisë.²¹

- Gjakovë:

Në artikullin me titull: “Interesim i madh për Referendum”, pasqyrohet se qytetarët e Gjakovës dhe rrethinës, me të madhe po tregojnë interesim për të hedhur votat e tyre në Referendum. Po ashtu, në artikull theksohet se: “...Gjakovarët këtë referendum e vlerësojnë si rastin e parë të vërtetë të cilin shqiptarët e Kosovës do ta kenë mundësi të shprehin vullnetin e tyre politik, prandaj janë të bindur se ata do të deklarohen për një Kosovë shtet të pavarur, të cilin ditë më parë e shpalli Kuvendin i Kosovës...”. Është me interes të cekët së në komunën e Gjakovës sipas statistikave në Referendum të drejtë vote kanë mbi 59 mijë banorë, dhe ata do të kenë mundësi të votojnë në 35 vendvotime në gjithë komunën e Gjakovës.²²

- Rahovec:

Në artikullin: “Referendumi legal”, mësojmë për fillimin e Referendumi në qytetin e Rahovecit. Sipas raportit, në Rahovec dhe rrethinë kanë të drejtë vote 65 mijë banorë, të cilët do të deklarohen për sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës.²³

²¹ Po aty, f. 3. Duhet theksuar së edhe në komunën e Vushtrisë, qytetarët e saj, me të madhe ju përgjigjen thirrjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës për të dalë dhe për të votuar për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Shih më gjerësisht: Gazeta “Bota Sot”, Prishtinë, 15 qershor 2010, f. 18; Prishtinë, 17 qershor 2010, f. 17.

²² Gazeta “Bujku”, Prishtinë 27 shtator 1991, f. 3. Në raportin e gazetës “Bujku” për Gjakovë, theksohet së më 26 shtator 1991, në ditën e parë të votimit në Referendum, policia serbe vizitoi të gjithë objektet e shkollave fillore dhe të mesme në të cilat janë të vendosur qendrat e votimit dhe shqiptarët dhe pakicat e tjera përveç serbëve po votonin në Referendumin për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran.

²³ Gazeta “Bujku”, Prishtinë 27 shtator 1991, f. 3.

- Prizren:

Në artikullin: “Aktivitet i gjerë”, mësojmë se të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit të të gjitha nacionaliteteve e kanë pritur me padurim fillimin e Referendumit. Në këtë artikull mësojmë se në komunën e Prizrenit kanë të drejtë vote 60 mijë votues shqiptarë dhe 20 mijë votues myslimanë dhe turq, ku gjithsej janë 80 mijë votues.²⁴

- Glogoc:

Në artikullin me titull: “Gëzim i madh në Drenicë”, të datës 27 shtator 1991, thuhet: “...Qytetarët e komunës së Glogocit vendimin e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për referendum e pritën me gëzim të madh...”. Po nga ky artikull mësojmë se Kuvendi i Komunës së Glogocit, ka caktuar 36 vendvotime. Sipas statistikave, në komunën e Glogocit të drejtë vote kanë rreth 25 mijë qytetarë.²⁵

- Malishevë:

Në vazhdim të raporteve nga komuna të ndryshme të Kosovës, në gazetën “Bujku” të datës 27 shtator 1991, shkëpusim edhe artikullin me titull: “Për votë - 24 mijë qytetarë”, ku thuhet se me të shpallur vendimin për organizimin dhe mbajtjen e Referendumit, banorët e komunës së Malishevës, e kanë pritur me shumë gëzim. Po ashtu mësojmë se 24 098 qytetarë të kësaj komunë kanë të drejtë vote, ku do të ju drejtohen 42 qendrave të votimit në të gjithë komunën. Edhe tri dhomat e Kuvendit të Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 1991, përgëzuan delegatët dhe kryetarin e Kuvendit të Kosovës për vendimin dhe organizimin e Referendumit për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran.²⁶

- Ferizaj:

Nga artikulli me titull: “Vullneti më i fortë se reprezaljet”, njoftohemi se në qytetin e Ferizajt janë të hapur afër 60 vende të votimit. Qytetarët e Ferizajt dhe të rrethinës e kanë pritur me interesim shumë të madh ditën e votimit të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës mbi Referendumin për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran.²⁷

- Shtime:

Në raportin e gazetës “Bujku”, theksohet se organet e Kuvendit të Komunës së Shtimes, me gjithë vështirësitë i kanë bërë hapat e duhur për të hapur të gjithë vendet e votimit, ku qytetarët e kësaj komunës të

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty.

mund të hedhin votat e tyre. Në artikull theksohet se edhe në fshatrat më të largëta të kësaj komune si, në Devetak dhe në Topllë, qytetarët janë përgjigjur në masë të madhe procesit të votimit.²⁸

- Dragash:

Tek artikulli me titull: “Deklarim Demokratik”, mësojmë se edhe në trevën e Opojës dhe në komunën e Dragashit, janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura për mbajtjen e Referendunit. Në komunën e Dragashit si dhe në trevën e Opojës, në gjithsej 19 fshatra, qytetarët do të mund t’i drejtohen vendeve të votimit për të hedhur votat e tyre në Referendumin për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran.²⁹

Në gazetën “Bujku”, të datës 4 tetor 1991, në krye të gazetës hasim artikullin me titull: “Mbi 99 për qind të votueseve për sovranitetin shtetëror të Kosovës”, ku më tej mësojmë nga kumtesa e Komisionit Qendror për Zbatimin e Referendunit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, se: “Prej më se 1 milion votuesve kanë dalë në votime mbi 870 mijë veta ose rreth 85 për qind e numrit të përgjithshëm të qytetarëve me të drejtë vote. Pjesëmarrja e serbëve dhe e malazezëve në referendum ishte simbolike”. Më tej në këtë artikull mësojmë se deri më 3 tetor 1991, Komisionit Qendror të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili ishte i obliguar për zbatimin e vendimit për Referendumin për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran, ka pranuar rezultatet nga të gjithë komunat e Republikës. Po ashtu, Komisionit Qendror i kanë arritur edhe rezultatet nga disa shtete të Evropës Perëndimore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Australia.³⁰ Në vazhdim të artikullit potencohet se Komisioni Qendror, i bënte thirrje të gjitha komisioneve të komunave, të cilat nuk i kanë dorëzuar rezultatet e Referendunit, t’i dërgojnë sa më shpejtë ato, për çka Komisioni më pas do t’i raportojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.³¹

Në faqet e gazetës “Bujku” po të datës 4 tetor 1991, gjejmë edhe shumë artikuj të cilët kanë si thelb Referendumin për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Kështu, në artikullin me titull: “Votë për

²⁸ Po aty. Po ashtu nga ky raport shkoqisim një pjesë të komenteve të qytetarëve të komunës së Shtimes: “...Me dëshirën për pavarësi, liri dhe demokraci me të fortë se rapresaljet policore hegjemoniste serbe, të cilat po mundohen ta pamundësojnë këtë plebishit gjithëpopullor.”

²⁹ Po aty, f. 3.

³⁰ Komisioni Qendror kishte hapur vende të votimit edhe në disa shtete të Evropës, SHBA-së dhe të Australisë, që bashkatdhetarët tonë të cilët jetonin atje të kenë mundësi që të votojnë në Referendumin për Kosovën shtet i pavarur dhe Sovran.

³¹ Po aty, 4 tetor 1991, f. 1.

ardhmërinë e Kosovës”, hartuesi i artikullit sjell komente të ndryshme nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Nga ky artikull mësojmë se, populli me padurim ka pritur mbajtjen e Referendunit për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Nga artikulli i sipërm vlerësohej: “Akti i Referendunit për Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur është vazhdë e Kuvendit të Lezhës dhe e Shpalljes së Pavarësisë më 1912, dhe është plotësim i kërkesave shekullore gjithëshqiptare i trojeve tona. Më në fund, ky mund të jetë moment vendimtar në rrugën për bashkimin kombëtar”, - shprehej një nga qytetarët.³²

Në faqen e parë të gazetës “Bujku” të datës 8 tetor 1991, shkëpusim artikullin me titull: “Referendumi ishte i suksesshëm”, ku hasim raportin e Komisionit Qendror të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zbatimin e Referendunit, ndër të tjera veçojmë rezultatin e Referendunit: “Nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të Kosovës me të drejtë vote, prej 1 051 357 votueseve, në Referendum dolën 914 802 veta, ose 87.01% nga ky numër “PËR” Kosovën sovranë votuan 913 705 veta apo 99.87%, kurse “KUNDËR” votuan 164 veta, ndërsa të pavlefshme ishin 933 fletëvotime.”. Po ashtu më tej mësojmë se, për shkaqe të ndryshme, në Referendum nuk morën pjesë 136 555 qytetarë apo 12.99% të shtetasve të Republikës së Kosovës. Më tej theksohet se: “...Komisioni Qendror i Kuvendit të Republikës së Kosovës për zbatimin e Referendunit konstaton se Referendumi për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, që u mbajt prej datës 26 deri më 30 shtator 1991, ishte i suksesshëm. Sipas normave ligjore të Republikës së Kosovës, Referendumi është i suksesshëm nëse në të marrin pjesë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të qytetarëve me të drejtë vote dhe nëse “për” deklarohen më shumë se gjysma nga numri i qytetarëve që marrin pjesë në Referendum....Raportin komplet me të gjitha shënimet sipas komunave, sipas njësive votuese, sipas fletëvotimeve, sipas gjuhëve në të cilat u deklaruan qytetarët, Komisioni do ta paraqes në mbledhjen e ardhshme të rregullt të Kuvendit të Kosovës, në të cilën solemnisht do të shpallën rezultatet e Referendunit dhe do të shpallet Kosova shtet sovran dhe i pavarur”, - thuhet në kumtesën për media të Komisionit Qendror të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zbatimin e Referendunit.³³ Edhe gazetën “Bujku”, e datës 10 tetor 1991, në faqen parë e boton letrën e presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia, dërguar kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ilaz

³² Po aty, f. 4.

³³ Po aty, 8 tetor 1991, f.1.

Ramajlit, pas përfundimit të procesit të deklarimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës në Referendumin për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Ndër të tjera në këtë letër thuhej: "...me anën e kësaj letre kam kënaqësinë që në emër të popullit të Shqipërisë, të përshëndes përfundimin me sukses të Referendomit, me anën e të cilit Republika e Kosovës shpallet shtet i pavarur dhe sovran, me të drejtë të pjesëmarrjes konstituive në bashkësinë e shteteve - republikave sovraane në Jugosllavi mbi bazën e lirisë dhe barazisë së plotë të republikave - shteteve në lidhjen e tyre. Republika e Shqipërisë njehë si legjitim këtë vendim, duke pasur parasysh se parimi i vetëvendosjes është një e drejtë e pranuar nga dokumentet e KSBE-së dhe të OKB-së...

...Njëkohësisht ju siguroi se Republika e Shqipërisë do t'i japë gjithë mbështetjen e vetë Republikës së Kosovës që të njohët dhe të pranohet sa më gjerë në opinionin ndërkombëtar. Pranoni, i nderuar Kryetar përshëndetjet e mia vëllazërore, Ramiz Alia-president i Republikës së Shqipërisë", përfundon letra.³⁴

Më poshtë po japim vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shpalljen e rezultatit për Referendumin për Kosovën si shtet i pavarur dhe sovran:

REPUBLIKA E KOSOVËS - KUVENDI I REPUBLIKËS

Në bazë të nenit 97, alineja 1, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 1991 merë:

VENDIM MBI SHPALLJEN E REZULTATEVE TË REFERENDUMIT TË MBAJTUR NË KOSOVË PREJ 26-30 SHTATOR 1991, PËR KOSOVËN SHTET SOVRAN E I PAVARUR

I

Në Referendumin e mbajtur në Kosovë prej 26-30 shtator 1991, për Republikën e Kosovës shtet sovran e i pavarur, nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të Kosovës me të drejtë vote që ishin 1 051 357 veta, në Referendum dolën 914 802 veta ose 87.01%.

II

Nga ky numër "PËR" votuan 913 705 veta apo 99.87%.

³⁴ Po aty, 10 tetor 1991, f.1.

“KUNDËR” votuan 164 veta, ndërsa të pavlefshme ishin 933 fletëvotime.

Në Referendum për shkaqe dhe arsye të ndryshëm nuk dolën 135 555 votues, apo 12.99% qytetarë të Republikës së Kosovës me të drejtë vote.

III

Për realizimin e Referendumit pati 1 500 vendvotime dhe 450 njësi votuese.

IV

Kuvendi i Republikës së Kosovës, KONSTATON, se Referendumi i mbajtur në Kosovë prej 26-30 shtator 1991, për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, është i SUKSESSHËM pasi në të morën pjesë mbi 2/3 të numrit të përgjithshëm të qytetarëve me të drejtë vote në Republikën e Kosovës dhe se “PËR” u deklaruan më shumë se gjysma nga numri i qytetarëve, me të drejtë vote, që morën pjesë në Referendum.

V

Ky Vendim të shpallet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” dhe në mjetet e informimit publikë.

KK numër 17/19
Prishtinë, 19 tetor 1991

Kuvendi i Republikës së Kosovës
Kryetari i Kuvendit,
Ilaz Ramajli³⁵

Në fund mund të konstatohet se Referendumi për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran, i mbajtur nga 26 deri më 30 shtator të vitit 1991, ka një rendësi të madhe historike për arsye se populli shqiptar i Kosovës, u deklarua hapur për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.

Natyrisht, Referendumi ka rëndësi historike sepse ishte gur i rëndësishëm në shtetndërtimin e Kosovës si dhe drejt institucionalizimit

³⁵ ASHAK, Akte të Kuvendit..., f. 114-115.

të jetës politike në Kosovë. Referendumi si akt juridik dhe politik, gjeti përkrahje të fuqishme nga populli shqiptar në Kosovë si dhe nga disa etnitete të tjera, çka dëshmon provën për përcaktimin e qartë mbi të ardhmen shtetformuese të popullit shqiptar të Kosovës dhe për Republikën e Kosovës, si dëshmi më e mirë e sakrifice së shumë gjeneratave.

Shkodran IMERAJ

SUMMARY

THE REFERENDUM ON KOSOVO AS A SOVEREIGN AND INDEPENDENT STATE FROM 26th TO THE 30th OF SEPTEMBER 1991, ACCORDING TO THE NEWSPAPER "BUJKU" IN KOSOVO

The suspension of the Autonomy of Kosovo on March 28th, 1989, caused a fierce reaction of the Albanians. In all centers of Kosovo protests were organized, demonstrations and numerous meetings were held where the Albanians fiercely opposed approvals of the draft amendments with which Kosovo been detracted the constitutive element within the Yugoslav Federation. Assembly delegates elected in the elections of late 1989 had to deal with important duties. Since the first meetings of the Assembly, the relations between the Albanian and the Serb delegates of the Assembly of Kosovo became hardened. Being confronted with violent measures and in extraordinary circumstances, the delegates of the Assembly of Kosovo adopted by July 2nd, 1990 the Constitutional Declaration.

After the Constitutional Declaration, the delegates of the Assembly of Kosovo held a meeting in Kaçanik on September 7th, 1990, where they adopted the Constitution of the Republic of Kosovo – the Constitution of Kaçanik. The delegates of the Assembly of Kosovo adopted many other decisions and other acts of importance in which of particular importance was the decision about the referendum for a sovereign and independent state of Kosovo, dated on September 22nd, 1991. A referendum for a sovereign and independent state of Kosovo, was a very important event for the Kosovar Albanians and their statehood. With this referendum, the Kosovar Albanians had clearly defined their political future. The referendum was a major event, which did not pass without filling the pages of the press such as in Kosovo as well as beyond. In this paper, the referendum process organized and held from 26th to 30th of September 1991 in Kosovo is reflected by the daily newspaper "Bujku", which was published in the Albanian language in Kosovo.

Miftar KURTI

ZONA OPERATIVE E SHALËS DHE VEPRIMTARIA E SAJ LUFTARAKE¹

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte njëra prej kryengritjeve më të suksesshme të periudhës pas Luftë së Ftohtë, edhe pse u formua për një kohë relativisht të shkurtër. Nacionalizmi e definoi betejën e saj. Ideologjia e saj ishte pothuajse kryekëput ideologji e nacionalizmit shqiptar². Në vitin 1993 u krijuan rrethanat e mjaftueshme për krijimin e një organizmi ushtarak, që njihet si Ushtria Çlirimtare e Kosovës, kurse në vitin 1994 formohet Shtabi i Përgjithshëm (që ndryshe njihet si Shtabi Qendror) i saj, me seli në Prishtinë, në Lagjen Qendra të Prishtinës. Ky shtab kishte edhe objekte të tjera përcjellëse si në Kodrën e Diellit dhe në Dardani të Prishtinës. Në maj të vitit 1998, SHP formon të gjitha drejtoritë (G1-G9) përbërëse të Shtabit dhe merr formën complete të tij që nga struktura komanduese e deri te çdo detaj përbërës i organizimit të shtabit. SHP kishte edhe Batalionin vëzhgues-diversant, Batalionin e Policisë Ushtarake (PU), Batalionin e Logjistikës, Komandën e Mjekësisë Ushtarake dhe Batalionin e Ndërlidhjes, Radiostacionin “Kosova e lirë” dhe Agjencinë e lajmeve “Kosovapress”.³ UÇK kishte 7 zona operative: Zona Operative e

¹ Ku punim fillimisht (2008) është përgatitur gjatë studimeve si *Punim seminarik* në Departamentin e Historisë-Universiteti i Prishtinës. Kurse si punim është përgatitur për *Simpoziumin Shkencor* të organizuar nga *Instituti i Historisë* në Prishtinë, më 10 qershor 2010, në bashkëpunim me dr. Sabit Sylën dhe gjeneral Rrahman Ramën. Nga autori i këtij punimi janë bërë disa plotësime të nevojshme.

² Henry H. Perritt Jr., *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-rrëfim prej brenda për një kryengritje*, Koha, Prishtinë, shtator 2008, f. 8, 19, 25, 34, 47.

³ Gjeneralmajor Rexhep Selimi, *Rruga e formimit dhe organizimit të SHP të UÇK-së*, Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, SHFDU-Muzeu i Kosovës, 28 nëntor

Drenicës, Zonën Operative e Pashtrikut, Zona Operative e Dukagjinit, Zona Operative e Shalës, Zona Operative e Llapit, Zona Operative e Nerodimes dhe Zona Operative e Karadakut. Zona Operative e Shalës ishte njëra nga zonat operative të UÇK-së, e cila pati shtrirje që nga rajoni i Shalës së Bajgorës deri në Qyqavicë. Kjo Zonë kufizohej me Zonën Operative të Drenicës dhe Zonën Operative të Llapit.

Fillet e organizmit të UÇK-së në rajonin e Shalës i gjejmë që nga themelimi i Grupit të Drenicës dhe vet UÇK-së. Ali Jonuzi dhe Idriz Asllani kanë meritën kryesore në këtë drejtim, pra në formimin dhe masivizimin e UÇK-së. Prandaj ata akuzohen nga Serbia se kanë formuar “shoqatën terroriste” (UÇK-në-M.K.), se kanë ndërmarrë aksione të organizuara dhe koordinuara për të “rrezikuar rregullin shtetëror dhe sigurinë e RFJ-së, që territori i Kosovës dhe trojet tjera të banuara më shqiptarë të shpëputen nga ajo dhe të formohet shteti i veçantë dhe pastaj t’i bashkohet Shqipërisë”. Të ngarkuar me këto dhe akuza të tjera këta të dy, Idriz Asllani dhe Ali Jonuzi, më 11 korrik 1997 dënohen me nga 15 vjet burg (i fundit dënohet në mungesë).⁴ Mirëpo, një kontribut të çmuar për fillimin e luftës çlirimtare në Kosovë, për fillet e organizimit të UÇK-së, për masivizimin e saj në këtë rajon kanë dhënë, kush më shumë e kush më pak, kush më herët e kush më vonë, edhe Mehë Uka, Raif Çela, Gani Baliu, pastaj Rrahman Rama, Sabri Haziri, Hamit Muja, Isë Mërrnica, Ramadan Imeri, Rexhë Suma, Emin Musa, Hajzer Istrefi etj. Organizimi i një varg aksionesh kundër forcave pushtuese të celulave të para që nga themelimi i Grupit të Drenicës dhe vet UÇK-së, ku po veçojmë: sulmin në objektin e Ushtrisë Jugosllave në Vushtrri më 27 shtator 1996⁵; çarmatosjen e një patrulle të policisë serbe, më 9 dhjetor 1997, në Akrashticë⁶; sulmi i Grupit të Shalës, më 28 shkurt 1998, në burgun e Smrekonicës⁷ etj., hapin rrugën dhe shtrojnë nevojën e organizmit të njësiteve të UÇK-së (skuadra, togje, kompani, batalione deri edhe brigada) edhe në rajonin e Shalës së Bajgorës dhe Qyqavicë. Kështu, më 18 prill 1998, në fshatin Zabërgj të Shalës së Bajgore, me urdhër të Rrahman Ramës, del publikisht njësi

2002, Prishtinë, f. 14-16.

⁴ Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Dokumente dhe artikuj, Zëri i Kosovës, 1998, f. 165.

⁵ Po aty, f. 166.

⁶ Faik Shala: *U pamundësua plani sekret i armikut për krijimin e zonës së lirë serbe nga Frashri deri në Pantinë*, Zëri i Kosovës, 10 mars 2000.

⁷ Emin Musa&Miftar Kurti: *Kronologji ngjarjesh nga lufta dhe heroizmi i Brigadës 141 “Mehë Uka”*, Dorëshkrim, Arkivi i Brigadës 141 “Mehë Uka”, Mitrovicë, 2007, f. 1.

i parë i UÇK-së në rajonin e Shalës në përbërje: Avni Imeri, Freki Aliu, Emin Begu, Nexhat Dedia, Gani Imeri, Agim Zeka dhe Xhafer Bajrami. Mirëpo, një grup më i vogël në përbërje: Rexhë Suma, Isë Mërnica dhe Ramadan Imeri, kishte dalë në Bare dhe Bajgorë më 5 mars 1998.⁸

Më 17 mars të vitit 1998 u formua Shtabi në Zhilivodë.⁹ Më 5 maj krisi pushka çlirimtare në zonën urbane të qytetit të Mitrovicës nga studenti i Fakultetit Xehetaro-Metalurgji në Mitrovicë dhe Fakultetit të Gjuhës Angleze në Prishtinë, Artim Jashari, me ç'rast vrau dhe plagosi disa policë serbë. Gjatë sulmit të befasishëm ndaj policëve, Artimi plagoset rëndë dhe nga plagët e marra ndërron jetë.¹⁰ Më 6 qershor të vitit 1998, formohet zyrtarisht Shtabi i Ashlanit.¹¹ Më 18 qershor të këtij viti, merret Fabrika e Galanterisë së Lëkurës në Bare¹², e cila më vonë do të jetë në shërbim të Brigadës 141 “Mehë Uka” dhe gjithë UÇK-së. Nga kjo periudhë deri më 15 shtator 1998 në këtë fabrikë u qepën rreth 2 800 palë uniforma për Zonën Operative të Shalës (ZOSH), Zonën Operative të Llapit (ZOLL) dhe Zonën Operative të Drenicës (ZOD). Këto dhe veprime të tjera quan deri te formimi i Zonës Operative të Shalës (fillimisht si nënzonë) më 28 qershor 1998, ndërsa dy ditë më vonë, më 30 qershor formohet dhe Brigada 141 “Mehë Uka”, e cila pasohet nga Brigada 142. Shtabi i Zonës ishte në Ashlan. ZOSH, përveç dy brigadave kishte edhe Njësitin Special dhe Njësitin e Policisë Ushtarake. Brigadat kishin nga katër batalione (e para) përkatësisht dy batalione (e dyta), që ndaheshin në njësite më të vogla, si: kompani, togje, skuadra. Komanda e Zonës Operative të Shalës kishte këtë përbërje, këtë strukturë: Rahman Rama-komandant, Mensur Kosumizëvendëskomandant, Drita Simnica-ndihmëskomandant për çështje personale, Sabit Gashi-nd. komandant për informim, Bahri Nuredini-nd.komandant për financa, Ilaz Bejtullahu-nd.komandant për ndërlidhje, Xhevat Jusufi-nd.komandant për logjistikë, Ali Jonuzi-nd.komandant për moral dhe politikë, Isa Hajrizi-komandant i policisë ushtarake dhe Vedat Hyseni-zv.komandant, Bekim Shyti ishte komandant i Njësisë Speciale, ndërsa Ilir Shyti-zv.komandant. Duhet shtuar me këtë rast se

⁸ Po aty, f. 1.

⁹ Safet Hasani, Enver Tahiri (*Çyçavica çerdhe trimash*), Prishtinë: “Hivzi Sylejmani”, 2012, f. 48.

¹⁰ Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar, Mitrovicë, VipRint, Mitrovicë, 2009*, f. 175.

¹¹ Faik Shala: *U pamundësua plani sekret serb...*, Zëri, 10 mars 2000.

¹² Asllan Istrefi: *Themelimi i Brigadës 141 “Mehë Uka” dhe veprimtaria e saj luftarake njëvjeçare*, Raport, Ditari Operativ i Brigadës 141 “Mehë Uka” (1998-199).

Xhevat Jusufi, ka qenë ndihmëskomandant për logjistikë i Brigadës 141 “Mehë Uka” deri në nëntor 1998, pastaj është avancuar në nivel të ZOSH, ndërsa Behxhet Bala, pas datës 3 janar 1999 (pas vrasjes së Xhevat Jusufit), do ta kryejë detyrën e ndihmëskomandantit për Logjistikë në ZOSH. Edhe Ali Januzi, fillimisht do ta kryejë detyrën e ndihmëskomandantit për Moral dhe Politikë në nivel të Brigadës 141, mirëpo nga muaji nëntor 1998 do të avancohet në nivel të ZOSH.

Edhe dy brigadat kishin komandë dhe strukturë të mirëfilltë ushtarake. Ato ishin strukturuar me kohë. Kështu, Brigada 141 “Mehë Uka” kishte këtë strukturë: Hysni Ahmeti-komandant, Zymer Halimi-zëvendëskomandant, Feriz Fetahu-kryeshef i operativës, Emin Musa-ndihmëskomandant për çështje personale, Raif Preteni-nd. komandant për zbulim dhe kundërzbulim, Behxhet Bala-nd.komandant për logjistikë, Emin Begu-nd.komandant për moral dhe politikë, Ibrahim Ferati-komandant i togut të policisë ushtarake, ndërsa zv. komandant Ahmat Hasani. Nexhat Dedia ishte koordinator, por në Strukturën e Brigadës është edhe si ndihmëskomandant për Ndërlidhje. Në Shtabin e Brigadës, oficer për Operativë dhe Plane ka qenë i emëruar Asllan Istrefi. Shërbimin Mjekësor-Sanitar e kanë udhëhequr dr. Rustem Musa dhe dr. Agim Sherifi. Ky shërbim është formuar nga kirurgu i njohur Sami Beqiri. Udhëheqës i Shërbimit Teknik ka qenë Ramiz Osmani. Kjo brigadë kishte katër batalione (Batalioni I-komandant Hajzer Istrefi, zv.Riza Haziri; Batalioni II-komandant Ajet Bajrami; Batalioni III-komandant Hasan Preteni; dhe, Batalioni IV-komandant Gani Imeri dhe zv.komandant Bajram Beqiri), Njësitin Special-komandant Shemsi Ahmeti, zv.komandant Sabri Haziri, nd.komandant për çështje personale Miftar Kurti, kurse oficer për logjistikë Hajzer Kurti dhe, Njësitin për Intervenime të Shpejta në krye me komandant Rexhë Sumën; Togun e Policisë Ushtarake e ka komanduar Ibrahim Ferati. Në kuadër të Brigadës 141 “Mehë Uka” ka ekzistuar edhe Qendra e Stërvitjeve Themelore në shkollën-kazermë në Zabërgjë, të cilën fillimisht e ka udhëhequr Avni Imeri e pastaj Hysni Ahmeti dhe, krejt në fund Agim Zeneli. Edhe në Bajgorë ka ekzistuar Qendra e Stërvitjeve, të cilën e ka udhëhequr Shefqet Begu; në Bare Shemsi Ahmeti, kurse në Ceceli Shaip Azemi.¹³ Brigada 142 kishte këtë përbërje: Enver Oruqi-komandant, Met Shyti-ndihmëskomandant për çështje personale, Naim Qorolli-nd.komandant për çështje operative,

¹³ Miftar Kurti, *Intervistë me Emin Musën*, 5 janar 2013; Emin Musa, *Shënim*, prill 2015.

Eset Shaqiri-nd.komandant për logjistikë, Ferki Aliu-nd.komandant për Zbulim dhe Kundërzbulim, Avdyl Bahtiri-nd.komandant për çështje civile, Agim Zeka-komandant i Togut të Policisë Ushtarake. Brigada 142 kishte edhe dy batalione: Batalioni I, i cili për komandant kishte Aziz Bicin-Hafizi, kurse zëvendëskomandant ishte Behram Rrahmanin, ndërsa Batalioni II kishte komandant Gani Lahun.¹⁴

Si në çdo ushtri edhe në Ushtrinë Çlirimtare ka pasur strukturim dhe ristrukturim. Ristrukturimi ndodh (pas “*Ofensivës së verës dhe vjeshtës 1998*”) me një vendim të SHP të UÇK-së. Në Vendimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, me nr. prot. 442-7/662, të datës 19.11.1998, Prishtinë, të nënshkruar nga Jakup Krasniqi, thuhet: Shtabi i Përgjithshëm, në mbledhjen e mbajtur më 12.11.1998, mbështetur në nevojën e riorganizimit, strukturimit dhe ngritjes së komandimit, nxjerr këtë:

Vendim

1. Nënzonat Operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shpallen ZONA OPERATIVE.
2. Të bëhet ristrukturimi i Komandave të Zonave Operative.

Ky vendim u dedikohet: Zonave Operative, Arkivit të UÇK-së dhe Drejtorisë Operative.¹⁵ Ky vendim flet se UÇK-ja, pra edhe Zona Operative e Shalës, e kishte marrë veten shumë mirë dhe shumë shpejt pas *ofensivës së verës dhe fillim vjeshtës '98* dhe po bëhej gati për një luftë më gjithëpërfshirëse, për operacione shumë më të suksesshme dhe, pse jo edhe për një pranverë të nxehtë, ashtu siç edhe doli.

Konsolidimi i njësiteve të para të UÇK-së në rajonin e Shalës së Bajgorës dhe Qyqavicës, qe shoqëruar me veprime konkrete luftarake kundër forcave pushtuese. Mirëpo, intensiteti i veprimeve luftarake shtohet në muajin qershor të vitit 1998. Po veçojmë këtu fillimisht Betejën në Hamidi më 11 qershor 1998, në të cilën vriten dhe plagosen disa policë serbë. Në këtë betejë u plagosën ushtarët e UÇK-së, Brahim Kelmendi, Jashar Jashari dhe Rrahim Tahiri.¹⁶ Më pas do të zhvillohen luftimet në Pantinë dhe Frashër më 24-26 qershor 1998, që kulmojnë më 6 gusht 1998, me ç'rast bie heroikisht dëshmori i parë i UÇK-së në

¹⁴ Shih: *Struktura e ZOSH*, Arkivi i TMK, Sektori G5, Mitrovicë.

¹⁵ Shih: *Arkivi i Brigadës 141 “Mehë Uka”*.

¹⁶ Safet Hasani, *Enver Tahiri...*, f. 54.

Zonën Operative të Shalës, Jeton Tërstena.¹⁷ Pas këtyre u vjen radha betejave të tjera të ashpra dhe të përgjakshme, siç ishte rasti me Betejën e Mazhiqit që fillon më 10 përkatësisht 11 korrik, por që vazhdon me ndonjë ndërprerje deri më 16 shtator 1998. Në Betejën e Mazhiqit (më 11 korrik 1998), që njihet si beteja e parë frontale, morën pjesë ushtarë të dy Nënzonave Operative: të Shalës dhe Llapit.¹⁸ Me këtë rast, te Shkoza e Madhe e Mazhiqit, forcat armike lënë disa të vrarë dhe të plagosur, ndërsa u plagosën 5 ushtarë të UÇK-së. Barrën kryesore në këto luftime e ka patur Batalioni i Dytë me komandant Ajet Bajramin, por edhe me pjesëmarrjen edhe të Njësisë për Intervenime të Shpejta të Brigadës. Luftimet ishin shumë të ashpra, ku pati raste që u luftua edhe në 20 metra në distancë me armikun. Me këtë rast, kur flasim për Betejën e Mazhiqit, duhet veçuar edhe qëndresën burrërore të plakut Rifat Zeneli, i cili më 16 shtator 1998, duke luftuar bjen heroikisht, kurse shtëpia ju rrënua pothuaj tërësisht me tanke nga armiku serb. Është pohuar dhe dëshmuar nga vetë serbët se Rifat Zeneli gjatë luftimeve ka vrarë një toger të policisë dhe dy policë të tjerë i ka plagosur rëndë.¹⁹

Mirëpo, kulmi i qëndresës dhe sakrificës në këtë betejë dhe rajonin e Shalës së Bajgorës që ishte në zonën e përgjegjësisë së Brigadës 141 “Mehë Uka” arrihet me “*Ofensivën e Shtatorit*” nga data 14 deri 16 shtator 1998. “Sulmin në Shalë serbët e kishin bërë me një korpus dhe nga shumë drejtime”²⁰, duke e sulmuar Shalën përgjatë një vije të gjatë frontale: Rahovë-Cenaj-Melenicë-Trepçali-Mazhiq-Rashan-Sumë dhe nga prapa edhe nga Kaqanolli. Gjatë këtyre ditëve, gjatë kësaj periudhe kohore (prej 11 korrikut deri më 16 shtator) në këto vija të frontit bien në luftë 7 ushtarë të UÇK-së dhe po aq civil, ndërsa plagosen 20 ushtarë të tjerë. Numër të konsiderueshëm të vrarësh dhe të plagosurish pati edhe nga ana e forcave armike, të cilëve iu shkatërrua dhe një pjesë e mjeteve dhe pajisjeve luftarake. Shala e Bajgorës me këtë rast pothuaj u bë shkumb e hi nga forcat armike në pamundësi që ta shpartallojë Brigadën 141 “Mehë Uka”, e cila doli nga kjo luftë shumë e dëmtuar, por që shpejt i konsolidoj radhët e veta.²¹

¹⁷ Faik Shala: *U pamundësua plani sekret...*, 10 mars 2000.

¹⁸ Skender Zhitia: *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Zona Operative e Llapit*, Prishtinë, 2998, f. 134.

¹⁹ Miftar Kurti, *Intervistë me Emin Musën*, 5 janar 2013.

²⁰ Jakup Krasniqi: *Kthesa e madhe*, Buzuku, Prishtinë, 2007, f. 121.

²¹ Shih: *Ditari Operativ i Brigadës 141 “Mehë Uka”*; Miftar Kurti&Emin Musa: *Kronologji ngjarjesh ...*

Ofensiva e verës dhe e vjeshtës '98 në zonën e përgjegjësisë të Zonës Operative të Shalës nuk përfundon këtu. Ajo vazhdon më tutje drejt Vaganicës, Ashlanit dhe fshatrave të tjera rrëzë Qyqavicës. Një nga betejat më të ashpra në rajonin e përgjegjësisë së Brigadës 142 është edhe Beteja e Ashlanit. Për këtë betejë rrëfen dëshmitar i gjallë, pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i saj, nënkolonel i TMK-së Brahim Gjaka. Për këtë betejë ai shprehet: "Më datë 22. 09. 1998, në orët e hershme të mëngjesit, forca të mëdha policore e ushtarake me mjete të motorizuara dhe me artileri, pozicionohen në vijën frontale me gjatësi 3 km prej Kodrës së Madhe, fshati Pirç, dhe Kodra të "Pritat e Arifit" prej ku me artileri dhe mjete luftarake granatojnë fshatin Ashlan gjegjësisht pozicionet e UÇK-së. UÇK-ja ishte pozicionuar në vijën e mbrojtjes në Gurëbardh, në "Rrogën e Zhigës", të "Zabeli i Marës", të "Kodra e Vogël" në pjesën veriore të Ashlanit dhe të Kodra e Kishës. Luftimet zgjatën tërë ditën... Në mbrëmje, rreth orës 21:35, forcat e UÇK-së organizuan formën e luftës diversante në pozicionet e okupatorit dhe teknikën e tij duke i shkatërruar një tank, një autobлиндë dhe një kamion si dhe duke i vrarë dhe plagosur disa ushtarë dhe policë.

Kjo betejë zgjati edhe në ditët në vijim (më 23 dhe 24 shtator 1998)... Armiku në këtë betejë kishte angazhuar një numër të madh të ushtarëve, policëve dhe paramilitarëve të shoqëruar me artileri të rëndë dhe me pajisje të tjera luftarake. UÇK-ja në këtë betejë pati 4 ushtarë të vrarë dhe 5 të plagosur, por edhe 14 civil të vrarë dhe 1 i plagosur."²² Nga tetori deri në dhjetor, Zona Operative e Shalës merret me konsolidimin e radhëve të veta, me stërvitje të Njësitit Special të ZOSH-it dhe të Brigadës 141 "Mehë Uka", me sigurimin e sasisë së mjaftueshme të armatimit, të logjistikës etj. Pastaj në këtë kohë arrihet "Shpallja e Vetëpërmbajtjes nga SHP i UÇK-së, pas marrëveshjes Hollbruk-Milloshëviq", e cila, sipas U. Uokerit, ishte një nga ngjarjet që e ka përshpejtuar thirrjen e Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje.²³ Muaji janar i vitit 1999 në Zonën Operative të Shalës veçohet për dy ngjarje. E para, shumë e rëndë dhe e dhimbshme për UÇK-në, ka të bëjë me vrasjen në pritë nga forcat armike e Xhevat Jusufit ndihmëskomandant për logjistikë në ZOSH dhe plagosja e Zymer Halimit, zëvendëskomandantit të Brigadës 141 "Mehë Uka". Kjo

²² Nënkolonel Brahim Gjaka: *Beteja e Ashlanit...*, Shënim, Komanda e ZIV të TMK-së në Mitrovicë, 20.07.2001.

²³ Jakup Krasniqi: *Kthesa e madhe...*, f. 157.

ishte një humbje e madhe jo vetëm për Zonën Operative të Shalës por për gjithë UÇK-në. Kur Serbia mendoi se me këtë vrasje e shkatërroi UÇK-në në Zonën Operative të Shalës, kjo iu kthye bumerang me zënien rob të 8 pjesëtarëve të saj. Pra, ngjarja e dytë ka të bëjë me zënien rob të 7 ushtarëve dhe 1 rreshteri të Ushtrisë Jugosllave, më 8 janar 1999, rreth orës 11:00, në fshatin Bare, nga pjesëtarë të Policisë Ushtarake dhe të Njësitit Special të Brigadës 141 “Mehë Uka”. Dhe për këtë ngjarje është folur dhe shkruar gjatë luftës dhe pas saj. Vazhdon të shkruhet edhe sot. Kjo nuk është për t’u çuditur, sepse “*për historinë e UÇK-së, shënon një ndër të arriturat e saj më të mëdha gjatë luftës kundër forcave serbe*”.²⁴ Sipas ambasadorit U. Uoker, janë tri ngjarje që kanë ndodhur në Kosovë gjatë vitit 1998 dhe në janarin e vitit 1999 të cilat e kanë përshpejtuar thirrjen e Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje në dobi të Kosovës dhe popullit të saj. Njëra nga to, sipas tij, është “*marrëveshja me bashkësinë ndërkombëtare për lirin e pengjeve të luftës*”.²⁵

Pas zënies rob të ushtarëve jugosllavë, SHP i UÇK-së kishte proklamuar kushtet për lirin e tyre. Kushti kryesor ishte që të bëhej këmbimi i robërve të luftës. Pra, 8 ushtarët jugosllavë mund të liroheshin vetëm nëse liroheshin 9 ushtarët e UÇK-së të zënë rob në natën e 13-14 dhjetorit 1998 në kufirin Shqipëri-Kosovë. Kërkesa ultimative e UÇK-së për këmbimin e robërve të luftës atë kohë po e tmerronte Serbinë. Pavarësisht kërcënimeve dhe ultimatumave nga Serbia, UÇK-ja nuk lëshoi pe. Pas bisedimeve intensive mes faktorit UÇK dhe bashkësisë ndërkombëtare, e këta të fundit me Serbinë u arrit pajtimi që të bëhet këmbimi i robërve të luftës. Kështu, më 13 janar 1999 lirohen 8 ushtarakët serbo-malvezë të UJ-së, ndërsa dhjetë ditë më vonë, sipas marrëveshjes dhe garancisë së faktorit ndërkombëtar, më 23 janar, lirohen edhe 9 pjesëtarët e UÇK-së. Kjo përbënte një fitore të madhe politike, ushtarake dhe diplomatike për UÇK-në dhe Kosovën. Kjo ngjarje ishte edhe në fokus të shtypit të huaj. Komentet ishin të ndryshme. Sipas gazetës serbe “*Vreme*”, të datës 11 janar 1999, gazeta britanike “*Sandey telegraf*” njofton për bisedimet dramatike midis UÇK-së, e cila i mban tetë ushtarë të rrëmbyer jugosllav dhe përfaqësuesve të Komisionit Verifikues Kosovar. Gazeta shkruan se një nga oficerët në përbërje të KDOM-it është përpjekur që t’i vazhdojë bisedimet me UÇK-në për lirin e ushtarëve të zënë peng, por eprorët i kanë thënë

²⁴ Agim Zogaj: *Vdekja e madhe erdhi pa paralajmërim*, Zëri, 16 nëntor 2002, f. 18.

²⁵ Jakup Krasniqi: *Kthesa e madhe*, Buzuku, Prishtinë, 2007, f. 157.

që ai të tërhiqet, meqenëse ndërkohë është drejtuar presioni i fuqishëm ndërkombëtar ndaj komandantëve të UÇK-së në Dragobil, shtabin lokal të shqiptarëve të armatosur. Shqiptarët kryengritës, sipas kësaj gazete, po kushtëzojnë lirimin e ushtarëve me kërkesën që të lirohen nëntë pjesëtarë të UÇK-së.

Sipas gazetës tjetër, “Der Standard”, “rrëmbimi i tetë ushtarëve jugosllavë nga e ashtuquajtura UÇK nuk është i rastësishëm, por është aksion i planifikuar... Koha kur është bërë aksioni nuk është e zgjedhur rastësisht, sepse kryesuesi i ri i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, ministri i jashtëm norvegjez Knut Volebek, ka udhëtuar dje në Jugosllavi, ku do të bisedojë si me Millosheviqin ashtu edhe me liderët shqiptarë të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe Adem Demaqi, OSBE duhet të mbikëqyrë armëpushimin e arritur në tetor të vitit të kaluar, kurse tashti përfaqësuesit e saj po bisedojnë për lirimin e ushtarëve. Në këtë mënyrë, UÇK-ja politikisht ka fituar rëndësi, peshë...”. Ndërsa komenti i gazetës “Vreme”, të datës 16 janar 1999, ishte ky: “Nga kriza e pengjeve ka përfituar vetëm UÇK-ja... Është e qartë se shteti i Serbisë nuk është në gjendje që me mjetet e dhunës të shkatërrojë ose të mund UÇK-në. Të bësh përpjekje për një gjë të tillë, do të na kushtonte edhe më shtrenjtë sesa që kemi për të paguar. Në të vërtetë, UÇK-ja është shndërruar në faktorin më të fuqishëm politik të shqiptarëve.”²⁶ Mirëpo, përkundër të gjitha këtyre vlerësimeve, komenteve etj., lidhur me ngjarjen në fjalë, kohëve të fundit, janë bërë lëshime, janë hapur të pavërteta të cilat duam të besojmë se janë të paqëllimshme. Një gjë e tillë ka ndodhur në librin “Shqiptaro-amerikanët e UÇK-së” të autorit Uk Lushi. Aty thuhet: “Në janar të vitit 1999, formacionet e UÇK-së, të komanduara nga Rustem Mustafa (Komandant Remi), zunë rob tetë ushtarët jugosllavë në Zonën Operative të Llapit.”²⁷ Me gjithë respektin për autorin e këtij libri, për botuesin e librit, për Zonën Operative të Llapit dhe komandantin e saj Rustem Mustafën, duhet të themi se e vërteta është tjetër. Sepse faktet flasin ndryshe. Dhe e vërteta është kjo: Më 8 janar 1999, diku rreth orës 11:00, në fshatin Bare të Shalës së Bajgorës, Njësi Special në bashkëpunim me Policinë Ushtarake të Brigadës 141 “Mehë Uka” të Zonës Operative të Shalës, zunë rob 7 ushtarë dhe 1 rreshter të Ushtrisë Jugosllave, pa pasur mundësi që ata

²⁶ Po aty, f. 18.

²⁷ Uk Lushi: *Shqiptaro-amerikanët*, Koha, Prishtinë, 2009, f. 35-36.

ta shkrepin asnjë plumb.²⁸ Pra, siç flasin edhe faktet, siç flet burimi të cilit iu referuam, këta ushtarë janë zënë në Shalë të Bajgorës, në zonën e përgjegjësisë të Brigadës 141 “Mehë Uka” të Zonës Operative të Shalës.

Pas kësaj ngjarje, në muajin në vijim, më saktë më 22 shkurt 1999, atëherë kur bisedimet e Rambujesë kishin ditë që kishin filluar, armiku u mësyhet pozicioneve të Brigadës 142. Luftime të ashpra, që zgjatën nga 22 shkurti deri më 15 mars 1999, u zhvilluan sidomos më 22- 25, 27-28 shkurt dhe 8, 9, 12-15 mars. Luftohesh në kodrën që ndan Akrashticën dhe Shtitaricën, në fshatrat Bukosh, Liqe, Balinc, Dolak, Pantinë, Gurëbardh, Ashlan etj. Në këto luftime qenë përfshirë njësitet e Brigadës 142, Njësi Special i Zonës Operative të Shalës, Policia Ushtarake, mirëpo në ndihmë u shkon edhe një njësit i Brigadës 141 “Mehë Uka”. Njësi i Brigadës 141 do të qëndroi atje nga 25 shkurti deri më 17 mars 1999. Nga ky njësit në luftimet që u zhvilluan atje ra dëshmor Selim Bislimi, kurse u plagosën rëndë 6 të tjerë. Më saktë, në këto luftime, nga fillimi e në fund, ranë heroikisht 4 pjesëtarë të UÇK-së ku njëri nga ta ishte komandant togu, ndërsa u plagosën 14 pjesëtarë të tjerë, duke përfshirë këtu komandantin (Bekim Shyti) dhe zëvendëskomandantin (Ilir Shyti) e Njësitit Special të ZOSH dhe komandantin e Policisë Ushtarake (Isa Hajrizi) etj.²⁹ Të vrarët dhe të plagosurit ishin nga të gjitha njësitet pjesëmarrëse në këtë betejë, duke përfshirë këtu edhe nga Brigada 141 “Mehë Uka”.³⁰ Mirëpo, vija e frontit në zonën e përgjegjësisë së Brigadës 142 ishte më e gjatë, më e madhe, aq sa ishte e madhe edhe qëndresa. Me këtë rast, duhet përmendim Betejën e Druarit. Sipas Salih Salihut, që nga 3 marsi deri më 12 mars 1999, në fshatin Druar u zhvilluan luftimet ashpra jashtë të cilave nuk ngelën as Sallqi, Rezniku, Mirashi etj. Atje luftuan ushtarët e UÇK-së nga: Sibovci, Zhilivoda, Strofci, Bivolaku, Beçuku, Mihaliqi, Gurakuqi (ish-Gllavotini) etj. E gjithë kjo luftë, sipas veteranit të UÇK-së Salih Salihut, kishte filluar pas vrasjes së vëllezërve Radivoje e Lubisha Mitrovic që të dy policë përkatësisht pjesëtarë të organizatës “Dora e zezë” (Črna ruka) dhe zënies së Milan Radivoje Mitroviqit-ushtar i UJ-së nga ushtarët e UÇK-së në fshatin Mirash, më 3 mars 1999. Pozicionet e UÇK-së gjatë këtyre luftimeve qëllloheshin nga Lumi i Madh, Graca, Vërnica, Sallqi, Prilluzha etj. Në këto luftime në rajonin

²⁸ Shih: *Ditari Operativ i Brigadës 141 “Mehë Uka”*, Arkivi.

²⁹ Faik Shala: *Heroizimi i paparë i Brigadës 142*, Zëri i Kosovës, 25 shkurt 2000, f. 10.

³⁰ M. Kurti&E. Musa: *Kronologji ngjarjesh...*, Arkivi i UÇK-së, Mitrovicë, 2007.

e përgjegjësisë së Batalionit I të Brigadës 142, sipas Salih Salihut, u plagosën 8 pjesëtarë të UÇK-së. Mirëpo edhe armiku pati disa të vrarë dhe të plagosur.³¹

Duke e parë gjendjen shumë të vështirë të Brigadës 142 për shkak të sulmeve të forcave armike, me urdhër të komandës të Zonës Operative të Shalës, vihen në veprim dhe në sulm kundër forcave armike njësite të Brigadës 141 “Mehë Uka”, edhe pse një njësit kishte shkuar tashmë në ndihmë atje, por kjo sikur nuk po mjaftonte. Prandaj, më 13 mars 1999, fillon sulmi i koordinuar i njësiteve të brigadës së Shalës. Me granatahedhës 82mm dhe 120mm nga Trepçalitë dhe me top 75mm dhe gulinov 12.7mm nga Melenica sulmohen pozicionet armike në Trepçë dhe Kutllovc, ndërsa forcat armike në Bajër sulmohen nga fshati Sumë me granatahedhës 120mm.

Mesa duket, në shenjë hakmarrjeje ndaj këtij sulmi të rrufeshëm, vetëm dy orë pasi ndalen sulmet e UÇK-së, të njëjtën ditë, më 13 mars, pason një hakmarrje (masakër) e tmerrshme e armikut ndaj popullatës civile në tregun e Mitrovicës, me ç’rast vriten 6 dhe plagosen mbi 120 civilë³² moshash të ndryshme, por sulmohen edhe disa pozicione të UÇK-së në Shalë me artileri të rëndë. Një javë më pas, më 21 mars, fillon një ofensivë serbe e përmasave të mëdha, me ç’rast sulmohen me artileri (nga Kutllovci, Bajri dhe Zherovnica) dhe këmbësori nga Trepça e Rahova, pozicionet e UÇK-së në Trepçali, Melenicë, Vidishiq, Bare etj. Kjo vazhdon edhe në ditët në vijim (më 22 dhe 23 mars), kurse më 24 mars zgjerohet vija frontale e luftës, me ç’rast sulmohet Suma dhe Skroma. Pastaj, më 26 mars, artileria armike sulmon edhe në drejtim të Kçiqit dhe Karaçës. Kësisoj armiku vazhdon deri më 31 mars. Në këtë datë, pra më 31 mars, vija e frontit zgjerohet në drejtim të Studimes, Cecelisë, Dumnicës, Samadrexhës etj. Kur armiku e pa se Shala e Bajgorës nuk mund të pushtohet as me artileri e as me këmbësori, atëherë u detyrua të përdor aeroplan luftarak. Kështu, më 2 prill 1999, me aeroplan luftarak bombardohet shkolla-spital ushtarak në fshatin Bajgorë, që s’do mend se la dy të vrarë dhe disa të plagosur. Po të njëjtën ditë granatohet dhe Kçiqi me ç’rast vriten 8 civil pjesëtarë të një familje. Sulmet frontale me këmbësori dhe artileri pothuaj ishin të përditshme në vijën frontale Melenicë-Trepçali-Vidishiq etj. deri më 30

³¹ Salih Salihu: *Beteja e Druarit...*, Shënim, Vushtrri, 6.08. 2001, Arkivi i Zonës IV Mbrojtëse -Sektori G5.

³² Halit Barani, *Tmerri i dokumentuar...*, f. 3.

prill. Që t'i ndalet turri forcave armike, me urdhër të komandës të ZOSH-it njësite të Brigadës 141 "Mehë Uka", duke përfshirë këtu edhe Njësitin Special, hidhen në sulm për herë të tretë në pozicionet e armikut në fshatin Rahovë në natën e 5-6 prillit. Edhe në Rahovë, si edhe në të gjitha vijat e frontit, pati disa të vrarë dhe të plagosur nga të dy anët. I vrarë mbeti ushtari i Batalionit III, Hajrullah Sinani, kurse u plagos komandanti i Togut të Tretë të Njësisë Speciale, Ali Berisha.

Të nesërmen e kësaj date, pra më 7 prill, armiku sulmoi pozicionet e Batalionit IV ne Ceceli, Studime, Stanovc, Dumnicë etj. Si kundërvënie, më 10 prill, një njësit i Batalionit IV dhe disa ushtarë të Batalionit I i sulmojnë pozicionet armike në Gojbulë. Më 12 prill nga Njësitin Special sulmohet një konvoj i forcave serbe të cilat po ngjiteshin në drejtim të bazës ushtarake në Kutllovc. Ditët në vijim po zgjerohej edhe më vija frontale, por tash në drejtim të pozicioneve të UÇK-së (të Batalionit III) në Lagjen Cenaj, Majdan dhe Preten. Intensiteti i luftimeve po shtohet, humbjet në njerëz dhe mjete luftarake ishin të mëdha nga të dy anët. Municioni nisi të pakësohej në radhët e UÇK-së. Duhej bërë zgjidhje. Zgjidhja ishte sulmi mbi objektin ushtarak serb në Kutllovc. Dhe kjo ndodhi më 21 dhe 22 prill 1999. Me sulme të shpejta, të rrufeshme u arrit të nxirren nga ajo bazë rreth 80 mijë fishekë kalibrash të ndryshëm, predha granatahedhësish, disa pushkë automatike, snajperë, por edhe miell e artikuj të nevojshëm për popullatën.³³

Nga data 23-30 prill 1999 e gjen në zjarr të egër të këmbësores dhe artilerisë pothuaj çdo pozicion të UÇK-së në Shalë të Bajgorës, por luftimet më të ashpra zhvilloheshin përgjatë Lagjes Cenaj, Mali i Majdanit, Preten, Melenicë, Tepçali, Studime, Dumnicë etj. Po ashtu sulmohen Vallahia, Magjera, Selaci, Kaçanolli etj. Se me çfarë lufte po përballeshin shaljanët, mjafton të përmendet fakti se vetëm më 26 prill, në Kodrën e Majdanit, vriten 6 pjesëtarë të UÇK-së (Rrustem Hyseni, Arsim Muzaqi, Ahmet Haxha, Xhemajl Haxha, Asllan Cimili) në krye me komandantin e Njësitit Special Shemsi Ahmeti dhe u plagosën 3 të tjerë (Ismail Istrefi, Mustafë Ibishi dhe Bajram Peci). Luftime tepër të ashpra u zhvilluan edhe më 27-29 prill me ç'rast u vranë 5 pjesëtarë të UÇK-së (Qazim Cimili, Sokol Preteni, Esat Mehulli, Enver Musa-Divi dhe Shemsi Istrefi) dhe 3 u plagosën (Miftar Kurti, Basri Zeneli dhe Lulzim Cimili). Më 30 prill njësitet e UÇK-së nisin të tërhiqen në pozicionet e dyta (rezervë), sepse ata u sulmuan nga shumë drejtime.

³³ Gjeneral Zymer Halimi-Besi, *Ditari i luftës*.

Sulmet ishin drejtuar mbi këto pozicione të UÇK-së: Maja e Madhe-Gurishtë-Qafë Bare-Cërnavërë; Bajgorë- Vesekovc- Ceceli-Studime; Bajgorë-Parduzaj-Kurillovë-Sllakovc; Bare- Gumnishtë Bozhlan-Skromë-Studime; Mazhiq-Tërstenë-Rashan-Sumë-Smrekonicë etj. Forcat armike në pamundësi që ta shpartallojnë UÇK-në në këto anë dhe për shkak të humbjeve të mëdha që kishin pësuar sidomos në Majdan dhe Preten, më 2 maj 1999, na fshatin Studime vranë dhe masakruan diku rreth 100 civilë dhe plagosen shumë të tjerë. S'do mend se numri i të rënëve dhe të plagosurve në Shalë gjatë kësaj ofensive (13 mars-30 prill 1999) dhe më vonë, ishte i konsiderueshëm në të dy anët. Nëpër vija të fronit vetëm nga data 13 mars deri më 10 maj ranë 28 dëshmorë dhe rreth 110 civil, ndërsa u plagosën 35 ushtarë të UÇK-së dhe 11 civilë.³⁴ Në maj të vitit 1999, në ZOSH u realizuan edhe një mori aksionesh guerile nga luftëtarët e UÇK-së, të Batalionit të Parë të Brigadës 142, me ç'rast armiku pësoi edhe humbje.³⁵

Rajoni i Shalës së Bajgores, përveç arenë luftimesh, qe shndërruar edhe në poligon stërvitjesh për ushtarët e Zonës Operative të Shalës dhe të Zonës Operative të Llapit. Sidomos kjo ndodhi në fshatrat Zabërgj, Bajgorë dhe Bare. Stërvitjet e para, që filluan diku kah fundi i muajit prill dhe fillimi i muajit maj, nisin në fshatin Zabërgj të Shalës së Bajgorës, mirëpo intensiteti i stërvitjeve në këtë qendër stërvitjesh vjen duke u rritur me të madhe në muajit qershor dhe korrik. Zabërgja ishte qendra e parë e stërvitjeve themelore për të dy (nën)zonat operative të Shalës dhe Llapit. "Gjithçka në këtë kohë kishte adresën Lajthishtë (Zabërgj), Malësi e Shalës, adresë ku po stërviteshin ushtarët e dy nënzonave Operative të UÇK-së".³⁶ Kah mesi i korrikut '98 Qendër e Stërvitjeve (për dy nënzonat-M.K) do të bëhet shkolla e fshatit Bajgorë, fushat, kodrat dhe malet e atyre anëve. Kështu ndodh deri në përfundim të "Ofensivës së shtatorit '98" në rajonin e Shalës. Më pas, nga tetori 1998, Bajgora dhe Barja do të bëhen qendra të stërvitjeve themelore, por edhe të stërvitjeve speciale të Njësitit Special të Brigadës 141 "Mehë Uka", ndërsa ushtarët e ZOLL stërvitjet do t'i vazhdojnë në vende të tjera të krahinës së Llapit. Nga mesi i vitit 1998, pjesa më e madhe e ushtarëve të UÇK-së iu nënshtruan stërvitjeve sistematike. Stërvitja e UÇK-së mund të krahasohet me një shumëllojshmëri

³⁴ M. K.&E. M.: Kronologji ngjarjesh..., Ditari Operativ i Brigadës 141 "Mehë Uka".

³⁵ Habib Mustafa, Shënim, 15 maj 2013.

³⁶ Skender Zhitia: *Ushtria Çlirimtare...*, f. 128.

modele. Sepse UÇK-ja kishte kuadrin e nevojshëm për t'i organizuar stërvitjet. UÇK u bazua në modelet e programeve stërvitëse të Ushtrisë Jugosllave dhe Armatës së Shqipërisë dhe, kur kishte njohuri për to, në modelet e NATO-s, që janë të ngjashme me modelin e Armatës së SHBA-së.³⁷ Nga stërvitjet fitoi shumë edhe Zona Operative e Shalës. U arritën të përgatiten, të stërviten dhe njësi elite, Njësi Speciale, siç ishin ajo e ZOSH dhe e Brigadës 141 "Mehë Uka", të cilat bartën barrën më të rëndë të luftës dhe, në fund të luftës, për rezultatet e treguara këto njësite, u shndërruan në Batalion Gardist. Për organizimin e këtyre stërvitjeve, sipas gjeneralbrigade Zymer Halimi (ish-zv. komandant i Brigadës 141 "Mehë Uka"), u caktua plani i ushtrimeve, i stërvitjeve enkas për Njësitin Special në këto fusha: taktikë e përgjithshme, taktikë speciale, përdorim i të gjitha llojeve të armatimit në dispozicion, topografi dhe përgatitje moralo-politike. Për çdo lëmi u caktuan eprorët përkatës në stërvitje."³⁸

Në qendrat stërvitore në Zabërgj, Bajgorë dhe më pas edhe në Bare, rekrutët stërviteshin fillimisht që të përdornin armët e disa llojeve që i posedonin aso kohe, si: AK-47, M-48, snajper, gjysmautomatikë, mortaja, osa, bazuka, nitroglicerina, armë kundërblinduese, armë kundërajrore ('gulinov 12.7), të topave 75 mm, por disa edhe në përdorimin e granatahdhësve 60mm, 82 mm dhe 120 mm, kur dihet se në këtë Zonë (më saktë Brigada 141 "Mehë Uka"), me iniciativën, punën dhe angazhimin e komandant Shemsi Ahmetit formohet (shkurt 1999) dhe Njësit i Artilerisë. Sa i përket furnizimit me armë duhet thënë se është bërë, siç thotë ish-komandanti i ZOSH, Rrahman Rama, përmes kanaleve të ndryshme, por kryesisht nga Shqipëria dhe Bosnja. *"Personalisht ka udhëhequr grupe të shumta për armatim në Shqipëri. Ishin këto rrugëtime të gjata dhe të mundimshme, me plot peripeci dhe rreziqe, por ideali për liri ishte mbi të gjitha"*.³⁹ Furnizimit me armatim, duhet thënë se kanë ekzistuar disa linja prej nga u furnizua me armatim kjo Zonë. Më së shumti armatimi u mor nga Shqipëria, pastaj nga Bosnja, por dhe gjatë betejave dhe sulmeve në objekte ushtarake serbe, siç ishte rasti më 21 dhe 22 prill 1999, ku ushtarët e UÇK-së u futën në objektin ushtarak në Kutlllovç dhe marrin me mijëra fishekë, disa lloj armësh dhe artikuj ushqimor për popullatën.

³⁷ Hanry Perritt: *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: rrëfim prej brenda...*, f. 144-145.

³⁸ Riza Greiçevci: *Gjergji i maleve të Shalës*, Prishtinë, 2004, f. 40.

³⁹ Hysni Syla, *Fushata ajrore e NATO-s për ne ishte shpresëdhënëse (Intervistë me Rrahman Ramën ish-komandant i ZOSH)*, "Kosova sot", 25 mars 2000, f. 10.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, si në gjithë zonat ashtu edhe në Zonë Operative të Shalës, pati përkrahjen nevojshme sidomos të popullatës, por edhe të shoqatave (si SHHB “Nënë Tereza”, subjekteve politike (LDK, LBD etj.), shërbimit sanitar etj., por edhe të ndonjë afaristi. Bashkëpunim të kënaqshëm pati edhe me media lokale dhe të huaja. Përzemërsia e popullatës, afria e saj me bijtë e saj të UÇK-së, ua lehtësoi shumë punën ushtarëve. Çdo kund dhe çdo herë, në situata e rrethana të caktuara, çdo shtëpi ishte e hapur për ushtarët, sofrat ishin të shtrutura në çdo moment, popullata e ndau bukën e gojës me bijtë e vet. Pa përkrahjen e nevojshme sidomos të popullatës UÇK-ja nuk do të arrinte të mbijetonte pas atyre sfidash dhe vështirësish. Fundja dhe lufta po bëhej për lirinë e popullit dhe të atdheut, prandaj ekzistonte kjo afri, kjo përkrahje, ky bashkëpunim i dyanshëm. Edhe subjektet politike (që vepronin aso kohe në komunat e Vushtrrisë dhe Mitrovicës) dhanë mbështetjen e vet si gati në asnjë zonë tjetër. Në shenjë mirënjohjeje, komanda e Zonës Operative të Shalës, me rastin e 28 Nëntorit-Ditës së Flamurit, në një organizim të një manifestimi të përbashkët me popullatën dhe ushtarët, në fshatin Bajgorë, pas demonstrimit të një stërvitjeje të Njësitit Speciale të Brigadës 141 “Mehë Uka” u ndanë mirënjohje jo vetëm për ushtarë të dalluar, për individë aktivist të dëshmuar, por edhe për subjekte politike (duke përfshirë këtu edhe LDK-në-M.K.), edhe për gazetarë. Ky fakt flet vet. Mirëpo, edhe UÇK-ja në çdo rast dhe rrethanë punën e parë që bënte ishte t’i dalë në mbrojtje popullatës, të bëjë evakuimin e saj nga zona më të rrezikshme në ato më pak të rrezikshme, t’i strehojë, t’u jap ndihmë dhe trajtim mjekësor aq sa mund të veprohet në rrethana lufte, t’u sigurojë ushqim etj. Më këtë Zonë ka qenë karakteristikë sigurimi i rezervave të miellit, ndërtimi furrave të bukës, aktivizimi i mullinjve për bluarje të grurit dhe misrit, kujdesi shëndetësor, ndihma dhënë të plagosurve civil etj. Vetëm nga 2 maji 1999 deri në përfundim të luftës, sipas evidencave të shërbimit sanitar të Brigadës 141 “Mehë Uka” janë trajtuar, u është dhënë ndihma e nevojshme mjekësore rreth 4000 civilëve. Kështu u veprua deri me përfundimin e luftës. Zona Operative e Shalës pati konsideratë të nevojshme edhe ndaj gazetarëve të cilëve për aq sa ishte e mundur u ndihmojë, u ofrojë bashkëpunim në rrethana lufte, u plasojë informata që ishin për opinion duke kontribuar shumë në informimin e drejtë të opinionit publik vendor dhe të huaj për gjithë atë që po ndodhte. ZOSH për këtë kishte emëruar personat përkatës, pra për t’u marrë edhe me gazetarë, me informim etj. Kjo shihet edhe nga struktura

e saj. Për më tepër Brigada 141 “Mehë Uka” kishte dhe *Buletinin*, ekzemplarë të cilët ruhen edhe sot në Arkivin e Brigadës. Natyrisht nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me gazetarë mediesh të ndryshme (të huaja) botërore prestigjioze.

Përveç me gazetarë mediesh të huaja bashkëpunimi nuk ka munguar edhe me Misionin Verifikues Ndërkombëtar, me OSBE-në etj.⁴⁰ Mirëpo, në ndonjë rast marrëdhëniet me to kanë njohur edhe acarime, presione dhe “mosmarrëveshje”. Kjo është reflektuar sidomos me rastin e zënies rob të 8 ushtarëve serbë, ku presioni i tyre ka qenë i madh dhe, në ndonjë rast i paarsyeshëm sidomos ndaj kreut të ZOSH. Por, nuk do të kalojë shumë kohë që edhe faktori ndërkombëtar, i cili vepronte aso kohe në Kosovë, të bëjë presion ndaj atyre që duhej bërë, pra ndaj forcave policore, ushtarake dhe paramilitare serbë që po ushtronte gjenocid. Presioni ndërkombëtarë do të kulmojë me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s. Kjo çoi deri te koordinimi i veprimeve UÇK-NATO, kjo qoi edhe në çlirimin e Kosovës në qershor të vitit 1999, ku një kontribut shumë të çmuar dha edhe Zona Operative e Shalës. Në Zonën Operative të Shalës u zhvilluan, në të shumtën e rasteve, dy forma të luftës: guerile dhe frontale. Në ndonjë rast pati edhe kombinim të këtyre të dyjave. Por mund të themi se lufta frontale dominoi duke pasur parasysh pozitën gjeografike që kishte ky rajon. Numri i ushtarëve a komandantëve të UÇK-së të Zonës Operative të Shalës që ranë në luftë kundër armikut është i konsiderueshëm. Ata ishin nga fshatra dhe qytet të ndryshme. Edhe profesionet, edhe dëshirat, edhe ëndrrat, edhe përgatitja shkollore profesionale i kishin të ndryshme. Edhe mosha e tyre ishte e ndryshme. Por ata kishin një gjë të përbashkët: ëndrrën për çlirim dhe bashkim kombëtar. Rënia e tyre ishte sa heroike aq edhe krenare. Vende, betejat, aksionet, istikamet, pozicionet, çastet, orët, ditët, javët muajt dhe vitet kur ata ranë ishin, gjithashtu, të ndryshme. Ata ranë në mbrojtje të nderit, identitetit dhe krenarisë kombëtare pavarësisht nga cili vend, nga cila lagje, në cilin fshat, qytet a krahinë u lindën, u rritën, punuan, u shkolluan dhe luftuan derisa ata ranë: dikush në prag të shtëpisë a kullës, dikush maje ndonjë kodre, në ndonjë lëndinë, buzë një lumi a të ndonjë shkëmb, pranë një lisi a shkurreje të cilës do krahinë të Kosovës: në Shalë, Drenicë, Dukagjin, Llap..., a në brezin kufitar që ndante shqiptarët padrejtësisht. Kështu ishte edhe me të plagosurit. Zona Operative e Shalës dha 136 dëshmorë dhe 209 të plagosur.

⁴⁰ Shih: Lista e personave të Misionit Verifikues..., Arkivi i Brigadës 141 “Mehë Uka”.

Sipas listës zyrtare të qershorit 2010, Zona Operative e Shalës dha 136 dëshmorë. Numri i të plagosurve është edhe më i madh se i atyre që morën rrugën e përjetësisë. Sipas Listës zyrtar numri i të plagosurve arrin në 209.⁴¹ Shpesh është paragjykuar pa të drejtë se në kuadër të UÇK-së përgjithësisht, pra edhe të ZOSH nuk ka pasur, ose ka pasur shumë pak njerëz të arsimuar. Të dhënat nga terreni, nga arkivi Brigadës 141 e 142, të ZOSH dhe Zonës IV Mbrojtëse të TMK-së, dëshmojnë se ka pasur mjaft të shkolluar. Kështu nga Brigada 141 pjesë e UÇK-së ishin: Abedin Ferizi (drejtor shkolle), Asllan Istrefi (profesor i gjuhës shqipe dhe oficer rezervë i APJ), Ajet Bajrami (arsimtar dhe oficer rezervë), Azem Musliu (arsimtar), dr. Faik Bllata (profesor dhe mjek-kirurg), dr. Bajram Rexhepi (profesor dhe mjek-kirurg), Bajram Uka (arsimtar), Bahtir Përçuku (arsimtar), Behxhet Bregaj (profesor), Dibran Përçuku (drejtor), Emin Musa (arsimtar), Esat Miftari (arsimtar), Fetah Tahiri (arsimtar), Hajzer Istrefi (mësues), Hamit Muja (mësues), Imer Miftari (drejtor shkolle dhe oficer rezervë), Ilmi Ahmeti (profesor), Ismail Hasani (mësues), Jetullah Zeneli (arsimtar), Miftar Kurti (arsimtar), Mexhit Hyseni (arsimtar), Mustafë Murseli (arsimtar), Musë Tërbunja (profesor), Muhamet Sadiku (mësues), Niman Nimani (drejtor shkolle dhe oficer rezervë), Nexhmedin Mustafa (profesor), Naim Hyseni (arsimtar), Rizah Haziri (drejtor), Rexhep Islami (arsimtar), Rexhep Ahmeti (profesor), Ramiz Osmani (profesor), Remzi Prroaj (arsimtar), Ramë Uka (mësues), Shkuri Begu (mësues), Sheshivr Ademi (arsimtar), Shaip Azemi (arsimtar), Xhevat Jusufi (drejtor shkolle dhe oficer rezervë) dhe Xhafer Fejza (arsimtar).⁴² Pra, gjithsej 38 mësimdhënës, prej të cilëve 6 mësues, 17 arsimtarë, 8 profesorë dhe 6 drejtorë. Oficerë dhe ushtarakë profesionistë nga Brigada 141 “Mehë Uka” ishin: Zymer Halimi, Shemsi Ahmeti, Hysni Ahmeti, Hasan Preteni, kurse me shkollë të mesme dhe akademi policore ishin: Raif Preteni, Ibrahim Ferati, Driton Zabërgja etj. Zymer Halimi, Shemsi Ahmeti dhe Hysni Ahmeti ishin pjesëmarrës të luftërave në Kroaci dhe Bosnjë. Afërsisht i njëjtë ishte edhe në Brigadën 142. Si personal arsimor si pjesë e UÇK-së në Brigadës 142 ishin: Afrim Zhabari (profesor), Agron Gjaka (mësues), Ali Krasniqi (arsimtar), Adem Shyti (arsimtar), Abdyl Bahtiri (arsimtar), Bashkim Asllani

⁴¹ Lista e dëshmorëve dhe të plagosurve të ZOSH-it, Arkivi i ZVM-TMK, Mitrovicë.

⁴² Emin Musa, *Lista e mësimdhënësve të cilët ishin pjesë e Brigadës 141 “Mehë Uka”*, 2013.

(mësues), Avdi Gela (mësues), Bedri Shyti (profesor), Bedri Shala (mësues), Behxhet Jashari (profesor), Beqir Asllani (arsimtar), Eset Kadriu (profesor), Ferit Avdiu (arsimtar), Fetah Berisha (arsimtar), Fadil Berisha (mësues), Fejzullah Hasani (punëtor teknik), Gëzim Jashari (arsimtar), Halit Gjaka (arsimtar), Habib Kamberi (profesor), Habib Mustafa (arsimtar), Hamdi Shyti (mësues), Ibrahi Gjaka (mësues), Ismet Saraqi (mësues), Mustafë Shyti (sekretar shkollë), Met Shyti (profesor dhe oficer), Mrikë Berisha (mësuese), Nuredin Hasani (punëtor teknik), Petrit Saraqi (profesor), Sefer Shyti (mësues), Smajl Jashari (arsimtar), Skender Sylja (arsimtar), Sheremet Saraqi (mësues), Xhemajl Pllana (profesor) dhe Xhavit Haliti (arsimtar). Gjithsej: 38 vetë, prej tyre 8 profesorë, 12 arsimtarë, 11 mësues, 1 sekretar shkollë dhe 2 punëtorë teknikë. Mos të harrojmë se me akademi ushtarake ishte edhe komandanti i Brigadës 142, Enver Aruçi. Nga personeli arsimor si pjesë e ZOSH ranë dëshmorë: Abedin Ferizi, Xhevat Jusufi, Fetah Tahiri dhe Mustafë Shyti, kurse ata që u plagosën ishin: Eset Kadriu, Miftar Kurti, Hamdi Shyti, Sefer Shyti etj.⁴³ Kemi edhe një rast të veçantë dhe të rrallë kur një nxënës i Gjimnazit “Franga Bradhi”, jo vetëm që bëhet ushtar i UÇK-së, por edhe bjen heroikisht në luftë kundër armikut më 2 maj 1998, dhe shpallet Dëshmor i Kombit. Është fjala për Bajram Musën (1981-1999), i cili ishte madje edhe pjesë e Njësitit Special të Brigadës 141 “Mehë Uka”. Shpesh diskutohet dhe spekulohet se kush në të vërtetë e çliroi Kosovën. Mirëpo, lidhur me këtë, gjenerali i Ushtrisë Shqiptare, Kudusi Lama, me të drejtë konstaton: “Në të gjitha analizat dhe planet e luftës del përfundimi se faktori vendimtar për të gjitha të arriturat në Kosovë, ishte Lufta Çlirimtare e Kosovës, ishte UÇK-ja me dinamizmin, pjekurinë, operacionalitetin, zhdërvjelltësinë, largëpamësinë, qëndrueshmërinë unitetin, kompleksitetin dhe ndërveprueshmërinë.

Të gjithë faktorët e tjerë kanë qenë faktorë ndihmës dhe mbështetës... Pra, është e qartë se pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe pa luftën e saj, nuk do të kishte as ndërhyrje të NATO-s dhe as mbështetje të opinionit ndërkombëtar dhe organizmave evropiane e botërorë.”⁴⁴ E pjesë e UÇK-së, e luftës së Kosovës ishin edhe shaljanët, ishte edhe Zona Operative e Shalës, një nga ato zona që sakrifikojë aq shumë për lirinë e atdheut dhe të kombit.

⁴³ Sabit Sylja, *Arsimi shqip në Mitrovicë 1990-1999*, Libri shkollor, Prishtinë, 2013, f. 203, 204.

⁴⁴ Kudusi Lama: *Kosova dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Tiranë, 2005, f. 361, 362.

Miftar KURTI

SUMMARY

THE SHALA OPERATIVE ZONE WAS ONE OF SEVEN OPERATIONAL ZONES OF THE KOSOVO LIBERATION ARMY

The Shala Operative Zone was one of seven operational zones of the Kosovo Liberation Army, which was founded on 28th of June 1998. The commander of the area was Rahman Rama. This area bordered the Drenica Operative Zone and the Llap Operative Zone. It consisted of two brigades, Brigade 141 named "Mehë Uka", whose commander was Hysni Ahmeti and Brigade 142, whose commander was Enver Aruçi, of one Special Unit, a Military Police, etc. There was a proper military structure, according to those types: Zone, brigade, battalion, company, platoon, squad and team. This area gave Kosovo three heroes: Mehë Uka, Xhevat Jusuf and Shemsi Ahmeti; 136 martyrs and 209 invalids; 2 generals: General Rahman Rama and Brigadier General Zymer Halimi-Besi. The combat activity of this area began in the early days of its formation.

From its combat activity can be highlighted several battles: the Battle of Hamidi, the Battle of Pantina, the Battle of Mazhiq, the Battle of Melenica, Majdan and Preteni; the Battle of Kaçanolli, the Battle of Ashlani; the battles fought around the villages at the foot of Qyqavica, the Battle of Druari; the Battle of the Dumnica, Samadrexha and Studime region, etc. Two of the major operations that gave the war of the KLA a national and international dimension are, the action of its members where they captured 8 soldiers of the Yugoslav Army on January the 8th 1999, who were exchanged with nine soldiers of the KLA, that were held captive in different Yugoslavian prisons and the operation of the overrun of the Serbian Military Base of Kutlllovc on 22nd and 23rd of April 1999. This area has applied two forms of war: a guerrilla war and the frontal fight. Weaponry has been secured from Albania, Bosnia and from its combat actions.

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Hamit KABA

TË DREJTAT E NJERIUT NË JUGOSLLAVI (1983)

Raporti i mëposhtëm u hartua nga Komisioni për Marrëdhëniet me Jashtë në Dhomën e Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në vitin 1984. Ai bazohet në vëzhgimet e Komisionit Amerikan të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe tek informacioni i sjellë nga “Amnesty International”. Dokumenti merret me probleme që prekin nivelin e zbatueshmërisë së lirive dhe të drejtave të njeriut në Jugosllavinë e vitit 1983. Baza morale dhe juridike për këto gjykime e kritika e kishte burimin tek “Karta e Helsinkit” dhe sidomos tek “shporta e tretë”, që u kushtohet lirive dhe të drejtat e njeriut, e miratuar në vitin 1975 në Konferencën e Helsinkit. Jugosllavia, një ndër vendet më aktive të thirrjes së kësaj konference, filloi dalëngadalë ta humbiste emrin e saj “të mirë” në këtë fushë, pavarësisht se vlerësimet për këtë vend, në krahasim me vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore e Qendrore e sidomos me Shqipërinë, vazhduan të mbeteshin deri diku pozitive. Jugosllavia, dalëngadalë në vitet në vazhdim (pas Konferencës së Helsinkit) u shndërrua në një problem të ndjeshëm për SHBA-të dhe vendet e tjera Perëndimore, në objekt kritikash për nivelin e zbatimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Siç dëshmon me të drejtë raporti, Kosova do t’i tregonte botës “thembrën e Akilit”, ndërsa qeveria dhe udhëheqja komuniste e Jugosllavisë do të tregonin para saj fytyrën e vërtetë. Jugosllavia do të akuzohej dhe kritikohej me të drejtë për vrasjet politike, për rrëmbimet dhe zhdukjet nga policia e fshehtë jugosllave e personave kundërshtarë të qeverisë, për kushtet e rënda të burgjeve, për arrestimet dhe burgimet e natyrës politike etj., të cilat do shtoheshin nga viti në vit.

Sipas një raporti të Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme, 62% e të akuzuarve për “krime politike” i përkisnin etnisë shqiptare, të cilët fajësoheshin “irredentizëm”. Sipas Iljaz Kurteshit, pas fillimit të trazirave në Kosovë në vitin 1981 ishin dënuar 595 vetë me burgim të ndryshëm. Mbi gjysma e të dënuarve në Jugosllavinë, me mbi 22 milionë banorë, ishin të kombësisë shqiptare.

Liria e fjalës vazhdonte të ishte e cenuar, fenomen ky pikant tek profesorati i Universitetit të Prishtinës, të cilët akuzoheshin për propagandë nacionaliste. E cënueshme vazhdonte të mbetej edhe liria e besimit, e cila ishte e shpallur, por jo e garantuar. Raporti përmend rastin e dënimit të 12 intelektualëve myslimanë në gusht të 1983, të cilët u burgosën me 5 deri në 15 vjet për “veprimtari armiqësorë” dhe për krime të tjera. Raporti sipas gjyqimit tim, përbën vetëm “majën e ajsbergut” për atë ç’ka ndodhte në realitet në Jugosllavi dhe sidomos për cenimin e lirive dhe të drejtave individuale e kombëtare të shqiptarëve. Me kalimin e kohës Jugosllavia do ta humbiste më tej emrin e fituar dhe do të shfaqej ashtu siç ishte në të vërtetë, një vend me probleme të rënda të zbatueshmërisë së standardeve individuale dhe nacionale, ku më të cënueshmit do të vazhdonin të mbeteshin shqiptarët.

Jugosllavia

RSF-ja e Jugosllavisë është një shtet federativ shumëkombësh që përbëhet nga gjashtë republika (një prej të cilave ka dy krahina autonome). Organizatat e partisë komuniste në çdo republikë dhe krahinë kanë monopol ndaj pushtetit politik. Në praktikë, teoria e vetadministrimit socialist, e vendosur nga i ndjeri presidenti Tito dhe ndihmësi i tij i ngushtë Edvard Kardeli, lejon autonomi të konsiderueshme në nivel republike, krahine dhe lokale, e komunizmi jugosllav ndryshon kështu në mënyrë thelbësore nga marksizëm-leninizmi jugosllav i shumë centralizuar. Vetadministrimi socialist në teori lejon punëtorët që të drejtojnë ndërmarrjet e tyre, ai lejon gjithashtu një sasi të vogël ndërmarrjesh private dhe fermash të vogla private. Megjithatë, parimet themelore të vetadministrimit socialist nuk mund të vihen në pikëpyetje brenda Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ka një debat relativisht të hapur lidhur me zbatimin e këtij koncepti. Ka gjithashtu debat të hapur lidhur me çështjet kryesore të ditës, duke përfshirë reformën ekonomike, funksionimin e sistemit politik dhe shfaqjen e nacionalizmit në politikat dhe shoqëritë jugosllave. Në aspektet kryesore të administrimit të qeverisë dhe të

drejtimit të ekonomisë, partia ka pushtet dhe përgjegjësi të deleguar ndaj këshillave ekzekutive federative, republikane dhe krahinore, si dhe ndaj organizatave të punës së bashkuar.

Ligjshmëria e regjimit të tanishëm qëndron kryesisht në kundërshtimin e pushtimit të vendeve të Boshtit në Luftën e Dytë Botërore, në triumfin e tij ndaj grupeve të tjera në një luftë të ashpër civile dhe në aftësinë e tij për të ekuilibruar aspiratat kombëtare të grupeve të shumta etnike të vendit dhe për të ngritur në mënyrë të rëndësishme nivelin e jetesës së popullit. Gjatë katër dekadave të kaluara dhe sidomos mbas prishjes së Titos me Stalinin, më 1948, Jugosllavia në mënyrë graduale dhe të vazhdueshme evoluoi drejt një shoqërie më pluraliste, pasi qeveria dha më shumë liri (veçanërisht liri udhëtimi) dhe lejoi diskutime me të hapura në shtyp.

Sot, ka pak çështje për të cilat nuk flitet nga mjetet e informacionit, kufizime në lirinë e shprehjes politike mbeten dhe disa çështje, përfshirë kritikën ndaj të ndjerit president Tito dhe sistemit të vetadministrimit socialist, janë në përgjithësi të ndaluara. Gjate viteve të fundit, megjithatë, ka pasur disa diskutime të kujdesshme dhe të matura të këtyre çështjeve. Qeveria nuk toleron denigrimin publik “bashkim-vëllazërim” të popujve të ndryshëm të Jugosllavisë dhe as shkrimet që ajo mendon se përbëjnë përpjekje për të ngjallur shpresat e shprehjes së nacionalizmit rajonal.

Jugosllavia lindi nga dezintegrimi i perandorive otomane dhe të Habsburgut. Popujt përbërës të Federatës Jugosllave: serbët, kroatët, sllovenët, maqedonasit, malazezët, shqiptarët, hungarezët dhe shumë të tjerë kanë eksperiencë të ndryshme në historinë e turbulluar të Ballkanit. Mbas krijimit të vendit në fund të Luftës së Dytë Botërore pati vetëm një periudhë të shkurtër demokracie parlamentare. Tensionet historike etnike dhe nacionale që nga Lufta e Dytë Botërore u kthyen në konflikt të hapur, vëllavrasëse. Armiqësitë vazhdojnë të ekzistojnë dhe mbeten në themelet të shumë çështjeve të brendshme që lidhen me aplikimin e të drejtave të njeriut, si trazira në krahinën autonome të Kosovës, të cilat shpërthyen përsëri në pranverë të vitit 1981. Megjithëse ka pasur përparim të konsiderueshëm material që nga viti 1945, qeveria jugosllave ka arritur vetëm një sukses të kufizuar në kapërcimin e pabarazisë në zhvillimin ekonomik brenda vendit. Gjendja e të drejtave të njeriut në Jugosllavi është e përzier dhe viti 1983 ishte viti i zhvillimeve të përziera. Nuk pati ndonjë ndryshim në tendencën e përgjithshme drejt një hapeje më të madhe, nuk u bënë as hapa gjigant në fushën e të drejtave të njeriut. Në një shkallë të madhe, qeveria dhe

partia ishin të preokupuar me problemet ekonomike të vendit dhe reformën e sistemit ekonomik. Ka filluar gjithashtu diskutimi i ndryshimeve politike dhe koncepti i përgjithshëm i ndryshimit mori miratimin e partisë në plenumin e 10 të KQ-së që u zhvillua më 25 tetor 1983.

Respektimi i të drejtave të njeriut

Pjesa 1. Respektimi i integritetit të personit, duke përfshi lirinë nga:

a) Privimi arbitrar dhe i paligjshëm i jetës.

Çështja e vrasjeve “politike” shtrohet kryesisht në kontestin e urrejtjeve ndëretnike historike, ose si rezultat i tensionit midis grupeve brenda vendit ose si rezultat i veprimtarisë të politikës të fshehtë jugosllave dhe grupeve emigrante jashtë vendit. Gjatë viteve të fundit ka pasur njoftime në shtypin evropiano-perëndimor policia e fshehtë jugosllave mban përgjegjësi për një numër vrasjesh të anëtarëve të organizatave emigrante antijugosllave. Disa prej viktimave kishin marrë pjesë, sipas tyre, në veprimet terroriste të zyrtarëve jugosllavë dhe misioneve jugosllave jashtë.

Në maj 1982 një zyrtar i lartë i shoqërisë më të madhe të naftës së Jugosllavisë, INA (Industria Naftë), Stepan Gjurakoviç, u zhduk ndërkohë që pati zëra për rrëmbim dhe u pa disa muaj më vonë në Republikën Federale Gjermane, ku ai krijoi shtëpinë botuese të Kroacisë. Më 2 korrik 1983, ai u vra. Shpjegimet e shtypit jugosllav sugjerojnë se ai u vra nga udhëheqës emigrantë që kishin inat popullaritetin e tij. Disa organizata emigrante pretendojnë se ai ishte viktimitë e policisë së fshehtë jugosllave.

Më 9 mars 1983 dy terroristë armenë vranë ambasadorin turk në Beograd, sulmi i dytë terrorist i tillë kundër diplomatëve në Jugosllavi. Policia jugosllave e ndihmuar nga dëshmitarët, kapi vrasësit, dy prej të cilëve presin të dalin para gjyqit. Një student jugosllav vdiq duke u përpjekur të parandalonte vrasjen dhe një oficer të dalë në pension u paralizua për jetë për shkak se u plagos kur u përpoq të ndalonte vrasësit.

b) Zhdukjet

Janë njoftuar pak raste të zhdukjeve të përhershme ose për një kohë të gjatë të personave brenda në Jugosllavi, megjithëse ka raste kur

nuk njoftohet publiku për ndonjë arrestim ose gjyq deri në njoftimin e dënimit dhe jo të gjitha rastet njoftohen. Në të kaluarën “Emnisti Internejshenell” dhe shtypi ndërkombëtar kanë njoftuar gjithashtu për të ashtuquajturat raste të rrëmbimit të emigrantëve jugosllavë nga shërbimet e zbulimit jugosllav me qëllim që t’i kthejnë ata në Jugosllavi për t’i gjykuar.

- c) Tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, çnjerëzor ose degradues

Kushtetuta garanton “pashkelshmërinë dhe integritetin e personalitetit njerëzor dhe thekson se përdorimi i forcës për të nxjerrë një pohim ose deklaratë ndalohej ose dënohet. Pjesë të shumta në Kodin Jugosllav dhe të Procedurës Penale kanë fjalë të ngjashme. Megjithatë, “Emnistri Internejshenell” njofton për marrjen e njoftimit se janë rrahur njerëz, janë torturuar ose janë kërcënuar në paraburgim “Shoqata Amerikane Psikiatrike” dhe “Eministi Internejshenell” kanë marrë njoftime të shumta për abuzimin e psikiatrisë. Përdorimi i torturës është bërë një çështje e ligjshme në shumë raste gjykimesh.

Kushtet brenda burgjeve jugosllave në përgjithësi duket të jenë të rënda, por jo çnjerëzore. Ka pasur njoftime të besueshme, megjithatë, për kushte veçanërisht të vështira në disa burgje jugosllave, duke përfshirë njoftimet se të burgosurit mbahen të vetmuar në qeli për kohë të gjatë. Shtypi jugosllav ka njoftuar herë pas herë dhe është shprehur kundër abuzimeve të autoritetit nga policia dhe kundër përdorimit të tepërt të forcës. Ndërsa të burgosurve u sigurohet shërbimi mjekësor, ka njoftime të shumta për mospërdorimin e kurimit të duhur mjekësor për të burgosur me probleme specifike mjekësore, megjithëse në disa raste (Franjo Tugjman, Gojko Gjovo) u është bërë trajtim i veçantë për sa i përket kurimit mjekësor ose në Jugosllavi, ose më rrallë, jashtë. Të burgosurit mund të presin vizita nga pjesëtarët e familjes, por disa herë vizitat kufizohen më gjatë burgimit, pse mund të pengojnë hetimet që vazhdojnë.

- d) Arrestimet arbitrare, burgimet ose mërgimet

Jugosllavët janë në përgjithësi të lirë nga arrestimi arbitrar. Organizmat dhe procedurat ligjore jugosllave kanë origjinën nga një francez (i Napoleonit) i cili nuk përfshinë parime të tilla si “Habeas korpus” (rregull që kërkon që një person të dalë para një hetuesi ose në

gjq sidomos për të hetuar të drejtën e ligjit për të mbajtur atë në burg) ose gjyqin me juri. Në bazë të kushtetutës, ekziston një kërkesë për të çuar të pandehurin para një hetuesi brenda 24 orësh që prej arrestimit për të nxjerrë të drejtën juridike të arsyës për ta mbajtur të arrestuar. I akuzuari ka të drejtë të këshillohet herë pas herë. Normalisht, përgatitjet pasojnë me shpejtësi arrestimin dhe padia mund të bëhet brenda tre muajsh në qoftë se shtyhen nuk miratohet në gjykata.

Qeveria vazhdon të arrestojë dhe të burgosë qytetarë jugosllavë për veprime që konsiderohen si krime politike edhe në qoftë se ato kryhen jashtë dhe nuk përbëjnë krime në vendin ku zhvillohen. Arrestimet për akuza të tilla kanë ndodhur edhe kur i akuzuari është bërë qytetar i vendit ku ndodh akti, pasi ligji e konsideron një person të tillë si me kombësi të dyfishtë në qoftë se nuk është miratuar një peticion për anulimin e qytetarisë së parë. Kjo praktikë duket të ketë ndodhur më rrallë gjatë vitit 1983.

e) Dënimi ose gjyqi i drejtë publik

Gjyqet janë në përgjithësi të hapura, me përjashtim të rasteve kur përfshihen çështje ushtarake ose “të sigurimit kombëtar”; kur gjykatësi ka të drejtë të zhvillojë procedurat in camera. I akuzuari ka të drejtë të këshillohet në mënyrë të pavarur që nga koha kur ai del përpara gjyqit. Megjithatë, deri sa padia të paraqitet, konsultimet midis të akuzuarit dhe avokatit të tij duhet të zhvillohen në praninë e një zyrtari të gjykatës. Padia duhet të bëhet brenda tre muajve, megjithëse një hetues duhet të kërkojë nga gjykatësi kryesor një shtyrje prej tre muajsh dhe më gjatë në qoftë se paraqitet një shkak për këtë.

Në raste të krimeve që kanë lidhje me mbrojtjen dhe sigurim kombëtar dhe me çështje që lidhen me shërbimin në ushtri, civilët mund të gjykohen në gjyqe ushtarake. Gjyqi gjithashtu në proceset ku përfshihen materiale sekrete mund të caktojë më shumë një ushtar si këshilltar për mbrojtjen se sa këshilltar civil. Rezultati i gjyqit nuk është e nevojshme të regjistrohet i plotë dhe e gjithë dëshmia mund të regjistrohet në fjalët e gjykatësit kryesor, kontrolli qeveritar ndaj mjeteve të informacionit grek gjithashtu shkallën dhe natyrën e publicitetit që i bëhet procedurave.

Qeveria megjithatë, nuk ka qëndruar gjithmonë e paanshme në procedurat gjyqësore, veçanërisht në rastet me interes politik. Organizatat e të drejtave të njeriut mendojnë se rezultati në gjyqe politike është përcaktuar përpara se i akuzuari të shkojë në gjyq.

“Emnisti Internejshenell” ka njoftuar për hezitimin e disa juristëve për t’u implikuar në gjyqe politike, sepse kanë frikë për reprezalje. Në procedurat e zakonshme kriminale dhe penale gjyqet veprojnë në përputhje me ligjin dhe kushtetutën dhe të drejtat civile të të pandehurit në përgjithësi respektohen. I akuzuari ka të drejtë të këshillon, dhe juristët jugosllavë i mbrojnë shpesh me forcë klientët e tyre.

Ligji jugosllav trajton si “krime politike” veprimet që përpiqen të rrezojnë rendin kushtetues dhe të sulmojnë integritetin territorial dhe vlerat bazë kushtetuese, duke përfshirë “vëllazërim-bashkimin dhe barazinë e popujve të Jugosllavisë”. Kështu ka njohje dhe përcaktim zyrtar të “të burgosurve politikë”, megjithëse kjo kategori nuk përputhet qartë me konceptet ndërkombëtare. Disa prej veprimeve politike që trajtohen si krime nga Kodi Penal janë: “Sulmet kundërrevolucionare”, “Rrezikimi i pavarësisë së shtetit”, “Bashkimi për veprimtari armiqësore” dhe “Propagandë armiqësore”. Megjithatë, krimet politike përfshijnë gjithashtu “krime kundër bazave dhe të sistemit vetadministrues socialist dhe të sigurimit të Jugosllavisë dhe abuzimi ndaj pronës publike nga zyrtarët e qeverisë ose anëtarëve të partisë. Ndryshimi i këtyre dhe i neneve të tjera ka qenë objekti diskutimi publik të ekspertëve ligjorë jugosllavë gjatë viteve të fundit dhe nga fundi i vitit 1983 një jurist propozoi në mënyrë të veçantë heqjen e krimit të “propagandës armiqësore”, që përbënë pjesë më të madhe të padive politike dhe për të cilën, në përgjithësi, janë vendime të rënda. Zyrtarët jugosllavë i kanë mbrojtur këto nene, duke paraqitur si arsye rrezikun që përbëjnë ndaj shoqërisë përpjekjet për të rigjallëruar armiqësitë e vjetra midis disa popujve të vendit. Numri i të burgosurve politikë është i vështirë të përcaktohet, pavarësisht nga përcaktimi relativisht i hapur zyrtar i krimit politik. Megjithatë, gjatë viteve të fundit, prokurori federativ ka bërë të ditur publikisht numrin e personave të dënuar për krime politike. Të akuzuarit për veprimtari kriminale me pasoja politike dhe krime antivetadministrues si dhe për abuzimet ndaj pronës publike dhe private u shtuan nga 555 në vitin 1980 në 594 më 1981, por ranë përsëri në 516 më 1982. Nga 516, 473 vetë u dënuan më 1982 dhe 422 prej tyre u dënuan me burgim. Prej tyre 65 për qind d.m.th. 340 individë, u dënuan për krime verbale (propagandë armiqësore, nxitje e urrejtjes nacionaliste, dëmtim i reputacionit të vendit dhe përhapje e njoftimeve remme) që zakonisht dënohen me disa muaj burgim. Ndërsa, numri i të akuzuarve ra 15 për qind në krahasim me një vit më parë, dhe numri i krimit verbale u rrit 15 për qind.

Sipas një raporti të tetorit 1983 të Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme, 62 për qind e të akuzuarave për “krime politike ishin etnikë shqiptarë të akuzuar për veprimtari “irredentiste””. Në një intervistë që dha në tetor të 1983, prokurori federativ Millosh Bakiçia atribuoi rritjen e krimeve verbale vendosjes së një rregulli më të madh mbas Demonstratave të pranverës së vitit 1981 në krahinën e Kosovës. Bakiçi vuri në dukje se shqiptarët përbëjnë 90 për qind të rasteve të konstatuara nga Prokuroria Publike në Kosovë, ku shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë. Sekretariati njofton gjithashtu për shpërndarjen e shtatë grupeve ilegale, që përfshinin 130 individë, Kosovë dhe Maqedoni nga fundi i vitit 1983 dhe për një rritje prej 90 përqindësh të rasteve të vënies së zjarrit. Po në tetor 1983 kryetari i Komitetit Krahinor të LK-së së Kosovës, Iljaz Kurteshi, njoftoi se qysh nga fillimi i trazirave të fundit në Kosovë, janë dënuar 595 me burgim. Meqenëse dënimet ishin ta paktën një ose dy vjet, shumica e këtyre personave tani ndodhen ndoshta në burg.

Në Kroaci, sipas autoriteteve lokale, në qershor të 1983, kishte 67 të burgosur politikë që ishin duke kryer dënimin dhe 10 të tjerë mbaheshin në paraburgim. Nga të 52 vetët e dënuar me 1982, nëntë u liruan me kusht, një u dënua me më se 10 vjet burgim, shtatë me 3-10 vjet burgim, 19 me 1+3 vjet burgim, 19 me 1-3 vjet burim dhe [...] vetë më me pak se 1 vit burgim.

Rënia e numrit të individëve të akuzuar për krime politike tregon se numri i të burgosurve politikë mund të ketë rënë me rreth 100 duke arritur në 700 dhe më se gjysma e tyre janë burgosur lidhur me trazirat në Kosovë.

- f) Ndërhyrjet arbitrare në jetën private, familje, shtëpi ose korrespondencën

Ka njëfarë ndërhyrje në jetën private të qytetarëve nga qeveria jugosllave. Kodi penal p.sh. përmban dispozita të hollësishme për të bërë kontrolle, me urdhër nga gjykata, me përjashtim të disa rrethanave të kufizuara. Megjithatë, kushtetuta parashikon se hyrja mund të bëhet pa urdhër arresti, në qoftë se kjo është e domosdoshme për arrestimin e imediat të atij që ka kryer krimin kundër sigurimit të jetës dhe të pasurisë, ose në qoftë se shihet se dëshmitë për procedurat penale nuk mund të sigurohen ndryshe. Nuk ka tregues të një shkeljeje në shkallë të gjerë të këtyre dispozitave. Megjithatë, shumë disidente mendojnë se autoritetet përgjojnë bisedat e tyre dhe lëshojnë posten e tyre. Të tjerët,

janë më pak të sigurt dhe mendojnë se praktika të tilla po pakësohen gradualisht.

Pjesa 2. Respektimi i të drejtave civile që përfshinë:

a) Lirinë e fjalës dhe të shtypit

Liria e fjalës dhe e shtypit janë të kufizuara. Megjithatë ka një tendencë të dukshme dhe të pranuar gjerësisht drejt një hapi më të madh dhe një lirie më të madhe të mjeteve të informacionit, sidomos gjatë pak viteve të fundit.

Shprehja publike joortodokse e pakënaqësisë politike shtypë shpesh, veçanërisht kur është fjala për shprehjen verbale të nacionalizmave lokale, të cilat qeveria i konsideron si nxitës. Siç theksoi më lart, 65 për qind e të gjitha krimeve politike më 1982 i takojnë kategorisë së krimeve “verbale” dhe shumica e gjyqeve politike të njoftuara në shtyp përfshijnë krimet verbale të “propagandës armiqësore”, “nxitjen e urrejtjes kombëtare” dhe “dëmtimin e reputacionit të vendit”. Pakënaqësia dhe mospajtimi me politikën për të cilën rënë dakord (për çështje të tjera, përveç këtyre të ndaluara) dhe me pozitën e grupeve të njohura politike brenda federatës, shprehen gjithnjë e më shumë në forumet politike dhe në mjetet e propagandës.

Në botime, kufizimet normalisht ushtrohen nga këshillat e shtëpive e botuese, të cilat tentojnë të veprojnë në mënyrë të pavarur nga partia. Mosmarrëveshjet midis këshillave botuese dhe organeve të partisë, si dhe midis këshillave botuese dhe këshillave redaksionale shpesh njoftohen në shtyp. Megjithatë, botimi dhe qarkullimi i materialeve me shkrim, u nënshtrohen gjithashtu rregullave, ku përfshihen regjistrimi dhe censura e pasbotimit. P.sh. në maj të vitit 1983 prokurori publik njoftoi se tetë vepra ishin ndaluar së shpërndari gjatë vitit të mëparshëm. Një hartë dhe një vjetar statistikor u ndaluan mbasi nuk përcaktonin kufijtë ndërrepublikanë. Tri gazeta studentesh u ndaluan, njëra sepse vinte në lojë Leonid Brezhnjev. Disa vjet më parë një gazetë studentësh u ndalua se vinte në lojë papën. Dy botime katolike dhe një afishe u ndaluan për përmbajtjen e tyre politike. Megjithatë, rasti më i njohur, ishte ndalimi i një koleksioni dokumentesh lidhur me rastin e poetit Gejko Gjoko, i cili u burgos për poema që u tha se fyenin ish-presidentin Tito. Liria e tij artistike u bë një çështje që mbrohej hapur nga komuniteti intelektual i Beogradit duke çuar kështu në lirimin e tij për arsye shëndetësore. Organizata

lokale e partisë e mbylli shtëpinë botuese që kishte botuar poemat e tij, si dhe vepra të tjera ofenduese, por ky rast u bë pjesë e një debati më të madh, midis disa anëtarëve të Shoqatës së Shkrimtarëve si dhe disa anëtarëve të LK-së së Serbisë. Në fillim të vitit 1983 një komitet lokal partie i Kroacisë gjithashtu përjashtoi nga partia, botuesin e “Realja dhe e mundshmja”, një përmbledhje esesh nga shkrimtari i shquar serb Dobrica Ćosić, që vlerësohet si nacionalist. Po kështu, më 1983 organizata e partisë e shtëpisë botuese të sindikatave federative përjashtoi autorin e romanit “Thika” rreth luftës etnike në Bosnjën e kohës së luftës, por sot autori punon në shtëpinë botuese si gazetar.

Në akademi, toleromi i pikëpamjeve të ndryshme është i përzier, por vazhdon përgjithësisht të rritet. Partia vazhdon të aplikoi presionin mbi profesorët në Universitetin e Prishtinës që dyshohen se propagandojnë nacionalizmin shqiptar, duke pasqyruar shqetësimin e saj rreth qëndrimeve të rinisë. Megjithatë, profesorët mbeten në postet e tyre. Anëtarët e grupit “Praksis” në Universitetin e Beogradit vazhdojnë të punojnë në qendrën e tyre të filozofisë dhe teorisë sociale, e cila botoi me fondet e republikës serbe “Pluralizmi ose monizmi i partisë” të autorëve Vojislav Kostunić dhe Kosta Čavoski, një histori kontradiktore e rrymave politike në Jugosllavi gjatë dhe menjëherë mbas Luftës së Dytë Botërore. Libri thekson se udhëheqja politike komuniste në atë kohë pranoi një sistem politik shumëpartish që u zhduk vetëm për shkak të influencës së jashtme, d.m.th. të sovjetikëve. Për më tepër, administratorët e Universitetit të Beogradit i rezistuan me sukses presionit politik për të marrë masa kundër ose për të dëbuar profesorin e shquar të letërsisë Nikola Miloshević, sepse kishte thënë se stalinizmi nuk është një fenomen i pavarur, produkt i një individi, por i ka pak a shumë rrënjët tek leninizmi. Së fundi një gazetë e kritikes letrare dhe kulturore sllovene “Nova Revija” ka vazhduar të botohet, pavarësisht nga sulmet kundër saj nga disa qarqe të partisë. Përveç botimeve fetare, shumë prej të cilave qarkullojnë gjerësisht, mjetet e propagandës jugosllave janë pronë e partisë ose qeverisë. Ato i nënshtrohen drejtimit të partisë, me gjithë që shkalla e këtij kontrolli ndryshon nga republika në republikë. Sllovë të mirinformuar thonë se shtypi trajton në mënyrë të gjithanshme dhe të besueshme çështjet e jashtme, dobësia e vetme, sipas të përgjithshëm, është animi propalestinez. Shtypi mund të jetë hapur në kritikën e tij ndaj qeverisë, kritika ndaj trajtimit të gjendjes në Kosovë dhe diskutimi i hapur lidhur me vështirësitë ekonomike, p.sh. janë dukur rregullisht në shtyp. Gjatë vitit 1983 kryeredaktori i të përditshmes së Beogradit “Politika” u zëvendësua pjesërisht për arsye

politike dhe ndryshime personeli ka pasur në revistat e përjavshme kryesore të Zagrebit dhe Beogradit “Danas” dhe Nin”, që nuk pati ndonjë ndikim të dukshëm në cilësinë e njoftimeve. Në përgjithësi, kur qeveria dhe partia ndërmarrin veprime kundër mjeteve të propagandës, ato përdorin një përzierje kritikash, paralajmërimesh gjobash, ndryshimesh personeli dhe ndonjëherë ia kalojnë edhe gjyqe.

Marrja në përgjithësi e materialit të shtypur, e materialeve dhe e filmave të regjistruar nga vendet perëndimore, është pakësuar si rezultat i masave të ashpra financiare, megjithëse, qeveria jugosllave caktoi fonde valutore për të siguruar një furnizim të përshtatshëm për botime të huaja gjatë sezonit turistik dhe situata në fund të vitit 1983 është më e mirë se sa ishte në fillim të vitit. Botimet individuale, duke përfshirë materiale që konsiderohen nga Sekretari i Punëve të Brendshme, si ofensive, censurohen, dhe gjatë vitit 1982 disa botime individuale të gazetave italianë dhe gjermano-perëndimore u hoqën nga qarkullimi. Shkaku i dukshëm në shumicën e rasteve ishte dalja e artikujve rreth Millovan Gjilasit, vartës i Titos në kohën e luftës, i cili u përjashtua nga partia në vitet ‘50 dhe u bë si rrjedhojë, zëri kryesor disident. “Emnisti Internejshenell” ka njoftuar për disa raste ku jugosllavët janë burgosur sepse kanë poseduar ose qarkulluar disa gazeta emigrantësh që kritikonin qeverinë. Disa herë janë arrestuar ose gjobitur turistë sepse kanë poseduar vepra të shtypura që qeveria i konsideron si armiqësorë ndaj politikës së saj.

b) Liria e mbledhjes dhe krijimit të shoqërive paqësore

Mbledhjet politike publike lejohen vetëm me autorizim të organeve dhe organizatave zyrtare. Në praktikë, e drejta për mbledhje politike ushtrohet pothuajse ekskluzivisht nga grupe që përkrahin politikën qeveritare. Të tjerat zakonisht nuk lejohen, sikurse ishte rasti kur tetë studentë të Universitetit të Beogradit që mbanin pllakate të “Solidarnostit” u arrestuan nga policia në një demonstratë propalestineze, të organizuar nga autoritetet e qytetit në korrik të vitit 1982. (Demonstrata prosolidarnostit u lejuan nga autoritetet sllovene në shkurt të vitit 1982). Megjithatë, në vitin 1983, autoritetet lejuan mbledhje të hënave pasdite në Klubin e Shkrimtarëve në Beograd, në përkrahje të poetit të burgosur Gojko Gjogo, ku mbledheshin 200 intelektualë të cilat kritikonin shpesh ashpër autoritetet.

Sindikatat nuk organizohen sipas degëve të industrisë, por sipas zonave gjeografike, republikave dhe të krahinave. Megjithëse, të

organizuar nga shteti si pjesë e sistemit vetadministrues të punëtorëve, sindikatat nuk punojnë vetëm për të siguruar përkrahjen e punëtorëve për politikën ekonomike qeveritare, por po luajnë një rol më të gjerë në përfaqësimin e interesave të punëtorëve. Në gusht 1983, sindikatat kryesuan kundërshtimin e rritjes së çmimeve, që pasoi humbjen e kontrollit të çmimeve dhe sindikatat kanë bërë thirrje shpesh se është e nevojshme të ruhen nivelet e jetesës së punëtorëve dhe pensionistëve, veçanërisht në përputhje me procesin vjetor buxhetor. Greva të quajtur “ndërprerja punë”, nuk ndalohen me ligj. Sipas statistikave zyrtare, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 1983 pati 175 ndërprerje pune, një rritje e theksuar në krahasim me një vit më parë. A janë shkaktuar në shumicën e rasteve nga faktorët ekonomike, kryesisht nga rënia prej 10 përqindësh në nivelin e jetesës qysh nga fillimi i vitit. Në qoftë se grevistët nuk kryejnë akte dhune kundër personit ose pronës, ata nuk ndëshkohen, megjithëse reputacioni i tyre politik tek organizata e partisë lokale mund të dëmtohet. Jugosllavia është vend anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Gupe profesionale, organe shkencore dhe organizata juriste kanë lidhje të rregullta me kolegët e tyre në organet e njohura ndërkombëtare të fushës së tyre. Shkalla e zbatimit të kriterit politik për qëllimet e zënies në punë, e cila ka qenë absolute për shumë vjet mbas Luftës së Dytë Botërore, tani është pakësuar. Megjithatë, kritika “i përshtatjes morale dhe shoqërore” - mase besnikëria ndaj shtetit dhe partisë, vazhdon të zbatohet për ata që kërkojnë punë të mirë, mjerisht në qeveri. Për poste qeveritare, anëtarësia në parti mbetet praktikisht kusht paraprak.

c) Liria e besimit

Shumica e besimtarëve jugosllavë i përkasin kishave katolike dhe ortodokse ose besimit islamik. Qysh prej Luftës së Dytë Botërore komuniteti çifut ka pasur vetëm disa mijë vetë. Megjithëse qeveria dhe partia inkurajojnë aktivisht ateizmin, liria fetare në përgjithësi respektohet për aq kohë sa organizatat fetare nuk angazhohen në veprimtari që autoritetet e konsiderojnë politike. Megjithatë, klerikë, kryesisht disa priftërinj katolikë, ndodhen tashmë në burg sepse kanë bërë deklaratat që konsiderohen si “antishtetërore” ose që nxisin urrejtjen etnike”. Rasti më i publikuar fetar, është ai i 12 intelektualëve myslimanë që u dënuan me 5-15 vjet burgim në gusht për “veprimtaria armiqësore” dhe krime të tjera. Autoritetet jugosllave theksuan se ishte

fjala për liri fetare, por se ata u përpoqën që të krijonin republikë etnikisht të pastër islamike, në kundërshtim me garancitë kushtetuese ndaj të gjitha kombësive jugosllave. Të pandehurit than se ata e kanë fjalën për kushtet jashtë Jugosllavisë. Po kështu, autoritetet kanë mbajtur një kontroll të rreptë në zonën rreth Megjugorës, thuhet se është shfaqur Shën Maria. Pelegrinët lejohen të vizitojnë kishën dhe është njoftuar se kështu kanë vepruar rreth 2 milionë veta deri nga mesi i vitit 1983.

Është e njoftuar se personat që praktikojnë lirisht fenë nuk mund të sigurojnë poste të larta partie dhe qeverie, ata që praktikojnë fenë mbajnë disa poste të mesme ose të ulëta, por mundësia për karrierë për ta këtu është e kufizuar. Ka kufizime në veprimtaritë e ndryshme të fesë dhe në arsimin fetar për fëmijët. Ekzistojnë seminare për përgatitjen e të rriturve si klerikë, por në to ka taksa dhe për studentët e seminarit nuk shtyhet shërbimi ushtarak. Kisha dhe xhami mund të restaurohen dhe janë ndërtuar ndërtesa të reja, disa herë me shpenzime të shtetit, por fetarët janë ankuar vazhdimisht se lejet nuk sigurohen lehtë. Ankesat e udhëheqësve fetarë janë botuar herë pas here, gazeta gjysmë zyrtare “Borba” njoftoi për shqetësimet e përmendura nga kisha ortodokse serbe në sinodin e saj vjetor, në maj të 1983, si dhe për takimin e patriarkut German me presidentin serb Ljubiçiç për të diskutuar për shqetësimet.

Numri i botimeve fetare ia kalon numrit të botimeve për marksizëm-leninizmin. Gazetat fetare botohen dhe shiten nëpër librari. Importimi i literaturës fetare kontrollohet gjithashtu rreptësisht. Udhëtimet fetare ashtu si të gjitha udhëtimet jashtë, lejohen lirisht, shumë jugosllavë myslimanë dhe priftërinjtë kristianë kanë marrë pjesë në konferencat jashtë. Këtë vit, u njoftua se vetëm 50 jugosllavë bënë pelegrinazh në Mekë, dhe më 1982 numri i tyre ishte 500. Arsyeja e dukjes për rënien është vendosja e një depozite për udhëtimet jashtë (shih pjesën D - Liria e lëvizjes). Personalitetet fetare nga vendet e huaja kanë udhëtuar gjithashtu në Jugosllavi për t’u takuar si më fetarë ashtu edhe më laikë.

d) Liria e lëvizjes brenda vendit, udhëtimet jashtë, emigracioni dhe riatdhesimi

Liria e lëvizjes brenda vendit garantohet në kushtetutë. Pothuajse të gjithë jugosllavët janë në gjendje të udhëtojnë jashtë sipas dëshirës. Masat e kursimit të paraqitura nga Këshilli Ekzekutues Federativ në tetor të 1982, të cilat janë ende në fuqi, kanë përcaktuar një depozitë prej 5 000 dinarësh (pothuajse 42 dollarë amerikanë sipas

kursit të tanishëm të shkëmbimit) që kthehet pas një viti për udhëtimet jashtë. Depozitat për çdo vit që pason rriten 2 000 dinarë. Depozita është e barabartë me një të tretën e pagës mesatare mujore. Kjo masë ka pakësuar shumë numrin e jugosllavëve që udhëtojnë jashtë, por ajo është pranuar në përgjithësi e domosdoshme dhe e përkohshme. Jugosllavët nuk kanë nevojë për viza daljeje për të udhëtuar për në ato vende me të cilat Jugosllavia ka marrëdhënie diplomatike ose konsullore. Në shtator 1980 gjykata kushtetuese vendosi se autoritetet duhet të informojnë qytetarët, me përjashtim të atyre që qeveria i quan “raste të sigurimit kombëtar”, për arsyet kur nuk jepen viza. Një numri të vogël disidentësh u është mohuar viza për arsye të sigurimit kombëtar. E përjavshmja “Nin” theksoi në korrik 1982 se tani nuk janë dhënë 26 000 pasaporta, kryesisht njerëzve që kanë bërë krime.

Qeveria krahinore e Kosovës është përndjekur ta ndërpres migracionin e vazhdueshëm të serbëve dhe malazezëve nga kjo zonë e banuar kryesisht nga shqiptarët. Shifrat e publikuara nga Sekretaria e Punëve të Brendshme të Serbisë (Kosova është një krahinë autonome e Serbisë), më 1983 zbulojnë se afro 2 500 serbë dhe malazezë u larguan nga Kosova për në Serbi gjatë gjysmës së dytë të vitit 1982 dhe shifrat e Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme për gjysmë dite të vitit 1982, tregojnë se edhe 2 600 serbë dhe malazezë të tjerë emigruan në pjesë të tjera të Jugosllavisë. Me një intervistë në fillim të tetorit, presidenti i Kosovës, Shefqet Jashari, tha se që nga maji i vitit 1981 janë larguar 13 000 serbë dhe malazezë nga krahina.

Ligji për hyrjen e të huajve në Jugosllavi thekson të drejtën e strehimit dhe siguron ndihmën qeveritare për personat që u jepet kjo e drejtë. Në bashkëpunim me zyrën e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, Jugosllavia u ka siguruar ndihmë të përkohshme refugjatëve politikë nga Evropa Lindore, të cilët kanë kërkuar rivendosjen në një vend të tretë. Mbi 600 mijë punëtorë jugosllavë punojnë tani në Evropën Perëndimore. Mbi emigrimin nuk ka asnjë kufizim.

Pjesa 3. Respektimi i të drejtave politike. E drejta e qytetarëve për të ndryshuar qeverinë e tyre.

Ndërsa, Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë me 2 milionë anëtarë ruan monopolin mbi pushtetin politik, ky autoritet shpërndahet gjerësisht në mbarë Federatën Jugosllave shumëkombëshe. Autoritetin përfundimtar brenda partisë e kanë 160 anëtarët e Komitetit Qendror

dha jo Kryesia e Partisë prej 24 anëtarësh. Por, më tepër, organizatat e partisë federative nuk mbështetet në një burokraci të madhe dhe përgjegjësia për zbatimin e konkluzioneve të arritura në plenumet e Komitetit Qendror dhe kongreset e partisë bie mbi organet republikane dhe krahinore të partisë. Sipas kushtetutës jugosllave, ai që mban post të lartë në parti nuk mund të mbajë njëkohësisht një post të lartë në qeveri, por individë të shquar mund t'i mbajnë të dy këto poste të partisë dhe qeverisë. Ushtrimi i vazhdueshëm i pushtetit varet nga ruajtja e një baze të fortë në organizatat politike republikane ose krahinore.

Autoriteti qeveritar në nivel federativ ushtrohet nga Presidenca e Shtetit, Këshilli Ekzekutiv Federativ (kabineti) dhe Kuvendi Federativ dhe i Krahinave ushtron rrallë pushtetin e saj të gjerë në publik. Pjesa më e madhe e administrimit të përditshëm të qeverisë kryhet nga kabineti, ku Kuvendi Federativ përfaqëson interesat e republikanëve dhe krahinave dhe shërben si një kundërpeshë ndaj administratës federative. Zgjedhja në të gjitha këto organe bëhet nëpërmjet një sistemi kompleks të delegatëve. Caktimet bëhen nga organizatat bazë të partisë". Lidhja Socialiste e popullit punonjës të Jugosllavisë dhe kalojnë nëpër një sërë miratimesh nga organizatat "Shoqëroro-politike", të tilla si bashkimet profesionale. Punëtorët e zakonshëm mund të luajnë një rol aktiv në procesin e zgjedhjeve.

Vetëm një kandidat caktohet për çdo post dhe jo të gjithë zyrtarët janë anëtarë partie, por shumica dërrmuese e tyre janë të tillë. Përpara caktimit me postin e lartë, personalitetet e rëndësishme me politikë në republika dhe krahina duket se bisedojnë për zgjedhje të kandidatëve, në mënyrë që procesi i përgjithshëm të ruajë unitetin. Një sistem i rotacionit siguron që të gjitha republikat dhe krahinat përfaqësohen në mënyrë të barabartë në nivelet më të larta.

Zgjedhjet shumëpartish nuk ekzistojnë, megjithëse mundësia e kandidatëve të shumtë është diskutuar. Ekziston pakënaqësi ndaj sistemit të delegatëve, veçanërisht si mjet për të zgjidhur delegatë për në Dhomën Federative të Kuvendit. Diskutimi i ditës, ndryshimi ka filluar.

Pjesa-4: Qëndrimi qeveritar për sa i përket hetimeve ndërkombëtare dhe joqeveritare mbi të ashtuquajturat shkelje të të drejtave të njeriut

Qeveria jugosllave ka shprehur gatishmërinë për të ngritur dhe për të diskutuar çështjen e të drejtave të njeriut në forume ndërkombëtare, duke përfshirë mbledhjet e vendeve të paangazhuara

dhe Konferencën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë. Ajo mbetet e ndjeshme ndaj akuzave për shkeljen e të drejtave të njeriut brenda Jugosllavisë, megjithëse ka lejuar vizitat nga “Emnis Internejshenell”. Komiteti i UNESCO-së mbi konventat dhe rekomandimet (të drejtat e njeriut) ka diskutuar gjithashtu rastet jugosllave, me pjesëmarrjen e një delegacioni jugosllav.

Në raportet e “Emnisti Internejshenell-it” të vitit 1983 lidhur me Jugosllavinë shprehet shqetësimi i saj rreth arrestimit dhe burgosjes së të burgosurve politikë edhe të akuzave të ndryshme për keqtrajtimin gjatë paraburgimit, për gjyqe të padrejta, kushte të këqija në disa burgje dhe dhënien e dënimit me vdekje. Gjithashtu, botohet një raport i posaçëm në shkurt të vitit 1983 me titull: “Jugosllavia: të burgosurit e ndërgjegjes”. Dhoma e Lirisë e konsideron Jugosllavinë si “pjesërisht të lirë”.

Gjendja ekonomike, shoqërore dhe kulturore

Popullsia e Jugosllavisë në vitin 1983 ishte afërsisht 22 825 000 banorë, me një ritëm vjetor rritjeje prej 0.7 për qind. Të ardhurat personale për frymë shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe të ardhurat për frymë më 1981 ishin 3 344,9 dollarë. Ndryshimi i rëndësishëm në nivelin e të ardhurave për frymë midis republikave të ndryshme është rezultat i dallimeve historike rajonale dhe burimeve natyrore. Jetëgjatësia më 1980 ishte 70,45 vjeç dhe në vitin 1983 shkalla e vdekshmërisë foshnjore ishte 30,7 për 1 000. Ekziston një sistem i gjerë i sigurimeve shoqërore dhe i përfitimeve të tjera për të moshuarit, të paafatit dhe ata nuk janë të zënë me punë. Qeveria paguan pensione për fëmijët dhe siguron një sistem të kujdesit të përditshëm për nënat që punojnë.

Më 1983 ekonomia jugosllave vazhdoi të vuante nga një krizë e likuiditetit të jashtëm, si rezultat i borxheve të jashtme të pakufishme gjatë viteve të mëparshme dhe qeveria hartoi një program afatgjatë të stabilizimit ekonomik, që kishte si qëllim ta riorientonte ekonominë drejt një eksporti më konkurrues dhe drejt riorganizimit me racional të brendshëm. Inflacioni, rezultat pjesërisht i importeve të kushtueshme të energjisë, si dhe i rritjeve të mëdha të pagave më shumë nga rritja e rendimentit, nuk është vënë nën kontroll. Jugosllavia mesatarisht ka patur rënie të vazhdueshme në nivelin e jetesës gjatë vitit 1983.

Ekonomia jugosllave është e decentralizuar në një shkallë të lartë e autonome në nivel republike dhe lokale. Jugosllavia kufizon të drejtën e individit për të akumuluar pronën personale për përdorim privat. Fshatarët mund të pronësojnë deri në 10 hektarë toke të punëshme, plus 10 hektarë terren malor si kullotë.

Kushtetuta e vitit 1974 parashikon një sistem të komplikuar për organizimin e ndërmarrjeve tregtare. Në teori mjetet e prodhimit janë pronë e shoqërisë në tërësi dhe u besohen punëtorë të organizuar në këshillat e punëtorëve në nivel ndërmarrjeje. Në praktikë, duket se këshillat e punëtorëve ushtrojnë influencë të rëndësishme lidhur me zgjedhjen e drejtim të ndërmarrjeve, politikën e tyre të gjerë dhe shpërndarjen e të ardhurave ndërmarrjes. Nuk ka ndërmarrje tregtare që të jenë pronë dhe të drejtohen direkt nga shteti, me përjashtimin e mundshëm të disa ndërmarrjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe institutet kërkimore bujqësore.

E drejta për arsim u garantohet të gjithë qytetarëve jugosllavë ashtu si dhe shkollimi në gjuhët e popujve të ndryshëm jugosllavë. Shkalla e të arsimuarve në radhët e të rriturve është 85 për qind. Ekziston pak diskriminim në sistemin arsimor jugosllav, gjë që mbështetet në sfondin politik dhe familjar.

Kushtetuta u ngarkon autoriteteve shtetërore në të gjitha nivelet mbrojtjen e të drejtave kulturore “popujve dhe kombësive” të Jugosllavisë. Përdorimi i gjuhës së rëndësishme lokale kërkohet në komunikimin zyrtar midis Beogradit dhe republikave të ndryshme dhe gjuhët lokale përdoren gjithashtu në shkolla, gjykata dhe shtypin lokal. Çdo qytetar ka të drejtë t’u drejtohet gjykatave dhe agjencive qeveritare në gjuhën e tij. Megjithatë, vazhdon njëfarë diskriminimi veçanërisht kundër shqiptarëve etnikë dhe romëve, pavarësisht nga politika federative.

Kushtetuta garanton barazinë e qytetarëve pavarësisht seksit. Qeveria ka përkrahur vazhdimisht këtë koncept me anë të masave që kanë patur si qëllim përmirësimin e statutit të grave, duke përfshirë, dispozitën e të drejtave të barabarta për arsim, statutin profesional dhe barazisë në pagë, përkrahjen për nënat në marrëdhënie pune me anë të qendrave të kujdesit të përditshëm dhe lejes së lindjes. Problemet kryesore të trajtimit të barabartë të sekseve gjenden në ato zona të vendit ku zhvillimi ekonomik është më mbrapa ose ka qëndrimet tradicionale të Ballkanit rreth rolit të gruas që vazhdojnë të ekzistojnë.

Gratë përfaqësohen në fusha të ndryshme të jetës, duke përfshirë postet qeveritare dhe marrin pagë të barabartë për punë të barabartë.

Megjithatë, gratë, nuk përfaqësohen në postet e nivelit të lartë të qeverisë dhe drejtuese. Jugosllavia mbetet në përgjithësi një vend i sunduar nga seksi mashkull dhe i orientuar po nga meshkujt, ku gratë kanë mundësi të kufizuara për poste të larta në parti, qeveri ose tregti. Kryeministrja e tanishme, Millka Planino, është një përjashtim i rëndësishëm ndaj këtij rregulli të përgjithshëm.

**Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (AMPJ),
Dosja nr. 1037/5, Viti 1984, faqe 1-20.**

Naser FERRI

SHTATORJA E PARË E NËNËS TEREZË ISHTE NGRITUR NË NOVOSELLË TË GJAKOVËS

Pas shenjtërimit të Nënës Terezë (por edhe më herët) mediet publike kroate publikuan lajmin sipas të cilit shtatorja e parë në botë e kësaj bije shqiptare ishte ngritur në ishullin Braç të Kroacisë në vitin 2002, ndërsa e vërteta është se ajo ishte ngritur në Novosellë të Gjakovës qysh në vitin 1990 deri sa ajo ishte ende gjallë.

Në qershor të vitit 2002 mediet kroate me pompozitet publikuan lajmin se në Supetar -lokalitetin qendror të ishullit dalmatin Braç, më 28 maj të atij viti ishte vendosur shtatorja, e para në botë siç pretendonin kroatët, e kushtuar humanistes Gonxhe Bojaxhiu, e njohur me emrin e saj kishtar Nëna Tereza. Shtatorja është punuar në përmasa reale (në madhësi natyrore të Nënës Terezë), nga mermeri i bardhë i Braçit, material tejet i çmuar për punimin e skulpturave të ndryshme që nga koha e okupimit romak të kësaj pjese të Dalmacisë ilire. Autor i kësaj vepre është skulptori, akademik Pero Jakshiq, nga Braçi. Shtatorja paraqet një grua të imtë fizikisht, modeste e cila me thjeshtësinë e vetë e kishte pushtuar botën dhe njerëzimin dhe cila me dashurinë e vetë ndaj më të varfërve ndër të varfëritë, e kishte dëshmuar që atyre mund t'u ndihmohet tejet shumë nëse edhe vetë jeton në mënyrë të njëjtë.

Nismën për ngritjen e shtatores kësaj humaniste e cila brenda 517 misionëve pune që i kishte kryer në më se 100 vende të botës, 45 vite të jetës së vet ia kishte kushtuar të varfërve, të sëmurëve, bonjakëve, skamnorëve, atyre në prag të vdekjes dhe të gjithë nevojtarëve në Kalkuta, Bejrut, Çernobil, Etiopi, Armeni e gjetkë, pa marrë parasysh përkatësinë fetare, racore, politike të nevojtarëve, e kishte ndërmarr aktori i mirënjohur amerikan Martin Sheen, i cili thotë që takimi me Nënë Terezë, apo “nënë e të varfërve” siç e cilësoi ai,

në Kalkuta të Indisë i kishte lënë mbresa të mirësisë, të dashurisë dhe të humanitetit dhe ia kishte ndërruar jetën e deriatëhershme dhe kuptimin e jetës dhe vlerave të saj në përgjithësi. Këtë hap ai e kishte ndërmarrë në shenjë “falënderimi gruas më të madhe të shekullit XX”. Donatorë dhe financues të ngritjes së shtatores kishin qenë biznesmeni amerikan me origjinë kroate, Marion Duzich, dhe kompania amerikane “Watterman”. Shtatorja ishte vendosur, dhe edhe tash qëndron, në oborrin e kishës së “Lajmërimit të Mërisë” (Crkva Navještenja Marijina) të ndërtuar në shekullin XVII. Përndryshe, kjo kishë simbolikisht ka të bëjë me lindjen e Krishtit, respektivisht më datën 25 mars, kur kremtohet “Lajmërimi i Zotit” ose “Zoja Nunciatë” ditë kjo kur, sipas kalendarit kishtar katolik, respektivisht sipas Ungjillit të Shën Lukës, kryengjëlili Gabriel ia kishte bërë të ditur (latinisht: nuntiatio-lajmërim, kumtim) ose ia kishte kumtuar lajmin Shën Mërisë në Nazaret që pikërisht ajo ishte zgjedhur nga Zoti që ta lind birin e tij. Dhe pikërisht 9 muaj pas kësaj ngjarje, respektivisht më 25 dhjetor Zonja e Bekuar, e virgjëra Shën Mëri kishte lindur, në Betlehem, Jezu Krishtin, i cili u bë predikues i fesë së re dhe në moshën 33-vjeçare u dënua, u gozhdua në kryq, vdiq dhe u ringjall.

Është me interes të cekët se shtatorja ishte ngritur me rastin e 70-vjetorit të dhënies së betimit për murgeshë të Agnesë ose Anjezë Gonxhe Bojaxhiut, dhe siç theksohet në lajmin e publikuar në mediet kroate, 16 muaj para lumturimit të saj që u bë në vitin 2003 nga papa Gjon Pali II. Shtatoren e kishte zbuluar në mënyrë solemne vetë aktori Sheen në prezencën e një numri të madh besimtarësh, zyrtarësh kishtarë e shtetëror si dhe mysafiresh të ndryshëm nga Kroacia dhe bota.

Vlen të përmendet që sa ishte gjallë Nëna Terezë u kishte lënë amanet motrave të rendit të cilin e kishte themeluar në vitin 1950 në Kalkuta (Misionarët e dashurisë, një rend modest kishtar i cili sot ka 5 000 murgesha të veshura me sari të bardhë (veshje karakteristike të grave indiane), me vija blu që u bënë shenja karakteristike të këtij rendi, në 500 misione anembanë botës, e në mesin e tyre edhe në Pejë), obligimin në shërbim duke u ikur festave e monumenteve. Mu për këtë arsye edhe me rastin e inaugurimit të shtatores nuk ishte prezentë asnjë nga motrat e rendit të saj. Fal publicitetit të madh mediatik që iu kishte dhënë që nga zbulimi i saj shtatorja e Nënë Terezë u shndërrua në objekt i lutjeve të besimtarëve nevojtarë, ndërsa kisha e “Lajmërimit të Mërisë” në vend pelegrinazhi, të cilin vazhdimisht e vizitojnë besimtarët dhe turistët nga mbarë bota duke e nderuar tashmë të shenjtën Nënë Terezën.

Për humanitetin dhe punën e saj, Nënë Tereza gjatë jetës së vetë ishte dekoruar me mjaft dekorata, si me dekoratën indiane “Padma Shri” më 1962, me çmimin për paqe “Ramon Magsaysay” (çmimi aziatik për paqe) po në të njëjtin vit, me çmimin “papa Gjoni XXIII” për paqe (nga ana e papa Palit VI) në vitin 1971, me çmimin shqiptar “Krenaria e artë e kombit” në vitin 1994, dhe me çmimin prestigjioz ndërkombëtar Nobel për paqe në vitin 1979, përfitimet materiale e të cilave i kishte shpenzuar për ata për të cilët kujdesej ajo dhe motrat e rendit të saj.

Pas shenjtërimit të Nënës Terezë në Vatikan më 4 shtator u përsërit prapë në mediet e shkruara dhe elektronike kroate (Slobodna Dalmacija, Medjugorje-info.com e disa të tjera), por tash me më shumë pompozitet, pohimi se gjoja shtatoren e parë e kësaj shenjtore në botë ia kishin ngritur dhe ia kishin vendosur pikërisht kroatët në Supetar të Braçit (“Prvi spomenik Majci Tereziji na svijetu podigli su Hrvati”). Dhe, përkundër respektit të madh ndaj këtij gjesti bujar e njerëzor të kroatëve, kjo na nxiti që t’i bëjmë ca hulumtime në bazë të të dhënave relevante të publikuara dhe në bazë të informatave nga terreni me qëllim të zbardhjes të së vërtetës.

Duke shikuar të dhënat statistikore na del se shtatorja në Prishtinë ishte vendosur më 2 korrik 2002, në përvjetorin e Deklaratës kushtetuese të vitit 1990 si dhuratë e vëllezërve Gojçaj nga SHBA, shtatorja në Tiranë në vitin 2010 me rastin e kremtimit të 100-vjetorit të lindjes së Nënës Terezë, ndërsa Katedralja në Prishtinë që bart emrin e Nënës Terezë është inauguruar në gusht të vitit 2010, po ashtu me rastin e 100-vjetorit të lindjes së saj. Duhet përmendur edhe faktin se në fshatin Dugajevë, që bënë pjesë në famullinë e Gllaviçicës, në vitin 2002 u ndërtua një kishë afër varrezave të fshatit dhe u pagëzua me emrin e Nënës Terezë, më 13 nëntor 2003, pas lumturimit të saj.

Sa i përket shtatoreve të tjera të Nënës Terezë ekzistojnë të dhënat kur ato u ngritën edhe në Zagreb (2007), Tuz, Strugë, Tiranë, Montreal, Miçigen, Detroit, Sarajevë (2015), Rio de Zhaniero, Nju Jork (bashkë me atë në Rio de Zhaniero të ngritura të fundit gjatë vitit 2016), në Pullë të Kroacisë (tetor 2016), Shkup (32 m e lartë, në realizim e sipër, parashihet të përfundohet në vitin 2017), në Pejë, Mitrovicë, e në mjaft qytete të tjera anembanë botës.

Ngritja e shtatores së Nënës Terezë në Supetar pa dyshim dëshmon admirimin dhe respektin e madh të popullit mik kroat dhe të aktorit Martin Sheen, ndaj kësaj bije të madhe të popullit shqiptar gjë që patjetër duhet vlerësuar dhe respektuar e kjo aq më tepër kur dihet se Nëna Terezë kurrë nuk kishte shërbyer në Kroaci por kishte qenë mjaft

prezentë në këtë vend meqë kishte qëndruar në Zagreb për një kohë në vitin 1928, pa filluar ende zyrtarisht jetën rregulltare, gjatë udhëtimit nga Shkupi në Irlandë e prej aty në Indi, pastaj e kishte vizituar prapë Zagrebin në vitin 1978, ndërsa, më 19 korrik 1990 ajo ishte shpallë qytetare e nderit e Zagrebit. Në vitin 1976 ajo kishte ardhur nga India në Solin afër Splitit me rastin e inaugurimit të kishës së Zojës së Bekuar bashkë me Pater Ante Gabriq. Gjuhën kroate Gonxheja kishte filluar ta mësojë në Shkup ku shkollën e vijonte në gjuhë shqipe, por famullia e Shkupit ishte nën udhëheqjen e jezuitëve kroatë, ndërsa këtë gjuhë e kishte perfeksionuar në Kalkuta të Indisë, fal kontakteve dhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm me murgun jezuit kroat, Pater Ante Gabriq, të cilin e konsideronte si “atë të vetin shpirtëror”.

Por, sipas informatave gojore nga besimtarët e famullisë së Shën Rrokut të Novosellës së Epërme të Gjakovës, në oborr të kësaj kishe ishte vendosur shtatorja e parë e Nënës Terezë e punuar prej bronzi, e cila e ka të skalitur vitin 1990, pra ishte punuar dhe vendosur në kohën derisa ajo ende ishte gjallë dhe 13 vite para lumturimit të saj.

Autor i kësaj vepre të bukur është skulptori, akademik prof. mr. Agim Rudi nga Prishtina, i cili e ka paraqitur Nënë Terezë në madhësi reale rreth të cilës janë disa fëmijë lakuriq, si simbol i kujdesit të saj ndaj fëmijëve bonjak dhe të varfër. Donatorë për punimin dhe për ngritjen e shtatores kanë qenë besimtarët e famullisë së përmendur, ndërsa shtatoren e kanë sjellë me shumë mundime e sakrifica (në kohën kur Kosova e okupuar vlonte nën zullumin e regjimit të Millosheviqit) nga Prishtina në oborr të kishës në Novosellë të Epërme Matej Tanushi, Lekë Tonë Lekaj dhe Hil Ton Lekaj në shenjë respekti ndaj së ëmës së Nënës Terezë, Drane (Roza) Bernaj, familja e cilës kishte jetuar në Novosellë të Epërme, por e cila, sipas informatave të banorëve të atjeshëm, kishte jetuar edhe në fshatin e afërte Gramaçel, dhe për nder të mbesës së tyre të respektuar Gonxhe Bojaxhiu.

Edhe pse për shkak të mungesës së publicitetit medial kjo shtatore nuk u bë e njohur sa ajo e Supetrit, megjithatë gëzon fakti që populli shqiptar e kishte vlerësuar dhe nderuar këtë bijë të vetën të jashtëzakonshme dhe nuk i kishte harruar veprat e angazhimet që ajo i kishte bërë për popullin e vetë për së gjalli, në kohët tejet të vështira për shqiptarët, dhe se ky respekt kishte filluar të manifestohet shumë vite para beatifikimit dhe kanonizimit të saj. Madje, ç’është edhe më me rëndësi, populli shqiptar ia ktheu një pjesë të borxhit kësaj humaniste jo me fjalë por me vepër.



1. Shtatorja e Nenës Terezë në Kishën e Lajmërimit të Mërisë, në Supetar të Braçit.



2. Shtatorja e Nënës Terezë në oborrin e Kishës së Shën Rrokut, në Novosellë.



3. Kisha e Shën Rokut, në Novosellë të Gjakovës.



4. Kisha e Lajmërimit të Mërisë, në Supetar të Braçit.

RECENSIONE

Zef Mirdita, *Dardanci i Dardanijs u antici*, Hrvatski institut za povijest (Biblioteka Hrvatska povjesnica: monografije i studije III/67), Zagreb 2015, 624 f.

Këtë vit (2016), u nda nga jeta, studiuesi më i shquar i dardanëve dhe Dardanisë, Zef Mirdita, i cili pas vetës na la një opus të madh shkencor, në mesin e të cilave edhe veprën kapitale, të cilës ia ka kushtuar pjesën më të madhe të jetës, monografinë shkencore të shkruar në gjuhën kroate me titull “*Dardanci i Dardanijs u antici*” (Dardanët dhe Dardania në antikë)”, për të cilën po i shkruajmë disa rreshta.

Ky studim, i cili më 1972 ishte mbrojtur si tezë doktorature në fakultetin Filozofik të Zagrebit, për tu plotësuar më vonë dhe botuar si studim i veçantë në vitin 2015 nga Instituti i Historisë në Zagreb, sjell para lexuesit një nga studimet më kompetente dhe më të plotë për historinë dhe kulturën e dardanëve dhe Dardanisë. Sipas natyrës së tij, libri është e ndarë në katër pjesë kryesore. Pjesa e parë trajton problemet teorike: etnogjenezën, kufijtë etnogjeografikë dhe politikë të dardanëve dhe Dardanisë. Pjesa e dytë merret me problemin dardanëve dhe marrëdhëniet e tyre me maqedonasit deri në dominimin e plotë të Romës. Në pjesën e tretë, diskuton për strukturën politike, sociale dhe ekonomike në periudhën para romake dhe atë të kohës romake, kurse në të katërtën janë trajtuar në hollësi, gjithashtu zakonet, kultura materiale e shpirtërore, komunikacionin, problemin e romanizimit, si dhe mundësitë ekonomike të Dardanisë në periudhën romake dhe në atë të fillimit të sundimit bizantin.

Zef Mirdita, profesor shumëvjeçar në Universitetin e Prishtinës, njohës i mirë i gjuhëve klasike dhe shumë gjuhëve moderne, në kuadër të këtij studimi ka trajtuar një sërë çështjesh të vështira të problemit dardan. Disa nga problemet e trajtuara janë prezantuar më herët nga autori, në formë të kumtesave apo studimeve shkencore para opinionit ndërkombëtar shkencor, të cilat sot e kësaj dite janë objekt interesimi i

shkencëtarëve me profile të ndryshme. Në mesin e tyre, një vend të veçantë zë, problemi i etnogjenezës apo iliriciteti i dardanëve. Që në fillim, duhet të theksojmë se studiuesi Mirdita, ka arritur që nëpërmjet burimeve materiale dhe dokumenteve relevante të dëshmojë iliricitetin e dardanëve dhe të Dardanisë, që nga koha e diferencimeve etnike që përkon me periudhën e bronzit të hershëm, respektivisht të mijëvjeçarit të II p.l.K) dhe për të vazhduar gjatë gjithë antikitetit deri në mesjetën e hershme. Sipas tij, në këtë kuadër janë trajtuar të gjitha aspektet politike, shoqërore, ekonomike, kulturo-fetare, linguistike, trashëgimia kulturore e ndonjë tjetër, të cilat e sforcojnë tezën e profesor Mirditës mbi etnogjenezën ilire të dardanëve dhe të Dardanisë.

Argumentimi i etnogjenezës ilire të dardanëve nuk ishte i lehtë për prof.Mirditen, meqë për këtë tezë kishte dhe ka përkrahës dhe kundërshtarë të shumtë. Ndër ata që e mohojnë në forma të ndryshme prejardhjen etnike ilire të dardanëve, autori përmendë studiuesit: G. Matesku, R.Vulpe, D.Deçev, G.Novak dhe Vl.I.Georgiev, të cilët kryesisht janë marrë me elementin onomastik, përkatësisht me ekzistimin e emrave me karakter joilir në një pjesë të territorit të Dardanisë. Konsiderojmë se është me interes të theksohet se historiografia serbe, në përkrahje edhe të disa qendrave ballkanike, përmes Akademisë së Shkencave Serbe, ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të ngushtuar territorin e banuar nga ilirët dhe në këtë kuadër për të treguar se dardanët dhe ilirët janë dy etnitete të veçanta (Илири и Албанци, САНУ, Београд, 1988).

Nuk mungojnë edhe ata autorë që kanë ndërruar kohë pas kohe mendimet, siç ishte M.Garashanin apo ata që në forma të ndryshme përkrahin dhe mbrojnë tezën mbi prejardhjen apo iliricitetin dardan, si: R. Katiçiq, M.Budimir, F.Papazoglu, M.Garashanin, Z.Mirdita, E.Çabej e shumë të tjerë. Praninë e etnosit dardan në këtë hapësirë, sipas profesor Mirditës, e dëshmojnë edhe historianët dhe gjeografët e antikitetit, si Herodoti, Apiani, Straboni, Ptolomeu, Tabula Peutingeriana, Nikolla i Damaskut e ndonjë tjetër të cilët shkruajnë për dardanët se janë pjesë e ilirëve dhe të Ilirisë. Në këtë studim të akademik Mirditës, janë të pakontestueshme provat shkencore se dardanët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e etnosit ilir dhe në zhvillimin e historisë ilire gjatë gjithë procesit deri në transformimin e tyre në arbër, përkatësisht në shqiptarë. Nga rezultatet e arritura, autori vjen në përfundim se dardanët janë me prejardhje ilire, me një element etnokulturor të dukshëm paleoballkanik dhe me gërshetime të elementit trakas në ekstremitete lindore të territorit të tyre.

Këto përfundime të arritura nga profesor Mirdita lidhur me etnogjenezën e dardanëve, mbështeten edhe në një dokumentacion relativisht të gjerë, si, bie fjala: tradita letrare, materiali gjuhësor (onomastika), tiparet etnike, të dhënat arkeologjike, e ndonjë tjetër tipar karakteristik. Në këtë kontekst, ngushtësisht lidhet edhe çështjen e shtrirjes Dardanisë, territor, i cili sipas prof. Mirdites, është shtirë ne veri deri te Morava Perëndimore, në verilindje ka përfshirë edhe territorin e Timokut, në jug deri te Velezi, në veriperëndim deri te Ivanjica, përgjatë Moravës perëndimore, kurse në lindje deri te kufiri bullgaro-maqedono-serb, duke e përfshirë pjesën verilindore, konkretisht trevën e Knjazhevcit.

Lidhur me kufijtë etnogeografikë dhe politikë të dardanëve dhe Dardanisë, autori vije në përfundim se përkundër të gjitha ndryshimeve dhe pasaktësive që dalin nga të dhënat e autorëve antikë dhe materialeve tjera, e sigurt është se kufijtë e Dardanisë, të paktën në kohët romake, përkojnë me kufijtë territorialë të *Municipiumit Naissus*, *Municipium DD*, *Municipiumi te Dërsniku* dhe kolonia *Scupi*. Në këtë mënyrë, ky territor, në kohën romake ka qenë i ndarë këto njësi administrativo-municipiale: *Municipium Naissus*, *Municipium DD*, *Municipium Ulpianum*, *Municipium te Dërsniku*, *Kolonia Scupi*, *Municipiumi i Kumanovës* dhe territoret te *Prizreni* dhe *Klllokoti*. Problemi i marrëdhënieve të dardanëve me popujt fqinjë, respektivisht qëndrimi i tyre ndaj maqedonasve dhe ndaj Romes deri në pushtimin romak përfundimtare të rajoneve ilire.

Përveç trajtimit të raporteve me fqinjët maqedonas (në mënyrë të veçantë luftërat dardano-bastarne), Roma ishte një tjetër faktor i jashtëm që ka ndikuar në zhvillimin e brendshëm të dardanëve dhe të Dardanisë si dhe në zhvillimin e mëtejshëm historik të saj. Dardania duhet të ketë pasur tejet të vështirë mbajtjen dhe ruajtjen e pozicioneve të pavarura të saja. Është pikërisht kjo hapësirë ku jetojnë dhe kundërshtojnë aspiratat e të tjerëve, dhe realizimi i interesave të tyre dhe mbrojtjen e tyre përballë synimeve maqedono-romake, i bëjnë që dardanët të jenë të njohur si një nga fiset më të organizuara në Ballkanin Qendror. Përveç kësaj, dardanët shfaqen si një faktor i organizuar shoqëror me një entitet shtetëror dhe organet e saj, me ushtrinë, e cila, kur ishte e nevojshme dhe thirrej mund të shkonte për ndihmë, me strukturë të diferencuar sociale. Sipas, autorit, kjo është edhe arsyeja, se pse Roma është dashur t'i merren parasysht dardanët dhe pse emri i tyre është ruajtur në formën administrative dhe etnografike deri në antikitetin e vonë. Si kontaktin e parë diplomatikë konkret në mes të dardanëve dhe

romakëve, autori e konsideroni rastin e djalit të Longarit, *Batos*, i cili i ofron ndihmë Romës kundër maqedonasve. Në vitin 200 p.l.K., mbreti dardan Bato, së bashku me ardianët e mbretër të tjerë ilirë, lidhën aleancë me romakët kundër Maqedonisë. Kjo i shtyu dardanët të ndërmerrnin sulme të reja në jug të kufirit të tyre.

Në anën tjetër edhe luftërat e dardanëve kundër romakëve vazhduan për shumë vjet me ashpërsi shumë të madhe, në rrethanat kur senati romak synonte të shtrinte pushtimet e tij në të gjitha tokat ilire dhe të arrinte deri në Danub. Dardania u bë pengesë serioze për shumë vjet me radhë për ushtrinë pushtuese romake, të cilat nuk hiqnin dorë nga synimet e tyre. Megjithëkëtë në vitin 97 p.l.K., romakët arritën të vinin nën varësi të përkohshme dardanët dhe fise të tjera fqinje, të cilat më vonë i ripërtërinë forcat dhe u shkaktuan humbje të rënda romakëve. Aq të vështira ishin këto luftëra për romakët, sa kur konsulli romak Gaj Kurioni përgatitej me 5 legjione të nisej në luftë kundër Dardanisë, njëri nga këto legjione ngriti krye dhe nuk pranoi t'i bindej komandantit të vet të shkonte në këtë luftë që ushtarët e quanin të rrezikshme. Pas luftërave të gjata me romakët, nga fundi i shek. I p.l.K., dardanët e humbën pavarësinë e tyre dhe hynë nën varësinë e plotë të Romës.

Me vendosjen e sundimit romak mbi ilirët struktura shoqërore nuk ka ndryshuar. Sipas autorit, ruajtja e strukturës së mëhershme, ka ndodhur për faktin se romakët, të udhëhequr nga politikanë pragmatikë, kanë ruajtur strukturat sociale ekzistuese të popujve, duke u dhënë atyre vetëm një interpretim juridik romak. Vetëm në këtë mënyrë Roma mund të zbatonte politiken e saj të jashtme, objektivi kryesor i së cilit ishte që të shfrytëzonte burimet e shumta minerare në të gjithë territorin ilir. Duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga Varroni, autori z.Mirdita, flet për ekzistencën e dy strukturave sociale kryesore: *fshatarët e lirë* (*pauperculi* – të varfërit apo pronarët e vegjël, *mercenari* - fuqi punëtore sezonale që kryenin punë të rënda në bujqësi dhe *obaerati* – qytetarë që për shkak të borxheve kishin rënë në pozitën e skllavërisë) dhe *skllavërit*. Aktiviteti ekonomik i dardanëve në periudhën pararomake me kohën romake ishte i ndryshëm. Ajo ishte një pasqyrim i strukturës sociale dhe konfigurimit gjeografik të Dardanisë. Pikërisht, nga vepra e Varonit njihemi edhe me atë strukturë sociale e cila merrej me blegtori dhe bujqësi. Falë tokës së pasur bujqësore aktivitetet bujqësore në fushën e Dardanisë, sidomos në pjesën e saj qendrore, e cila është territori aktual i Kosovës. Në këtë zonë dardanët kultivonin drithëra të ndryshme, pemëtarinë dhe vreshtarinë.

Por një nga veprimtaritë më të rëndësishme ekonomike që nga kohët parahistorike deri në antikitetin e vonë të dardanët ishin minierat. Straboni shkruan për minierat e pasura të argjendit në afërsi të qytetit Damastion. Plini Plak, shkruante se në Dardani burrat mbajnë rrathë të artë (bylyzykë), nga të cilët ato janë quajtur dardane. Qendrat kryesore të minierave ishin *Metalla Ulpiana*, ku i përkasin Kishnica, Janjeva dhe Novobërda, dhe *Metalla Dardanica*, me qendër në Municipiumin DD, duke përfshirë edhe zonat e minierave të Kopaonikut. Bazuar në materiali epigrafik, prof. Mirdita na njofton se këto miniera ishin direkt nën autoritetin e perandorit, kurse menaxhimin dhe kontrollin e tyre e bënte *procuratores metallorum*. Gjithsesi se tregtia ishte veprimtari e rëndësishme ekonomike të dardanët gjatë tërë sundimit romak. Në veprën e një autori Anonim të shek.IV, lexojmë se djathi dardan ka qenë i njohur, ku si traditë të përpunimit të djathit, autori Mirdita, e merr shembullin e përpunimit të djathit të Sharrit.

Një kapitull të tërë, autori i ka kushtuar rrugëve, vendbanimeve, lokaliteteve, stacioneve etj., ku duke u mbështetur në të dhënat e autorëve antikë, ato arkeologjike dhe të itinerarëve, me sukses ia ka arritur që të bëjë ubikacionin dhe identifikimin e një numri të madh të vendbanimeve të periudhës pararomake, romake dhe atyre të periudhës së hershme bizantine. Sipas tij, karakteristikë themelore e urbanizimit të trevës së Dardanisë, së paku sa i përket shek.III dhe IV, është se ato janë të koncentruar gjatë rrugëve dhe në regjionet e pasura me xeherore.

Duke vlerësuar rëndësinë e fenomenit të religjionit dhe kulturës shpirtërore përmes kulteve të ndryshme që janë dëshmuar në territorin e dardanëve, autori i ka kushtuar një hapësirë të veçantë këtij fenomeni duke e trajtuar që nga parahistoria e hershme e deri në antikën e vonë. Aty ku depërtimi i të mirave kulturore dhe shpirtërore ka qenë më i lehtë, e këtu në rendë të parë mendohet në luginat e lumenjve (Vardari, Morava, Drini i Bardhë, Drini i Zi dhe Ibri), pastaj në zonat e territoreve fqinjësore, aty edhe begatia shpirtërore e kulteve të ndryshme dhe formave të ndryshme religjioze, ka qenë i pranishëm në mënyrë vepruese. Siç e thekson edhe autori i librit, studimi i këtij fenomeni është mjaft i vështirë për faktin se vetëm romakët besonin në më shumë se 30,000 perëndi. Sipas rezultateve të tija, del se kultet kryesore të jetës religjioze të popullsisë dardane, kryesisht ishin simbole që paraqitnin hyjnitë htoniko-vegjetative, qoftë në trajtën e trupave gjeometrikë, me trajta të ndryshme, si roboidë apo kryqe të thyer (svasika), qoftë trajta të kafshëve, siç është gjeli dhe gjarpri.

Nga kultet epihorike autoktone, të cilat janë dëshmuar në trevën dardane, autori merr në shqyrtim hyjnitë: *Andinus*, *Atta*, *Dardaniae*, *Dionysos*, *Ezzaios*, *Iupiter Ulpianensis*, *Kalorësi i Pellgut Danubian*, *Kalorësi Trakas*, *Liberi dhe Libera*, *Melcidi*, *Myndry(tus?)*, *Quadr(iviae)*, *Silvani*, *Sonketene*, *Tato/Tatto* dhe *Zbeltiurdus*. Në Dardani janë dëshmuar edhe tri kulte të importuara nga kultet egiptiane: *Antinou*, *Isida* dhe *Serapisi*.

Duke qenë se Dardania, për nga pozita gjeografike ka qenë urëlidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit, autori evidenton kulte të importuara dhe sinkretizime të kulteve orientale me ato të botës ilire dhe greko-romake: *Bellona*, *Bonus Eventus*, *Caelus*, *Dea Syria-Atargatis*, *Domina et Dom(i)nus*, *Iupiter Dolichenus*, *Kibela*, *Mitra*, *Omfala*, *Pantos*, *Sabazius* dhe *Terra*. Edhe religjioni romak, jo vetëm që u bë tolerant ndaj kulteve dhe hyjnive të huaja, por ai edhe u pasurua me to, duke i përvetësuar përmes sistemit *interpretatio romana*. Kështu, prej zotërave romakë që janë dëshmuar në Dardani, vendin e parë e zë *Jupiteri Optimis Maximus* (IOM), i cili dëshmohet edhe në bashkësi me *Minerven*, *Herkulin*, *Neptunin*, *Junonën*, etj. Në Dardani dëshmohen edhe kultet joolimpikë: *Asklepi*, *Hygia* dhe *Telesforos*; pastaj hyjnitë e natyrës: *Gjarpëri* dhe *Nymfet*; zotërat e shtëpisë: *Geniusi* apo *Ora*, etj.

Mirdita, duke qenë njohës i kulturës materiale, asaj i kushtojë një hapësirë të veçantë, duke trajtuar këtë problem nga kultura e Starçevës dhe në veçanti të kulturës së Vinçës (figurinat antropomorfe e zoomorfe dhe altarët prej balte të pjekur) flasin për një botë të pasur shpirtërore, pos asaj materiale, ndërsa idolet e kulturës së Vinçës i arritën majat e shprehjes artistike në hapësirën e Dardanisë. Autori na ofron të dhëna për shtresat kulturore, për varret me urna - kultura e Berrnicës (Berrnicë, Grashticë), për nekropolet tumulare (Romajë, Rogovë, Ujz, Shirokë, Dibiçak, Porodime, etj.), të cilat në Dardani përkojnë me kompleksin kulturor të Gllasinacit dhe lidhen me tumat e Kukësit, Matit dhe Gllasinacit. Të dhëna dhe mendime të çmuara na ofron për artin e arkitekturës së periudhës romake të pranishme në trevën e Dardanisë (municipiumi DD dhe Ulpiana). Por, sipas Mirdites, arti i shek. IV ndryshe nga ato të mëparshme, karakterizohet nga monumentalja dhe abstraksioni në arkitekturë dhe në skulpturë. Liria e të krishterëve me dekretin e Milanos (më 313), është pasqyruar në arte, veçanërisht në arkitekturë dhe në afreska. Qendrat ipeshkvore, si Ulpiana, Scupi ose Justiniana Prima u dekoruan me bazilika dhe mozaikë, tani të paraqitura me simbolet e besimit dhe të figurave të shenjtoreve të krishterë. Përveç kësaj, sheshe, ndërtesa të ndryshme

administrative dhe kishtare, banjo, ujësjellës dhe shumë objekte të tjera ishin të dekoruara dhe funksionale në qendrat më të rëndësishme urbane të Dardanisë nga periudha e vonë Romake.

Problemi apo intensiteti i romanizimit është një çështje tjetër e rëndësishme e trajtuar në këtë monografi. Autori i librit, duke u bazuar në materiale të larmishme arrin në përfundime se nuk mund të flitet për një romanizim si faktor asimilimi për popullatën vendase dardane dhe se ky element ka qenë shumë sipërfaqësor. Sipas autorit, romanizimi është një proces i ndërlikuar me aspekte të ndryshme të pranisë së pushtetit romak, por jo në dëm të entitetit kulturor etnik të popullatës së nënshtruar, por në mundësimin e shfrytëzimit të të mirave, në rend të parë, të atyre ekonomike dhe juridike. Në këtë kontekst, sipas tij duhet kuptuar aktivitetet e ndryshme ekonomike. Në të vërtetë, nën nocionin “romanizim” duhet kuptuar “shtetësia” e popullatës së vendit përkatës. Mirëpo, edhe në dhënien e “shtetësisë romake” apo “*ius civile romanum*” ose “*ius civile peregrinorum*” pushteti romak ka qenë mjaft i kufizuar. Kjo sidomos vlen për ato treva të cilat për nga aspekti ekonomik kanë qenë të rëndësishme për mbushjen e arkës shtetërore. Një trevë e tillë, duke iu falënderuar resurseve natyrore, ka qenë edhe Dardania.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se organizimi socio-politik dhe ekonomik, përmes fenomenit të romanizimit, jo vetëm se nuk është shkatërruar, por vende-vende as që është prekur. Edhe nëse vërehet ndikimi i karakterit kulturor e social kjo gjë është shprehur në shtresat e larta politiko-shoqërore, ushtarako-ekonomike, të cilat kryesisht ishin me origjinë të huaj. Këtë fenomen e dëshmon edhe materiali epigrafik i gjetur në trevën e Dardanisë. Ky material më së shumti është gjetur në territorin e kolonisë Scupi dhe në vetë Scupin, pastaj në vendet urbane municipale ku, kuptohet elementi administrativ ka qenë me origjinë të huaj. Vetë fakti se procesi i urbanizimit në trevën e Dardanisë, në krahasim me atë të trevës tjetër të Moesia Superior, ka qenë më se i dobët, flet në të mirë të faktit se fenomeni i romanizimit të Dardanisë ka qenë tejet sipërfaqësor, i pjesshëm dhe është shprehur kryesisht në strukturat etnike të ardhacakëve. Kështu, bie fjala, në saje të materialit epigrafik, të zbuluar në Scupi, mund të dëshmohet se shumica e individëve të dëshmuar në të, janë nga Maqedonia, gjegjësisht nga treva e së folmes greke; pastaj nga Dalmacia dhe Italia Veriore. Ndërkaq, ai i trevës së Municipiumit të Naissusit na dëshmon për dy grupe të popullatës: popullatën vendëse, romanizimi i së cilës fillon që në kohën e perandorit romak Trajanit dhe elementi tjetër me origjinë nga qytetet tjera të Moesia Superior, shumica prej tyre nga Scupi, edhe pse ata me gentiliciumin perandorak *Aelius* gjithashtu kanë mundur të

jenë vendës. Sa i përket territorit *Timacum minus*, ata që dëshmohen në materialin epigrafik si popullatë me origjinë të huaj, aty kanë ardhur si pjesëtarë të kohortës I *Thracum*. Pjesa tjetër e përbërë nga pjesëtarë të kohortës II Aurelia Dardanorum, ka mundur të jetë e përbërë nga vendësit. Sidoqoftë edhe këtu elementi i huaj është më i pranishëm në materialin epigrafik.

Mirëpo, elementi ushtarak, aq sa mund të shihet në saje të materialit epigrafikë, si në Municipium Ulpianum ashtu edhe në Municipium DD është tejet i parëndësishëm. Këtu ka mjaft individë civilë, me origjinë qoftë orientale qoftë edhe nga provincat tjera. E çka të thuhet për territorin tjetër të Dardanisë ku materiali epigrafikë është tejet i pakët? Më në fund duhet thënë se romanizimi i dobët shprehet edhe në mosnjohjen e gjuhës latine, i cili fenomen shprehet pikërisht në materialin epigrafik, e sidomos në atë të gjetur në Dardani. Gabimet gjuhësore të cilat janë evidente në materialin epigrafik, e sidomos në atë të karakterit të stelave mbivarrore, nuk janë vetëm dëshmi e mosnjohjes së gjuhës latine të gurgdhendësve të cilët i kanë skalitur tekstet, por edhe të atyre që i kanë porositur këto tekste.

Për një proces të dobët të romanizimit të këtyre trevave, autori e merr si bazë edhe vetë strukturën sociale dhe kundërthëniet ndërmjet tyre, duke përmendur edhe dukurinë e *latronëve* (“lëvizje kaçake”, Gj.B), e që jo vetëm që tregon efektin e dobët të romanizimit të vendasve, por nxjerrë në pah edhe “izolimin e popullatës se joromanizuar prej asaj të romanizuar”. Nga ky fakt mund të kuptohet mungesa e materialit epigrafik me emrat e popujve indigjenë që materiali është gjetur kryesisht në qendrat urbane. Sipas prof. Mirdites, për më tepër, sistemi ekonomik i Dardanisë në kohën e perandorisë Romake dhe Perandorisë Bizantine ishte i bazuar në prodhimin e popullatës lokale, i cili ishte bartës kryesor i ekonomisë, megjithatë, dhe kjo tregon qartë se është ruajtur elementi autokton. Sipas tij, në këtë reflektohet politika “Pax Romana”, qëllimi i të cilit nuk ishte dominimi i plotë mbi pellgun mesdhetar, por edhe me forcimin e paqes së brendshme, tu jepej vetëqeverisja e plotë bashkësive fisnore, fshatarësia të cilëve ishte forca dhe boshti kryesor i prodhimit si në bujqësisë ashtu edhe në xehetari. Pastaj edhe ekonomia e antikitetit të vonë tregon për ekzistimin e elementit vendës ende të ruajtur, siç janë fshatarët e lirë (*incolae*) dhe të shtresave të varfra.

Duke qëmtuar në hollësi qofte materialin epigrafik qoftë atë historik, autori i këtij studimi, në lidhje me romanizimin, vjen në konkludime se nuk mund të flitet për romanizimin si një faktor i

asimilimit dhe të shpërndarjes së popullsisë autoktone të trevës së Dardanisë. Në këtë drejtim, edhe ata emra romakë të vendbanimeve, që janë të ruajtur deri vonë në përdorim dhe që e kanë mbijetuar edhe Perandorinë Romake, nuk mund të tregojnë për ekzistencën e popullsisë të romanizuar. Po ashtu, edhe emrat me origjinë të huaj mund të jenë vetëm provë e ndikimit të huaj, kulturor, por në asnjë mënyrë provën e ekzistencës së vërtetë të elementit të huaj. Dhe për këtë, si argument krahasues, autori, na përkujton antroponiminë e sotme shqiptare, e cila përbëhet prej asaj arabe, persiane, hebreje, të krishterë dhe kështu me radhë. Kështu, sipas arritjeve shkencore të akademik Zef Mirdites, nuk mund të flitet për një romanizim të popullatës vendëse dardane, e cila përkundrajt kataklizmave që ka përjetuar kjo trevë gjatë dyndjeve të barbarëve (gotëve, hunëve, sllavëve), u ka rezistuar dhe, aq sa ka qenë e mundur, ka qenë bartëse e procesit civilizues të ardhacakëve barbarë. Kjo më së miri shihet në procesin e kristianizimit të kësaj treve dhe në organizimin e jetës kishtare, e sidomos në kristianizimin e ardhacakëve. Duke u ngjitur prej antikitetit të vonë në mesjetën e hershme, qytetet e Dardanisë (Naissusi, Justiniana Secunda, Prizreni, Peja, Dërsniku) edhe më tej mbetën qendra të njohura të jetës ekonomike, si dhe ndërlidhëse në transmetimin e kulturës materiale e shpirtërore të lashtësisë dardane në mesjetën arbërore.

Për fund, do të konkludonim se vepra madhore “*Dardanci i Dardanija u antici*”, që dijetari i madh shqiptarë i formatit evropian, prof. Mirdita na la në fund të jetës së tij, e punuar me bazë në burime dhe literaturë të pasur shkencore, ka një vlerë të jashtëzakonshme shkencore jo vetëm për historiografinë shqiptare por edhe për historiografinë evropiane dhe më gjerë.

Me këtë vepër prof. Zef Mirdita ka treguar dhe vërtetuar se zotëron shkëlqyeshëm me materien dhe metodologjinë shkencore e cila mund t’u shërbej të tjerëve në trajtimin e problematikave të ngjashme. Mbetet obligim dhe nevojë që ku studim të përkthehet në gjuhën shqipe dhe atë angleze, me çka do të bëhej edhe më lehtë i përdorshëm për studiuesit dhe studentët shqipfolës dhe më i pranishëm te komuniteti i studiuesve ndërkombëtar.

Gjon BERISHA

Teuta Shala-Peli, “Drishti në Mesjetë”, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, Prishtinë 2016, 345 f.

Në mesin e botimeve më të reja të studiuesve të Institutit të Historisë “*Ali Hadri*”, është vepra e dr. Teuta Shalës me përmbajtje specifike dhe të rëndësishme për historinë mesjetare shqiptare me titull “Drishti në Mesjetë”. Ky studim monografik që po i prezantohet lexuesit, ka për objekt studimi qytetin mesjetar të Drishtit, duke përfshirë aspekte të ndryshme të zhvillimit historik, shoqëror, ekonomik, kulturor, religjioz e politik të këtij qyteti, që nga koha e formimit si qytet e deri tek rënia e tij nën sundimin osman. Qëllimi i kësaj monografie, ashtu siç theksohet edhe nga autorja, është që të vë në pah rëndësinë dhe rolin e këtij qyteti mesjetar, si dhe transformimin e tij nga një qendër dikur e rëndësishme, në një fshat të harruar dhe të lënë nën mëshirën e fatit.

Në të vërtetë, monografia “Drishti në Mesjetë”, është rezultat i punës disavjeçare të autores, ku si thelb i trajtimit të problemeve në këtë monografi është periudha, e cila kap harkun kohor fundi i shek. XIV deri në fund të shek. XV, periudhë e cila karakterizohet me arritjen e një shkalle të lartë të zhvillimit të Drishtit si qytet dhe si qendër e rëndësishme mesjetare, si dhe me rrudhjen graduale të këtij zhvillimi, shndërrimin e tij në fshat duke humbur rëndësinë që kishte më parë. Monografia “Drishti në Mesjetë”, është e ndarë në tre kapituj, si dhe është i pasuruar edhe me aparaturë shkencore, ngase përmban Përfundimin, Rezymenë në gjuhën angleze, Treguesin e Emrave, Burimet si ato të pa botuara ashtu edhe ato të botuara, si dhe një literaturë të përzgjedhur.

Duke përjashtuar disa shkrime të veçanta nëpër revista shkencore, padyshim të rëndësishme, që janë bërë në të kaluarën për historinë e këtij qyteti, të studiuesve si Jiriçeku e Shufflay, një histori integrale për qytetin e Drishtit nuk ka ekzistuar. Në këtë drejtim përmbledhja, studimi dhe ndërtimi i një historie gjithëpërfshirëse nga burime të botuara e të pabotuara të shpërndara gjithandej, është meritë e autores, punë të cilën ajo e ka arritur me sukses. Përfshirja në libër e aspekteve të ndryshme të historisë dhe jetës së qytetit (historia politike, ekonomike, shoqërore, fetare e kulturore), janë vërejtur, dokumentuar dhe parashtruar qartë dhe me elokuencë nga autorja.

Drishti, sikurse edhe qytetet arbërore gjatë mesjetës (Durrësi, Lezha, Shkodra, Ulqini), njohu rrugëtimin e saj historik. Nga një qendër e thjeshtë administrative e kishtare, me kalimin e kohës u bë një pikë e rëndësishme zhvillimi, derisa fitojë edhe një autonomi politike e administrative në raport me pushtuesit dhe administruesit e kohës, qofshin ata të huaj, qofshin vendas, siç ishin familjet e mëdha feudale arbërore të shek. XIV-XV. Një fat të tillë e kishte edhe Drishti, pozita gjeografike e së cilës favorizonte kryerjen e operacioneve tregtare dhe veprimtarive të ndryshme me karakter ekonomik e politik. Sikurse edhe studiuesve të mëhershëm dhe gjuhëtarëve, edhe autores nuk ka mundur t'i shpëtojë edhe trajtimi i origjinës dhe versioneve të emrit të qytetit (Drivastum, Driuastum, Drivasti, Driuasti, Drivastensem, Trivastum etj.), nga të cilat vjen në përfundim se dëshmon për vazhdimësinë iliro-arbërore të kësaj treve. Nëse i referohemi Milan Shufflay, Drishti u ngrit prej pjesëve të rrënuara të qytetit të madh të Diokles romake pas shkatërrimit të saj nga dyndjet barbare. Në fakt, shfaqja e Drishtit përkon me përmendjen në shekujt e parë të mesjetës së hershme, e cila do të formohet plotësisht si e tillë, kur edhe do të përmendet në dokumentet kishtare si seli ipeshkvnore që në shek. IX.

Gjatë mesjetës, qyteti i Drishtit për shkak të rëndësisë që kishte, ishte në shënjestër të sunduesve të ndryshëm, dhe si pasojë njohu disa sundues: pas ndarjes së P. Romake (359) ishte pjesë e Bizantit, ku me krijimin e Themës së Durrësit (shek. IX) edhe Drishti u bë pjesë e saj; prej viti 1198, për rreth 150 vite do të përballlet me pushtimin nemajidë të Rashës; nga fillimi i shek. XIII qyteti ra në duart e Despotatit të Epirit dhe përsëri u ripushtua nga serbët; pas shpërbërjes së mbretërisë së Stefan Dushanit, Drishti ra në duart e Dinastisë së Balshajve. Gjergji II duke mos qenë në gjendje t'i bëjë ballë osmanëve, ia dorëzoi në vitin 1396 Republikës së Venedikut bashkë me qytetin e Shkodrës pas një shpërblimi monetar. Luftën për marrjen e Drishtit do ta rifillonte i biri i

Gjergjit II. Është tashmë e njohur dhe e dokumentuar Kryengritja e vitit 1405. Gjatë kësaj kryengritje banorët vendas dëbuan magjistratët venedikas. Venedikasit u detyruan të marrin masa të menjëhershme dhe pas disa muajsh, në gusht të vitit 1405, e rimarrin qytetin. Qyteti i Drishtit do të rikalonte përsëri në duart e Balshajve në vitin 1418, pasi Balsha III nuk e reshti luftën asnjëherë. Pas vdekjes së Balshës III, Drishti përsëri bie nën sundim venedikas, kurse në vitin 1478, qyteti bie nën sundimin osman.

Gjatë sundimit të dinastisë Balshaj qyteti njohu zhvillim të madh ekonomik saqë arriti të nxirrte në qarkullim edhe monedhën e vet me mbishkrimin latin “Civitas Drivasti”. Për sa i përket të drejtës qytetare Drishti vetëm në shek. XIV cilësohet si një qytet autonom me statut që njihet si “antiqua statuta”. Për qytete si Shkodra, Tivari, Ulqini ekzistenca e statuteve dokumentohet po ashtu që në shek. XIV. Sipas dr. Teuta Shalës, duke u mbështetur edhe në Statutin e qytetit, pohon se qyteti i Drishtit gjatë mesjetës kishte arritur një organizim të lartë komunal. Bazuar në këtë Statut, i cili në qendër të tij kishte rregullimin e marrëdhënieve midis institucioneve fetare, del se pushteti laik në Drisht shkrihej me atë fetar. Elementët laikë të Statutit vërehen në ato kapituj të cilët synonin që të rregullonin raportet midis gjeneratave të vjetra me ato të reja, për respektin e ndërsjellë etj. Duke njohur vlerën e statuteve mesjetare të qyteteve, autorja bënë krahasime duke nxjerrë në pah të veçantat dhe të përbashkëtat e statuteve të qyteteve mesjetare arbërore, siç ishin statutet e Shkodrës, Tivarit, Kodit të Stefan Dushanit, Kanunit të Lekë Dukagjinit etj., me Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit.

Duke njohur natyrën kishtarë të qytetit, një vëmendje të veçantë, autorja, i kushton jetës dhe organizimit kishtar të qytetit, edhe për faktin se gjatë mesjetës, qyteti i Drishtit konsiderohej jo vetëm si seli ipeshkvnore, por edhe si qyteti më katolik i Shqipërisë. Përveç trajtimit për jetën kishtarë, organizimin dhe juridiksionin kishtar të saj, autorja na ofron një mori dokumentesh dhe të dhënash arkeologjike për ekzistimin e një numri të konsiderueshëm të objekteve kishtarë (katedrale, kisha, kishëza, manastire, prona kishtarë), duke përfshirë kishat katedralet e Shën Marisë dhe Shën Gjergjit, manastirin e Shën Gjonit etj. Ajo përmendë një listë të gjatë të klerit të Drishtit, sidomos radhët e ipeshkvijve, duke filluar nga viti 877 për të përfunduar me vitin 1636. Duke qenë një qytet i njohur me tipare kishtarë, Drishti nxori një numër të konsiderueshëm klerikësh, një pjesë e të cilëve shërbyen në Venedik, Raguzë e qytete tjera të Dalmacisë dhe Italisë, emrat e të cilëve dalin

qartazi në dokumentet e kohës, sidomos nga librat noterialë të Raguzës. Vetëm brenda viteve 1370-1390, identifikohen në Raguzë 50 klerikë të ardhur nga trevat shqiptare, ku pothuajse çereku prej tyre e kishin prejardhjen nga Drishti. Nisur nga këto të dhëna (nga aktet noteriale, testamentet etj.), më të drejtë, Drishti do të quhet edhe si fidanishte e klerikëve katolikë.

Namin dhe madhështinë e Drishtit, i cili në kohën e vet i bënte hije dhe Shkodrës fqinje, ia kishin rritur edhe personalitete e familje të njohura arbërore, të cilat me një mjeshtri të rrallë, autorja, i inkorporon në kuadër të historisë së ngritjes dhe rënies së qytetit. Njëra ndër këto familje është edhe personaliteti dhe familja fisnike e Pal Ëngjellit, bashkëpunëtorit, këshilltarit e diplomatit të Skënderbeut, për të cilin, recensenti i këtij libri, P. Xhufi do të shprehet se është mishërimi i një modeli kulturor nga më të lartët që mjedisi mesjetar shqiptar mundi të prodhonte. Por ai nuk është i vetmi. Në Statutin e Drishtit dhe në dokumente tjera relevante, autorja, evidentohet dhe na ofrohen të dhëna për disa familje fisnike arbërore, të cilat lanë gjurmë në jetën politike, kulturore, sociale e ekonomike të vendit. Lozen e këtyre familjeve studiuesja i ka kërkuar edhe larg Drishtit, në Venedik e në qendra të tjera italiane, ku diaspora drishtiane u vendos pas pushtimit osman. Në kuadër të familjeve fisnike arbërore që lanë gjurmë në historinë e qytetit, përveç familjes Ëngjelli, autorja i radhitë edhe familjet: Spani, Suma, Ungri (Ungaro), Prekali, Jonima, Lepore (Leporibus), Schipudari, Spironi, Polombo, Altamura, Bello, Sakati, Zaoni, Mertushi, Zogu, Bariloku, Kamishi etj.

Shfrytëzimi i Statutit të Drishtit dhe një sërë dokumentesh ia kanë mundësuar autores që të njihet me të dhëna të shumta për rolin dhe pozitën e gruas në këtë qytet dhe qytetin fqinj Shkodrën gjatë mesjetës. Nga ato që na i ofron dr. Teuta Shala-Peli, del se femra në shoqërinë mesjetare të Drishtit kishte fituar një rol të rëndësishëm në jetën ekonomike, kulturore dhe sociale të qytetit. Në këto dokumente, del se gruaja gëzonte të drejta të avancuara, të tilla siç ishte edhe e drejta e saj për trashëgimi dhe për hartimin e testamenteve, ku vajzat kishin të drejtë të trashëgonin pasuri nga prindërit. Këto dhe shumë të dhëna tjera, janë tregues i mirë se sa çmohej dhe cili ishte roli i gruas në shoqërinë mesjetare. Pas trajtimit të marrëdhënieve ekonomike të Drishtit me Venedikun e Raguzën; mbi prodhimet dhe tregtinë me kripën, drithërat, verërat; mbi doganat e mishit dhe herbatikut, vajit dhe mëndafshit, autorja e përmyll studimin me fazën e pestë, e cila përfshinë periudhën kohore 1448-1478, e që ngërthen me periudhën më

të rëndë, atë të pushtimit osman. Fundi i sundimit venedikas dhe fillimi i pushtimit dhe sundimit osman do të karakterizohet me humbjen graduale të rolit dhe rëndësisë që kishte Drishti dikur si qendër e rëndësishme, deri në fundin e ekzistimit të saj si qytet. Fati deshi që për të dëshmuar, Drishti la pas vetës rrënojat e saja, por jo vetëm kaq, ai la prapa një numër të konsideruar dokumentesh arkivore, akte noteriale, statutin, kronika, monedha, gjenealogji familjesh e shumë të tjera, që na bëjnë të mundur të njohim jetën e këtij qytetit mesjetar, derisa kjo jetë ju morë dhe iu shkretua nga osmanët në vitin 1479.

Një aspekt interesant e përbën edhe baza burimore e këtyre studimeve. Si njohëse, qëmtuese dhe vlerësuese e bazës dokumentare të burimeve arkivore, kryesisht atyre të Raguzës dhe Venedikut, studiuesja Teuta Shala-Peli, i kushton vëmendje sjelljes së të dhënave që gjejnë mbështetje në faktografi, por edhe në literaturën relevante të autorëve eminentë, qofshin ata të proveniencës shqiptare, qofshin të huaj. Në këtë mes, ajo që është më e theksuar dhe për t'u admiruar është vënia përballë e burimeve të ndryshme dhe qasja kritike e shkencore e burimeve dhe literaturës duke mos hezitur që në shumë raste të ofrojë edhe mendimet e saja personale mbi çështje të veçanta.

Qasja kritike në raport me burimet dhe studimet paraprake nis që në identifikimin e burimeve të trajtuara në kuadër të "Hyrjes" së studimit, duke mos u mjaftuar vetëm me përmendjen e emrave të përveçëm të studiuesve dhe të institucioneve shkencore të respektuara. Përkundrazi, bën një vlerësim kritik të burimeve, ashtu edhe të pikëpamjeve, duke i respektuar secilin, dhe duke i përballur ato dhe duke i vlerësuar, për të konstatuar qëndrueshmërinë dhe vërtetësinë e tyre. Kjo formë e punës, autores i ka krijuar komoditetin e shkrimit të një studimi të thjeshtë dhe të argumentuar, në të cilin lexuesit, dhe sidomos studiuesit, do të gjejnë një qasje racionale, tipik për natyrën e stilit të shkrimit shkencor.

Këto që u thanë dhe shumë vlera tjera, që studiuesja Teuta Shala-Peli i ka ofruar komunitetit të studiuesve dhe lexuesve të rëndomtë, e bëjnë studimin në fjalë, një kontribut të rëndësishëm për historinë e qytetit mesjetar të Drishtit në veçanti dhe historiografinë shqiptare në përgjithësi.

Gjon BERISHA

MITOLOGJIA ANTIKE MES “MJEKËSISË HYJNORE” DHE ASAJ PROFESIONISTE

Daniela Rigato, *Gli dei che guariscono: Asclepio e gli altri*, Itinerari di storia antica/5, Patron Editore, Bologna 2013, f. 164.

Libri “Gli Dei che guariscono: Asclepio e gli altri” (Hyjnitë shërues: Asklepi dhe hyjnitë e tjerë), i autores italiane Daniela Rigato, profesoreshë e Historisë Antike, në Universitetin e Bolonjës (Itali), i botuar në Bolonjë, në vitin 2013, trajton çështje interesante të mitologjisë klasike mbi baza të zbulimeve arkeologjike, besimet e njerëzve gjatë antikës në kultet e hyjnive të caktuara për të cilët besohej që kishin aftësi shëruese dhe bashkëjetesën dhe komplementimet e ndërsjella të mjekësisë “profesioniste” dhe të asaj “hyjnore”.

Shërimin (gr. *technike iamata*, lat. *sanationes*) në botën antike pos tek mjekët të sëmurit e kërkonin edhe përmes lutjeve dhe riteve të ndryshme nëpër tempuj e vende të shenjta me ndihmën e priftërinjve të hyjnive të caktuar për të cilët besohej që kishin aftësi shëruese, para se gjithash Asklepit (tek grekët) apo Aeskulapit-Eskulapit (tek romakët) dhe përcjellësve të tij. Lutjet përcjellshin me flijime, ndërsa të sëmurit duhej ta kalonin natën nëpër tempuj ose orakuj, të cilët kishin dhomat e gjumit ku pritej shërimi me anë të përdorimit të ujit nga burimet e shenjta dhe nga takimi me zotat në gjumë, të cilët, siç besohej dhe ishte e paraqitur nëpër relieve figurale nëpër tempuj, i shëronin të sëmurit me prekje me duar, lyerje me melheme të ndryshme, me operacione apo edhe në mënyra të ndryshme mirakuloze. Pos paraqitjeve figurale, si dëshmi e shërimeve, nëpër tempuj ruheshin shkopinjë, patericat dhe mjetet e ndryshme ndihmëse protetike si dhe skulpturat anatomike të organeve të shëruara.

Vepra në fjalë trajton tri çështje kryesore: krijimin e kultit të Asklepit në botën helene, përhapjen e kultit të hyjnive shëruese anembanë botës antike dhe shndërrimin e tij në kult universal si fenomen i botës antike, të bazuara mbi gjetjet arkeologjike të plotësuar me dëshmi të autorëve antikë dhe me të dhëna relevante nga një bibliografi e pasur të botimeve të botuara në një varg vendesh të ndryshme të botës.

Pjesa e parë “Il culto nel mondo greco” (Kulti në botën greke, f. 27-128): trajton origjinën e kultit, mënyrat e shërimit, tempullin më të madh kushtuar Asklepit-Asklepionin në Pergamon, dhuratat (si shenjë falënderimi perëndive për lutjet e realizuara) me forma anatomike të organeve të shëruara, rastet e posaçme të shërimit të besimtarëve, mjekët-adhures të Asklepit, shkollat e bibliotekat e mjekësisë si dhe dilemat e nevojtarëve, a t’i drejtohen mjekëve apo perëndive me qëllim shërimi apo për shëndet të mirë?

I biri i hyjit grek Apolon, Asklepi gjithmonë paraqitej i shoqëruar me bijën e tij hyjneshën Hygieia (Hygia ose Igea), e cila paraqitej në skulptura, gema, unaza, talismane e nëpër monedha e shoqëruar me një gjarpër gjithmonë përkrah të të atit (që i jep kultit të Asklepit karakter familjar). Hygieia në disa raste njëjtësohej me hyjneshën greke të urtësisë Athinen-Atena Hygieia, ndërsa tek romakët që nga shekulli II të erës sonë, njëhej me emrin Salus (shëndeti) që i përgjigjej nocionit valetudo (lat. shëndeti, sëmundja) dhe personifikonte shëndetin e mirë fizik.

I biri i Asklepit, Telesfori (gr. tele=fund, foros=bartës, pra bartës i fundit të sëmundjes), ishte përcjellës dhe ndihmës (me origjinë nga Pergamoni ose Epidauri) i Asklepit dhe i Hygias, që paraqitej si djalë i ri me trup e kokë të mbuluar me mantel të gjatë me kapulet-bardocucullus, nga e cila i dukej vetëm fytyra dhe shputat e këmbëve (lidhur me çka kishte mendime që ishte i shëmtuar dhe kishte trup e fytyrë të deformuar nga sëmundjet e dhembjet dhe që të sëmurëve ua sillte fundin e jetës e jo të sëmundjes). Detyrë e kishte kurimin e të sëmurëve me një lloj balsami shërues. Në shenjë falënderimi për ndihmën e tij perandorët Trajani e Hadriani shpeshherë e vendosnin figurën e Telesforit në monedha. Në paraqitjet figurale shumë rrallë paraqitej së bashku me Asklepin e Hygian. Hyjni të ngjashëm shërues në botën greke kishin qenë edhe Anfiari, Tronconi, Lebadea si dhe heronjtë e shërimit Amynos, Haloni, Hipoliti, Aristomaku, Iatros e disa të tjerë, të njohur edhe me emër heros iatros (heronj të shërimit, sipas nocionit grek iatrike tehne-shkenca e mjekësisë).

Nënkapitull të veçantë autorja Rigato ua kushton “I grandi dei” (hyjnive të mëdhenj), kryehyjit të plotfuqishëm grek Zeusit, pastaj birit të tij Apolonit - hyjit i cili, pos të tjerash, i largonte sëmundjet; Herakliut - simbolit të forcës fizike; hyjneshës së gjahut e natyrës Arthemides e Nimfave mbrojtëse të shëndetit, të cilët po ashtu konsideroheshin shërues, por nuk e posedonin fuqinë shëruese në atë masë si Asklepi (i cili kishte aftësi edhe të ringjallte njerëz të vdekur) dhe përcjellësit e tij. Në shtjellimin e vet, autorja zë në gojë edhe hyjnitë autoktone të helenizuara nga Azia e Vogël siç ishin: Hemithea, Men, Plutoja e Koret, të cilët nderoheshin në raste të caktuara dhe nuk e kishin rëndësinë e Asklepit dhe hyjnive që kishin të bëjnë me të.

Në nënkapitullin “Il culto nelle province dell’impero romano” (Kulti nëpër provinca të Perandorisë romake, f. 129-148), trajton përhapjen dhe nderimin e kultit të hyjnive shërues në Sicili, Sardenjë, në Magna Grecia-Megale Hellas, Pompei e Romë, Itali Qendrore e atë Veriore, ku ky kult kishte mjaft ithtarë dhe ku janë gjetur gjurmët e tempujve kushtuar hyjnive të shërimit.

Në pjesën e tretë të këtij studimi (f. 149-156), autorja ka trajtuar çështjen dhe procesin e përhapjes së kultit të Asklepit dhe hyjnive të tjerë të shërimit anembanë botës antike dhe fenomenin e shndërrimit të këtij kulti në kult universal në botën e asaj kohe.

Tekstet e monumenteve epigrafike dëshmojnë se adhuruesit e Asklepit kishin qenë njerëzit e rëndomtë (skllëvërit, të liruarit, ushtarakët me origjinë orientale, itallike, hispanike), por edhe zyrtarët e lartë shtetërorë e madje edhe vetë mbretërit dhe perandorët, të cilët për realizimin e lutjeve të tyre kishin ofruar fljime të gjakshme (gjela, këndesa) ose të pagjeshme (skulptura anatomike të organeve të shëruara, altarë, të holla) ose i kishin ngrit tempuj si shpagim *ex voto* (sipas premtimit të dhënë) apo *ex viso* (sipas ëndrrave) pas shërimit ose të realizimit të lutjeve të tyre. Lidhur me faktin sa i fortë kishte qenë besimi tek hyjnitë shërues janë ruajtur shënimet në shkrimet e autorëve antikë që kanë të bëjnë me shërimin në tempujt e Asklepit, përmes ritit *incubio* (lat. shtrirje, fjetje në tempull) të mbretit Pirro të Epirit (306-302; 297-292 para erës sonë), me ç’rast ishte flijuar gjeli i bardhë sipas dëshmive të Plutarkut (lidhur me çka ka mendime që Asklepi kishte qenë hyj origjinal ilir-vërejtje e NF). Duke shënuar këtë rast, autori Plini kishte shkruar se pas djegies së trupit të Pirros janë ruajtur organet e tij të shëruara (shpretka e shëruar nga inflamacioni). Autorë të tjerë antikë konfirmojnë rastet e shërimeve nëpër tempujt e Asklepit, Apolonit,

Serapisit e hyjnive të tjerë shërues të perandorëve romak Vespazianit (Taciti), Karakales, Komodit e disa perandorëve të tjerë (Dion Kasi).

Kërkimi i ndihmës nga mjekët (mjekësia profesionale) apo nga hyjnitë (mjekësia hyjnore) mes të cilave ekzistonte një komplementim i përsosur që nga shekulli V para erës sonë (prej cilës kohë ishin eliminuar elementet magjike, ndërsa që nga kjo kohë Asklepi paraqitej me attribute të mjekëve) varej edhe nga fakti se në shumë zona nuk kishte mjekë profesionistë të aftë apo edhe nuk kishte mjekë fare, pastaj nga sukcesi i shërimit tek mjekët, por edhe nga forca e besimit të të sëmurëve. Nevojtarët nganjëherë i drejtoheshin vetëm mjekëve, në disa raste të tjera vetëm perëndive apo në shumë raste edhe mjekëve e hyjnive njëkohësisht.

Në raste të këtilla të sëmurit vizitoheshin tek mjekët (në ato rajone ku kishte mjekë), dhe i nënshtroheshin terapive nëpër banja termale-minerale dhe me melheme e ilaçe të ndryshme varësisht nga natyra e sëmundjes, por njëkohësisht në mënyrë kompatible iu drejtoheshin edhe hyjnive me lutje për shpëtim e shërim, për çka flet një mbishkrim i ruajtur falënderimi: “Mjeku më ka shëruar, Zoti më ka shpëtuar!”. Nga ana tjetër mjekët e nderonin Asklepin si paraardhës të tyre dhe si mbrojtës të profesionit që e ushtronin ata, e disa nga këta ushtronin detyra të rëndësishme nëpër tempuj të Asklepit e të hyjnive të tjerë shërues. Shumë shpesh mjekët bartnin emra vetanake sipas hyjnive shëruese: Asclepius, Aesculapius, Apolo, Serapis. Se sa ishin të lidhura e të ndërthurura mjekësia profesionale me atë hyjnore, dëshmon edhe fakti që afër tempujve të Asklepit apo edhe në kuadër të vetë tempujve gjendeshin shkollat dhe bibliotekat e mjekësisë dhe se, sipas mitologjisë, Hipokrati, themeluesi i mjekësisë moderne, autori i 60 veprave mbi mjekësinë të përmbledhura në “Corpus Hippocraticum” si dhe autori i betimit të mjekëve, konsiderohej që ishte i biri i Asklepit.

Nga perënditë shërues edhe vetë perandorët shpeshherë kërkonin shpëtim nga të këqijat, siç ishte rasti me perandorin romak Titus (79-81 të erës sonë), gjatë sundimit të të cilit në Perandori kishin ndodhur disa fatkeqësi të njëpasnjëshme: shpërthimi i vullkanit Vezuv, një zjarr i madh i cili kishte kapluar qytetin e Romës, epidemia e tmerrshme e murtajes e disa fatkeqësi të tjera, e i cili në shenjë shprese për shpëtim i kishte vendosur shtatoret e Asklepit, Hygias dhe të hyjnive të ngjashëm nëpër hyrje-daljet e Romës dhe të qyteteve në Itali, por edhe nëpër provinca. Një gjë të ngjashme me qëllim mbrojtjeje nga një epidemi e tmerrshme, që e kishte përfshirë Romën gjatë sundimit të tij, e kishte bërë edhe perandori Klaudius (41-54 të erës sonë).

Kulti i Asklepit ishte i përhapur edhe nëpër provinca jashtë Italisë: në Gali, Germani, në Gadishullin Iberik, në Dalmaci, Daki, Traki, në Britani e Afrikë ku shpeshherë identifikohet me hyjni lokale (në Traki, p.sh. ishte i lidhur posaçërisht me kultin e kalorësit trakas). Ndoshta për shkak të mungesës së të dhënave, autorja me këtë rast nuk e ka trajtuar prezencën dhe përhapjen e kultit të hyjnive shërues në Dardani, gjë që në një ribotim eventual mund të plotësohet me të dhëna relevante nga studimet e autorit të këtij shkrimi (të botuara para publikimit të librit në fjalë): N. Ferri, *Shëndeti, mjekësia dhe kultet e hyjnive shërues në Dardaninë romake*; 2. *Uluslararası Balkanlarda Sosyal Bilimler Kongresi*, Prizren 30 maj-6 qershor 2010, f. 1513-1520 (botuar në gjuhën shqipe); dhe, N. Ferri, *Medicine, Health and Cults of Remedial deities in Roman Dardania*, -Albanological Researches 1/2015, Institute of Albanology, Prishtina 2015, 289-308 (në gjuhën angleze), në të cilët janë trajtuar hyjnitë greko-romak: Asklepi, Higyeia, Telesfori, Herkuli, Fortuna Salutaris, Nimfe Salutares, perënditë egjiptiane Isis e Serapis, pastaj hyji lokal dardan Jupiter Propulsator, hyjnitë ilire Medaurus, Tadenus e disa hyjni të tjerë të shërimit, kultet e të cilëve janë dëshmuar mbi baza të zbulimeve arkeologjike në trojet e banuara nga dardanët gjatë antikës.

Lidhur me këtë duhet theksuar gjetjet e gjurmëve të nderimit të kultit të Asklepit-Aeskulapit (së bashku me Telesforin e Hygian) të dëshmuara në Pejë e Prizren si dhe ato të kultit të hyjit egjiptian Serapis të dëshmuara në Zllakuqan, Dresnik e të Klinës e Llukavc të Thatë të Istogut, Fortuna Salutaris në Çiflak të Rahovecit, Jupiter Propulsator në Bajskë të Vushtrrisë etj.

Në një nënkapitull të veçantë autorja merret me rivalitetin e Asklepit me hyjin Serapis, të cilin si hyj sinkretik greko-egjiptian e kishin nderuar në fillim në Greqi e Egjipt e më vonë në Romë e anembanë botës antike, e që konsiderohej hyj shërues i lëndimeve traumatologjike ortopedike, por edhe të sëmundjeve të syve, të atyre gjinekologjike si dhe të infeksioneve të ndryshme, por edhe të shëndetit në përgjithësi. Përkundër shtrirjes së gjerë dhe të popullaritetit në popull, nderimi i kultit të Serapisit kishte mbetur në hije të kultit të Asklepit. Gjatë mesjetës, për të krishterët, një ndër objektet e ngjashme të lutjeve për shërim ka qenë (dhe është akoma) shtatorja prej bronci e Shën Pjetrit në bazilikën e tij në Vatikan, ku nevojtarët duke u lutur për shëndet njëkohësisht e lëmojnë shputën e këmbës së tij të djathtë, gishtërinjtë e të cilës, për shkak të lëmimeve e fërkimeve të shumta

gjatë shekujve të kaluara, janë tëholluar dhe kanë marrë pamjen e një tehu të thikës së mprehtë.

Përndryshe, nderimi i kulteve të hyjnive shëruese, por edhe të hyjnive të tjerë antikë me flijime e rite të tjera kanë lënë gjurmë edhe në besimin e krishterë dhe në atë islam, ku nevojtarët shkojnë e lutën, ndezin qirinj dhe lënë oferta nëpër kisha, apo luten e lënë “nezra” në të holla e oferta të tjera materiale si veshmbathje, ushqim posaçërisht hallvë e të ngjashme nëpër tyrbe (mauzole apo vetëm varre të thjeshta) e vende të tjera të ndryshme të kultit.

Naser FERRI

IN MEMORIAM

Akademik Zef MIRDITA (1936–2016)



Më 4 prill të vitit 2016, në moshën 80 vjeçare, në Zagreb u nda nga jeta, profesori, studiuesi, historiani dhe dardanologu i shquar Akademik Zef Mirdita, jeta dhe vepra e të cilit për vite të tëra ishte e lidhur me Universitetin e Prishtinës dhe atë të Kroacisë. Në të dyja fushat e aktiviteteve të tij, në kërkime shkencore dhe mësimdhënie, ka arritur rezultate të jashtëzakonshme dhe ka lënë gjurmë të thella, që do ti qëndrojnë gjithmonë. Pothuajse e tërë jeta e tij dhe puna shkencore ishte e lidhur, që nga rinia e deri në vdekje, në mes Kosovës dhe Kroacisë.

Zef Mirdita u lind në Prizren, më 13 mars 1936. Shkollën fillore dhe gjimnazin e ulët i kreu në vendlindje, kurse gjimnazin klasik në Pazin (Istër) dhe Zagreb. Në Fakultetin Teologjik të Zagrebit në vitin 1958 diplomoi në filozofi. Në vitin shkollor 1959/1960 u regjistrua në Degën e Historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit, në të cilin u diplomua më 8 korrik të vitit 1965. Gjatë viteve 1961 dhe 1962 ka qenë demonstrator i prof.dr.Jaroslav Šidakut, në Katedrën e Historisë Kroate, kurse si student i vitit III dhe IV të studimeve ka qenë ligjërues i lëndës së historisë në gjimnazin e mbrëmjes “Iso Kršnjavi” në Zagreb.

Pas diplomimit, kthehet në vendlindje, ku si profesor i gjimnazit të Prizrenit ligjëron lëndët: histori, sociologji, latinisht dhe frëngjisht, paraleleve shqipe, serbe dhe turke. Po ashtu, latinisht dhe sociologji ligjëron edhe në shollën e mesme të mjekësisë dhe në shkollën e mesme të muzikës. Gjatë semestri dimëror, në Fakultetin Filozofik u ligjëron latinishten studentëve të historisë dhe gjuhësisë, në gjuhën shqipe dhe serbe. Nga 1 janari i vitit 1967 kalon në Prishtinë, në Fakultetin Filozofik, si asistent i pavarur në Degën e Historisë – Koha e vjetër. Pasi që si student dhe pastaj si asistent, kishte publikuar studime të shumta në revista shkencore, u lirua nga studimet e magistraturës, gjë që i hapi rrugën që në nëntor të vitit akademik 1967/68, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit të praqes tezën e doktoraturës, e cila iu pranua më 1968, me titull “*Dardanci i Dardanija u antici*” (Dardanët dhe Dardania në Antikë), të cilën e mbrojti me sukses më 3 nëntor 1972 para komisionit, të përbërë nga akademikët: Mate Suić (kryetar), Duje Rendić-Miočević dhe Radoslav Katičić (anëtarë).

Më 20 prill 1973 promovohet në gradën e doktorit të shkencave historike (*docent*), nga viti 1978 *profesor inordinar* dhe më 1983 *profesor ordinar* i lëndës Historia e Kohës së Vjetër. Më 3 prill të vitit 1991 zgjedhet anëtar me korrespondencë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Për shkak të rrethanave të vështira politike në Kosovë në fillim të viteve ‘90 detyrohet të largohet nga Prishtina dhe të shkojë në Zagreb. Atje, me ftesë të drejtorit të atëhershëm Mirko Valentić punësohet (nga 1 marsi i vitit 1993 deri më 2004 kur pensionohet) në pozitën e këshilltarit shkencor në Institutin Kroat të Historisë, ku drejton projektin për vllëhët “*Vlasi – starobalkansko stanovništvo od povijesne pojave do danas*”. Që nga viti akademik 1997/98 në Fakultetin Pedagogjik të Osijekut “J.J.Strossmayer”, punoi në detyrën e profesorit ordinar për lëndën Historia e Kohës së Vjetër – Lindja e Lashtë.

Profesor Mirdita, nuk u ndal së studiuar dhe punuari asnjëherë. Në përpjekje të vazhdueshme për t’i zgjeruar njohuritë e tij, në gusht të vitit 1973 mori pjesë në gërmimet arkeologjike në Shqipëri (Pogradec), ku njëkohësisht do ti vizitojë të gjitha lokalitetet me rëndësi të Shqipërisë. Në vitin 1974 si bursistë i qeverisë italiane vazhdon specializimin në Departamentin e Historisë së Vjetër në Universitetin La Sapienza të Romës. Dy herë ishte bursist i Alexander von Humboldt-Stiftung nga Boni: 1 tetor 1976 -30 shtator 1977 (Heidelberg) dhe 1 tetor 1991-30 shtator 1992 (Mynih) për specializim në historinë e vjetër dhe në paleoallkanistikë - arkeologji. Nga viti 1980 deri 1990 ishte

anëtar i Komitetit Kombëtar të Jugosllavisë për Ballkanologji. Njëherësh ka qenë anëtar i redaksisë së disa revistave shkencore në Prishtinë dhe Zagreb si dhe anëtar i redaksisë kosovare për Enciklopedinë e Jugosllavisë. Gjatë tërë kohës, përveç veprimtarisë arsimore në Universitete të ndryshme, Zef Mirdita, ka marrë pjesë edhe në shumë kongrese shkencore kombëtare e ndërkombëtare (Bukuresht, Ankara, Beograd, Dubrovnik, Innsbruck, Palermo, Prishtinë, Zagreb, Tiranë, Sofje, Stuttgart etj).

Ka botuar më shumë se 100 studime shkencore, punime e artikuj, vlerësime, kritika e polemika të botuara në “Enciklopedija Jugoslavije”, “Hrvatska Enciklopedija”, si dhe në revista kombëtare e ndërkombëtare në gjuhën shqipe, kroate, frënge, gjermane dhe italiane.

Studimet e prof. Zef Mirdites përfshijnë një periudhë të gjerë kohore (nga parahistoria deri më sot), por që fokusohen në historinë e kohës së vjetër dhe në atë të mesjetës së hershme. Vëmendja e tij në studime është përqendruar kryesisht në Dardani dhe përgjithësisht në Ballkan. Në të vërtetë, pjesa më e madhe e kërkimit të tij shkencor i referohet historisë së ilirëve, veçanërisht historisë së dardanëve dhe Dardanisë. Me këtë temë ai u mor që në fillim të karrierës së tij shkencore, për tu thelluar gjatë punës së disertacionit të tij, të cilës i mbeti besnik gjatë tërë jetës. Vetëm disa muaj para se të kalonte nga kjo jetë, ai botoi një monografi me titull “Dradanci i Dardanija u antici, Hrvatski institut za povijest Zagreb 2015” (Dardanët dhe Dardania në Antikë), në të cilën i mblodhi rezultatet e shumë viteve të hulumtimit për këtë çështjeje.

Përveç një seri punimesh mbi historinë e Dardanisë dhe të dardanëve, ndërkohë, botoi monografinë “Religjioni dhe kultet e dardanëve dhe Dardanisë në kohën antike, Zagreb 2001”, në gjuhën shqipe dhe të njëjtën në vitin 2007 në gjuhën kroate. Derisa punonte në Universitetin e Prishtinës botoi një libër dedikuar antroponimisë dardane në kohët romake “Antroponimia e Dardanisë në kohën romake, Prishtinë 1981” në shqip dhe gjermanisht. Nga veprat studimore të tij, duhet përmendur edhe: “Krishtenizmi ndër shqiptarë”, Prizren-Zagreb 1998”, “Mitet dhe mitologjia në Antikë – funksioni dhe trajtimi i tyre, Prishtinë 1988”, “Studime dardane, Prishtinë 1979”, etj. Një kontribut të rëndësishëm Zef Mirdita ka dhënë në hulumtim e një fenomeni historik të Ballkanit, *vllëhet*, një çështje jashtëzakonisht komplekse dhe e ndjeshme në historiografi. Përveç disa punime shkencore nga kjo çështje, rezultati kryesor në këtë fushë është publikimi i dy

monografive: “Vlasi u historiografiji, Zagreb 2004” dhe “Vlasi: starobalkanski narod (od povijesne pojave do danas), Zagreb 2009”.

Një tematikë tjetër mjaftë e gjerë, të cilës i ka kushtuar vëmendje të konsiderueshme në studimet e tij është historia e krishterimit në mesin e shqiptarëve dhe për këtë ka botuar fillimisht një libër “Historia e Kishës në popullin shqiptar: material për historinë e Kishës Kombëtare në Institutin Katekistik Kombëtar në Shkodër, 1994”, pastaj veprën e përmendur më lartë “Krishtenizmi ndër shqiptarë”, një sintezë e plotë dhe përmbajtësore kushtuar lindjes dhe zhvillimit të krishterimit në mesin e shqiptarëve.

Sipas miqve të tij, prof. Zefi, edhe në muajt e fundit të jetës së tij, kishte në dorë duke përgatitur një monografi në gjuhën kroate kushtuar Kishës Katolike në mesin e shqiptarëve. Ndër punimet e tij në këtë fushë të hulumtimit mund të përmendim: “Alcuni aspetti del christianesimo fra gli Albanesi in epoca bizantina” në përmbledhjen e punimeve *Le minoranze etniche e linguistiche. Atti del 2^o Congresso Internazionale Piana degli Albanesi 7 – 11. Settembre 1988*, “Katolicizmi dhe ortodoksia te shqiptarët”, në *Buletini i Fakultetit Filozofik të Prishtinës* XX (1990), “Kulturnoprosvjeta i znanstvena djelatnost isusovaca među Albancima” në përmbledhjen e punimeve nga simpoziumi ndërkombëtar *Isusovci na vjerskom, znanstvenom i kulturnom području u Hrvata* (Zagreb – Beč, 1992.), “Vicko Zmajević i njegovo zauzimanje za Albance katolike (25. 12. 1670. – 11. 09. 1745.)” në *Zborniku Stjepanu Antoljaku u čast* (Zagreb, 2003.), “Das Christentum und seine Verbreitung in Dardanien”, në *Balkanica* IV (1973), “Gjashtë shekujt e parë të krishtenizmit në trevat iliro-shqiptare”, në simpoziumin ndërkombëtar *Krishterimi ndër shqiptarë: Tiranë 16-19 nëntor 1999* (Shkodër 2000), “Krishterimi ndër shqiptarë – riti ortodoks”, në *Malësia* 10 (Podgoricë 2015), etj.

Për kontributin e veçantë të dhënë në albanologji, në vitin 2004 Akademik Mirdita u dekorua nga presidenti i Shqipërisë, Alfred Moisiu. Më 21 dhjetor 2011, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Republikës së Kosovës e shpalli shkencëtar të vitit 2011. Në vitin 2005 mori çmimin vjetor të Akademisë Kroate të Shkencave dhe Arteve për arritje të larta shkencore dhe artistike në kategorinë e shkencave filologjike për librin “Vlasi u historiografiji Zagreb, 2004”. Disa muaj para vdekjes, po ashtu ka marrë dy çmime: Medaljen Presidenciale të Meritave të Republikës së Kosovës dhënë nga presidentja Atifete Jahjaga dhe certifikatën e meritës “Milan Šufflay” për “kontribut të

shquar në studimin e lashtësisë së ilirëve dhe shqiptarëve të kohës moderne” nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kroaci.

Mbesim me shpresë se gjenerata e tashme dhe ajo e ardhshme do ta ndjekin rrugën shkencore të trasuar nga Akademik Zef Mirdita, kurse vepra dhe puna e tij të na shërbej si një shembull i shkëlqyer dhe motiv për kërkime të mëtejme.

Gjon BERISHA

Prof.dr.Tahir Abdyli (1942-2015)



Me 14 shkurt 2015, pas një sëmundje të gjatë e të rëndë në Prishtinë u shua Prof.dr.Tahir Abdyli, historiani i mirënjohur shqiptar dhe drejtori shumë vjeçar i Institutit të Historisë në Prishtinë. Tahir Abdyli u lindi me 5. II. 1942 në fshatin Kerninë të Istogut. Shkollën fillore e kreu në Rakosh, ndërsa të mesmen në Pejë. Në vitin 1969 diplomoi në Fakultetin Filozofik- Dega e Historisë në Prishtinë. Studimet e shkallës së tretë i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku dhe mbrojti me sukses temën e magjistraturës: “Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1900-1903”. Doktoroi me temën Zhvillimi i industrisë në Kosovë, në vitin 1978, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Kosovës në Prishtinë.

Punoi si arsimtar i historisë në Rakosh të Istogut, dhe në Prishtinë deri me 1974. Puna e zellshme në arsim dhe përkushtimi serioz në punë e bënë të njohur të respektuar dhe të dashur për nxënësit dhe qarqet intelektuale të kohës. Nga viti 1975 e deri në vitin 1981 punoi si zëvendës sekretar në Bashkësinë Krahinore për Punë Shkencore të Kosovës. Me rekomandimin e Akademik Ali Hadrit u emërua drejtor i Institutit të Historisë së Kosovës në Prishtinë. Udhëhoqi me sukses dhe dinjitete këtë institucion të rëndësishëm shkencor e kombëtar në vitet më të vështira të zhvillimeve politike në Kosovë (1981- 1990).

Tahir Abdyli me punën dhe angazhimet e tij tashmë ishte bërë emër i njohur për veprimtarinë arsimore dhe shkencore. Në kohën sa ishte drejtues i Institutit të Historisë organizoi shumë sesione e konferenca shkencore të cilat kishin për synim të afirmimit dhe dokumentimit të vërtetën historike dhe lashtësinë e pandërprerë të popullatës shqiptare si shumicë në këto treva. Organizoi, udhëhoqi dhe realizoi një numër të madh të projekteve shkencore me rëndësi të veçantë për historinë shqiptare.

Gjatë kësaj periudhe menaxhoi dhe shkroi studime dhe monografi me peshë të madhe dhe me ndikim pozitiv në zhvillimet aktuale të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për liri dhe bashkim kombëtar si: Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1900- 1903, si dhe monografitë për Hasan Prishtinën dhe Isa Boletinin, si dhe shumë studime të tjera përfshirë këtu edhe temën e tij të doktoraturës: Zhvillimi i Industrisë në Kosovë. Prof. dr. Tahir Abdyli ka shkruar dhe botuar edhe shumë punime nëpër revista shkencore në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja. Duhet veçuar sidomos polemikat e tij me historianët serbë.

Këto shkrime dhe qëndrimi vertikal e i pathyeshëm i tij ndaj pushtetit okupues, nacional shovinist serbë, bëjnë emrin dhe veprën e Prof. Dr. Tahir Abdylit të pavdekshme dhe krenare për familjen, kolegët në Institutin e Historisë dhe mbar popullin shqiptar në Kosovë, Shqipëri dhe në të gjitha trevat e tjera etnike shqiptare.

Haki KASUMI

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË, GJATË VITIT 2016

Aktivitetet shkencore

Instituti i Historisë “*Ali Hadri*”-Prishtinë, në bashkëpunim me Instituti Albanologjik të Prishtinës dhe Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës, më 29 shkurt dhe 1 mars 2016, organizuan në Prishtinë Konferencën Shkencore: “*Veprimtaria atdhetare dhe intelektuale e Adem Demaçit*”, për nderë të 80-vjetorit të lindjes së atdhetarit Adem Demaçi. Në këtë Konferencë me kumtesa u paraqitën studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, të cilët trajtuan veprimtarinë atdhetare e intelektuale, të Adem Demaçit, duke përfshirë kontributin e tij në jetën politike, në fushën e letërsisë si dhe atë humanitare etj. Organizimi i Konferencës Shkencore: “*Veprimtaria atdhetare dhe intelektuale e Adem Demaçit*”, u mbështet nga Ministria e Drejtësisë.

Fjalën e hapjes e mbajti prof. assoc. dr. Sabit Sylja, drejtor i Instituti të Historisë “*Ali Hadri*”-Prishtinë. Në këtë Konferencë Shkencore me kumtesa u prezantuan 42 studiues. Punimet e Konferencës ishin të ndara në katër seanca. Në seancën e parë u lexuan këto kumtesa: Kudusi Lame, “*Parimet themelore të filozofisë së jetës së Adem Demaçit*”; Ramë Buja, “*Binarët drejt çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës*”; Jakup Krasniqi, “*Adem Demaçi, udhërrëfyes i atdhetarisë*”; Hydajet Hyseni, “*Adem Demaçi dhe strategjia e padhunshme politike*”; Meriman Braha, “*Adem Demaçi dhe plejada e atdhetarëve pararendës*”; Bajram Kosumi, “*Filozofia kombëtare e politike e Adem Demaçit*”; Albin Kurti, “*Adem Demaçi dhe përfaqësimi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*”, Emin Kabashi, “*Adem*

Demaçi - mendësi e luftës për liri kombëtare"; Agim Zogaj, *"Vizioni politik i Adem Demaçit"*; Ibrahim Gashi, *"Lufta e Ftohtë dhe çështja e Kosovës, sipas Demaçit"*, Behxhet Shala, *"Kontributi i Adem Demaçit në Këshillin për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut"*.

Në seancën e dytë u lexuan këto kumtesa: Sabit Syla, *"Dimensioni historik i figurës së Adem Demaçit"*; Paskal Milo, *"Figura e Adem Demaçit në arkivat e Shqipërisë komuniste"*; Selatin Novosella, *"Gjykimi i Parë i Adem Demaçit (1958)"*; Sabile Keçmezi-Basha, *"Programi i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve"*; Hakif Bajrami, *"Gjykimi i Dytë i Adem Demaçit (1964)"*; Ismet Salihu, *"Gjykimi i Tretë i Adem Demaçit (1975)"*; Ismet Hajrullahu, *"Adem Demaçi, pararendës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës"*; Izber Hoti, *"Historia në shkrimet e Adem Demaçit"*; Qerim Lita, *"Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve në burimet sekrete maqedonase"*; Shkëlzen Gashi, *"Adem Demaçi dhe Konferenca e Rambujesë"*; Ibish Neziri, *"Adem Demaçi në burgun e Stara Gradishkës"*.

Në seancën e tretë u lexuan këto kumtesa: Sadri Feti, *"Romanet e Adem Demaçit"*; Agim Vinca, *"Për Bacën shkrimtar"*; Shefkije Islama, *"Ligjërimi artistik në prozën e Adem Demaçit"*; Isak Shema, *"Proza e pabotuar e Adem Demaçit"*; Hysen Matoshi, *"Adem Demaçi në historinë e letërsisë shqipe"*; Fadil Grajçevci, *"Adem Demaçi në revistën letrare 'Jeta e re'"*; Myrvete dhe Begzad Baliu, *"Femra në romanet e Adem Demaçit"*; Sali Bytyqi, *"Adem Demaçi në vargje"*; Adem Zejnullahu, *"Adem Demaçi në këngët popullore"*; Teki Kurti, *"Shtypi i Shqipërisë mbi kontributin e Adem Demaçit"*; Pren Buzhala, *"Publicistika e Adem Demaçit"*; Sejdi Gega, *"Adem Demaçi në shkrimet e gazetës 'Zëri i Kosovës'"*.

Në seancën e katërt u lexuan këto kumtesa: Resmie Kryeziu, *"Dekoratat, çmimet, mirënjohjet dhe falënderimet për Adem Demaçin"*; Arben Hoxha, *"Demaçi - Epistema kombëtare në kontekstin e kolonializmit jugosllav"*; Daut Dauti, *"Adem Demaçi në Foreign Office anglez"*; Haki Kasumi, *"Binomi Adem Demaçi dhe Ukshin Hoti"*; Hamdi Thaçi, *"Adem Demaçi dhe Fazli Grajçevci"*; Skender Asani, *"Reflektimi i ideve të Adem Demaçit në orientimet politike të shqiptarëve të Maqedonisë"*; Arsim Sinani, *"Adem Demaçi dhe shqiptarët e Maqedonisë"*; Ismet Jonuzi, *"Figura e Adem Demaçit, metaforë lirie tek të burgosurit shqiptarë në Pollog"*; Mehmetali Rexhepi, *"Demaçi në veprat e Selatin Novosellës"*.

Fjalën e mbylljes së Konferencës Shkencore e mbajti prof.dr.Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik-Prishtinë.

Më 1 qershor 2016, me rastin e 70-vjetorit të mbajtjes së Kongresit II (IV) të NDSH-së në Shkup, u mbajt Konferenca Shkencore: “70-vjetori i Kongresit II (IV) i NDSH-së në Shkup”, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë. Fjalët përshëndetëse në këtë Konferencë i mbajtën drejtori i Institutit për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dr.Skender Asani, drejtori i Institutit të Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, prof.asoc.dr. Sabit Syla.

Konferenca në fjalë u mbajt në Shkup, në të cilën morën pjesë 12 studiues, nga Kosova dhe Maqedonia, duke prezantuar këto referate: Sabile Keçmezi-Basha, “*Formimi dhe veprimtaria e NDSH-së (1945-1947)*”; Qerim Lita, “*Organizimi dhe mbajtja e Kongresit II (IV) të NDSH-së në Shkup*”; Skender Asani, “*Komiteti i NDSH-së për qytetin e Shkupit dhe veprimtaria e Ibrahim Haki-Kelmendit*”; Sabit Syla & Izet Miftari, “*Rezistenca kundër vendosjes së pushtetit komunist në rajonin e Shalës së Bajgores (1944-1947)*”; Haki Kasumi, “*Veprimtaria atdhetare e Gjon Serreqit*”; Daut Bislimi, “*Veprimtaria dhe ndikimi i Halim Oranës në Kongresin II të NDSH*”; Ibrahim Gashi, “*NDSH-ja në rajonin e Drenicës*”; Izber Hoti, “*Organizata No. 2. dhe Ajet Gërguri*”; Naim Halimi, “*Historiografia shqiptare dhe e huaj për dhe rreth NDSH-së*”; Nuridin Ahmeti, “*Kontributi i krerëve fetarë nga Kosova në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare*”; Sevdail Demiri, “*Arrestimet dhe gjykimet e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së së Kumanovës në vitin 1946*”; Ismet Kroci, “*Dëshmi të reja për aktivitetin e anëtarëve të Komitetit të NDSH-së për qarkun e Tetovës*”.

Më rastin e 106-vjetorit të lindje së Nënë Terezës-Gonxhe Bojaxhiut, dhe në prag të shenjtërimit të saj, më 26 gusht 2016, në Shkup u hap ekspozita: “*Shenjtoria nga Shkupi - korrespondenca*”, nga Instituti për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në bashkëpunim me Shoqatën e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë, Institutin Shqiptar në St. Galen të Zvicrës, Arkivin Shtetëror të Lucernit në Zvicër, Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar në Tiranë, Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë dhe Shoqatën Zvicër-Shqipëri.

Koordinatori i projektit, të kësaj ekspozite dr. Skender Asani, mbajti një fjalë rasti, pastaj me fjalë përshëndetëse u paraqitën edhe zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, dr.

Festim Halili, ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Shkup, z. Fatos Reka, ambasadori i Republikës së Kosovës në Shkup, z. Ylber Hysa, pastaj dr. Izer Maksutin, foli në emër të Institutit Shqiptar në St. Galen të Zvicrës, Arkivit Shtetëror të Lucernit dhe Shoqatës Zvicër-Shqipëri, drejtori i Arkivit Qendror të Shtetit Shqiptar në Tiranë, z. Gjet Ndoj, si dhe njëri nga përfaqësuesit e komunitetit shqiptar-katolik të Shkupit dhe njohës i jetës e veprës së Nënë Terezës, z. Anton Sereçi. Ndërsa, grupi “Duo Skupi” i përbërë nga Ermal Mehmeti në violinë, dhe Jeta Starova-Mehmeti në flaut, u paraqitën me dy përpunime nga këngë të vjetra shqiptare.

Ekspozita “*Shenjtoria nga Shkupi - korrespondenca*”, përveç Shkupit ishte paraparë që të hapej edhe në Konsullatën e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Nju Jork, Prishtinë, Tiranë, Bazel dhe qendra të tjera të rëndësishme evropiane e botërore.

Promovimet:

Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë- Tiranë, dhe Institutin për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, 22 janar 2016, promovuan në Shkup përmbledhjen me kumtesa e materiale nga Konferenca Shkencore, mbajtur më 5 qershor 2015, në Prishtinë, “*Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*”. Promovimi i kësaj përmbledhje me kumtesa u promovua në Shkup me rastin e ngritjes së shtatores së Isa Boletinit në komunën Saraj të Shkupit.

Në këtë promovim një fjalë përshëndetëse e mbajti pinjolli i familjes së Isa Boletinit, z. Gazmend Boletini, si dhe kryetari i Komunës së Sarajt të Shkupit, Bekim Murati.

Ndërsa, drejtori i Institutit të Historisë së Prishtinës, prof. dr. Sabit Sylja, dhe drejtori i ITSHKSH-së, doc.dr. Skender Asani, në fjalët e tyre përshëndetëse çmuan lart figurën e Isa Boletinit dhe përmbledhjen me materiale “*Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*”. Rreth përmbajtjes dhe rëndësisë së librit folën prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha nga Instituti i Historisë së Prishtinës, dhe doc. dr. Sevdail Demiri nga ITSHKSH-Shkup. Libri “*Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*” u botua me rastin e 100-vjetorit të rënies së Isa Boletinit.

Veprimtaria botuese:

Gjatë vitit 2016 Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, në kuadër të veprimtarisë botuese nxori këto botime:

1. Teuta Shala-Peli, “Drishti në Mesjetë”. Monografia “Drishti në Mesjetë”, ka për objekt

studimi qytetin mesjetar të Drishtit, duke përfshirë aspekte të ndryshme të zhvillimit historik, shoqëror, ekonomik, kulturor e politik të këtij qyteti, që nga koha e formimit si qytet e deri tek rënia e tij nën sundimin osman. Qëllimi i kësaj monografie është që të vë në pah rëndësinë dhe rolin e këtij qyteti mesjetar, si dhe transformimin e tij nga një qendër dikur e rëndësishme, në një fshat të harruar dhe të lënë nën mëshirën e fatit.

2. Vëllimet me dokumente: “Agjencia Shtetërore Informative “Kosovapress” - Arkivi i Luftës”, dy vëllime (3,4) e përgatitur nga Berat Luzha. Vëllimi i tretë pasqyron materialet e publikuara në periudhën kohore prej 11 prillit deri më 15 maj të vitit 1999, ku trajtohen ngjarje të shumta të luftës në Kosovë, por edhe të veprimeve të shumta e të ndryshme në arenën ndërkombëtare lidhur me Kosovën.

Vëllimi i katërt përfshin periudhën kohore 16 maj-17 qershor 1999, periudhë kjo kur lufta po shkonte drejt fundit të saj. Luftimet mes njësiteve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave serbe, sikur edhe fushata e bombardimeve e NATO-s mbi caqet e forcave serbe, po intensifikoheshin. Vëllimi i katërt “Agjencia Shtetërore Informative “Kosovapress” - Arkivi i Luftës”, i pasqyroi në mënyrën më të mirë të mundshme këto zhvillime, që ishin kulmi i përpjekjeve dhe i realizimeve të popullit tonë në shekuj dhe falë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila diti dhe munda ta fitojë lirinë e shumëpritur.

3. Sabile Keçmezi-Basha, “Kosova 1945-1990 (Vështrim historiko-politik)”, trajtohet periudha kohore 1945-1990, që është edhe periudha më e ndjeshme për shqiptarët, të ngelur nën okupimin jugosllav. Libri në fjalë, fillon me trajtimin e problemeve duke filluar me programet e elaboratet serbe antishqiptare, për të vazhduar me aneksimin e Kosovës nga Serbia, i cili ishte vetëm një pjesë e padrejtësisë që u bëhej shqiptarëve në Jugosllavinë komuniste, për të përfunduar me suspendimin e autonomisë së Kosovës.

4. “Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944-1945)” (përmbledhje studimesh), kjo përmbledhje studimesh nga Konferenca Shkencore: “Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufta e Drenicës (1944 -1945)”, përfshinë 19 punime shkencore. Kjo

përmbledhje me punime ka për qëllim ta ndriçojë rezistencën gjithëshqiptare kundër ripushtimit jugosllav, në veçanti atë të Drenicës, në fund të Luftës së Dytë Botërore, kur zgjedha mbi popullsinë shqiptare e nacionalizmit agresiv sllav u kombinua me diktaturën komuniste në aspekte të shumta.

5. Iljaz Rexha, “Vendbanimet dhe popullsia albane e Kosovës sipas defterëve osmanë të shekullit XV”, Prishtinë 2016. Ky studim, përveç në burimet fragmentare, të pakta sllave, të shekujve XIII-XIV dhe të dy regjistrave përmbledhës të Arkivit të Raguzës (1411-1438), kryesisht bazohet në të dhënat e regjistrave kadastralë të shekullit XV, të hartuar nga administrata osmane për qëllime ekonomike, pronësore dhe fiskale, ku janë regjistruar me përpikëri të gjithë kryefamiljarët me emrat dhe patronimet e tyre heterogjene, si taksapagues me të ardhurat e tyre në të gjitha vendbanimet mesjetare, urbane dhe rurale në territorin e Kosovës. Studimi ka për qëllim kryesorë të trajtojë dhe analizojë përkatësinë fetare dhe etnike të kryefamiljarëve që mbanin antroponime dhe patronime karakteristike dhe tradicionale shqiptare me forma të shqipes të cilët ishin në simbiozë me emra sllavë, si pasojë e sllavizmit të antroponimisë së tyre gjatë sundimit mesjetar, sllavo-bullgar dhe sllavo-serb, në Kosovë. Libri, përmban dhe një CD me të gjitha dokumentet që përmenden në të.

6. Kosova nr. 41 (2016), revistë shkencore e Institutit të Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, e cila përfshinë 15 *punime shkencore*, tri *recensione*, dy *in memoriam*, si dhe *materiale dhe dokumente*.

7. Hajrush Kurtaj, “Flakë e pa shuar”, Prishtinë, 2016. Ky libër përfshin biografitë e 94 dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga komuna e Kaçanikut, që kishin rënë në fushëbetejat nga Kosharja, Reçaku, Jezerci e deri në shkrepat e Sharrit. Libri ka për qëllim që të vë në pah veprimet ushtarako-luftarak të këtyre trimave të lirisë në territorin e gjerë të Kaçanikut, të cilët të vetëdijshëm për misionin e tyre historik, kishte për qëllim e synim parësor çlirimin nga ekspansionizmi serbo-çetnik. Këtë program luftarak, qëllim themelor ushtarët e lirisë të cilëve u dhimbsej kombi në të gjitha trevat shqiptare, e përpunuan në hollësi e strategji ushtarake dhe e vunë në zbatim si detyrë të shenjtë atdhetare.

8. Limon Rushiti, “Lëvizja Kaçake në Kosovë, 1918-1928”, Prishtinë 2016 (Ribotim). Me rastin e ribotimit të kësaj monografie autori i librit i ka kushtuar vëmendje plotësimit të këtyre problemeve, si: Zona Neutrale e Junikut, Masakra në zonën e Llapit-Prapashticës, e janarit 1921, e cila është plotësuar me materiale nga arkivat britanike,

Masakra e fshatit Kabash të Prizrenit e 16 marsit 1913. Po ashtu, libri është plotësuar edhe me regjistrat e personave të shpallur kaçakë nga ana e shtetit në periudhën 1941, dhe më 1922, sipas qarqeve, rretheve e komunave. Gjithashtu autori ka bërë plotësimin e librit më fotografi të kohës dhe personazheve të Lëvizjes Kaçake.

9. Frasher Demaj, “Mulla Zekë Bërdynaj, intelektual, atdhetar e prijës fetar”, Prishtinë 2016. Autori në këtë botim monografik trajton personalitetin dhe kontributin atdhetar të Mulla Zekë Bërdynaj që nga rinia e hershme e deri në momentet e fundit të jetës së tij me 12 janar 1987. Zekë Bërdynaj ishte mësues, hoxhë, intelektual dhe atdhetar. Ai në vitin 1938 hapi mejtepin në të cilin i mësonte nxënësit për fenë, për historinë shqiptare për gjuhën, letrësinë dhe fusha tjera të dijes. Mori pjesë në shumë luftëra e beteja kundër pushtuesve serb e malazez si dhe njesive çetnike e partizane në mbrojtje të kufirit e popullates shqiptare. Betejat më të njohura ku mori pjesë Mulla Zeka janë: Lufta e Pazarit të Ri, Kolashinit, Kacuberrit Smilevicës etj. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore ai u dënua me 14 burgim të rendë prej te cilat i mbajti në Burgun e Pejës, të Nishit dhe në Burgun famëkeq të Goli Otokut. Pas lirimimit nga burgu e deri në momentet e fundit të jetës u përkushtua për shkollimin e vajzave dhe djemëve sepse emancipimin dhe shkollimin e shqiptarëve e konsideronte si armë të forte në perpjekjet e popullit shqiptar për liri e bashkim kombëtar.

10. ФРАШЪР ДЕМАЙ, “ВЕЛИКОБРИТАНИЯ И АЛБАНСКИЯТ ВЪПРОС, (1875-1913)” në shqip: Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913. Përkthyes dhe botues: Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, Universiteti i Sofjes dhe Ballkanski Naucen Institut-Sofje. Në këtë studim të përkthyer në bullgarisht autori trajton qëndrimin e diplomacisë britanike ndaj çështjes shqiptare në periudhën 1875-1913. Një vemendje e veçantë brenda këtij studimi i kushtohet disa momenteve të rëndësishme të historisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare me fokus të veçantë diplomacisë së Mbretërisë së Bashkuar e cila përbënte njërin nga gjashtë fuqitë e mëdha. Ky botim i dedikohet auditorit bullgarisht folës, posaçërisht studentëve, profesorëve dhe studiuesve bullgar të Universitetit të Sofjes dhe universiteteve tjera bullgare si dhe të institutive kërkimore shkencore. Përkthimi i autorit Frashër Demaj në bullgarisht shënon vargun e arritjeve të studiuesve dhe punonjësve shkencor të Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.

Marrëveshje bashkëpunimi:

Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, gjatë vitit 2016, Instituti i Historisë “*Ali Hadri*” ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, me Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe me Bartësin e Arsimit të Lartë, Kolegjin AAB në Prishtinë.

Fushëveprimtaria e këtyre marrëveshjeve përfshinë sfera të ndryshme, si: bashkëpunime për punë të përbashkëta kërkimore-shkencore dhe akademike; krijimin këshillave koordinues për bashkërendimin e punës kërkimore-shkencore; organizimin e veprimtarive shkencore në interes të dy institucioneve si: konferenca dhe simpoziume të përbashkëta për ngjarje dhe personalitete historike; botime të përbashkëta nga fusha e historiografisë; botimin e studimeve dhe artikujve shkencor në revistat shkencore; këmbimin e materialeve arkivore dhe literaturë shkencore; ofrimin e ndihmës së ndërsjellë për studiuesit për të lehtësuar punën në kryerjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore; pjesëmarrjen e studiuesve në projekte të përbashkëta të dy institucioneve respektive, etj.

Teuta SHALA-PELI

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË

KOSOVA

41/2016

Redaktore gjuhësore: Shqipe Doda

Rezimetë i përktheu: Selve Islami

Tirazhi 300 copë